



ISBN 978-9928-210-18-0

ISSN 2413-1334

Konferenca VI Shkencore Ndërkombëtare

VËLLIMI I KATËRT



Policimi dhe **SIGURIA**

Fenomenet ekstreme të natyrës
dhe çështjet e sigurisë

QERSHOR
2021

PROCEEDINGS
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021



KONFERENCA VI NDËRKOMBËTARE

Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë

PROCEEDINGS

Vëllimi IV

Botimi u realizua me mbështetjen e
United Nations Development Programme
(UNDP Albania)



© - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të së drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë :
konferenca VI ndërkombëtare : proceedings / Akademia
e Sigurisë ; red. shkenc. Albert Hitoaliaj. - Tiranë :
Akademia e Sigurisë, 2021
Vol. 4, 185f. : 16.5X24cm.
ISBN 978-9928-210-18-0

1.Siguria kombëtare 2.Policia 3.Konferenca

351.74 (062)

NR **24**
QERSHOR
2021

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA

Dr. Frank HARRIS

Dr. Albert HITOALIAJ

Redaktor shkencor
Dr. Albert HITOALIAJ

Punimet grafike
MP Andi OSMANI

Realizimi teknik
Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

AKADEMIA E SIGURISË
ISBN 978 - 9928 - 210 - 18 - 0
ISSN 2413 - 1334

KONFERENCA VI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
"Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë"

Komiteti shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i Bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Kriminolog

Anëtarë/Members

Prof. Dr. Xhovani ARCUDI

Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali

Prof. Dr. Vasilika HYSI

Kriminologe, ligjvënëse

Prof. Dr. Artan HOXHA

Rektor i Universitetit të Tiranës

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

Prof. Dr. TIINA KOIVUNIEMI

Drejtuuese e projektit të BE-së, "Forcimi i Kapaciteteve dhe

Efikasitetit të Akademisë së Sigurisë" 18 IPA JH 01 19"

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë

Prof. Dr. Laura TAFARO

Profesor, Universiteti i Barit, Itali

Prof. Dr. Petrit ZORBA

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), Tiranë

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA

Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali

Prof. Dr. Ethem RUKA

Rektor, Universiteti "Luarasi"

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIAJ

Drejtori i Politikave të Sigurisë në Ministrinë e Brendshme.

Dr. Bilbil MEMAJ

Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Dr. Xhavit SHALA

Drejtori i Qendrës Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Dr. Frank HARRIS

University of Portsmouth

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Dekan i Fakultetit të Sigurisë, Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Prof. Asc. Dr. Zaho GOLEMI

Shefi i sektorit të kërkimit shkencor, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Dr. Albert HITOALIAJ

Shefi i sektorit të botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë.

AKADEMIA E SIGURISË
ISBN 978 - 9928 - 210 - 18 - 0
ISSN 2413 - 1334

KONFERENCA VI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
"Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë"

Komiteti organizator/Organizational Committee

Kryetar/Chair

Dr. Bilbil MEMAJ, Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Zëvendëskryetarë

Dr. Xhavit SHALA, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Anëtarë/Members

Z. Haki ÇAKO

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Dr. Bajram IBRAJ

Akademia Profesionale e Biznesit

Z. Malfor NURI

Administrator i Përgjithshëm TAP Albania

Dr. Elton Qendro

Prezenca e OSBE-së, Shqipëri

MSc. Elvita KABASHI

UNDP, Shqipëri

MSc. Klajdi NIKOLLA

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Prof. Dr. Laura TAFARO

Profesoreshë, Universiteti i Barit, Itali

Prof. Asc. Dr. Rezana KONOMI

Dekan i Fakultetit Juridik, Universiteti "Luarasi"

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA

Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali

Dr. Artur BEU

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Koordinatorët / Coordination

Dr. (proc.) Gjon VORFI, Koordinator i përgjithshëm, QKSH, Akademia e Sigurisë

Dr. (proc.) Anisa HYSESANI, Koordinatore, QKSH, Akademia e Sigurisë

MSc. Qetësor GURRA, Koordinator, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

MP. Andi OSMANI, Koordinator, Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Punimet grafike

MP. Andi OSMANI, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Realizimi teknik: Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2021



**AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE**

KONFERENCA VI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
FENOMENET EKSTREME TË NATYRËS DHE ÇËSHTJET E SIGURISË

Në bashkëpunim me:

Projektin e Binjakëzimit, financuar nga BE, "Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë", 18 IPA JH 01 19, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Universitetin e Romës "Tor Vergata", Universitetin "Luarasi", Tiranë, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Universitetin Polis, Tiranë,



dhe me mbështetjen e:

Trans Adriatic Pipeline,
United Nations Development Programme (UNDP) Albania,
Prezencës së OSBE-së Shqipëri,



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Akademia e Sigurisë, organizon
konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë".

31 maj 2021, Tiranë

Përmbajtja

FJALËT PËRSHËNDETËSE NË HAPJEN E KONFERENCËS VI

Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë, Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ

«Nuk ka fenomen ekstrem të natyrës ku nuk ndihet gjithëpërfshirja e strukturave ligjzatuese shtetërore, e sidomos, e Policisë së Shtetit» 10

Zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë, Prof. Dr. Vasilika HYSI

«Vlerësoj energjitë dhe përkushtimin e stafit të Akademisë së Sigurisë, për kërkime shkencore dhe tematikat e përzgjedhura që janë të prekshme dhe të nevojshme të adresohen» 14

Zëvendësministri i Brendshëm, z. Julian HODAJ

«Ndihej i kënaqur që Akademia hedh një tjetër hap cilësor në kontributin shkencor në fushën e sigurisë». 18

Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit,

Drejtues i Lartë Albert DERVISHAJ

«Organizimi i kësaj konference, në këto momente, ka një rëndësi të veçantë për Shqipërinë» . . . 22

Head of the OSCE Presence in Albania, Ambassador Vincenzo Del MONACO

«Security has a multidimensional character, and it is in this spirit that I commend the Security Academy for this important event» 26

Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasador Vincenzo Del MONACO

Tirana, përballë krimit mjedisor, për të siguruar mjedisin e duhur për çdo qytetar të saj 28

Vice capo della Polizia di Stato, direttore centrale della Polizia criminale, Prefetto Vittorio RIZZI

«L'idea che lancia in questa sede è quella di arricchire l'ampio ventaglio della nostra cooperazione di polizia con un tavolo di confronto sui fenomeni criminali emergenti nella post-pandemia». 30

Zëvendëshefi i Policisë Italiane, drejtor i Drejtorisë Qendrore të Policisë Kriminale Italiane, z. Vittorio RIZZI

«Ideja që po jap në këtë takim, është ajo e pasurimit të mëtejshëm të bashkëpunimit tonë policor, mbi fenomenet kriminale emergjente, post-pandemi». 34

UNDP Resident Representative, Mrs. Limya ELTAYEB

«I strongly believe that academic and research work is very important for raising awareness and providing solutions to the many challenges of security». 38

Rezidente e Përhershme e UNDP, znj. Limya ELTAYEB

«Besoj fuqimisht se puna akademike dhe kërkimore është shumë e rëndësishme për sigurimin e zgjidhjeve të shumë sfidave të sigurisë» 42

Kryetar i Bashkisë së Tiranës, z. Erlon VELIAJ

«Të tilla organizime na ndihmojnë ta ngremë debatin nga niveli i thashethemeve dhe i “fake news”, në nivel akademik dhe shkencor » 46

Këshilltar Rezident i “Binjakëzimit”, PhD Tiina KOIVUNIEMI

«Unë jam e sigurt që Akademia ka një të ardhme të madhe përpara, dhe ajo është e gatshme të bashkohet me familjen e policisë evropiane» 48

Resident Twinning Advisor, PhD Tiina KOIVUNIEMI

«I am sure that the Academy has a great future ahead of it and, as a result of its active development work, it is ready to join the family of European police» 52

Administrator i “TAP Albania”, z. Malfor NURI

«Të lumtur që rikthehem në këtë konferencë ndërkombëtare të sigurisë» 56

Drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, z. Haki ÇAKO

«Përcjell ndjesinë e respektit për punën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të stafit të Akademisë së Sigurisë» 58

Përfundime dhe rekomandime të konferencës VI

Dr. Xhavit SHALA, prof. asc. dr. Idriz HAXHIAJ, dr. Albert HITOALIAJ, prof. asc. dr. Qetsor ORHAN, prof. asc. dr. Zaho GOLEMI, dr. Bajram IBRAJ, prof. asc. dr. Bejtush GASHI, dr. Dorian KOÇI

Përfundime dhe rekomandime të konferencës VI shkencore ndërkombëtare: “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë” 62

Conclusions and recommendations of the VI conference

PhD Xhavit SHALA, Assoc. Prof. PhD Idriz HAXHIAJ, PhD Albert HITOALIAJ, Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN, Assoc. Prof. PhD Zaho GOLEMI, PhD. Bajram IBRAJ, Assoc. Prof. PhD Bejtush GASHI, PhD. Dorian KOÇI

(Translation in english: PhD-c Anisa HYSESANI)

Conclusions and recommendations of the VI International Conference of the Security Academy “Extreme phenomena of nature and security issues” 98

Punime të pabotuara të vëllimit II, të konferencës VI ndërkombëtare

“Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”

Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë, Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ

Policia dhe rëndësia e kurrikulave për menaxhimin e emergjencave civile 136

Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN, MSc. Qetësor GURRA

Parandalimi dhe menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri, si qasje ndaj sigurisë kombëtare. . 144

Dr. Albert Hitoallaj

Gjeopolitika e pandemie, bioarmët dhe biosiguria 156



~ *Sesioni plenar* ~

Fjalët përshëndetëse të hapjes së konferencës VI
shkencore ndërkombëtare: “Fenomenet ekstreme
të natyrës dhe çështjet e sigurisë”

«Nuk ka fenomen ekstrem të natyrës ku nuk ndihet gjithëpërfshirja e strukturave ligjzbatuese shtetërore, e sidomos, e Policisë së Shtetit»



Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ
DREJTORI/REKTORI I AKADEMISË SË SIGURISË

Më lejoni që në emër të Akademisë së Sigurisë dhe personalisht t'ju falënderoj për pjesëmarrjen! Akademia e Sigurisë, në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë e të kërkimit shkencor në Shqipëri, si dhe me institucione të tjera kombëtare e ndërkombëtare, organizon sot konferencën e 6-të shkencore: “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”. Akademikë, studiues, profesionistë nga vendi e bota, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit, të të gjithë institucioneve ligjzbatuese, janë ftuar dhe kanë dorëzuar punime, projekte, propozime dhe prezantime për konferencën, që rrokin fushën e emergjencave civile dhe të sigurisë publike.

Në fokus të kësaj konference do të jetë siguria e individit e qytetarit dhe ndihma në shpëtimin dhe mbrojtjen e tyre nga emergjencat civile në rastet e fenomeneve ekstreme natyrore. Nisur nga situata në të cilën vendi ynë është përfshirë në dy vitet e fundit si nga tërmeti, por edhe nga pandemia COVID-19, ne vlerësuam se në rastin e fenomeneve ekstreme të natyrës krijohet një situatë komplekse që mund të shkaktohet nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste etj., të cilat sjellin dëme të menjëhershme të rënda për jetën, për shëndetin e komunitetit, të gjësë së gjallë, pasurisë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjala e drejtorit/rektorit të AS-së, drejtues i lartë dr. Bilbil Memaj, në konferencën VI shkencore ndërkombëtare: “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”.

private e shtetërore, trashëgimisë kulturore dhe mjedisin. Ndaj, në këtë konferencë po fokusohemi në:

- Njohjen dhe studimin e sa më shumë faktorëve të cilët i shkaktojnë këto dukuri. Nisemi nga fakti që nuk mund të shohim nga qielli dhe thjesht të lutemi mos ndodhjen e tyre, por të vëmë në funksion dijet tona për të parandaluar dhe pastaj menaxhuar situata të tilla.

- Ndërtimin ose përmirësimin e një kornize ligjore dhe ekzekutive mbi sigurinë publike në rastet e emergjencave civile.

- Njohjen e përgjegjësive që duhet të kenë strukturat shtetërore e civile nga situatat e thjeshta deri tek ato më komplekset. Nuk ka aksident, përmytje, tërmet, pandemi, orteK, ngricë, erë të fortë, bllokim rrugësh, zjarr, dëmtim nga breshëri, etj. ku nuk ndihet gjithëpërfshirja e strukturave ligjzbatuese shtetërore, e sidomos e Policisë së Shtetit. Situata të tilla kërkojnë veprime të menjëhershme ndaj kërkohet organizim trajnim dhe gatishmëri e vazhdueshme.

Konferenca ka si qëllim: përthithjen e mendimit të kualifikuar akademik, trajtimin në mënyrë shkencore të fenomeneve ekstreme si dhe rëndësia e veprimit dhe koordinimit të emergjencave civile si dhe në vijimësi për të mbrojtur e siguruar komunitetin; përmirësimin e shpejtësisë dhe efikasitetit të strukturave përgjegjëse për përballimin e emergjencave, përmes kontributit akademik institucional dhe më gjerë, duke përgjithësuar praktikën më të mira botërore dhe mësimet e nxjerra nga to; evidentimin e mangësive në aktet ligjore e nënligjore si dhe dhënia e propozimeve dhe rekomandimeve për përmirësime në politika; dhënie të rekomandimeve për kurrikula, programe trajnimesh për fushën e sigurisë, programe trajnimesh për fushën e emergjencave, programe trajnimesh për fushën e fatkeqësive natyrore.

Kjo konferencë do ketë si synime kryesore:

ndërgjegjësimin publik për mirinformim dhe përhapjen e njohurive në lidhje me rreziqet nga fatkeqësitë, veprimet e mundshme që mund të ndërmerren në mënyrë individuale e kolektive për të zvogëluar ekspozimin ndaj kërcënimit dhe rreziqeve nga fenomenet ekstreme të natyrës;

përforcimin dhe theksimin e bindjes që emergjencat civile janë të prekshme, të vërteta, të qenësishme, të përsëritshme, të ndjeshme në raport me sigurinë kombëtare, si dhe me pasoja, ndaj Shqipërisë si dhe ndaj çdo shteti tjetër, të ekspozuar ndaj fenomeneve kërcënuese të natyrës në të gjitha stinët;

zgjerimin e bashkëpunimit të segmenteve përgjegjëse të shtetit për sigurinë komunitare në rast emergjencash, si dhe binden për bashkëpunim të aktorëve ndërshtetërorë në vend, por edhe rajonalë, veçanërisht ata fqinjësorë;

rritjen e vetëdijes për çështjet e emergjencave civile, për praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra për përmirësimin e aftësisë themelore të sigurisë komunitare në të gjithë hapësirën shqiptare;

trajtimin e aspekteve ligjore dhe juridike e historike krahasuese, të emergjencave për tërmetet, përmytjet, orteKët, zjarret, aksidentet e rënda në terrene të vështira dhe mundësia e bashkëpunimit e koordinimit të shpejtë,

ofrimin e rekomandimeve, për përmirësim në politika dhe strategji zgjidhjeje për strukturat e shtetit që trajtojnë problematikën e emergjencave civile;

përfshirjen në studime dhe analiza të thelluara të aspekteve ligjore dhe teknike lidhur me menaxhimin praktik të problemeve të emergjencave në shkallë vendore e rajonale, duke shfrytëzuar praktikën më të përparuar ndërkombëtare në fushën e

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »

përballimit të emergjencave dhe të gjithë faktorëve ekstremë të natyrës.

Tema, për nga natyra, përfshinte auditor të gjerë me kërkues shkencor nga vendi dhe bota si dhe staf akademik nga Akademia e Sigurisë; studiues dhe ekspertë të çështjeve të sigurisë; drejtues dhe specialistë nga strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, nga strukturat e pushtetit vendor e qendror, organet e specializuara të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm; nga agjencitë ligjzbatuese; përfaqësues të misionëve të huaja policore që asistojnë Policinë e Shtetit; Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), Shërbimet Meteorologjike, instituteve të ndërtimit, Akademisë së Shkencave, instituteve të kriminologjisë, të universiteteve që mbulojnë shkencat ekzakte, të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe të akademive që përafrojnë me fokus studimet për emergjencat civile; Universiteti i Durrësit, Universiteti i Tiranës, Akademia e Forcave të Armatosura, Universiteti Tor Vergata; nga stafi i ushtarakëve të ushtrisë së Izraelit (ish-pjesëtarë të ekipit që erdhi në Shqipëri për tërmetin e 26.11.2019), përfaqësues të institucioneve akademike partnere në vend dhe të akademive, kolegjeve e universiteteve policore etj. E gjithë eksperiencia pozitive e përdorur në menaxhimin e dëmeve të tërmetit si dhe menaxhimi i pandemisë duhet të shërbej si eksperiencë për përgatitjen e strukturave përgjegjëse për të qenë në nivel më të lartë profesional.

Jam shumë i nderuar për kontributin tuaj në këtë çështje madhore. Punë të mbarë konferencës së VI shkencore!



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Vlerësoj energjitë dhe përkushtimin e stafit të Akademisë së Sigurisë, për kërkime shkencore dhe tematikat e përzgjedhura që janë të prekshme dhe të nevojshme të adresohen»



Prof. Dr. Vasilika HYSI
ZËVENDËSKRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Me lejon të falënderoj organizatorët e kësaj veprimtarie për ftesën, dhe që bënë bashkë, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, vendase dhe ndërkombëtare dhe botës akademike për të diskutuar rreth një çështje me rëndësi, siç janë fenomenet ekstreme të natyrës dhe siguria kombëtare. Vlerësoj energjitë dhe përkushtimin e stafit të Akademisë së Sigurisë, por jo vetëm, për kërkime shkencore dhe tematikat e përzgjedhura që janë të prekshme dhe të nevojshme të adresohen.

Sot ndryshimet klimaterike dhe fenomenet natyrore përbëjnë një nga kërcënimet e sigurisë globale dhe kombëtare. Shpesh siguria e jetës së personave dhe siguria kombëtare kërcënohen nga veprimet dhe mosveprimet, sjelljet e kundërligjshme dhe mosushtrimi sa dhe si duhet i kompetencave nga institucionet ose strukturat publike dhe private që janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, lumenjve, liqeneve, planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në një mjedis të qëndrueshëm është angazhim i liderëve të shteteve, përfshirë edhe shtetin shqiptar në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Ndaj, vlerësoj që kjo temë është në vëmendje të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjala e prof. dr. Vasilika Hysi, zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë, në konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë".

shumë institucioneve dhe si përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë e kam vlerësuar. Fenomenet natyrore dhe jo vetëm, kërkojmë vlerësime sistematike të rreziqeve dhe masa paraprake për adresimin e tyre, vlerësim të nevojave dhe bashkërendim të veprimeve mes institucioneve, përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi në kohë dhe me cilësi nga strukturat që ligji i ngarkon me përgjegjësi dhe për kërkime e studime shkencore nga ekspertë dhe institucione të pavarura. Është për t'u vlerësuar fakti që në këtë konferencë bëhen bashkë përfaqësues të institucioneve, kërkues dhe studiues të pavarur për të trajtuar fenomenet natyrore nga këndvështrimi i sigurisë kombëtare.

Tërmeti i shtatorit, ai i 26 nëntorit të vitit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19 nxorën në pah një sërë problematikash që lidheshin me kuadrin ligjor dhe nënligjor, ligje të miratuara, por të pazbatuara sa dhe si duhet, institucione që kanë nevojë për burime njerëzore dhe financiare, si dhe nevoja për kërkime dhe studime sistematike nga profesionistë të trajnuar dhe të financuara, ridoli në pah. Rreziqet dhe kërcënimet nga fenomenet natyrore mund të menaxhohen, pasojat e tyre mund të ulen dhe në shumë raste mund të parandalohen. Kuvendi ka përgjegjësitë e tij.

Kuadri ligjor, nëse ka nevojë të plotësohet, përmirësohet ose të harmonizohet mund dhe duhet të bëhet nga ligjberësi, bazuar në mësimet e nxjerra nga fatkeqësitë e pësuar, por para së gjithash bazuar në gjetjet e studimeve dhe kërkimeve shkencore të instituteve të kërkimit dhe ekspertëve të tjerë në fushë. Kuvendi ka ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes civile dhe vazhdimisht Shqipëria ka aderuar në konventat ose protokollet shtesë ose ndryshuese të tyre. Strategjia e zvogëlimit të rreziqeve dhe zbatimi i saj nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nga strukturat vendore pranë organeve të vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e tjera përgjegjëse kanë nevojë të monitorohen më mirë. Një rol të veçantë në këtë proces luan Kuvendi i Shqipërisë që, mes kontrollit parlamentar, mundëson zbatimin më të mirë të ligjeve dhe strategjive në fushën e mbrojtjes civile.

Miratimi i buxheteve të mjaftueshme për mbrojtjen civile është detyrë e Kuvendit të Shqipërisë. Me gjithë dëshirën e mirë, jemi të ndërgjegjshëm që buxhetet nuk kanë qenë të mjaftueshëm. Informimi i publikut dhe i komuniteteve të rrezikuara, bazuar në dokumentin e vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë; veprimtaritë trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre, një sistem monitorimi, i paralajmërimit të hershëm, i njoftimit dhe informimit në kohë të komunitetit të rrezikuar janë masa që mund të zvogëlojnë rrezikun. Në këtë vështrim, roli i komisioneve parlamentare në monitorimin e funksionit të organeve të qeverisjes vendore merr një rëndësi të veçantë.

Integriteti dhe profesionalizmi i strukturave përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror, ndëshkimi i rëndë i abuzimit me detyrën dhe fenomenit të korrupsionit në kontrollin e territorit, në zhvillimin dhe planifikimin e tij, janë me rëndësi. Është kjo arsyeja që hetimi i veprave të korrupsionit ju besua strukturave të posaçme të krijuara nga Kuvendi për hetimin e korrupsionit. Sistemi i drejtësisë penale dhe dhënia fund e pandëshkueshmërisë ndaj abuzimit me zhvillimin dhe kontrollin e territorit dhe supervizimin e investimeve ose kur institucionet nuk ndërmarrin masa për investimet në kohë për mbrojtjen civile ose kur abuzohet me detyrën do të ndikojnë në zvogëlimin e riskut nga fenomenet natyrore. Ndryshimet e fundit në *Kodin penal* lidhur me veprat penale që lidhen me ndërtimet dhe supervizimet e punimeve kanë nevojë të monitorohen.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Së fundi, për nga radha por jo nga rëndësia, është përmirësimi i kurrikulave të arsimit në të gjitha nivelet e tij për të edukuar dhe trajnuar cilindo për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshëm të tij, edukimin në fushën e mbrojtjes civile dhe veçanërisht rritjen e kapaciteteve të institucioneve të kërkimeve shkencore në fushën e mbrojtjes civile.

Mirëpres gjetjet dhe sugjerimet e konferencës, për Kuvendin e Shqipërisë.
Suksese në vijimin e punimeve të konferencës!



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Ndihem i kënaqur që Akademia hedh një tjetër hap cilësor në kontributin shkencor në fushën e sigurisë»



Z. Julian HODAJ
ZËVENDËSIMINISTËR I BRENDSHËM

Organizimi i konferencës “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë” nga Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë së Sigurisë, ka një rëndësi të veçantë si për organizatorët, pasi shënon një arritje të çmuar si për institucionin, edhe për strukturat e larta ekzekutive, pasi nga kjo konferencë mund të dalin platforma konkrete që mund të përmirësojnë apo sofistikojnë modalitetet e veprimit në rast emergjencash civile, dhe problematikash të sigurisë që lidhen me to. Ndikimi i emergjencave civile në balancat e sigurisë është i njohur dhe nga një këndvështrim i caktuar, ato ndikojnë te njëra tjetra sipas parimit të enëve komunikuese. Pra, nëse kemi një cenim të sigurisë, patjetër që krijohet një emergjencë e natyrës civile, dhe, nga ana tjetër, nëse kemi një emergjencë civile të shkaktuar nga fenomene ekstreme të natyrës, është e natyrshme të ketë edhe probleme të sigurisë së përgjithshme.

Për këtë arsye, fenomenet ekstreme të natyrës dhe emergjencat civile kanë qenë gjatë gjithë kohës në fokusin e përgjegjësive qeverisëse. Mund të them se është e dukshme rritja e vëmendjes dhe e aftësisë qeverisëse për të përballuar, vit pas viti, këtë natyrë rreziqesh në kuadër të sigurisë kombëtare, të garantimit të zhvillimit të vendit dhe të

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjala e zëvendësiministrit të Brendshëm z. Julian Hodaj, në konferencën VI shkencore ndërkombëtare: “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”.

përmirësimit të mirëqenies shoqërore. Këto fenomene kërcënuese natyrore, por fatkeqësisht hera-herës shkaktuar apo përkeqësuar nga dora e njeriut, kanë një kontekst rreziku që përshkallëzohet kryesisht në mënyrë të paparashikuar. Mbetet prioritet yni qeverisës rritja vëmendjes për të mbrojtur infrastrukturën kritike kombëtare dhe jetën e qytetarëve. Duke parë këtë problematikë kaq të mprehtë që kanë fenomenet ekstreme të natyrës, ndihem i kënaqur që akademia hedh një tjetër hap cilësor në kontributin shkencor në fushën e sigurisë. Mjafton të shohim edhe konferencat e tjera të zhvilluara nga Akademia e Sigurisë në vite dhe kuptojmë se po ndërtohet një traditë e konsoliduar për fuqizimin e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë. Dhe kjo është padyshim një arritje e një meritë e personelit akademik e kërkimor, jo vetëm të Qendrës Kërkimore Shkencore, e cila organizon këto aktivitete, por të gjithë Akademisë së Sigurisë dhe të partnerëve të saj kombëtarë e ndërkombëtarë, të fushës së arsimit, kërkimit e më gjerë.

Kam bindjen se institucionet dhe ekspertët që janë thirrur në këtë konferencë, madje edhe autoritete të shkallës ndërkombëtare, do ta trajtojnë me shembuj konkretë dhe të qartë ndërlidhjen mes këtyre dy problematikave. Më vjen mirë që në konferencë nuk mungojnë ekspertët dhe institucionet kombëtare, ashtu siç ndihem mirë kur shikoj se kjo konferencë ka fituar vëmendjen e organizatave të rëndësishme ndërkombëtare si BE, OSCE apo UNDP. Uroj që këtë seriozitet dhe cilësi të punimeve e të organizimit të kërkimit, ta rrisim edhe më shumë si institucion!

Ministria e Brendshme, ka si objektiv parësor mbrojtjen e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve, të rendit dhe qetësisë publike. Këtij synimi madhor i kemi dedikuar gjithë vëmendjen e përkushtimin tonë. Investimet e Ministrisë së Brendshme në fushën e sigurisë janë të vazhdueshme, të ndjeshme dhe të prekshme nga të gjithë qytetarët. U bënë disa vite që ne kemi nisur një program reformash dhe modernizimi qoftë të strukturave, ashtu edhe të mjeteve, pajisjeve dhe teknologjisë që përdorim me qëllim forcimin e sigurisë në vend. Vetë riaktivizimi i kësaj akademie ku po zhvillojmë këtë konferencë, është dëshmi e vullnetit tonë në këtë drejtim. Sot mund të themi se kemi “përtërirë” realisht trupën e Policisë së Shtetit, duke ulur në mënyrë të ndjeshme moshën mesatare, pasi trupa që trashëguam kishte një moshë mesatare ndër më të lartat në rajon e më gjerë. Forcuam kontrollin mbi territorin, duke rritur me mbi 1/4 numrin e përgjithshëm të efektivëve të policisë dhe, për pasojë, edhe raportin që duhet të ketë një punonjës policie me numrin e popullatës.

Qasja jonë konceptore ndaj sigurisë, sot, ashtu si në gjithë botën, po vendos në thelb sigurinë njerëzore. Siguria njerëzore është transformuar tanimë në një agjendë kryesore të politikave botërore dhe po ndikon jo vetëm programet politike të partive, por edhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Fenomenet ekstreme të natyrës, vlerësohen si një rrezik esencial dhe në rritje ndaj sigurisë njerëzore. E përfshirë në këtë vorbull ndryshimesh, është edhe policia. Sfidat me të cilat ajo përballet lidhen padyshim edhe me fenomenet ekstreme. Për përballimin e këtyre sfidave, jemi përpjekur që të ndërtojmë politikat e duhura. Por ajo që është më e prekshme apo më e dukshme nga syri i qytetarëve, është rinovimi i mjeteve, pajisjeve, futja e pajisjeve moderne teknologjike, aplikimi i programeve të sofistikuara kundër krimit etj. Motoja jonë gjatë këtyre viteve ka qenë: “Siguri - Inovacion - Progres”. Të gjitha në funksion të sigurisë së qytetarit.

Këto reforma e investime kanë dhënë frytet e veta dhe sot mund të flasim për Policinë e Shtetit si për institucionin më të besueshëm nga publiku i gjerë, në bazë të sondazheve të kryera nga institucione të pavarura ndërkombëtare. Dhe ky besim nuk ka ardhur pa punë, pa sakrifica, të cilat në ndonjë rast kanë qenë edhe fatale. Të kemi

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

parasysh se në këto dy vitet fundit, trupa e policisë ka përballuar emergjencat e shkaktuara nga disa tërmete të forta, me pasojë humbjen e dhjetëra jetësh njerëzore; po kështu edhe situatën e pazakontë të shkaktuar nga COVID-9. Më lejoni të përmend këtu, se për shkak të virusit, 29 punonjës policie kanë humbur jetën. Natyrisht që kërcënim i pandemisë ishte botëror dhe u prek e gjithë shoqëria shqiptare, por efektivat e policisë edhe pse të ekspozuar në maksimum, nuk reshtën së mbajtur situatën në kontroll. Jo çdo rast mund të lidhet me tubimet e qytetarëve, por me siguri mund të themi se detyra e punonjësit të policisë është të dalë në rrugë, aty ku ndodhin ngjarjet, për pasojë kontaktet me një numër të lartë njerëzish, sigurisht mund të bëhen shkas për t'u prekur nga virusi. Pas trupës së mjekëve, organizata e Policisë së Shtetit është ajo që ka pasur humbjet më të larta nga çdo strukturë tjetër shtetërore apo publike.

Unë kam bindjen se nga kjo konferencë do të dalin kontribute mjaft të rëndësishme shkencore, që do të vlerësohen nga nivelet ekzekutive, qoftë sa u përket emergjencave, ashtu edhe atyre të sigurisë. Nga ana tjetër, edukimi ka një rol të padiskutueshëm në pakësimin e rreziqeve dhe në menaxhimin e emergjencave. Pikërisht, ky proces informimi dhe edukimi publik i shoqëruar edhe me gjetjet, analizat e ekspertizat profesionale, të vlefshme për institucionet tona, është një kontribut i vyer i kësaj konference. Duke e mbyllur, dëshiroj t'i uroj kësaj konference dhe organizatorëve, suksese dhe punime të mbara!

Faleminderit dhe mirë u takofshim në konferencën e radhës!



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Organizimi i kësaj konference, në këto momente, ka një rëndësi të veçantë për Shqipërinë»



Drejtues i Lartë Albert DERVISHAJ
ZËVENDËSDREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHQIPTARË

Gjatë dekadave të fundit, shpeshtësia dhe intensiteti i fatkeqësive natyrore, shoqëruar me dëme të mëdha në burime materiale dhe fuqi njerëzore, është rritur ndjeshëm në nivel global dhe rajonal. Kjo situatë është përkeqësuar akoma më shumë për shkak të degradimit të mjedisit, ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike. Në një pjesë të madhe të rasteve, fatkeqësitë natyrore janë shndërruar në katastrofa për shkak të shkallës së ulët të ndërgjegjësimit dhe mungesës së informacionit të komunitetit.

Vendi ynë, në të cilën frekuenca e emergjencave natyrore është domethënëse, nuk përbën përjashtim nga ky rregull. Dhe në këto raste, qytetarët e veçanërisht fëmijët, përfaqësojnë kategorinë më të cenueshme. Me gjithë punën e bërë, fëmijëve, por edhe të rinjve u mungojnë njohuritë dhe nuk kanë aftësitë e nevojshme për t'u mbrojtur nga rreziqet që u kanosen.

Çështja e emergjencave civile është shndërruar në një nga shtyllat e rëndësishme dhe jetike të sigurisë publike. Kjo sepse ato janë situata komplekse të cilat mund të shkaktohen nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, kërcënuese, luftarake, të cilat sjellin dëme të menjëhershme dhe të rënda për jetën, për

Fjala e zëvendësdrojtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtues i lartë Albert Dervishaj, në konferencën Vi shkencore ndërkombëtare: «Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë».

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

shëndetin e njerëzve, të gjësë së gjallë, pasurisë private e shtetërore, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.

Përgatitja dhe edukimi për përballimin e fatkeqësive të ndryshme dhe menaxhimin e situatave emergjente është detyrë për çdo institucion shtetëror, arsimor dhe më gjerë. Ne nuk jemi në gjendje të parandalojmë dridhjet e tokës, stuhitë që fryjnë, ose shiun që bie, por përmes edukimit të vazhdueshëm dhe përgatitjes për rreziqet natyrore apo ato të shkaktuara nga vetë njeriu, mund të ndihmojmë që institucionet dhe komuniteti, të menaxhojnë këto rreziqe dhe të parandalojmë që këto ngjarje të mos shndërrohen në katastrofa.

Organizimi i kësaj konference në këto momente ka një rëndësi të veçantë, pasi Shqipëria jo më larg se fundi i vitit 2019, është përballur me një nga fenomenet më ekstreme të natyrës siç janë tërmetet. Gjithashtu duke filluar nga viti 2020 dhe aktualisht, globi është duke u përballur me një nga pandemitë më të rënda në historinë e njerëzimit, siç është ajo e COVID-19.

Këto fenomene, të cilët nuk kanë qenë edhe shumë të zakonshme për vendin tonë, vendosën në sprovë të madhe institucionet e vendit, ku një ndër to është edhe Policia e Shtetit. Megjithatë Policia e Shtetit, nuk ka pasur përvojë dhe eksperiencë në përballjen dhe kryerjen e detyrave në situata të tilla si COVID-19, nga punonjësit e policisë sidomos në fazën e parë dhe më të egër të epidemisë, u manifestua një angazhim dhe përgjegjshmëri e plotë në përmbushjen e përgjegjësiwe institucionale, të detyrave dhe masave të veçanta të autorizuara nga akti normativ i qeverisë, duke fituar një përvojë të re në menaxhimin e situatës së “Gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, edhe për rastet e epidemive si ajo e infeksionit të COVID-19, duke mësuar, por edhe duke policuar dhe mbrojtur jetët e njerëzve, pavarësisht se nga radhët tona pësua dëme njerëzore.

Në periudhën e pandemisë, bashkëpunimi ndërinstitutional midis Policisë së Shtetit, Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Forcave të Armatosura, institucioneve të tjera, si dhe strukturave rajonale të tyre, ka qenë në nivele shumë të mira dhe në mbështetje të njëri-tjetrit. Punonjësit e policisë kanë mbajtur qëndrime korrekte dhe bashkëpunuese me qytetarët, duke qenë së pari këshillues dhe në ndihmë të tyre, por edhe kemi gjetur mirëkuptim dhe mbështetje të plotë të tyre për punën e Policisë së Shtetit.

Mendoj se nga kjo përvojë e jona, eksperiencia rajonale por edhe ajo globale, duhet të përfitojë Akademia e Sigurisë, për ta studiuar atë dhe të hartojë kurikula apo module të veçanta, për zhvillimin e trajnimeve specifike lidhur me mënyrën e veprimit të institucioneve të sigurisë në tërësi dhe të Policisë së Shtetit në veçanti, në një situatë pandemie, tërmeti etj.

Mendoj se konferenca do t'i shërbejë më së miri edhe evidentimit dhe nxjerrjes në pah të mangësive të konstatuara në raste konkrete të fenomeneve ekstreme, me qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore, që ato të jenë më të përgatitura për t'iu përgjigjur në mënyrën e duhur këtyre fenomeneve në të ardhmen, ndërgjegjësimi dhe krijimi të një kulture bashkëpunimi e solidariteti midis institucioneve, anëtarëve të komunitetit, apo dhe midis shteteve.

Puna për planifikimin dhe menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive dhe të emergjencave, mendoj se duhet të trajtojë tre dimensionet e sigurisë:

- sigurimin e një infrastrukture të qëndrueshme dhe të sigurt;
- menaxhimin e emergjencave të përgjithshme apo edhe në një rajon të caktuar;
- edukimin për reduktimin e rrezikut dhe zbutjen e pasojave.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »

Kam besim se lektorët sipas sesioneve, nëpërmjet analizave teorike dhe eksperiencës praktike, do të japin një kontribut të rëndësishëm për ndërtimin e një kornize të plotë mbi sigurinë publike në rastet e emergjencave civile, mbi përgjegjësinë që kanë institucionet publike, agjencitë ligjzbatuese, si dhe gjithë shoqëria për forcimin e sigurisë, kontrollin e territorit dhe mjedisit dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve.

Në përfundim, në emër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i uroj punime të mbara dhe suksese konferencës, organizatorëve, kontribuuesve dhe pjesëmarrësve.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Security has a multidimensional character, and it is in this spirit that I commend the Security Academy for this important event»



Ambassador Vincenzo Del MONACO
HEAD OF THE OSCE PRESENCE IN ALBANIA

I am particularly honored to attend this conference, and I will make the best use of the three minutes time allotted to me. Let me offer to you 3 antithesis and a final point on the role of the OSCE.

1. Predictability v. surprise.

We all agree that there are natural phenomena that are impossible to predict, despite all the laudable efforts of the scientific community. Earthquakes, with their tragic human lives toll, are a typical example par excellence. On the other hand, if one looks back to the last 20 years, we count a number of epidemic outbreaks. SARS in China, MERS in the Arabian Peninsula, H1N1 flu in Mexico, Ebola in West Africa, Zika from the Pacific Islands. All different one from the other but with one thing in common: they all came as surprises, and they should not have. Actually, we are cognizant that extreme natural phenomena, for instance those climate change related, exacerbate pandemics, worsens food and water shortages, increase the risks of pandemics, and aggravate mass displacement. Extreme weather disrupts public health infrastructure and service. Ex-

Welcoming speech at the VI International Scientific Conference: "Extreme phenomena of nature and security issues."

treme phenomena pose a threat to security.

2. Planv. Planning

We have read number of times that plans are worthless, but planning is certainly everything. I humbly tend to believe that both are indispensable. Emergencies come often with a set of unknowns, eventually with a mismatch between what we expect and what will happen indeed. Still, even if the details of a plan do not match the unexpected reality, planning is a fundamental process. And here is the deep meaning of today's works. In fact, already in 2005, Michael Osterholm predicted that "The arrival of a pandemic influenza would trigger a reaction that would change the world overnight", and pointed out to the need for a blueprint for how to get a population through one to three years of a pandemic. A plan that must involve all the key components of society, the full spectrum of the public sector together with the private one and the business community. Plan is indispensable, but let us keep in mind that resilience is a real key to crisis management.

3 – Me v. We

This antithesis opens a Pandora box. We could even rephrase it as Global challenges against local capacities, to remain in a diplomatic and nuanced terrain. Extreme natural events such as Covid have highlighted a gap between global problems and the capacity to meet them, which had an impact on the scale of the pandemic. I believe in a strong case for multilateralism and global cooperation to tackle extreme natural phenomena, and this was exactly the main message that came out from the works of the Global Solutions Summit a few days ago, with the idea (or hope) that "Multilateralism is bouncing back".

4 - OSCE PiA

I strongly believe in the benefit of multilateralism and in closer international cooperation, and it is not by chance that I am serving in the OSCE, and in Albania. There is no need to list here all the concrete initiatives that the Presence in Albania has conducted hand-in-hand with its Albanian interlocutors, since the beginning of the pandemic, starting with the Security Academy to end with the Parliament. Our engagement on the ground to strengthen resilience and security, to bring together a number of critical stakeholders in the field on environment, to address transnational threats, working together with a multi-level and multi-stakeholders approach.

As was highlighted also in a very recent security public opinion survey published by the Regional Cooperation Council, each of the threats and risks has a multidimensional character, requiring a holistic and coordinated approach rather than simplification and reductionism. And it is in this spirit that I commend the Security Academy for this important event that serves as a platform to harvest best knowledge and experiences available in the field of civil emergencies, natural disasters and addressing related security issues. This exercise, with such a "parterre de roi" of speakers, contributes to reinforce trust in the institutions. And trust enters the national chain at every link when extreme natural phenomena are at stake.

Please continue to count on us, on the OSCE Presence for the follow up to this exercise.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Siguria ka një karakter shumëdimensional, dhe pikërisht në këtë frymë dua të përgëzoj Akademinë e Sigurisë për këtë aktivitet të rëndësishëm... »



Ambasador Vincenzo Del MONACO
KRYETAR I PREZENCËS SË OSBE-së NË SHQIPËRI

Është nder i veçantë për mua të marr pjesë në këtë konferencë dhe do t'i shfrytëzoj më së miri tre minutat që më janë dhënë për fjalën time. Më lejoni t'ju parashtoj 3 antiteza dhe një pikë përfundimtare në lidhje me rolin e OSBE-së.

1. Parashikueshmëria kundrejt të papriturave

Të gjithë jemi dakord se ka fenomene natyrore të cilat është e pamundur të parashikohen, përkundër të gjitha përpjekjeve të lavdërueshme të komunitetit shkencor. Tërmetet, me gjithë numrin tragjik të jetëve njerëzore që kanë marrë, janë një shembull tipik që e vërteton më së miri këtë. Nga ana tjetër, nëse hedhim vështrimin pas në kohë në 20 vitet e fundit, ne numërojmë një sërë shpërthimesh epidemie. SARS në Kinë, MERS në Gadishullin Arabik, gripi H1N1 në Meksikë, Ebola në Afrikën Perëndimore, Zika nga Ishujt Paqësor. Të gjitha ishin të ndryshme nga njëra-tjetra, por kishin një gjë të përbashkët: të gjitha erdhën si të papritura, ndërkohë që nuk duhet të kishin ardhur si të tilla. Në fakt, ne jemi të vetëdijshëm se fenomenet ekstreme natyrore, si për shembull ato që lidhen me ndryshimet klimatike, i bëjnë pandemitë edhe më të rënda, rrisin mungesat e ushqimit dhe ujit, shtojnë rreziqet e pandemive dhe përkeqësojnë

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjala e ambasadorit Vincenzo Del Monaco, kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë".

zhvendosjen masive. Moti ekstrem dëmton infrastrukturën dhe shërbimin e shëndetit publik. Fenomenet ekstreme paraqesin rrezik për sigurinë.

2. Plani kundrejt planifikimit

Kemi lexuar disa herë që planet nuk kanë ndonjë vlerë, por planifikimi është padyshim gjithçka. Me gjithë përlulësinë time kam prirjen të besoj se të dyja janë të domosdoshme. Urgjencat vijnë shpesh me një sërë të panjohurash, duke sjellë edhe një mospërputhje midis asaj që ne presim dhe asaj që do të ndodhë vërtet. E megjithatë, edhe nëse hollësitë e një plani nuk përputhen me realitetin e papritur, planifikimi është një proces thelbësor. Dhe këtu e gjejmë kuptimin e thelluar të punimeve të sotme.

Në fakt, që në 2005, Michael Osterholm parashikoi që “Ardhja e një gripi pandemik do të shkaktoje një reagim që do të ndryshonte botën brenda natës”, dhe vuri në dukje se ishte e nevojshme të përpilohej një plan për mënyrën se si mund ta kalojë një popullatë një pandemi e cila zgjat një deri në tre vjet. Një plan që duhet të përfshijë të gjithë përbërësit kryesorë të shoqërisë, spektrin e plotë të sektorit publik së bashku me atë privat dhe komunitetin e biznesit. Plani është i domosdoshëm, por le të kemi parasysh se qëndrueshmëria është çelësi i vërtetë për menaxhimin e krizave.

3. Unë kundrejt Ne

Kjo antitezë hap kutinë e Pandorës. Ne madje mund ta riformulojmë atë si sfida globale kundër kapaciteteve vendore, për të qëndruar në një terren diplomatik dhe të nuancuar. Dukuritë ekstreme natyrore të tilla si Covid kanë vënë në pah një hendek midis problemeve globale dhe aftësisë për t'i qasur ato, të cilat patën ndikim në shkallën e pandemisë. Unë besoj fort tek multilateralizmi dhe bashkëpunimi global për të trajtuar fenomenet ekstreme natyrore, dhe ky ishte pikërisht mesazhi kryesor që doli nga punimet e Samitit të Zgjidhjeve Globale disa ditë më parë, me idenë (ose shpresën) se “Multilateralizmi po rikthehet”.

4. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Unë besoj fuqimisht në dobinë e multilateralizmit dhe në bashkëpunimin më të ngushtë ndërkombëtar, dhe nuk është rastësi që po shërbej në OSBE dhe në Shqipëri.

Nuk ka nevojë të rendit këtu të gjitha nismat konkrete që Prezenca në Shqipëri ka kryer krah për krah me interlokutorët e saj shqiptarë, që nga fillimi i pandemisë, duke filluar me Akademinë e Sigurisë e për të përfunduar me Parlamentin. Ka qenë angazhimi ynë në terren për të forcuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë, për të sjellë së bashku një numër aktorësh kritikë në fushën e mjedisit, për të adresuar kërcënimet transnacionale, duke punuar së bashku me një qasje të përbërë prej shumë nivelesh dhe palësh të interesit.

Siç u vu në dukje edhe në një sondazh të kohëve të fundit në lidhje me opinionin publik për sigurinë, i cili u botua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, secili prej kërcënimeve dhe rreziqeve ka një karakter shumëdimensional, që kërkon më shumë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduar sesa thjeshtim dhe reduktim. Dhe pikërisht në këtë frymë dua të përgëzoj Akademinë e Sigurisë për këtë aktivitet të rëndësishëm që shërben si një platformë për të korrur njohuritë dhe përvojat më të mira që mund të gjenden në fushën e emergjencave civile, katastrofave natyrore dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë. Ky ushtrim, me një “ajkë” të tillë folësish, kontribuon në forcimin e besimit tek institucionet. Dhe besimi hyn në çdo hallkë të zinxhirit kombëtar kur bëhet fjalë për dukuri ekstreme natyrore.

Ju lutemi vazhdoni të mbështeteni tek ne, tek Prezenca e OSBE-së për vazhdimësinë e këtij ushtrimi!

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

«L'idea che lancio in questa sede è quella di arricchire l'ampio ventaglio della nostra cooperazione di polizia con un tavolo di confronto sui fenomeni criminali emergenti nella post-pandemia... »



Prefetto Vittorio RIZZI

VICE CAPO DELLA POLIZIA DI STATO,
DIRETTORE CENTRALE DELLA POLIZIA CRIMINALE

L'Italia ha avuto da sempre un rapporto d'amicizia con l'Albania, non dovuto esclusivamente alla vicinanza geografica, ma soprattutto a comuni radici culturali e alla presenza nel nostro Paese di una comunità molto numerosa di cittadini albanesi. Sotto il profilo della sicurezza (che è la cornice del nostro incontro), la cooperazione internazionale di polizia con l'Albania è tra quelle più intense e vivaci del mio Paese e, come accennerò più avanti, lo testimoniano dati oggettivi.

Il nostro Capo della Polizia e il Capo della Polizia Veliu hanno fortemente voluto l'istituzione del recente *Tavolo Tecnico Permanente tra Italia e Albania*¹ e lo stesso Ambasciatore italiano qui a Tirana, Fabrizio Bucci, ha sostenuto con grande energia questa iniziativa, che è soltanto l'ultimo approdo del tanto lavoro svolto insieme.

Il Tavolo rappresenta un'occasione di confronto snella e diretta, che ci consente di scambiare informazioni operative non solo sui temi più urgenti (come quello della recrudescenza del fenomeno migratorio dal confine greco-albanese o il contrasto alle coltivazioni della cannabis) ma a tutto tondo, sia nella fase iniziale delle indagini che nella predisposizione di report d'analisi sui fenomeni criminali su cui orientare comuni

¹ Parola di saluto, VI Conferenza scientifica "Le problematiche dei fenomeni meteorologici estremi e connessione con gli aspetti relativi alla sicurezza"

strategie di prevenzione e contrasto.

L'Italia è da sempre sostenitrice (o "prima fan") dell'ingresso dell'Albania nell'Unione europea ed è in prima fila con una serie di PROGETTI favoriti proprio dalla Commissione europea. Mi riferisco, anzitutto, al Progetto IPA 2019 "*Countering Serious Organized Crime in the Western Balkans*", che segue quello precedente del 2017, in cui il nostro Dipartimento della Pubblica Sicurezza, insieme all'agenzia GIZ tedesca, ha il compito di operare in tre aree di intervento progettuali, quali:

- il supporto operativo;
- la cooperazione strategica;
- lo sviluppo dell'interoperabilità e della compatibilità dei sistemi di informazione e delle banche dati.

Mi riferisco, ancora, al Progetto PAMECA V, a guida italiana, con il *partneriato* di Austria e Francia, che è in fase conclusiva² e che ha offerto straordinarie occasioni formative per la polizia albanese. Tanto che l'Unione europea sta negoziando il nuovo progetto che subentrerà, con l'auspicio, anche del Direttore Velu, che si possa allargare alla specializzazione e alla modernizzazione della polizia albanese.

Il fatto che questi progetti non siano solo l'espressione di buone intenzioni e di buon vicinato, è testimoniato in modo tangibile dai *risultati dell'attività operativa comune*. Nel 2020, con il calo inevitabile dell'attività operativa dovuto alla pandemia, gli arresti di latitanti attivi (ricercati dalle autorità italiane e rintracciati in Albania) sono stati 68 e quest'anno i dati aggiornati parlano già di 47 persone. I latitanti passivi (rintracciati in Italia perché ricercati dalle autorità albanesi) sono stati 24 nel 2020, mentre nei prime cinque mesi del 2021 sono stati 6.

Sempre nel 2020, le estradizioni attive sono state 28, mentre nei primi cinque mesi del 2021 già 22. Le estradizioni passive sono state 14 nel 2020, dato già superato nel 2021 con 17 estradizioni nei primi 5 mesi. Con questi dati l'Albania si colloca al primo posto tra i Paesi extra-UE sia per numero di latitanti che di estradizioni attive e al secondo posto tra i Paesi extra-UE per numero di latitanti passivi. Attualmente sono attive 7 Squadre Investigative Comuni che riguardano vari reati, dal traffico internazionale di droga alla pedofilia, ed è in corso di sottoscrizione un'ulteriore accordo finalizzato all'istituzione dell'ottava.

I dati della nostra Direzione Centrale per i Servizi Antidroga testimoniano, d'altra parte, che il quantitativo di marijuana sequestrata in Italia, che proviene o transita dall'Albania, è in forte diminuzione nell'ultimo quadriennio, così come è in diminuzione se si raffronta il primo quadrimestre dell'anno in corso con quello dell'anno scorso. Obiettivi ottenuti anche grazie alla campagna sorvoli, realizzata sulla base di uno specifico protocollo operativo siglato tra la Direzione Generale della Polizia albanese ed il Ministero dell'Interno italiano³ che si avvale dell'attività operativa di sorvolo della Guardia di Finanza. Campagna che nel 2020, in piena pandemia, ha dato risultati operativi brillanti in termini di piantagioni individuate, consentendo alla Polizia albanese l'eradicazione e la distruzione di oltre 58.000 piante (58.423).

Proposta

Proprio in forza della nostra storia, di grande cooperazione di polizia, mi sento legittimato a lanciare una nuova ipotesi di lavoro, condividendo un'esperienza che abbiamo maturato in Italia e condiviso anche in seno ad Europol. L'Italia è stato purtroppo il primo Paese europeo a dover affrontare la pandemia e subito, già da aprile

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

2020, è stato costituito un *organismo permanente di monitoraggio ed analisi sul rischio di infiltrazione nell'economia da parte della criminalità organizzata*, di cui mi è stata affidata la presidenza.

Vi partecipano tutte le forze di polizia italiane, la Direzione Investigativa Antimafia e della Direzione Centrale per i servizi antidroga e ho la possibilità di invitare ai lavori i massimi esponenti delle amministrazioni pubbliche e private che possano fornire elementi informativi e di analisi sui temi d'interesse.

La *mission* dell'Organismo permanente è quella di anticipare, attraverso un attento monitoraggio svolto sul fronte interno ed internazionale, ogni iniziativa di espansione, di alterazione del mercato, di inquinamento del tessuto economico, di condizionamento dei processi decisionali pubblici funzionali all'assegnazione degli appalti da parte della criminalità organizzata.

Sulla base dell'esperienza italiana, nel luglio scorso è stato costituito in seno ad Europol, il *Working Group on Covid-19 criminal threats and law enforcement responses*, copresieduto da me e dal Direttore Esecutivo della predetta Agenzia Catherine De Bolle, che si è riunito già cinque volte, l'ultima la scorsa settimana.

Il *Working Group* vede la partecipazione delle forze di polizia di Austria, Belgio, Francia, Germania, Olanda, Polonia, Spagna, Svezia, Svizzera e Regno Unito, oltre all'Italia e ad Interpol, e ha l'obiettivo di condividere le informazioni sugli scenari criminali per una più efficace azione di prevenzione e contrasto, intercettando segnali e tendenze volti a generare *alert* di esposizione dell'economia legale all'aggressione mafiosa.

L'idea che lancio in questa sede è quella di arricchire l'ampio ventaglio della nostra cooperazione di polizia con un tavolo di confronto sui fenomeni criminali emergenti nella post-pandemia sempre con l'obiettivo di prevenire e di contrastare sul nascere le nuove minacce. (E chissà che questa idea non piaccia anche ad Europol e che il nostro *Working Group* possa essere esteso anche a tutta l'area balcanica)

Concludo il mio intervento, nella cornice di un'accademia così prestigiosa, con un'iniziativa dedicata propria alla formazione dedicata a funzionari albanesi che partirà in Italia il prossimo lunedì 7 giugno per una settimana (finanziata dal Progetto PAMECA V).

Si tratta del *training formativo per 28 investigatori albanesi dell' NBI (National Bureau of Investigation)*, il nuovo Ufficio molto simile vicino alla nostra DIA e che fa parte della *SPAK*, nuova struttura speciale istituita per la lotta corruzione e al crimine organizzato.

Abbiamo preparato il programma della training con molta cura prevedendo un'offerta formativa molto ricca, con visite a strutture d'eccellenza come il Servizio Polizia Scientifica, il CRAIM e la Polizia Postale e delle Comunicazione e siamo sicuri che i colleghi albanesi torneranno a casa con una bella esperienza professionale ed umana.

Grazie dell'attenzione e buon lavoro.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Ideja që po jap në këtë takim, është ajo e pasurimit të mëtejshëm të bashkëpunimit tonë policor, mbi fenomenet kriminale emergjente, post-pandemi...»



Z. Vittorio RIZZI

ZËVENDËSSHEFI I POLICISË ITALIANE,
DREJTOR I DREJTORISË QENDRORE TË POLICISË KRIMINALE ITALIANE

Italia ka pasur gjithmonë një raport miqësie me Shqipërinë, dhe jo i bazuar ekskluzivisht nga afërsia gjeografike, por mbi të gjitha nga rrënjët e përbashkëta kulturore dhe nga prezenca në vendin tonë i një numri të lartë shtetasish shqiptar. Në profilin e sigurisë (që është edhe kuadri i takimit tonë) bashkëpunimi ndërkombëtar policor me Shqipërinë është ndër më intensivët dhe aktivët në vendin tim, dhe si do theksoj edhe më tej, e dëshmojnë të dhënat objektive. Shefi jonë i Policisë dhe Shefi i Policisë Veliu, kanë dashur me shumë vullnet krijimin së fundmi të *takimit të përkohshëm teknik midis Italisë dhe Shqipërisë*¹ dhe Ambasadori Italian këtu në Tiranë, Fabrizio Bucci, ka mbështetur me shumë dëshirë këtë iniciativë, që është vetëm një nga bashkëpunimet më të fundit ndër shumë aktiviteteve të kryera së bashku.

Takimi përfaqëson një mundësi për konfrontim të drejtpërdrejtë, dhe na lejon të shkëmbejmë informacione operative jo vetëm mbi çështjet më urgjente (si ajo e rritjes së fenomenit emigrues nga kufiri greko-shqiptar ose ajo e luftës kundër kultivimit të kanabisit) gjithëpërfshirëse që nga fazat fillestare të hetimeve si edhe për përgatitjen e raporteve mbi analizat e fenomeneve kriminale mbi të cilat duhet të orientojmë strategji

¹ Fjala e z. Vittorio Rizzi, zëvendës shefi i Policisë Italiane dhe drejtor i Drejtorisë Qendrore të Policisë Kriminale Italiane, në konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe sigurisë".

të përbashkëta për parandalimin dhe goditjen e tyre. Italia është përherë mbështetëse (ose “tifoza e parë”) për futjen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe është në rresht të parë me një seri *projektesh* të favorizuara pikërisht nga Komisioni Evropian. I referohem, mbi të gjitha, Projektit IPA 2019 “*Countering Serious Organized Crime in the Western Balkans*”, i cili pason atë të mëparshmin të 2017-s, në të cilin Departamenti jonë i Sigurisë Publike, së bashku me agjencinë gjermane GIZ, ka detyrën të operojë në tre aspekte thelbësore, projektesh si:

- suporti operativ;
- bashkëpunimin strategjik;
- zhvillimin e mëtejshëm të ndërveprimit dhe të përputhshmërisë së sistemeve të informacionit dhe të bankës së të dhënave.

I referohem, ende Projektit PAMECA V, nën drejtimin italian, me *partneritetin* e Austrisë dhe Francës i cili është në fazë përmbyllëse² dhe që ka dhënë mundësi të jashtëzakonshme formimi për policinë shqiptare. Aq sa Bashkimi Evropian po negocion për një projekt të ri që të fillojë, dhe kjo dhe me mbështetjen e drejtorit Veliu, që të mund të zgjerohet në specializime dhe në modernizime të policisë shqiptare.

Fakti që këto projekte nuk janë vetëm shprehje të vullnetit të mirë dhe të fqinjësisë së mirë, dëshmohet në mënyrë të qartë nga *rezultatet e aktiviteteve operative të përbashkëta*. Në 2020, me rënien e paevitueshme të aktiviteteve operative nga shkak i pandemisë, arrestimet e të kërkuarve aktiv (të kërkuar nga autoritetet italiane dhe të gjendur në Shqipëri) kanë qenë 68 dhe këtë vit të dhënat e azhurnuara flasin që tani për 47 persona. Të kërkuarit pasivë (të gjendur në Itali dhe të kërkuar nga autoritetet shqiptare) kanë qenë 24 në 2020, ndërsa në pesë muajt e parë të 2021 kanë qenë 6. Gjithmonë në 2020, ekstradimet aktive kanë qenë 28, ndërsa në pesë muajt e parë të 2021 kanë qenë 22. Ekstradimet pasive kanë qenë 14 në 2020, të dhëna më të larta në 2021 me 17 ekstradime në pesë muajt e parë. Me këto të dhëna Shqipëria vendoset në vendin e parë midis vendeve *extra-BE* si për numrin e të kërkuarve si dhe për ekstradimet aktive dhe në vend të dytë midis vendeve *extra-BE* për numrin e të kërkuarve pasivë.

Aktualisht janë aktive 7 skuadra hetimore të përbashkëta që përfshijnë vepra të ndryshme, nga trafiku ndërkombëtar i drogës deri tek pedofilia, dhe është në fazë firme edhe një bashkëpunim i mëtejshëm për të krijuar dhe skuadër të tetë. Të dhënat e Drejtorisë Qendrore për Shërbimet Antidrogë, dëshmojnë nga ana tjetër se sasia e marijuanës e sekuestruar në Itali, që vinte ose transitonte nga Shqipëria, është në rënie të ndjeshme në katërvjeçarin e fundit, ashtu si është në rënie nëse krahasojmë katërmujorin e këtij viti me atë të vitit të kaluar. Objektivat e arritura, edhe fal fushatës së monitorimit, e kryer mbi bazën e protokollit specifik operativ i firmosur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme Italiane³ për aktivitetin e monitorimit nga *Guardia di Finanza*. Fushat e cila në 2020, në pandemi të plotë, ka dhënë rezultate operative të shkëlqyera në lidhje me plantacionet e gjetura, çka i lejoji Policisë Shqiptare të priste dhe të shkatërronte më shumë se 58.000 bimë narkotike (58.423).

Propozimi

Pikërisht fal historisë së bashkëpunimit tonë policor, ndjehem i nderuar të propozoj një variant të ri pune, për të ndarë një përvojë të cilën e kemi fituar në Itali dhe gjithashtu shpërndarë edhe nëpërmjet Europol. Italia ka qenë fatkeqësisht vendi i parë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

evropian i cili përballoi pandeminë dhe direkt nga prilli i 2020, është krijuar një *organizëm i përkohshëm monitorimi dhe analizimi mbi rrezikun e infiltrimit në ekonomi të krimit të organizuar* për të cilën më është besuar kryesimi. Marrin pjesë të gjitha forcat e policisë italiane: Drejtoria Hetimore Antimafia dhe Drejtoria Qendrore për Shërbimet Antidrogë, dhe kam mundësinë të ftoj në punimet e saj përfaqësuesit më të lartë të administratës publike dhe private që mund të japin elementë informativë dhe analizimi për temat në interes.

Misioni i organizmit të përkohshëm, është ai i parashikimit, nëpërmjet një monitorimi të hollësishëm në rrafshin e brendshëm dhe ndërkombëtar, çdo mundësi zgjerimi, të ndryshimit të tregut, të ndërhyrjes në sistemin ekonomik, të ndikimit në proceset vendimmarrëse publike për të përcaktuar tenderët nga ana e kriminalitetit të organizuar. Mbi bazën e eksperiencës italiane, në korrik u krijua nëpërmjet Europol-it, *Working Group on Covid-19 criminal threats and law enforcement responses*, i bashkëdrejtuar nga unë dhe nga drejtori ekzekutiv i të ashtuquajturës *Agjencia*, Catherine De Bolle, e cila është mbledhur tanimë pesë herë; takimi i fundit javën e kaluar.

Working Group ka pjesëmarrjen e forcave të policisë së Austrisë, Belgjikës, Francës, Gjermanisë, Holandës, Polonisë, Spanjës, Suedisë, dhe Mbretërisë së Bashkuar, përtej Italisë dhe Interpolit, dhe ka objektivin e dhënies së informacioneve mbi skenarët kriminalë për një aksion me efikas për parandalimin dhe goditjen, duke kapur sinjale dhe tendenca për të dhënë *alarme* mbi ekspozimin e ekonomisë së ligjshme mbi agresionin mafioz.

Ideja që po jap në këtë takim është ajo e pasurimit të mëtejshëm të bashkëpunimit tonë policor me një takim mbi konfrontimin mbi fenomenet kriminale emergjente post-pandemie gjithmonë me objektivin e parandalimit dhe të goditjes së kërcënimeve të reja që lindin (dhe ndoshta kjo ide mund t'i pëlqejë edhe Europolit dhe *Grupi* jonë i punës mund të shtrihet në të gjithë zonën ballanike).

Përmbyll ndërhyrjen time, në kuadër të akademisë kaq prestigjioze me një iniciativë të dedikuar ndaj formimit të funksionarëve shqiptarë që do të nisë në Itali më 7 qershor e që do të zgjasë një javë (financuar nga Projekti PAMECA V).

Flitet për *kursin trajnues për 28 hetuesit shqiptarë të BKH-së (Byroja Kombëtare e Hetimit)*, zyra e re e ngjashme me DIA-n tonë dhe që bën pjesë në SPAK, strukturën e re speciale të krijuar për luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kemi përgatitur programin e trajnimit me shumë kujdes duke parashikuar një mundësi trajnimi mjaft të pasur, me vizita në strukturat ekselente si në Shërbimin e Policisë Shkencore, CRAIN (Qendra e kërkimit për analizimin e të dhënave multimediale) dhe në Policinë Postale dhe të Komunikacionit dhe jemi të sigurt se kolegët shqiptarë do të kthehen në shtëpi me një eksperiencë të bukur profesionale dhe humane.

Faleminderit për vëmendjen dhe punë të mbarë.

¹ Kjo deklaratë bashkëpunimi është firmosur fillimisht në Tiranë më 10 dhjetor dhe në Romë më 17 dhjetor 2020.

² Mbarimi ishte më 19 majin e shkuar, por me zgjatje deri më 19 shtator 2021.

³ Në periudhën 2017-2019 një pjesë e orëve të monitorimit është financuar nga projekti SANCAS.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«I strongly believe that academic and research work is very important for raising awareness and providing solutions to the many challenges of security»



Mrs. Limya ELTAYEB
UNDP RESIDENT REPRESENTATIVE

Dear Excellencies, Colleagues and organizers of this scientific conference,

I am very pleased to be at this conference that brings together professionals from different sectors and academia in the area of Natural Disasters and Security. I strongly believe that academic and research work is very important for raising awareness and providing solutions to the many challenges of today, including security, natural disasters, pandemics and climate change. The UNDP HDR 1994 stated “The world can never be at peace unless people have security in their daily lives”, thus introducing the concept that human security is “people-centered” and in line with the concepts of human rights and human development.

Seven types of human security: economic security; food security; health security; environmental security; personal (physical) security; community security; and political security. This challenge calls for bold action and integrated approaches that preserve and uphold human rights, improve people’s living conditions and access to basic services, strengthens people’s resilience to natural and manmade disasters, and, in Albania

Mrs. Limya Eltayeb, UNDP Resident Representative Welcoming speech at the VI International Scientific Conference: “Extreme phenomena of nature and security issues.”

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

in particular, also fight organized crime, corruption and domestic violence as threat the main to human dignity.

At the regional level, NATO and EU integration can be a cornerstone of security, democratization and economic development for the region, however, difficult and slow implementation have prevented the Western Balkans from emerging as a security community.

Unresolved issues in the region also slow down the reconciliation processes and are contributing to maintaining a low level of trust among the countries. Insecurities emerge from risks (especially unmanaged risks). Risks are more and more interdependent and multidimensional. The Covid-19 pandemic has made clear that security depends on many different factors, including state capacities, public goods, as well as accessible and inclusive information. Personal risks, like domestic violence, and risks posed by the environment, like land degradation, floods or the pandemic, also affect one's perception of security.

Maintaining the right balance between security and human rights and adhering to the democratic principles of transparency and accountability, has become more and more challenging. It is evident that *Human Security* is not only a question for the armed or security forces but also one where the public sector plays an important role, including the provision of health care and social security, and citizen trust in state institutions. We all recognize the importance that proper planning and preparedness can have in mitigating the impact of a disasters and risks.

UNDP work

For the last two decades, UNDP supported national capacities for managing, monitoring, and coordinating humanitarian mine action activities and the clearance of mine contaminated area of northeast Albania and hotspots. This assistance concluded earlier this year and by the end of 2020, a total of 1,5 million sqm of land has been cleared and certified as free of ammunitions in 18 cleared hotspots. Since 2019 we have supported the implementation of the Western Balkans Roadmap for a sustainable solution to the illegal possession, misuse and trafficking of Small Arms and Light Weapons (SALW) and their ammunition in the Western Balkans by 2024.

the modernization of the Albanian Institute of Scientific Police and the State Police for strengthening their capacities and technology in small arms control and the fight against crime and the reduction of firearms misuse and illicit trafficking. In partnership with the Government of Poland, UNDP has just started another initiative that supports the firefighting and rescue services in several Albanian municipalities. The annual opinion poll Trust in Governance, capturing public perceptions on public institutions' performance, institutional transparency and accountability, corruption, level of citizen engagement in policy and decision-making, satisfaction with public service delivery, and enforcement of non-discriminatory laws and policies.

DRR

In partnership with the Government of Sweden, UNDP supports the national framework for DRR and resilience both for national policy and legal framework and its operationalization at the local level. We partnered with the Ministry of Defense, the National Agency of Civil Protection and many institutions to establish a strong system of Disaster Risk Reduction and Civil Protection system so Albania can become a mem-

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

ber of the EU Civil Protection Mechanism. UNDP has completed the Capacity Assessment process as indispensable step for risk informed policy and implementation of the DRM system in Albania. And for a shared vision for the Disaster Risk Management System in the DRR strategy and other planning documents at central and local level. Instead of postdisaster interventions, such as reconstruction and rehabilitation efforts, we are working together with the Government and development partners ... to build more disaster resilient institutions and society.

Closing

We stand with Albanian people, Albanian Government and Albanian partners to further strengthen the Disaster Risk Management System in Albania and together with academia and research institutions implement policies that will ensure human security and protect people, investments and human development in the face of multidimensional risks.

Thank you to all and especially to the Security Academy for bringing us all together in this important cause!



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Besoj fuqimisht se puna akademike dhe kërkimore është shumë e rëndësishme për sigurimin e zgjidhjeve të shumë sfidave të sigurisë»



Znj. Limya ELTAYEB
REZIDENTE E PËRHERSHME E UNDP

Të nderuar Shkëlqesi, kolegë dhe organizatorë të kësaj konference shkencore! Unë jam shumë e kënaqur që marr pjesë në këtë konferencë, e cila bashkon profesionistë nga sektorë të ndryshëm, si dhe akademikë në fushën e katastrofave natyrore dhe sigurisë.

Unë besoj fuqimisht se puna akademike dhe kërkimore është shumë e rëndësishme për rritjen e ndërgjegjësimit dhe sigurimin e zgjidhjeve për shumë sfida të sotme, përfshirë sigurinë, katastrofat natyrore, pandemitë dhe ndryshimet klimatike.

HDR e PNUD-it 1994 deklaroi: “Bota nuk mund të jetë kurrë në paqe nëse njerëzit nuk kanë siguri në jetën e tyre të përditshme”, duke prezantuar kështu konceptin se siguria njerëzore është “në qendër të njerëzve” dhe në përputhje me konceptet e të drejtave të njeriut dhe zhvillimit njerëzor. Shtatë llojet e sigurisë njerëzore: siguria ekonomike; siguria ushqimore; siguria shëndetësore; siguria mjedisore; siguria personale (fizike); siguria në bashkësi; dhe siguria politike. Kjo sfida kërkon një veprim të guximshëm dhe qasje të integruara që ruajnë dhe mbështesin të drejtat e njeriut, përmirësojnë kushtet e jetesës së njerëzve dhe qasjen në shërbimet themelore, forcon qëndrueshmërinë

Fjala e Rezidentës së Përhershme të UNDP-së, znj. Limya Eltayeb, në konferencën VI shkencore ndërkombëtare: “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

e njerëzve ndaj katastrofave natyrore dhe të krijuara nga njeriu, dhe në veçanti në Shqipëri, gjithashtu lufton krimin e organizuar, korrupsionin dhe dhunën si kërcënim kryesor për dinjitetin njerëzor.

Në nivelin rajonal, integrimi në NATO dhe në BE mund të jetë një gur themeli i sigurisë, i demokratizimit dhe i zhvillimit ekonomik për rajonin, megjithatë, zbatimi i vështirë dhe i ngadaltë ka parandaluar që Ballkani Perëndimor të shfaqet si një komunitet i sigurisë. Çështjet e pazgjidhura në rajon ngadalësojnë gjithashtu proceset e pajtimit dhe po kontribuojnë në ruajtjen e një niveli të ulët të besimit midis vendeve. Pasiguritë dalin nga rreziqet (sidomos rreziqet e pamenaxhuara). Rreziqet janë gjithnjë e më të ndërvarura dhe shumëdimensionale. Pandemia Covid-19 bëri të qartë se siguria varet nga shumë faktorë të ndryshëm, përfshirë kapacitetet shtetërore, të mirat publike, si dhe nga informacione të arritshme dhe gjithëpërfshirëse. Rreziqet personale, si dhuna në familje, dhe rreziqet që paraqiten nga mjedisi, si degradimi i tokës, përmbytjet ose pandemia, gjithashtu ndikojnë në perceptimin për sigurinë.

Ruajtja e ekuilibrit të duhur midis sigurisë dhe të drejtave të njeriut dhe respektimi i parimeve demokratike të transparencës dhe përgjegjësisë, është bërë gjithnjë e më sfiduese. Është e qartë se *siguria njerëzore* nuk është vetëm një çështje për forcat e armatosura ose të sigurisë por edhe një çështje ku sektori publik luan një rol të rëndësishëm, duke përfshirë sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe sigurinë shoqërore, si dhe besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore. Ne të gjithë e njohim rëndësinë që mund të ketë planifikimi dhe gatishmëria e duhur në zbutjen e ndikimit të fatkeqësive dhe rreziqeve.

Puna e PNUD-it

Për dy dekadat e fundit, PNUD-i mbështeti kapacitetet kombëtare për menaxhimin, monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarive humanitare të çminimit dhe pastrimin e zonës së kontaminuar nga minat në verilindje të Shqipërisë dhe pikat e nxehta. Kjo ndihmë përfundoi në fillim të këtij viti dhe deri në fund të vitit 2020, një total prej 1.5 milion m^2 tokë është pastruar dhe certifikuar si pa municione në 18 zona të kontaminuara. Që nga viti 2019 ne kemi mbështetur zbatimin e *Udhërrëfyesit të Ballkanit Perëndimor* për një zgjidhje të qëndrueshme për posedimin, keqpërdorimin dhe trafikimin e paligjshëm të *Armëve të Vogla dhe të Lehta* (SALW) dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor.

Deri në vitin 2024, synohet modernizimi i Institutit Shqiptar të Policisë Shkencore dhe Policisë së Shtetit për forcimin e kapaciteteve dhe teknologjisë së tyre në kontrollin e armëve të vogla dhe luftën kundër krimit dhe uljen e keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe trafikimit të paligjshëm. Në partneritet me Qeverinë e Polonisë, PNUD-i sapo ka filluar një iniciativë tjetër që mbështet shërbimet zjarrfikëse dhe shpëtimit në disa komuna shqiptare. Sondazhi vjetor i opinionit *Besimi në qeverisje*, ka kapur perceptimet e publikut mbi performancën e institucioneve publike, transparencën institucionale dhe llogaridhënien, korrupsionin, nivelin e angazhimit të qytetarëve në politikë dhe vendimmarrje, kënaqësinë me ofrimin e shërbimeve publike dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave jo-diskriminuese.

DRR

Në partneritet me Qeverinë e Suedisë, PNUD-i mbështet kornizën kombëtare për DRR dhe qëndrueshmërinë si për politikën kombëtare dhe kornizën ligjore dhe funksionimin e saj në nivelin lokal. Ne kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Mbrojtjes,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe shumë institucione për të krijuar një sistem të fortë të Reduktimit të Rrezikut nga Katastrofat dhe Mbrojtjen Civile. Shqipëria mund të bëhet anëtare e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së.

PNUD-i ka përfunduar procesin e Vlerësimit të Kapacitetit si hap i domosdoshëm për politikën e informuar mbi rreziqet dhe zbatimin e sistemit *DRM* në Shqipëri, si dhe për një vizion të përbashkët për Sistemin e Menaxhimit të Rrezikut të Fatkeqësive në strategjinë e DRR-së dhe dokumentet e tjera të planifikimit në nivelin qendror dhe lokal. Në vend të ndërhyrjeve pas shkatërrimit, siç janë përpjekjet për rindërtim dhe rehabilitim, ne po punojmë së bashku me qeverinë dhe partnerët e zhvillimit për të ndërtuar institucione dhe shoqëri më të qëndrueshme ndaj katastrofave.

Në mbyllje

Ne qëndrojmë me popullin shqiptar, qeverinë shqiptare dhe partnerët shqiptarë për të forcuar më tej Sistemin e Menaxhimit të Rrezikut nga Katastrofat në Shqipëri dhe së bashku me akademinë dhe institucionet kërkimore zbatojnë politika që do të sigurojnë sigurinë njerëzore dhe do të mbrojnë njerëzit, investimet dhe zhvillimin njerëzor përballë rreziqeve shumëdimensionale.

Faleminderit të gjithëve dhe veçanërisht Akademisë së Sigurisë që na bashkoi të gjithëve në këtë kauzë të rëndësishme!



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Të tilla organizime na ndihmojnë ta ngremë debatin nga niveli i thashethemeve dhe i *fake news*, në nivel akademik dhe shkencor»



Z. Erion VELIAJ
KRYETAR I BASHKISË SË TIRANËS

Kur morëm detyrën në 2015, Tiranën e gjetëm me territor më të zgjeruar, si rezultat i reformës administrative territoriale. Ky ishte një rast ideal për t'i përfshirë zonat rurale në rrugën e transformimit urban të Tiranës duke u ofruar atyre mundësi për zhvillim më të qëndrueshëm si dhe shërbime më efikase e gjithëpërfshirëse. Por në anën tjetër, pesha e përgjegjësisë së menaxhimit të sfidave, kryesisht atyre që lidhen me fenomeneve ekstreme të natyrës, për ne, do të rëndonte më shumë.

Përmbytjet ishin një sfidë më vete. Sasitë e mëdha të reshjeve ishin kthyer në makth për shumë lagje të kryeqytetit duke rrezikuar shpesh daljen nga shtrati të Lumit të Tiranës, apo rrëshqitje të dherave pranë zonave të banuara. Por, me mbështetjen e komunitet ia dolëm të gjejmë zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë. Shumë qytetarë na u bashkuan për mbjelljen e mijëra pemëve në kuadër të projektit “Pylli Orbital”. Gjithashtu, jemi angazhuar në zgjerimin dhe sistemimin e shtratit të Lumit të Tiranës dhe sot në kohë reshjesh apo stuhish, lumi fatmirësisht qëndron brenda shtratit si dhe rreziku i rrëshqitjeve të dherave është ulur dukshëm.

Zjarret në pyje, janë një sfidë tjetër me të cilën jemi përballur vazhdimisht përgjatë

Fjala e z. Z. Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë së Tiranës, në konferencën VI shkencore ndërkombëtare: “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

këtyre viteve. E megjithatë, duke investuar për transformimin e rrënjësishëm të shërbimit të zjarrfikësve, kryesisht me shtesa në staf, trajnime, veshje dhe uniforma, ambiente dhe pajisje moderne, kemi arritur që t'i përgjigjemi më me efikasitet thirrjes së banorëve, deri në zonat më të thella rurale të territorit të Tiranës. Gjithashtu, kemi filluar ndërtimin e stacioneve të reja të shërbimit zjarrfikës, si ai në Kinostudio, ku nuk ishte vënë dorë prej 40 viteve. Ndaj, jam realisht krenar, pasi me stacionet moderne, të cilat po ndërtohen sipas standardeve evropiane, risim jo vetëm cilësinë e shërbimit, por edhe kohën e përgjigjes në raste zjarri, aksidentesh, apo emergjencë të tjera.

Ndërkohë, rishtazi, dy nga sfidat e fundit, ndoshta më të vështirat e shekullit, ishin tërmetet shkatërruese dhe pandemia për të cilat u kërkuar jashtëzakonisht shumë energji dhe përkushtim për t'i vendosur nën kontroll. Sfidat të cilat testuan qëndrueshmërinë dhe karakterin tonë. Dy tërmetet ishin një mundësi për të reflektuar se si mund të projektojmë më mirë dhe të ndërtojmë më fortë. Në anën tjetër, pandemia na mësoi të jemi më njerëzor, më solidar, më të organizuar dhe më të ndjeshëm ndaj njëri tjetrit. Të gjithë këto përbërës, të kombinuar me mirëqeverisjen dhe vaksinimin masiv rezultuan një formulë suksesi që po na ndihmon të rihapim Tiranën më shpejt, duke u rikthyer tek punët e mira dhe përgatitjet plot entuziazëm për vitin 2022, kur Tirana do të jetë *Kryeqyteti evropian i rinisë*.

Ndaj, sot me krenari mund të them se duke punuar të bashkuar kemi mësuar se sfidat janë një mundësi për t'u ringritur më të fortë dhe më të përgatitur si shoqëri. Besoj fort se jemi në rrugën e duhur. Por, pyetja është: "A mund të bënim më shumë dhe më mirë"? Patjetër që po! Gjithmonë ka hapësirë për reflektim ku si shoqëri mund të nxjerrim mësim, për t'u përmirësuar dhe përgatitur më mirë për sfidat e ardhshme.

Bota ofron mjaft shembuj të mirë, ku në shoqëritë e dijes, këto tema zhvillohen me ndihmën dhe kontributin e komunitetit shkencor. Studiues, profesionistë dhe akademikë, përmes kërkimeve shkencore dhe hulumtimeve, japin alternativa, zgjidhje dhe rekomandime se si mund të avancojmë dhe të përmirësohemi për sfidat e ardhshme. Ndaj jam shumë i lumtur, që në të njëjtën frymë po zhvillohet edhe kjo konferencë në Tiranë. Të tilla organizime na ndihmojnë ta ngremë debatin nga niveli i thashethemeve dhe "fake news", në nivel akademik dhe shkencor.

E megjithatë, jam i bindur se sfida me tërmetet dhe pandeminë nuk ka qenë një periudhë e lehtë për komunitetin e shkencës dhe të dijes, të cilët, me përkushtim, kanë punuar dhe kontribuar me numra dhe me fakte, nën presionin e asaj minorancës zhurmuese që hasim përditë në rrjetet sociale. Por, asgjë nuk munda t'u ndalë, pasi besoj, se tek secili prej jush, personifikohet ajo thënie e Neil de Grasse Tyson: "E mira e shkencës është se qëndron gjithmonë e vërtetë pavarësisht nëse zgjedhim të besojmë apo jo në të".

Shumë mirënjohës ndaj të gjithë atyre që vazhdojnë ndihmojnë, punojnë dhe kontribuojnë duke bërë të mundur që përmes dijes dhe shkencës, sot, si shoqëri, të jemi më të fortë dhe më të lehtësuar nga ethet e tërmeteve dhe pandemisë.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Unë jam e sigurt që Akademia ka një të ardhme të madhe përpara, dhe ajo është e gatshme të bashkohet me familjen e policisë evropiane»



PhD Tiina KOIVUNIEMI
KËSHILLTAR REZIDENT I BINJAKËZIMIT

Në janar 2020 ne filluam një projekt të binjakëzimit: *Forcimi i kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë, Shqipëri*. Binjakëzimi është një instrument i Bashkimit Evropian për bashkëpunimin institucional midis administratave publike të shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve përfituese ose partnere. Projektet e binjakëzimit mbështesin zhvillimin e administratës dhe legjisllacionit në zgjerimin e BE-së dhe vendet fqinje. Kjo arrihet duke transferuar njohuri midis vendeve përfituese dhe organizatave të sektorit publik të vendeve anëtare të BE-së ose organeve të tjera publike të mandatuara nga Komisioni Evropian. Përmes projekteve të binjakëzimit, agjencitë në vendet përfituese dhe shtetet anëtare të BE-së mund të ndajnë praktikatat më të mira, të krijojnë rrjete të vlefshme dhe të forcojnë vizibilitetin e tyre ndërkombëtar. Binjakëzimi është një investim në ekspertizën e agjencive pjesëmarrëse dhe shërben si një nxitje për zhvillimin e burimeve njerëzore.

Qëllimi i projektit, *Forcimi i kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë*, është të përmirësojë aftësitë arsimore dhe trajnuese, aftësitë kërkimore shkencore dhe menaxhimin e përgjithshëm të Akademisë Shqiptare të Sigurisë në ofrimin e programeve

Përsëritetja e PhD Tiina Koivuniemi, Këshilltar Rezident i Binjakëzimit, për konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë".

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

arsimore profesionale për Policinë e Shtetit Shqiptar dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Projekti mbështet Akademinë e Sigurisë për të përditësuar dhe përmirësuar vizionin e saj strategjik dhe planifikimin operacional, për të ndërtuar kapacitetet e saj njerëzore dhe kapacitetet e tjera dhe për të mundësuar ndarjen e njohurive midis ekspertëve shqiptarë, finlandezë dhe estonezë në trajnimin e zbatimit të ligjit.

Projekti ka dy komponentë. Gjatë *Komponentit 1*, qeverisja dhe menaxhimi i Akademisë së Sigurisë do të përmirësohet dhe harmonizohet me standardet e BE-së. Si rezultat i komponentit, mandati dhe funksionet e Akademisë së Sigurisë (AS) harmonizohen me kornizën ligjore dhe organizative, në përputhje me standardet e BE-së. Procedurat administrative, qeverisja dhe menaxhimi i Akademisë së Sigurisë gjithashtu përmirësohen.

Gjatë vënies në zbatim të *Komponentit 2*, do të forcohet një *zhvillim i kapaciteteve* në fushën e bashkëpunimit ndërinstitucional. Si nënrezultat i komponentit 2, aftësitë e trajnimit dhe kërkimit të Akademisë së Sigurisë janë rritur dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit është plotësisht funksional.

Kohëzgjatja e projektit është 24 muaj dhe buxheti është 2 milion euro. Në këtë projekt, kemi 4 partnerë: Kolegji Universitar i Policisë, Universiteti i Shkencave të Zbatuara JAMK, Instituti Finlandez i Menaxhimit Publik HAUS, nga Finlanda, si dhe Siisekaitseakademie nga Estonia. Dy partnerë janë institucione arsimore policore. Në projekt, ekspertë afatshkurtër nga Finlanda dhe Estonia po punojnë së bashku me kolegët në Akademinë e Sigurisë. Mekanizmat e rëndësishëm të projektit janë puna ndërmjet kolegëve dhe shkëmbimi i përvojave. Për shkak të pandemisë Covid-19, projekti është zbatuar në distancë që nga maji i vitit 2020. Shpresojmë që të kthehemi në zbatimin normal në fund të korrikut dhe kjo do të thotë që pothuajse çdo javë do të kemi ekspertë që punojnë në akademinë e sigurisë me kolegët tanë shqiptarë.

Hapat e ardhshëm në projekt janë ndërtimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë në Akademinë e Sigurisë dhe përditësimi i strategjisë së kërkimit dhe zhvillimit. Më vonë këtë vit ne do të fillojmë trajnimin për kurrikulën e drejtuar nga aftësitë dhe pedagogia bashkëkohore, trajnimin për kërkimin akademik dhe trajnimin për *udhëheqjen pedagogjike*. Një pjesë e rëndësishme e projektit është zhvillimi i programeve mësimore në të gjitha nivelet - në Kolegjin e Policisë, nivelin *bachelor* dhe *master* si dhe trajnime të mëtejshme.

Në nëntor 2020, hyri në fuqi vendimi Këshillit të Ministrave nr. 881, datë 28.10.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”. Sipas vendimit, Akademia e Sigurisë është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike. Përvojat në Finlandë dhe Estoni kanë treguar se një sistem i unifikuar policor dhe trajnimi i zbatimit të ligjit garanton arsim policor me cilësi të lartë dhe se profesionistët më të mirë do të punojnë në forcën e policisë. Sidomos në vendet e vogla siç janë vendet tona, kjo është mënyra më mbresëlënëse për të prodhuar arsim. Pavarësia e akademive i jep mundësinë zhvillimit aktiv të organizatës dhe ofron një mundësi për të zhvilluar vetë trajnimin policor. Kërkimi, zhvillimi dhe inovacionet janë një pjesë integrale e akademisë moderne të sigurisë. Konferenca në të cilën po marrim pjesë është një shembull i mirë i kësaj. Në një botë që ndryshon me shpejtësi, akademitë e sigurisë duhet të jenë në gjendje të ofrojnë kërkime me cilësi të lartë për të mbështetur punën e policisë dhe njësive të zbatimit të ligjit.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

“ Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë ”

Unë jam e sigurt që Akademia ka një të ardhme të madhe përpara dhe, si rezultat i punës së saj aktive të zhvillimit, ajo është e gatshme të bashkohet me familjen e policisë evropiane dhe institucioneve të trajnimit të zbatimit të ligjit. Tema e konferencës së sotme është shumë e rëndësishme. Autoritetet duhet të veprojnë pa probleme në të gjitha situatat sfiduese, qofshin operacionet policore apo katastrofat natyrore. Shpresoj që kjo konferencë të ofrojë një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe aktorët më të gjerë në fushën e zbatimit të ligjit, për të mësuar gjëra të reja. Shpresoj që dhjetëra punime kërkimore të paraqitura sot të ofrojnë ide për zhvillim dhe bashkëpunim të shtuar midis aktorëve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«I am sure that the Academy has a great future ahead of it and, as a result of its active development work, it is ready to join the family of European police»



PhD Tiina KOIVUNIEMI
RESIDENT TWINNING ADVISOR

Ladies and Gentleman,
In January 2020 we started a Twinning-project *Strengthening the capacities and efficiency of the Security Academy – Albania*.

Twinning is a European Union instrument for institutional cooperation between Public Administrations of EU Member States and beneficiary or partner countries. Twinning projects support the development of administration and legislation in the EU enlargement and neighbourhood countries. This is achieved by transferring knowledge between the beneficiary countries and EU Member States' public sector organizations or other public bodies mandated by the European Commission. Through Twinning projects, agencies in beneficiary countries and the EU Member States can share best practices, set up valuable networks, and strengthen their international visibility. Twinning is an investment in the expertise of participating agencies and serves as an incentive for the development of human resources.

The aim of the *Strengthening the capacities and efficiency of the Security Academy*

PhD Tiina Koivuniemi, Welcoming speech at the VI International Scientific Conference:
“Extreme phenomena of nature and security issues.”

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

– *Albania* – project is to improve the education and training capacities, scientific research capabilities, and overall management of the Albanian Security Academy in delivering professional educational programs for Albanian State Police and other Law Enforcement Agencies. The project supports the Security Academy to update and enhance its strategic vision and operational planning, build its human and other capacities, and enable knowledge sharing between Albanian, Finnish and Estonian experts in law enforcement training.

The project has two components. During *Component 1* Security Academy's governance and management will be improved and aligned with EU standards. As a result of the component, the mandate and functions of the Security Academy (SA) are harmonized with the legal and organizational framework, in line with EU standards. Security Academy's administrative procedures, governance, and management are enhanced.

During the implementation of Component 2, a Capacity Development in the area of inter-institutional cooperation will be strengthened. As a *Sub-result of component 2* Security Academy's training and research capacities *are enhanced* and Inter-Institutional Cooperation with other Law Enforcement Agencies is fully functional.

The duration of the project is 24 months and the budget is 2 million Euros.

In this project, we have 4 partners: Police University College, *JAMK University of Applied Sciences* and *HAUS Finnish Institute of Public Management* from Finland, and *Siisekaitseakademie* from Estonia. Two partners are police education institutes. In the Project, Short term experts from Finland and Estonia are working together with colleagues in the Security Academy. Important mechanisms of the project are peer-to-peer working and sharing experiences. Due to the Covid-19 pandemic, the project has been implemented remotely since May 2020. We hope to return to the normal implementation at the end of July and this means that almost every week we will have experts working in the security academy with our Albanian colleagues.

The next steps in the project are building up a quality management system in the Security Academy and update research and development strategy. Later this year we will start training on competence-driven curricula and contemporary pedagogies, training on academic research, and training on Pedagogical Leadership. One important part of the project is developing curriculums on all levels – in Police College, bachelor and master level as well as further training.

In November 2020 Decision 881 *awarding the Special Status to the Security Academy, as the only public institution of higher education in the field of public security order, as well as its organization and functioning* came into force. According to the decision The Security Academy, is the only public institution of higher education in the field of public order and security. Experiences in Finland and Estonia have shown that a unified police and law enforcement training system guarantees high-quality police education and that the best professionals will work in the police force. Especially in small countries like our countries are, this is the most impressive way to produce education. The independence of the academies gives the possibility to the active development of the organization and provides an opportunity to develop police training itself. Research, development, and innovations are an integral part of the modern security academy. The conference we are participating in today is a good example of this. In a rapidly changing world, security academies need to be able to provide high-quality research to support the work of police and law enforcement units.

I am sure that the Academy has a great future ahead of it and, as a result of its active

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

development work, it is ready to join the family of European police and law enforcement training institutions. The topic of today's conference is very important. The authorities must act seamlessly in all challenging situations, be it police operations or natural disasters. I hope that this conference will provide an opportunity for all participants, as well as wider actors in the field of law enforcement, to learn new things. I hope that the dozens of research papers presented today will provide ideas for development and increased collaboration between actors in the area of safety and security.

Thank you!



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

«Të lumtur që rikthehemi në këtë konferencë ndërkombëtare të sigurisë»



Z. Malfor NURI
ADMINISTRATOR, "TAP ALBANIA"

Jemi të lumtur të rikthehemi në këtë konferencë ndërkombëtare të sigurisë, falë bashkëpunimit tonë të ngushtë me Akademinë e Sigurisë. Sot, TAP-i është një kompani e ndryshme nga dy vite më parë, kur ne morëm pjesë për herë të parë në një konferencë të tillë të Akademisë së Sigurisë. TAP-i ka finalizuar fazën e ndërtimit në Shqipëri, si edhe në dy vendet e tjera, në Greqi dhe në Itali, dhe duke filluar nga data 15 nëntor 2020 ka hyrë në fazën e operacioneve tregtare. Në dhjetor 2020, sasia e parë e gazit mbërriti në Greqi dhe Bullgari, si edhe në Itali, pra ne jemi në një fazë të plotë të operacioneve komerciale në gjithë territorin ku punojmë. Në mes të muajit maj, deklaroj këtu sot në këtë konferencë, janë transportuar më shumë se 2 miliardë metër kub gaz natyror, i cili ka hyrë në Evropë nëpërmjet TAP-it, duke kontribuar në sigurinë energjetike, dhe në diversifikimin e burimeve energjetike për Evropën.

TAP është gazsjellësi i parë i këtij lloji në Shqipëri dhe si i tillë ka sjellë shumë risi. Ne jemi angazhuar të ndjekim gjithmonë praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare, duke filluar nga ndërtimi i tubacionit deri tek marrëdhënia me komunitetet apo mbrojtja e mjedisit. Ne kemi zbatuar një sistem të fortë sigurie që është

Përhëndetja e z. Malfor Nuri, administratori i "TAP Albania"-s, për konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë".

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

i njëjtë në të tre shtetet ku TAP operon, në Shqipëri, Greqi dhe Itali. Duhet të them se ndjeshmëria e TAP-it në rastet e emergjencave ka qenë aty dhe ne kemi qenë gjithmonë pranë komuniteteve. Këtu përmend rastin kur TAP qëndroi pranë komuniteteve, si në zonën e Korçës, Tiranës dhe komunitetin e Durrësit, me rastin e tërmeteve, pa lënë pas edhe bashkëpunimin e TAP-it me qeverinë Shqiptare me një ndihmë të ndjeshme financiare me rastin e pandemisë së COVID-19. Kemi sjellë të njëjtën ekspertizë në menaxhimin e operimeve të “Gazsjellësit TAP” në Shqipëri, si edhe standardet për të mbështetur zhvillimin e tregut të gazit.

Si pjesë e trashëgimisë sonë, praktikat e sigurisë të aplikuara nga TAP-i mund të përdoren në të ardhmen, gjatë procesit të gazifikimit të Shqipërisë nga kompanitë shqiptare apo nga ato të huaja, si Albgaz, IAP, etj. Ne krenohemi me bashkëpunimin e ngushtë që kemi vendosur me autoritetet vendore dhe qendrore që janë pjesë e menaxhimit të emergjencave, në rajonet përgjatë gjurmës së tubacionit. Vitin që shkoi, përpara se të fillonte operimi tregtar, TAP organizoi një seri takimesh me përfaqësuesit e këtyre institucioneve, për të ndarë me to masat e parashikuara nga TAP për menaxhimin e emergjencave ku u diskutuan gjithashtu edhe format e komunikimit dhe bashkërendimit midis TAP dhe autoriteteve shqiptare. Ne besojmë se mënyra më e mirë për t’u kujdesur për të ardhmen, është të jemi të përgatitur për të gjithë skenarët e mundshëm, duke përdorur teknologjinë dhe metodat më efikase, dhe burimet njerëzore më të kualifikuara. Gjithashtu, nëpërmjet programeve tona të Investimeve Socio Mjedisore, ne mbështetim Njësitë zjarrfikëse në të gjithë bashkitë përgjatë gjurmës së TAP-it. Këto projekte kanë përforcuar flotën e secilës bashki, me automjete të reja, pajisje të reja, si edhe trajnime të brigadave zjarrfikëse.

Në 25 vitet e ardhshme, TAP-i do të mbetet i angazhuar për bashkëpunim të ngushtë me autoritetet ligjvënëse të sigurisë, duke respektuar legjislacionin shqiptar dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurisë. Dhe, shpresoj se do të kemi kënaqësinë të ndjekim një prezantim më të detajuar nga kolegu im, Foto Duro, Këshilltar i Sigurisë në TAP, gjatë sesionit plenar në vijim.

TAP-i do të vazhdojë të punojë me autoritetet e sigurisë për çështjet e emergjencave. Është këmbim i vazhdueshëm i ekspertizës në fushën e sigurisë, që do t’i shërbejë edhe projekteve të tjera në industrinë e transmetimit të gazit që pritet të zhvillohen në Shqipëri.

Në mbyllje, ne do të vazhdojmë të punojmë sipas standardeve më të larta të industrisë, tek mbetemi të angazhuar për siguri me zero dëme për njerëzit dhe mjedisin.

Ju lutem qëndroni të sigurt! Faleminderit!

«Përcjell ndjesinë e respektit për punën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të stafit të Akademisë së Sigurisë»



Z. Haki ÇAKO

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË KOMBËTARE PËR MBROJTJEN CIVILE

Me lejon të shpreh kënaqësinë time të singertë për mundësinë dhe prezencën në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare, të organizuar nga Akademia e Sigurisë, Qendra e Kërkimeve Shkencore në veçanti, në bashkëpunim me partnerë të rëndësishëm, sikurse janë OSBE-ja, Bashkimi Evropian, UNDP-ja, universitete prestigjioze, IGJEUM-i, por edhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Si një ndër qindra dhe mijëra qytetarë të cilët kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë privilegjin të studiojnë dhe formohen në ambientet e kësaj akademie, përcjell ndjesinë dhe respektin për punën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të stafit të Akademisë së Sigurisë. E rëndësishme të theksojmë se rritjes së potencialeve me formimin e burimeve njerëzore në edukimin, trajnimin dhe shkollimin e brezave të rinj me drejtim ruajtjen e rendit dhe sigurisë, i shtohet sot kërkimi dhe studimin shkencor i proceseve dhe fenomeneve natyrore që ndikojnë në ecurinë normale të shoqërisë, rritjes ekonomike dhe sigurisë mbarëkombëtare. Prej kohësh qeveria shqiptare ka vendosur në prioritet një reformë të rëndësishme për përballimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, fenomene të cilat e kanë ekspozuar dhe vazhdojnë ta ekspozojnë vendin tonë ndër

Përshëndetja e Z. Haki Çako, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, për konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë".

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

vendet me rrezikshmërinë më të lartë në Evropë dhe në botë. Bazuar në analizën dhe studimet e bëra, Shqipëria është vend shumë i prekshëm nga fatkeqësitë, duke qenë në dhjetë vendet e botës me rrezikun më të lartë ekonomik nga rreziqet e shumëfishta: 86 % e territorit të saj, ku prodhohet 88.5 % e GDP-së, janë të ekspozuara ndaj dy ose më shumë rreziqeve. Këto, por edhe shumë tregues të tjerë të lidhur me rrezikun, cenueshmërinë, ekspozimin, kapacitetet përballuese dhe ato përshtatëse ndaj fatkeqësive, kanë bërë që qeveria shqiptare t'ua japë përparësi politikave të reduktimit të rrezikut të fatkeqësive në politikat e saj kombëtare.

Nisur nga vëmendja e shtuar e qeverisë shqiptare, ne veçanti të kryeministrit të vendit, u orientua një reforme ligjore, institucionale dhe organizative në fushën e mbrojtjes civile, e cila kulmoi me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ligj i cili hartoi politika të qarta në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore si dhe rregullon funksionimin e *sistemit të mbrojtjes civile*, duke përcaktuar, përgjegjësitë e institucioneve, strukturave operacionale të këtij sistemi, por edhe rolin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve shoqërorë të ekspozuar ndaj këtyre fenomeneve. Vlen të theksohet se ligji 45/2019, “Për mbrojtjen civile” është i hartuar dhe bazuar në praktikat më të mira evropiane dhe botërore, në përputhje të plotë me direktivat e BE-së, për fatkeqësitë natyrore, “Kuatrin Sendai” (si një nga dokumentet me të rëndësishëm të OKB-së në zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive) si dhe “Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike”.

Ky ligj sjell disa risi, ndër të cilat përmendim hartimin dhe miratimin e *Strategjisë kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore*, bazuar në *Dokumentin e vlerësimit kombëtar të rrezikut*, ngritjen dhe konsolidimin e mekanizmit të mbrojtjes civile, ngritjen dhe funksionimin e AKMC-së dhe strukturave të posaçme të mbrojtjes civile në institucionet qendrore dhe njësitë e pushtetit vendor.

Element shumë i rëndësishëm i kësaj reforme është përcaktimi i buxheteve të dedikuara nga qeveria, në kuota të përcaktuara në përqindje, për pushtetin vendor dhe institucionet; konkretisht, 2-4% në ministrinë e linjës dhe 4% e buxhetet e bashkive, me qëllim investimin e drejtpërdrejtë në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e tyre duke i ardhur në ndihmë në kohë reale komunitetit. AKMC-ja sot, si institucion i fushës së përgjegjësisë pranë Ministrisë së Mbrojtjes, është autoriteti më i lartë koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe atë të mbrojtjes civile. Një strukturë e tillë moderne, gjithëpërfshirëse, po ndihmon dhe do të ndihmojë në arritjen e objektivave të saj, përmbushjen e detyrimeve në kuadër marrëveshjeve ndërkombëtare me synim anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane, si element shumë i rëndësishëm në anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 45/2019, synohet hartimi dhe miratimi sa më i shpejtë i tre dokumenteve themelore në fushën e mbrojtjes civile në plan kombëtar të emergjencave, në linjë me vizionin e AKMC-së dhe baza për realizimin e objektivave afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Siç u përmend në fillim, Shqipëria është vend i ekspozuar ndaj një sërë fatkeqësish natyrore, ku mund të rendisim përmbytjet, zjarret, tërmete, rrëshqitjet masive të tokës, bllokimi i rrugëve nga dëbora etj. Por dy vitet e fundit treguan se fenomene të caktuara, si tërmeti apo pandemia, mund të mbizotërojnë mbi çdo fatkeqësi. Tërmeti i 26 nëntorit 2019, i cili pasojë me një sërë tërmetesh të tjera, veç dëmeve të konsiderueshme materiale ne banesa, objekte dhe institucione shkaktoi edhe humbjen e 51 jetëve njerëzore. Falë masave të jashtëzakonshme të qeverisë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

shqiptare, e cila shpalli *gjendjen e fatkeqësisë natyrore* dhe ngriti Komitetin Ndërmnistror të Emergjencave Civile, u aktivizua Mekanizmi i Mbrojtjes Civile Evropiane si dhe u kërkuu asistencë ndërkombëtare në Qendrën Evropiane të Koordinimit të Përgjigjes ERCC dhe Qendrën Operacionale të NATOS, EADRCC; u bë i mundur menaxhimi i situatës dhe ardhja në ndihmë mijëra familjeve dhe qytetarëve të goditur nga ky tërmet. Reagimi i menjëhershëm dhe solidariteti kombëtar e ndërkombëtar ishin faktorë të rëndësishëm në rehabilitimin e situatës dhe kthimin në normalitet të jetës shoqërore. Nën drejtimin e kryeministrit Rama, qeveria shqiptare aktivizoi të gjithë mekanizmin e mbrojtjes civile, për përballimin e kësaj fatkeqësie natyrore.

Sot, jemi të gjithë dëshmitarë okularë të shndërrimit të zonave të goditura nga tërmeti në kantiere ndërtimi të mijëra banesave individuale, por edhe kolektive, pa diskutuar mijëra familje të trajtuara me *bonus* në riparimin e banesave të dëmtuara në vlerësim të kategorizimit të bërë nga grupet me inxhinierë të vendit e të huaj, në vlerësimet e dëmeve. Si të mos mjaftonte fatkeqësia e tërmetit, vendi ynë u përfshi në ndikimin e pashmangshëm të pandemisë Covid-19, një fatkeqësi e paparashikuar që përfshiu të gjithë globin. Ndonëse të ndodhur në vështirësi të konsiderueshme ekonomike edhe për shkak të pasojave të tërmeteve të njëpasnjëshëm, menaxhimi i pandemisë Covid-19, në vendin tonë tregoi se aktivizimi i mekanizmave civile ndërinstitucionale dhe strukturore mundëson rezultate konkrete, të prekshme dhe efektive.

Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kombe, racë, ngjyrë apo kufi, ato ndëshkojnë dhe sjellin pasoja të jashtëzakonshme, ndaj të gjithë duhet të sensibilizohemi në parandalimin, zvogëlimin e rrezikut dhe menaxhimin në kohe të këtyre fatkeqësive natyrore. Koha në të cilën reagojmë, bashkëpunojmë dhe ndërveprojmë është shumë e rëndësishme. Motoja për reagim në fatkeqësitë natyrore është: *Të gjithë për një dhe një për të gjithë*. Shtëpia jonë është Shqipëria!



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Në përfundim të konferencës VI ndërkombëtare "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë", e cila u organizua nga Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë së Sigurisë, (në bashkëpunim me: Projektin e Binjakëzimit, financiar nga BE, "Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë", 18 IPA JH 01 19, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Universitetin e Romës "Tor Vergata", Universitetin "Luarasi", Tiranë, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Universitetin Polis, Tiranë; dhe me mbështetjen e *Trans Adriatic Pipeline, United Nations Development Programme* (UNDP) Albania, si dhe të Prezencës së OSBE-së Shqipëri), u zhvillua edhe një sesion përmbyllës. Sesioni i pestë ishte sesioni ku drejtuesit e sesioneve në të cilat u prezantuan kumtesat, sollën përfundimet e diskutimeve dhe informuan pjesëmarrësit për ecurinë e punimeve. Në botimin të cilin mbani në duar, i cili është vëllimi i katërt i punimeve të konferencës, sillen nga drejtuesit e sesioneve, të përmbledhura, përfundimet dhe rekomandimet e gjithë konferencës.

~ Sesiioni V ~

Përfundime dhe rekomandime të konferencës VI
shkencore ndërkombëtare: “Fenomenet ekstreme
të natyrës dhe çështjet e sigurisë”.

■Dr. Xhavit SHALA
Drejtues i sesionit të parë

■Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIAJ
Drejtues i sesionit të parë

Përfundime dhe rekomandime nga sesioni i parë: “Siguria në kuadrin e fenomeneve ekstreme të natyrës dhe të emergjencave civile”

1. Sesioni i parë i kësaj konferencë trajtoi fenomenet ekstreme të natyrës dhe emergjencat civile pjesë e përgjegjësiqe qeverisë dhe rritjes së aftësisë së saj për të përballuar rreziqet në kuadër sigurisë kombëtare, të garantimit të prosperitetit ekonomik të vendit dhe të mirëqenies sociale të shtetasve të saj si funksione bazë të çdo qeverie. Duke i konsideruar këto fenomene natyrore por edhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut si një kontekst i caktuar rreziku që evoluon në mënyrë të vazhdueshme dhe në mënyrë të paparashikuar, – rritja e qëndrueshmërisë për të mbrojtur infrastrukturën kritike kombëtare, – u vlerësua baza e suksesit në përballimin e tyre.

2. E parë në këtë këndvështrim, konferenca zhvilloi edhe një trajtim teorik të konceptit të fatkeqësiqe natyrore/emergjencave civile si dhe raportin e tyre me sigurinë kombëtare, sigurinë publike e sigurinë njerëzore.

3. Shqipëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta natyrore, prandaj në këtë konferencë ato janë vlerësuar si rrezik e kërcënim real për sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Edhe në rang botëror Shqipëria renditet ndër vendet me pasoja të larta ekonomike nga fatkeqësitë natyrore.

4. Konceptimi sigurisë së sotme po vë në qendër të saj sigurinë njerëzore, si një ndër elementët bazë të së drejtave të njeriut dhe si një koncept modern për menaxhimin e sigurisë globale. Siguria njerëzore është bërë tashmë çështje e ditës së politikave globale dhe po udhëheq agjendën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo është e rrezikuar nga

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

fenomenet ekstreme të natyrës, vlerësuar si një rrezik shumëdimensional në botën e sotme.

5. Fenomenet ekstreme të natyrës aktualisht po perceptohen ndër rreziqet dhe kërcënimet kryesore për sigurinë dhe jetën e qytetarëve në Shqipëri. Por ky perceptim është në shpërpjesëtim me nivelin e pamjaftueshëm të njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave të katastrofave natyrore e teknologjike dhe të përgatitjes materiale për t'u përballuar me këto fatkeqësi.

6. Siguria njerëzore në raport me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile u trajtua në nivele të ndryshme duke veçuar rolin e çdonjërit prej këtyre niveleve, nga përgjegjshmëria dhe ndërgjegjësimi individual, roli i qeverisjes vendore dhe deri detyrimet e institucioneve në informimin e publikut dhe trajnimin e aftësimin e tij për të kontribuar në këtë drejtim. Harmonizimi i drejtë i këtyre roleve merr një rëndësi të dorës së parë. Përshkallëzimi i katastrofave dhe i pasojave të tyre, shpesh herë e kanë burimin në mungesën e informimit të publikut.

7. Pjesa më e madhe e të anketuarve për fenomenet ekstreme të natyrës, mendojnë se për të përmirësuar sigurinë duhet investuar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe/ose emergjencave civile në këto drejtime:

- në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile;
- në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile;
- në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile;
- në minimizimin e pasojave të fatkeqësive natyrore/menaxhimin e emergjencave civile në komunitetet më shumë rrezikshme përfshirje nga një fatkeqësi natyrore/emergjencë civile;
- në fushën e edukimit në arsimin para universitar dhe universitar;
- në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuere të publikut të gjerë.

8. Roli i edukimit në minimizimin e rreziqeve, në menaxhimin e emergjencave dhe në aftësinë për tu rikuperuar sa më shpejt u trajtua gjerësisht nga diskutues dhe referues të ndryshëm. Është pikërisht procesi i informimit dhe ai i edukimit të publikut, që do na aftësojë të parashikojmë dhe jo të sfidohemi me surpriza, do na aftësojë të planëzojmë nga skenarët më të lehtë dhe deri tek skenarët më të vështirë dhe jo të gjendemi pa plane. Një proces planëzimi i shëndoshë duhet të përfshijë sektorin publik dhe atë privat. Ky proces analize dhe planëzimi do të krijojë profile të caktuara dhe të shumta në numër dhe skenarë të sigurisë publike, të lidhura me fenomene të caktuara dhe me rreziqe që vijnë prej tyre.

9. Thelbi i trajtesave dhe referimeve u fokusua pikërisht në rritjen e qëndrueshmërisë kombëtare ndaj këtyre fenomeneve ekstreme, e cila u përkufizua si aftësia e komuniteteve lokale e qendrore, të mbështetura nga të gjitha nivelet e qeverisjes, por edhe nga sektori privat për të planifikuar, përgatitur, përballuar, reaguar dhe për t'u rimëkëmbur nga fatkeqësitë dhe fenomenet ekstreme të natyrës dhe për t'u adaptuar me kushtet e reja të situatës së krijuar.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

10. Qëndrueshmërinë ndaj këtyre fenomeneve, referuesit e konsideruan si vija e parë e mbrojtjes së vendit, por në dallim me rreziqet dhe kërcënimet që vijnë nga jashtë ata nxorën si përfundim, nevojën e konsolidimit të shërbimeve publike dhe garantimin e tyre si më poshtë vijon:

- vazhdimësinë e qeverisjes;
- vazhdimësinë e sistemit të energjisë;
- vazhdimësinë e lëvizjes së individëve;
- vazhdimësinë e burimeve ushqimore;
- vazhdimësinë e sistemit të transportit;
- vazhdimësinë e sistemit të komunikimit;
- shmangien e viktimave masive.

11. Nga shumica e referuesve mesazhi kryesor për organet vendimmarrëse qeveritare ishte ngritja e një sistemi të qëndrueshëm reagimi dhe rimëkëmbjeje ndaj këtyre fenomeneve. Ky sistem do të arrihet vetëm pasi plotësohen dhe arrihen disa standarde të caktuara siç u përmenden:

- kryerja periodike e vlerësimit të rrezikut në të gjitha aspektet dhe spektrin e rreziqeve të mundshme në vend;
- komunikimi i këtyre rreziqeve dhe njohja e tyre nga ana e komunitetit;
- planëzimi i emergjencave civile dhe zhvillimi i qëndrueshmërisë kombëtare;
- ndërveprimi mes strukturave dhe institucioneve më përgjegjëse në këtë drejtim, siç janë PSH, MZSH, AKEMC, FARSH, pushteti lokal dhe stërvitjet e trajnimet e përbashkëta të tyre;
- ngritja dhe funksionimi i një sistemi të konsoliduar paralajmërimi dhe menaxhimi të emergjencave civile përfshirë qendrat e koordinimit strategjik për përgatitjen dhe aktivizimin e operacioneve kur lind e nevojshme;
- aftësia për të menaxhuar dhe garantuar vazhdimin e biznesit;
- aftësia për t'u rimëkëmbur në nivel lokal e atë qendror.

12. Nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme u prezantuan përgjegjësitë konkrete të institucioneve të caktuara në përballimin e fenomeneve ekstreme dhe në menaxhimin e emergjencave civile. Nga pjesëmarrës të shumtë, u identifikua angazhimi i Policisë së Shtetit në përballimin e emergjencave, shpesh edhe më shume sesa juridiksioni i saj ligjor por edhe se kapacitetet e saj reale dhe ekspertiza që ajo posedon. Në interes të menaxhimit profesional dhe efektiv të këtyre fenomeneve, secili institucion shtetëror duhet të marrë përgjegjësitë e veta duke mos e perceptuar vetëm si përgjegjësi e Policisë së Shtetit, - një qasje e tillë, shumëinstitucionalëshe e konsoliduar tashmë edhe në konceptin e strategjisë së sigurisë publike.

13. Interes të gjerë ngjalli prezantimi i praktikave më të mira në menaxhimin e sigurisë nga disa drejtues dhe përfaqësues të institucioneve, të sektorit publik dhe atij privat, vendas dhe investitorë të huaj. Mënyra e organizimit dhe e menaxhimit të emergjencave nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, nga qendra e sigurisë e kompanisë së gaz sjellësit TAP Albania, apo nga institucione ndërtimi dhe urbanistike u mirëpritën dhe u vlerësuan shumë nga pjesëmarrësit.

14. Nga të gjitha përkufizimet dhe referimet e sjella në këtë sesion/konferencë,

aspekti i përbashkët i tyre është se fatkeqësitë natyrore në ditët e sotme i tejkalojnë caqet lokale, i mbingarkojnë kapacitetet lokale dhe pasojat e tyre nuk njohin kufij kombëtare duke u bërë rrezik me shtrirjen e tyre rajonale e më gjerë në nivel global.

15. Pjesëmarrësit nga vendet fqinjë si Italia, dhe organizma rajonale e ndërkombëtarë si BE, OSBE, UNDP etj., vunë theksin tek rritja e bashkëpunimit dhe zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta mes vendeve si dhe në nivel rajonal.

16. Nga diskutimet e zhvilluara në konferencë, u dhanë rekomandime me vlerë, të cilat duhen analizuar dhe konsideruar nga vendimmarrja politike dhe nga administrata publike që vepron në këtë fushë përgjegjësie në lidhje me: arkitekturën e qëndrueshmërisë kombëtare, elementet e saj dhe funksionaliteti në çdo situatë e në çdo skenarë rreziku, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe të individëve; strategjinë e qëndrueshmërisë kombëtare dhe programet qeveritare për implementimin e saj; hartimin e dhe freskimin e regjistrit kombëtar të rreziqeve dhe mënyrën e reagimit ndaj tyre, njohjen e komuniteteve me to, etj.

17. Përmirësimet ligjore, njohja dhe zbatimi i përgjegjësi nga çdo institucion, hartimi i procedurave të duhura që mbështesin bashkëpunimin ndër-institucional dhe përmirësoi i kapaciteteve të çdo strukturë, bazuar në eksperiencën e fituar deri tani vlerësohet e një rëndësie të veçantë.

18. Shqipëria, çështjet e infrastrukturës dhe masave për parandalimin e pasojave të fatkeqësive natyrore e emergjencave civile i ka ndjekur nëpërmjet institucioneve shtetërore dhe në rastet kur ka pasur tërmete, përmytje, etj., strukturat shtetërore, ato vendore, si dhe populli në mënyrë vullnetare kanë marrë masa urgjente për minimizimin e parandalimin e dëmeve njerëzore dhe në ekonomi. Krejt e kundërta, ka ndodhur pas vitit 1990, kur startoi ndërtimi i shtetit të së drejtës dhe që u shkatërruan shumë vepra arti, sisteme e kanale kulluese, vaditëse, etj. Kështu, pas vitit 1991 ka vazhduar me reforma strukturore, të tokës, të pronës, infrastrukture etj., dhe këto tre dekada kanë treguar mangësi të mëdha për sa i përket aspekteve të mbrojtjes së mjedisit, tokës, pronës, ndërtimeve pa leje, dëmtimit të kanaleve kulluese, ndërtimeve pa kriter dhe pa marrë lejet përkatëse nga institute e specialist përkatës. Janë suprimuar shumica e instituteve shkencore dhe profesionale të cilat bënë studime dhe përcaktonin shkaqet, mangësitë, nevojat dhe jepnin sugjerime e bënë propozime konkrete ministrive përkatëse dhe qeverisë marrjen e masave për minimizimin e rreziqeve që mund të shfaqen në të ardhmen nga rreziku i katastrofave, fatkeqësive natyrore dhe projekteve e dëmtimeve të bëra nga institucionet apo banorë të zonave të caktuara.

19. Shqipëria është e “brishtë” dhe në zhvillim e sipër, prej tre dekadash dhe është dëmtuar rëndë infrastruktura e parandalimit dhe minimizimit të fenomeneve ekstreme të natyrës. Pra në një mënyrë apo tjetër eksperiencia ka treguar dhe tashmë është provuar njëkohësisht se Shqipëria është shtet dhe vend në “*emergjencë*”, edhe në rastet kur nuk e ka shpallur “gjendjen e emergjencës civile”, apo të “fatkeqësisë natyrore” e ka të domosdoshme që minimalisht për një mandat qeverisës katër vjeçar të krijohet Ministria e Emergjencave Civile.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

20. Shqipëria akoma nuk ka të planifikuara dhe funksionale struktura të mirëfillta emergjente, të cilat veprojnë në momentet e para kur ndodh emergjenca civile, dhe vetëm pasi është bërë ndërhyrja e parë dhe janë marrë masat përkatëse, kërkohet ndihma nga strukturat e tjera shtetërore e private. Nga mos ngritja e këtyre strukturave permanente, krijohen vështirësi e probleme për çështjet e sigurisë e jetës e aktivitetit normal dhe cenohet siguria kombëtare.

21. Rëndësia e madhe që kanë emergjencat civile për sigurinë njerëzore, shtetërore, komunitare dhe për sigurinë kombëtare kanë gjetur pasqyrim dhe në *Strategjinë e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë*. Sipas saj “*Kriza energjetike, që kërcënon sigurinë e furnizimit të RSH-së dhe cenon rritjen ekonomike*” është klasifikuar si rreziku i dytë, në rreziqet e nivelit të parë; “*Degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut*”, është klasifikuar si rreziku i pestë, në rreziqet e nivelit të parë, dhe sipas këtij dokumenti kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e Republikës së Shqipërisë; “*Shfaqje e një pandemie që kërcënon në masë shëndetin publik të popullsisë*” është klasifikuar si rreziku i dytë, në rreziqet e nivelit të dytë; dhe “*Pasojat e ndryshimeve klimaterike në ekuilibrat natyrorë të RSH-së*” është klasifikuar si rreziku i tretë, në rreziqet e nivelit të tretë. Pra, kjo konfirmon se fenomenet ekstreme të natyrës cenojnë sigurinë kombëtare.

22. Në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 68, “Kundërvajtjet administrative”, janë parashikuar gjithsej 37 shkelje administrative të cilat dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë - 100 000 (njëqind mijë) dhe nga 100 000 (njëqind mijë) - 500 000 (pesëqind mijë) lekë. Por nga studimi i këtij legjislacioni rezulton se nuk kanë përputhje: neni 14, pika 8, shkronja “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “ë”, me nenin 68, kundërvajtjet administrative, pika 2; neni 22, pika 2; shkronjat “f”, “g” nuk ekzistojnë dhe nuk kanë përputhje me nenin 68 kundërvajtjet administrative, pika 2; neni 30; pikat 3, nuk ekziston pika 3 në nenin 30, dhe nuk ka përputhje neni 30, pika 3, me nenin 68 kundërvajtjet administrative”.

23. Çështjet e fatkeqësive natyrore, mbrojtjes civile dhe emergjencave civile në vendin tonë, duhen “sigurizuar”, nga shteti në tërësi dhe nga qeveria e institucionet përkatëse. Në *Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë*, nuk ka parashikime për vepra penale kundër mbrojtjes civile, fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile, përveç veprave penale kundër mjedisit të parashikuara në kreun IV, (neni 201 deri neni 207). Ndërkohë, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës* parashikon disa vepra penale si: neni 356, *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*; neni 357, *Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike*; neni 362, *Mos evitimi i rrezikut*; dhe neni 363, *Keqpërdorimi i sinjalit të fatkeqësisë apo të rrezikut*.

24. Sigurizimi i fatkeqësive natyrore/emergjencave civile nuk mund të arrihet duke i trajtuar autorët dhe shkaktarët e pasojave të rënda vetëm për kundërvajtjet administrative por duke i parashikuar ato si vepra penale kundër fatkeqësive natyrore e emergjencave civile.

25. Reagimi ndaj sfidave kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri ka të bëjë me

ndikimin që ka krijuar dhe që krijon shteti, institucionet e sigurisë kombëtare, institucionet ligjzbatuese, në raport me përgjegjësinë për të mbrojtur, përgjegjësinë për të parandaluar, përgjegjësinë për të reaguar dhe me përgjegjësinë për të rindërtuar në aspektin e uljes e frikës së qytetarëve ndaj jetesës së tyre më të mirë, në aspektet e sigurisë së jetës, shëndetit, pasurisë dhe të ardhmes së tyre më të sigurt.

26. Në këtë konferencë u vu theksi edhe në drejtim të ndërgjegjësimit të autorëve, lidhur me huazimin e panevojshëm, nga anglishtja në shqipe, të fjalës “risk”. Kjo gjë nuk përbën vetëm një pasaktësi të rrafshit gjuhësor, por cenon një koncept themelor të sigurisë. Termi “rrezik” lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me termin “siguri”. Sillen referime argumentuese për këtë arsye të rëndësishme konceptore, dhe për arsye se në fjalorët më të rëndësishëm termi “risk” përkthehet shqip si “rrezik”. Përdorimi i fjalës “rrezik” në vend të “risk”, është një përpjekje për mirëmbajtjen e terminologjisë në fushën e sigurisë, për shkak, se sa më të qarta termat, aq më i madh është edhe ndikimi e kuptimësia e rrënjosur te lexuesit, apo zbatuesit, e dokumenteve strategjike.

Mbi bazën e këtyre përfundimeve, rekomandohet:

1. Të përmirësohen politikat për rritjen e sigurisë së komunitetit me synimin krijimin e komuniteteve të sigurt përballë fatkeqësive natyrore e teknologjike.

2. Mbështetje e politikave për fuqizimin e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për t’u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile në rastet e fenomeneve ekstreme të natyrës.

3. Përmirësimi i politikave për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe edukimin e tij me njohuritë e duhura, në nivel grupi dhe individ, për menaxhimin e katastrofave natyrore e teknologjike.

4. Përmirësimi dhe forcimi i legjislacionit për fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile në Shqipëri, duke përcaktuar qartë, kush bën çfarë.

5. Mbështetja e programeve për trajnimet në komunitet për t’u përballur me çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile që mund të ndodhë, përfshirë dhe hartimin e një plani emergjence familjare dhe mbështetjen e sigurimit të jetës e pronës në raste të fatkeqësive natyrore.

6. Përmirësimi i kurrikulave në arsimin para universitar dhe universitar dhe pasurimi i tyre me njohuritë e nevojshme për përballimin dhe menaxhimin e situatave në raste të fenomeneve ekstreme të natyrës.

7. Rritja e shkallës së informimit të publikut mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile si dhe për përgjegjësitë që qytetarët duhet të marrin për sigurinë e tyre individuale.

8. Mbështetja e politikave për nxitur përgatitjet materiale të komunitetit për tu përballur me një situatë urgjence/fatkeqësie duke siguruar furnizimin në të tilla situata me: minimumin 72 orë me ujë dhe me ushqime; një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike; mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite; mjete evakuimi në rastet emergjence ose fatkeqësie; kuti të ndihmës së parë; një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin; produkte të nevojshme higjenosanitare; kuti për raste fatkeqësish natyrore; telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë; sasi të hollash në rast urgjence ose fatkeqësie; mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia;

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

pajisje për fëmijët; pajisjet për të moshuarit; një plan evakuimi e një plan operacional të urgjencës; me sigurim (mbulimin e sigurimit) të jetës.

9. Mbështetja e politikave afatgjata për reduktimin e faktorëve që ndikojnë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, si shpyllëzimi; ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit; zjarret e qëllimshme; mosndëshkimin e individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore; niveli në ulje i biodiversitetit; urbanizimin e shpejtë; bioterrorizmin; mbipopullimin; mbeturinat bujqësore e djegien e fosileve.

10. Miratimi i një strategjie kombëtare për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore e teknologjike, si dokumenti kryesor i politikave për të parandaluar dhe zvogëluar rrezikun nga këto fatkeqësi, nëpërmjet përfshirjes së tërë shoqërisë e të institucioneve shtetërore në këtë proces.

11. Të shikohet mundësia e krijimit të Ministrisë së Emergjencave Civile ose Ministrisë së Mjedisit dhe Emergjencave Civile, pasi ngritja e nivelit në rang ministrie mundëson ngritjen në një nivel më të lartë të punës për parandalimin, kur është mundësia, dhe të mirëmenaxhimit e minimizimit të pasojave të katastrofave natyrore/ emergjencave civile.

12. Të krijohen dhe të funksionojnë strukturat dhe shërbimet e mirëfillta emergjente, të cilat duhet të jenë permanente, të gatshme e në gatishmëri për të vepruar në momentet e para kur ndodhin emergjenca civile. Në rastet kur emergjenca civile përshkallëzohet më tej, kërkohet angazhimi i strukturave dhe shërbimeve të tjera që i ngarkon ligji “Për mbrojtjen civile”.

13. Të krijohet një grup pune me urdhër të kryeministrit nën drejtimin e ministrit të Financave për të vlerësuar rrezikun dhe kostot e emergjencave civile në Shqipëri për periudhën 1991-2021. Rreziku lypet të përcaktohet si (1) probabiliteti dhe frekuenca e një rreziku që ndodh, (2) niveli i ekspozimit të njerëzve dhe pasuria në rrezik, dhe (3) efektet ose kostot, si direkte ashtu edhe indirekte, të këtij ekspozimi, pasi çmimi i mosveprimit, në lidhje me reduktimin e rrezikut në Shqipëri është veçanërisht i lartë. Qëllimi është që mbi bazën e vlerësimit të rrezikut dhe kostove që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile për vendin tonë, institucionet përgjegjëse të përmirësojnë punën për menaxhimin e fatkeqësive/katastrofave natyrore e të marrin masa të plota për sigurinë e jetës, shëndetit e pronës, të drejta këto të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

14. Të hartohet platforma kombëtare për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive, dhe kjo lypet të shndërrohet në mekanizmin kryesor institucional për drejtimin dhe vlerësimin e progresit të parandalimit e minimizimit të emergjencave civile në vendin tonë.

15. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të propozojë ndryshimet përkatëse për përputhjen e nenit 68, pika 2, “Kundërvajtjet administrative” të ligjit “Për mbrojtjen civile” me: nenin 14, pika 8, shkronja “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “ë”; pika 2; neni 22, pika 2; shkronjat “f”, “g” “f” dhe neni 30, pikat 3, që nuk ekzistojnë dhe që nuk kanë përputhje por edhe që nuk përputhen me nenin 68 kundërvajtjet administrative”.

16. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Ministria e Drejtësisë të hartojnë projektligjin “Për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ku të propozohen veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë të shkaktuara nga pasojat që sjellin fenomenet ekstreme të natyrës dhe emergjencat civile, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në lidhje me papërgjegjësinë shtetërore, politike,

komunitare, njerëzore e private dhe që sjellin pasoja me humbje të jetëve njerëzore e dëme të mëdha ekonomike.

17. Rekomandohet të ndryshohet fjala “risk” e përdorur pa asnjë arsye, e logjikë gjuhësore, e konceptore në ligj e dokumente strategjike. Konkretisht, ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ka një mbingarkesë të panevojshme të fjalës “risk”, e cila duhet gjetur mundësia që të zëvendësohet me fjalën “rrezik”. Ky ndryshim nuk duhet të jetë vetëm gjuhësor, por duhet të ketë mbështetje konceptore kur përdoren termat e fushës së sigurisë, si në dokumente strategjike, ashtu edhe në ligje.

■Dr. Albert HITOALIAJ
Drejtues i sesionit të dytë

■Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN
Drejtues i sesionit të dytë

Përfundime dhe rekomandime nga sesioni i dytë: “Kuatri ligjor dhe institucional, eksperiencia kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile”

1. *Fatkeqësitë natyrore dhe lidhja me kolapset urave.* Si rekomandim kryesor, për shmangien e situatave kritike që lidhen me kolapsin e urave, rezistencën dhe gjendjen e tyre, si gjatë katastrofave natyrore edhe në situata normale, do të ishte ai i krijimit të një *Komiteti të Urave*. Ky komitet do të ishte i një karakteri të ngjashëm me *Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha*. Nevojitet një strukturë e cila të marrë në konsideratë monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së urave në Shqipëri. Kjo gjë do i paraprinte edhe dëmeve që sjellin kolapset e urave në raste katastrofash.

Rrugët dhe autostradat gjithmonë kanë një rëndësi jetike në sistemin infrastrukturor të çdo vendi, për shkak të aftësisë së tyre të madhe për të depërtuar në territorin e vendit; në raste katastrofash rëndësia e infrastrukturës merr rëndësi më të madhe edhe për shkak të nevojës së sigurimit të ndihmave të ndryshme. Për më tepër, mirëmbajtja e tyre mund të përfaqësojë së bashku me mbrojtjen e infrastrukturës dhe impiantet industriale dhe restaurimin e trashëgimisë historike, si një forcë e madhe shtytëse për zhvillimin ekonomik të vendit. Një pikë e dobët e tyre, janë strukturat dhe mënyrat e ndërtimit. Në raste katastrofash ato mund të bëhen elementi që sjell ndryshimin pozitiv ose negativ.

Strukturat prej betoni të parapresuar shpesh janë përdorur në të kaluarën për lehtësinë e ndërtimit, fleksibilitetin e përdorimit dhe, për gjithë efikasitetin e tyre ekonomik më të lartë në krahasim me zgjidhjet e tjera të projektimit. Fatkeqësisht, koha dhe ngjarjet katastrofike kanë treguar se si strukturat e betonit të armuar të paratërhequr shfaqin dobësi strukturore.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Strukturat e paratërhequra të betonit të ndërtuara gjatë bumit ekonomik kanë treguar disa dobësi, me pasoja të mëdha në drejtim të kapacitetit të qëndrueshmërisë jetëgjatësisë. Shkaqet e degradimit janë, për fat të keq, mjaft të qarta si: mungesa e planifikimit, ekzekutimi jo i duhur i projektimit dhe përdorimi jokorrekt i materialeve të ndërtimit. Por, ajo që gjithmonë theksohet më pak, është marrëdhënia midis mënyrës dhe kohës të ndërtimit dhe jetëgjatësisë të strukturës: njohuritë, teknikat, materialet kanë evoluar në mënyrë eksponenciale në 30 vitet e fundit.

Koncepti i qëndrueshmërisë, i cili në sektorin shkencor tani është një term i përdorur gjerësisht, sigurisht nuk mund të jetë për struktura të realizuara mbi 50 vjet më parë. Qëndrueshmëria është vlerësuar në një mënyrë plotësisht intuitive dhe sjellja e betonit që i nënshtrohej ngarkesave ciklike për në thyerje ishte një problem krejt i panjohur.

Duke analizuar ngjarjet e fundit në Itali dhe në mbarë botën në lidhje me rastet e shembjes kaq të shpeshta të urave, është formësuar një kornizë mjaft e larmishme, dhe në të njëjtën kohë shqetësuese, për infrastrukturën rrugore në drejtim të sigurisë. Kjo kornizë mund të përmblihet në shkaqet e mëposhtme:

- mungesa e një shkalle adekuate të duktilitetit (epshmërisë) dhe qëndrueshmërisë strukturore, e lidhur kryesisht me periudhën e ndërtimit dhe/ose materialin e përdorur;
- planet e mirëmbajtjes të paparashikuara ose jo të kryera shpesh me korrektësi dhe në afatet e duhura, të cilat amplifikojnë mangësitë e sistemit strukturor dhe, rrjedhimisht, sjellja e paparashikueshme e konstruksionit;
- probleme të qëndrueshmërisë (mbi të gjitha) që lidhen me zgjedhjen e materialit të përdorur;
- sistemi i monitorimit, i aplikuar në ndërtime tashmë të degraduara, që nuk premtojnë të interpretojnë plotësisht gjendjen e vetë të progresit të degradimit, në shumë raste johomogjene dhe joefikase; shpesh, rezultatet janë të pakuptueshme, të palexueshme ose të parëndësishme për të vlerësuar sigurinë në një madhësi të caktuar absolute;
- dobësitë e brendshme në lidhje me teknologjinë strukturore të miratuar;
- kapaciteti i ulët i projektimit të konstruksioneve të lidhur me natyrën statike të projektimit strukturor të infrastrukturës rrugore.

Në një të ardhme të afërt do të duhet të përballemi me problemin e menaxhimit të përkeqësuar të strukturave dhe, mbi të gjitha, të metodologjive të studimit të tyre. Kjo do të jetë thelbësore, sepse, për strukturat e betonit të armuar të paratensionuara, janë zvogëluar provat e jashtme të dëmtimit dhe/ose të përkeqësimit.

Në këtë kuadër këto shqetësime duhet të tërheqin vëmendjen e organeve përkatëse për të siguruar në kohë parandalimin e kolapseve në urat e sistemit rrugor kombëtar, për të parandaluar efektet negative nga këto fatkeqësi si në aspektin social-ekonomik edhe në atë mjedisor.

2. Bioterrorizmi si rrezik i konsiderueshëm ndaj sigurisë kombëtare. Kërcënimi i përhapjes së qëllimshme të agentëve biologjikë (si viruset, bakteret, kërpudhat ose toksinat e tyre) me qëllim për të shkaktuar sëmundje ose vdekje në popullsinë e një vendi apo kulturave ushqimore dhe bagëtisë së tyre, me qëllim terrorizimin e një popullate civile ose për të manipuluar qeveritë e shteteve të ndryshme, si formë e një akti terrorist, sot është bërë një realitet i mundshëm për të gjitha vendet. Nuk përjashtohet mundësia që Shqipëria, duke marrë parasysh pozicionin gjeografik dhe ekonomik, të jetë e përfshirë në sulme të mundshme biologjike, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, për

shkak të afërsisë së madhe me shumë vende evropiane. Nevojitet kështu, një përmirësim i instrumenteve ligjore dhe i mekanizmave institucionalë në funksion të mbrojtjes dhe sigurisë publike, duke bërë një qasje përmes fuqizimit të lidhjes së sigurisë kombëtare dhe strukturave që merren me shëndetin publik. Në vijim jepen disa rekomandime dhe përfundime lidhur me rrezikun e bioterrorizmit dhe sigurinë kombëtare.

Bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të parandalimit nga strukturat e inteligjencës kombëtare ashtu dhe në asistencën teknike dhe profesionale për identifikimin dhe trajtimin në kohë të kërcënimeve ndaj shëndetit publik, pavarësisht origjinës së tyre, përbën një element thelbësor në parandalimin e rrezikut nga bioterrorizmi, por edhe të infeksioneve virale apo bakteriale me rrezik përhapjeje pandemike.

Bashkëpunimi intensiv në nivel ndërkombëtar i strukturave të inteligjencës dhe ato të shëndetit publik me qëllim parandalimin dhe identifikimin në kohë të sulmeve të mundshme terroriste (bioterroriste) mbetet thelbësore për parandalimin dhe goditjen në kohë të tyre.

Mbështetja financiare dhe logjistike për strukturat e kontrollit kufitar me mjete të avancuara të teknologjisë për identifikimin dhe parandalimin e futjes në kufi të substancave të dyshuara si agjentë kimikë apo biologjikë, me risk të shtuar në kuadër të luftës kundër terrorizmit, sot paraqet një domosdoshmëri për vendin.

Përmirësimi i infrastrukturës logjistike dhe pajisja me mjete e teknologji të avancuar për Institutin e Shëndetit Publik dhe Departamentin e Survejancës të Sëmundjeve Infektive, me qëllim identifikimin dhe analizimin në kohë të rasteve të dyshuara për patogenë dhe agjentë viralë ose bakteriologjike, me risk për sëmundje infektive.

Rishikimi dhe përditësimi periodik i listës së sëmundjeve infektive dhe simptomave të detyrueshme për raportim nga strukturat vendore, në kuadër të mbikëqyrjes së sëmundjeve infektive, duke zgjeruar listën e sëmundjeve infektive për raportim. Gjithashtu, caktimi i një personi kontakti, të specializuar në këtë fushë në çdo njësi mjekësore publike apo private, që ka detyrimin për raportim të rasteve të dyshuara pranë ISHP, do të ishte një masë efektive për identifikimin e rasteve të dyshuara me risk nga bioterrorizmi.

Trajnimi i vazhdueshëm i këtyre strukturave raportuese dhe përditësimi i njohurive për të rejtat e shkencës dhe vigjilencës së zgjeruar që duhet të kenë në ndjekjen e rasteve në territorin e tyre.

Informimi i publikut dhe ngritja e vetëdijes mbi rreziqet që lidhen me sulmet terroriste dhe format e tij (bioterrorizmi) duhet të jenë pjesë integrale e aktiviteteve të organizmave dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse për të arritur efikasitetin në masat parandaluese dhe trajtimin në kohë të rasteve të dyshuara.

Strukturat e Policisë së Shtetit, të cilët janë të parat që përballen me një sulm të mundshëm bioterrorist, duhet të jenë të trajnuara dhe të pajisura me mjetet e nevojshme, së pari për të mbrojtur veten e kolegët nga një infektim i mundshëm dhe së dyti, për të marrë masa të menjëhershme për izolimin e rastit, deri sa organet e specializuara të shëndetit publik të kenë analizuar rastin e dyshuar.

Gjithashtu, strukturat e patrullës së përgjithshme të Policisë së Shtetit, duhet të trajtohen dhe kenë një protokoll të qartë të konsultuar nga specialistë të shëndetit publik, se si duhet të veprojnë në rast dyshuar sulmi bioterrorist, me qëllim sigurinë e tyre shëndetësore dhe izolimin në kohë të rastit të dyshuar.

Bioterrorizmi të vlerësohet me seriozitet si element rreziku për t'u përfshirë në

Planin e veprimit për gjendjet e emergjencës, në zbatim të ligjit nr. 45/2019.

Patogjenët e kategorisë A, janë ata organizmat/agjentë biologjikë që paraqesin rrezikun më të lartë për sigurinë kombëtare dhe shëndetin publik sepse ata: mund të përhapen ose transmetohen lehtësisht nga personi në person; rezultati në nivele të larta të vdekshmërisë dhe kanë potencialin për ndikim të madh në shëndetin publik; mund të shkaktojnë panik publik dhe përçarje shoqërore; kërkon veprim të veçantë për gatishmërinë e shëndetit publik.

Patogjenët e kategorisë B, janë organizmat/agjentët biologjikë të përparësisë së dytë: janë mesatarisht të lehtë për t'u shpërndarë; rezultati në nivele të moderuara sëmundjeje dhe në shkallë të ulët vdekshmërie; kërkon përmirësime specifike për kapacitetin e përcaktimit të diagnozës dhe për mbikëqyrjen e përmirësuar të sëmundjes.

Patogjenët e kategorisë C, janë përparësia e tretë më e lartë dhe përfshijnë patogjenë në zhvillim që mund të projektohen për shpërndarje masive në të ardhmen për shkak të: disponueshmërisë; lehtësia e krijimit dhe shpërndarjes; potencial për nivele të larta sëmundjeje dhe vdekshmërie dhe ndikim të madh në shëndet.

3. Reformimi i sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri. Duke iu referuar analizës së zhvillimit të sistemit të mbrojtjes civile në të gjithë fazat historike, sfidave dhe problematikave të krijuara ndër vite, mund të parashtrojmë disa përfundime dhe rekomandime për të rritur efektin e tij, nga pikëpamja institucionale dhe funksionale, të cilat vijojnë si më poshtë:

- ndjekja e hartimit të *Strategjisë kombëtare për reduktimin e rrezikut*, referuar ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në nivel kombëtar dhe lokal;

- ndjekja e hartimit të *Dokumentit të vlerësimit të rrezikut*, referuar ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” në nivel kombëtar dhe lokal;

- përditësimi i *Planit kombëtar* referuar ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” në nivel kombëtar dhe lokal;

- ndjekja e përditësimit, hartimit, dhe harmonizimit të akteve nënligjore me synim përmirësimin e kuadrit ligjor në tërësinë e saj për arritjen e objektivit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në UNCPM (*Union Civil Protection Mechanism*), si një nga kushtet e anëtarësimit në BE.

4. Roli i IoT (“Internet of Things”/“Interneti i gjërave”) në menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Duke qenë se fatkeqësitë natyrore nuk mund të ndalen, jemi ne ata që duhet të përgatitemi për t'i trajtuar. IoT shihet si zgjidhja, që faktikisht ka filluar të përdoret gjerësisht. IoT, lejon ndërlidhjen pa ndërprerje midis pajisjeve me funksione të ndryshme dhe ka treguar se është një zgjidhje e vlefshme për menaxhimin e katastrofave.

Duke aplikuar analizën e të dhënave dhe mjeteve të inteligjencës artificiale, sistemet e menaxhimit të katastrofave të mundësuar nga IoT mund të përdoren për paralajmërimin e hershëm të një fatkeqësie natyrore, për të gjetur viktimën dhe për të ndihmuar në operacionet e shpëtimit. Përmirësimi në teknologji si robotika, inteligenca artificiale dhe analiza e të dhënave do të ndihmojë përmirësimin e mëtejshëm të aftësive të IoT, në menaxhimin e katastrofave, duke minimizuar pasojat.

5. Kuadri ligjor e juridik i bashkëpunimit rajonal në fushën e emergjencave civile. Shqipëria është një vend i ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore. Efekti i tyre ka tendencën të përkeqësohet për shkak të urbanizimit të shpejtë, të shoqëruar me praktika të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

pakontrolluara të ndërtimit në injorim të kodeve përkatëse, keqpërdorimit të tokës, burimeve natyrore, veprimtarisë ndaj mjedisit dhe një numër faktorësh të tjerë që karakterizuan kalimin nga një ekonomi e centralizuar në atë të tregut të lirë. Me gjithë progresin e Shqipërisë në menaxhimin e emergjencave civile, është e domosdoshme të bëhet më shumë për përsosjen e legjislacionit, koncepteve doktrinarë dhe planeve zbatuese, për përmirësimin e rolit dhe kontributit të çdo institucioni me përgjegjësi ligjore ndaj emergjencave civile, fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe krijimin e kapaciteteve të nevojshme për të përballuar një spektër të gjerë fatkeqësish natyrore apo të shkaktuara nga njeriu. Fatkeqësitë e viteve të fundit, me gjithë dëmet e shkaktuara, kanë evidentuar një farë kapaciteti të institucioneve dhe të popullsisë shqiptare për t'i përballuar ato.

Mësimet e nxjerra prej tyre, si dhe një aftësi në rritje e institucioneve për të bashkëpunuar e mbështetur njëri-tjetrin e kundërpërgjigjur ndaj emergjencave, përbëjnë një bazë të mirë për sfidat e kësaj natyre në të ardhmen. Në përpjekjet për kompletimin dhe përsosjen e kapaciteteve kombëtare në interes të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, Shqipëria duhet të reduktojë gradualisht pjesën ushtarake të tyre. “Demilitarizimi” i kapaciteteve dhe i masave të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë, dhe për mbrojtjen civile do t’u krijonte institucioneve të tjera qendrore apo lokale, me detyrime ndaj emergjencave civile, hapësirën e nevojshme për të luajtur sa më mirë rolin e tyre para dhe gjatë fatkeqësisë. Nga ana tjetër, ky proces, do të lehtësojë e do të bëjë më të pranueshëm (nga një numër aspektesh) çdo kontribut shqiptar ndaj vendeve të tjera, të prekura nga fatkeqësi të kësaj natyre. Duke pasur parasysh stadin aktual të kapaciteteve shqiptare për nevojat e masave të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë, dhe për mbrojtjen civile, si në aspektin institucional ashtu dhe në atë operacional, Shqipëria e ka të pamundur të menaxhojë e vetme një katastrofë madhore. Bile, duke e parë problemin nga pikëpamja “kosto-përfitim”, kjo nuk është as e këshillueshme. Nisur nga ky konstatim, si dhe nga fakti që fatkeqësi të kësaj natyre janë “ndërkufitare” në shtrirjen dhe efektin e tyre, zgjidhja më racionale është një bashkëpunim më i mirë me vendet e tjera të rajonit dhe me organizata ndërkombëtare (OKB, NATO, BE, Banka Botërore, etj.).

Në mënyrë të posaçme, një qasje rajonale në “bashkimin dhe shkëmbimin” e kapaciteteve do të bënte që masat e RRF&MC të ishin jo vetëm më efektive, por edhe me kosto më të ulët për secilin nga vendet e rajonit. Deri tani, bashkëpunimi rajonal i ka munguar niveli i duhur i “pronësisë”. Përfshirja disa iniciativave të sponsorizuara nga OKB-ja, BE-ja apo Banka Botërore, pjesa tjetër e organizimeve rajonale kanë rezultuar më shumë për formë. Në përgjithësi, atyre u mungojnë mekanizmat e nevojshëm për të pasur efekt të ndjeshëm në fatkeqësitë natyrore. Bashkëpunimi rajonal për emergjencat civile mund të fuqizohet nëpërmjet takimeve ndërinstitutionale, planifikimit dhe stërvitjeve të përbashkëta dhe shkëmbimit në mënyrë të vijueshme të informacioneve dhe raporteve. Në esencë, çdo aktivitet i kryer në fazën para emergjencë që krijon besim, miqësi e lidhje profesionale midis personelit e institucioneve kyçe në këtë fushë, shkon në dobi të një reagimi e menaxhimi rajonal efektiv ndaj fatkeqësive. Pavarësisht lidhjeve etnike e kulturore midis Shqipërisë e Kosovës, të cilat kanë nxitur një bashkëpunim bilateral në rritje në një numër fushash, deri tani, bashkëpunimi në fushën e emergjencave civile, pavarësisht nga hapat përpara, ka qenë nën nivelin e pritshëm dhe nuk i ka shfrytëzuar të gjitha potencialet e mundshme. Për shkak të lidhjeve të sipërpërmendura, por edhe të afërsisë gjeografike, e cila mbart mundësinë që e njëjta

fatkeqësi të prekë njëkohësisht të dy vendet, është me rëndësi dhe përfitim reciprok thellimi i bashkëpunimit midis të dy vendeve në të gjithë spektrin e reduktimeve të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile.

6. Mbi problematikat e efikasitetit dhe zbatimit të ligjit për emergjencat civile. Nevoja për mbrojtje nga emergjencat civile sjell nevojën për pasjen e një rregullimi ligjor konkret, të plotë, të qartë dhe shterues, i cili të jetë pararendës i çdo situatë të mundshme fatkeqësie, me qëllim minimizimin dhe kur është e mundur parandalimin e pasojave që vijnë prej tyre.

Detyrimi për miratimin e akteve të tjera gjatë kohës së ndodhjes së fatkeqësisë, mungesa e ndarjes së saktë të kompetencave dhe detyrave, janë rrjedhojë e nevojës për përmirësim në vazhdim të kuadrit ligjor, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe qartësisht të përcaktojë reagimin që duhet të bëhet nga strukturat kompetente, cilat prej tyre duhet të veprojnë më shpejt, etj.

Mbështetja e dhënë nga aktorët ndërkombëtarë, pavarësisht rezultateve pozitive të saj, nuk justifikon nevojën për një rregullim të brendshëm, i cili duhet të jetë i plotë dhe t'iu vijë në ndihmë të gjithë shtetasve të një shteti në rastin e përballjes me një fatkeqësi të caktuar.

Shqipëria konsiderohet si shtet me probabilitet të lartë të goditjes nga një shumëllojshmëri fatkeqësish, e për rrjedhojë edhe humbjet ekonomike konsiderohet të jenë në nivele shumë të larta. Për një periudhë kohe nga 1980/2010 janë regjistruar 23 fatkeqësi, të tilla si: përmbytje, katër tërmete dhe tre goditje nga temperatura ekstreme.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8756/2001, u evidentuan një sërë problematikash, të tilla si nevoja për rritje të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të DPEC-së, nevoja e ngritjes së një sistemi funksional dhe të integruar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, etj.

Miratimi i ligjit 45/2019 kishte si qëllim të plotësonte të gjitha mangësitë e ligjit të mëparshëm, duke u mbështetur kryesisht në një sërë objektivash, ku më kryesori është përmbytja e detyrimeve që rrjedhin nga platformat globale, strategjitë, konventat, iniciativat, marrëveshjet dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, etj.

Pavarësisht nga vullneti i mirë i ligjvënësit për miratimin e një kuadri të ri ligjor, i cili do të përmbushte objektivat e cituara edhe në paragrafët më sipër, në fakt ka një sërë paqartësish dhe problematikash. Nevoja për miratimin e një akti normativ, për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga tërmeti i 2019, nxori në pah detyrimin e shtetit shqiptar për përmirësim të kuadrit ligjor bazë në fuqi, me qëllim përballimin në mënyrën e duhur të fatkeqësive të mundshme në të ardhmen.

7. Aksesit [qasja] në drejtësi, në rastet e emergjencave civile. Gjendjet e emergjencave civile janë gjendje të cilat shkaktojnë probleme të mëdha jo vetëm ekonomike, sociale, jetike, por edhe ligjore. Në raste të tilla jemi përpara balancave të shumë të drejtave dhe lirive, të cilat nevojitet një studim dhe analizë e mirëfilltë, në mënyrë që të mos cenohen në thelbin e tyre.

Qasja në drejtësi është një garanci kushtetuese që i mundëson individit të mbrojnë të drejtat e shkelura. Qasja në drejtësi është një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe rregullimin e tij e gjen në aktet kryesore juridike të një shteti, por edhe në marrëveshjet

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

ndërkombëtare, konventat, traktatet, etj. Nga ana tjetër emergjencë civile është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Periodha e pandemisë paralizoi në të njëjtën kohë një sërë aktivitete ku ndër të tjerash ishte dhe veprimtaria ligjore e gjykatave. Gjykimet administrative, civile dhe penale në disa prej nënkategorive të tyre u kufizuan. Ajo çka është ofruar si zgjidhje në shumë vende të botës ka qenë adoptimi i mjeteve teknologjike, me qëllim mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore, si dhe ndalimi i publicitetit të seancave, etj. Roli i teknologjisë, sigurisht që është një rol mbështetës i sistemit gjyqësor, duke ofruar ndihmë në menaxhimin e çështjeve gjyqësore, por që mund të hapë rrugën për implementimin në të ardhmen të programeve dhe sistemeve kompjuterike të veçanta që mundësojnë gjykimin dhe trajtimin e rasteve gjyqësore. Por zbatimi i tyre, pavarësisht teorive që e mbështesin atë, pasi rrit qasjen në drejtësi, është dhe një çështje e vetë shteteve, për sa i përket mundësive të tyre ekonomike dhe teknologjike.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, me anë të Zyrës për Drogat dhe Krimet, si dhe Programin për Zhvillim, ka hartuar një dokument strategjik i cili mundëson qasjen në drejtësi në kushtet e COVID-19. Ky është një dokument i mirëfilltë politikash që synon t'i drejtohet shteteve për të siguruar të gjitha masat e domosdoshme për përgatitjen, përgjigjen dhe rikuperimit të qasjes në drejtësi gjatë gjendjes së pandemisë.

8. Parandalimi i emergjencave civile, si qasje ndaj sigurisë kombëtare. Nisur nga eksperiencia e deritanishme në Shqipëri, mund të thuhet se nevojitet që *Strategjia e sigurisë kombëtare* (SSK) të shërbejë si orientim për konsolidimin e një sektorëve të sigurisë që lidhen me emergjencat civile. Domosdoshmëria strategjike lidhet detyrimisht me Kryeministrinë, Qendrën Kombëtare të Emergjencave Civile, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, të Shëndetësisë etj. Por, nëse strategjia do të mbetet thjesht një parim i pazbatueshëm e i pakonkretizuar në veprime, edhe rreziqet do të jenë të patrajuara sipas rëndësisë së tyre. Dëmi i faktorit njerëzor mbetet shoqërues i shtimit të rrezikshmërisë nga katastrofat natyrore. Sullm vetëm dy shembuj se si rrjeti lumor dhe digat përbejnë një imperativ të trajtimit strategjik, por që në fakt janë trajtuar thjesht në nivel qeveritar dhe me plane afatshkurtrat. Mungesa i institucioneve që të kryejnë studime të thelluara dhe analiza të gërshetuara me qëllim që të masin shkallën e rrezikut që vjen nga pasojat e katastrofave natyrore, shkatërrimit të mjedisit, degradimit të kontrollit mbi territor etj., shton akoma më shumë dëmin që shkakton natyra kur shfrenohet me forcat e saj.

Për t'i bërë ballë natyrës dhe katastrofave natyrore, duhet investuar te infrastruktura fizike, materiale, teknologjia, mjetet etj., dhe, te elementi njerëzor. Ky i fundit është “truri” që do përballojë rreziqet e natyrës. Nëse nuk arrijmë që të ngremë kapacitete njerëzore, institucionale, shoqërore, të cilat të jenë të afta dhe të denja shkencërisht për analizimin e gërshetuar të çështjeve të sigurisë, në fokusin e katastrofave natyrore, atëherë katastrofat natyrore do të dëmtojnë dyfish. Kjo masë e dyfishtë, do të shtohet për arsye se në vend që të parandalojmë do të përkeqësojmë me paafësinë tonë shoqërore e institucionale. Shkatërrimi i instituteve shkencore në këtë dekada është një shembull; shkatërrimi i territorit, është një tjetër shembull, mungesa e trajtimit të çështjeve sizmologjike, hidroenergjetike, të digave, të pyjeve, etj., si çështje të rëndësisë së parë, të sigurisë kombëtare, është një shembull tjetër. Në tërësinë e diskutimit, që sollëm, ajo që

synonim ishte që të vendosnim nën prizmin e sigurisë kombëtare çdo gjë që lidhet me degradimin mjedisor dhe me katastrofat natyrore; emergjencat civile kanë një rrezikshmëri të tillë, që duhen parë si një luftë e vazhdueshme në të cilën kombi është i përfshirë. Në luftë nuk ka vetëm dëmtime fizike, por ka edhe dëme materiale e financiare. Për këto të fundit, vit pas viti jemi dëshmitarë që ato janë të pranishme. Për t'i parandaluar nuk mjafton vetëm kodi penal, por duhet organizuar mendimi sipas një rrjeti ndërinstitucional i cili të ofrojë ekspertizë të sigurisë. Emergjencat civile, kanë qenë janë dhe do të mbeten çështje të sigurisë kombëtare. Dhe si të tilla duhen trajtuar.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

■Prof. Asc. Dr. Zaho GOLEMI
Drejtues i sesionit të tretë

■Dr. Bajram IBRAJ
Drejtues i sesionit të tretë

Përfundime dhe rekomandime nga sesioni i tretë: “Qasje praktike dhe shembuj konkret menaxhimi, në kuadrin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile”

1. Përgjigjia suplementare ndaj një tërmeti, nën dritën e misionit të Izraelit në Shqipëri.

Që prej fillimit të historisë njerëzore, katastrofat e mëdha natyrore janë një pasqyrë që reflekton dobësinë njerëzore. Në vetëm disa çaste, infrastrukturat e mëdha, të ndërtuara me shumë mund për shumë vite, rrëzohen; shumë njerëz bëhen viktimë, dhe ekzistenca kombëtare dhe personale e formësuar me shumë mendime dëmtohet seriozisht. Me qëllim të mirëfunksionimit të përballjes me forcave shkatërruese të natyrës, ka eksperiencë të shumta në botë, ku Izraeli është ndër vendet në avantgardë në politika, strategji, metodologji për rehabilitim dhe mbi të gjitha në praktikitet.

Përvoja institucionale të shtetit izraelit e grumbulluar në dekada është e plotë në trajtimin e katastrofave natyrore dhe luftërave. Teoritë dhe teknikat që shteti ka ngritur dhe zhvilluar kanë kontribuar në ndërtimin e një sistemi emergjent të zhvilluar, duke bërë të mundur ndihmën efikase në përballimin e fenomeneve ekstreme të natyrës si në Izrael ashtu edhe jashtë saj, në vendet mike e partnere. Misioni i Ekspertëve në Shqipëri që zhvilloi aktivitetin e tij nga data 3 deri 12 dhjetor 2019, ishte misioni i 35-të i ndihmës i dërguar nga Komanda e Frontit të Brendshëm të Forcave të Mbrojtjes së Izraelit në vendet e goditura nga katastrofat natyrore dhe terrori, përveç dhjetra misioneve të brendshme në përgjigje të katastrofave natyrore, luftërave, fushatave ushtarake brenda kufijve të shtetit të Izraelit.

Mund të arrijmë në përfundimin se analiza specifike në trajtimin e katastrofave natyrore, është mjaft e rëndësishme, e quajtur “Përgjigjia plotësuese”. Punimi i përgatitur posaçërisht për Akademinë e Sigurisë hedh dritë mbi sfidat e përballjes së vendeve që

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

kanë përjetuar katastrofa të mëdha natyrore, si tërmeti që lidhet me përvojat dhe masat kundërvepruese.

Misioni izraelit në mënyrë precize ka shprehur mirënjohjen për nderin që i është ofruar, për të ndihmuar qytetarët shqiptarë në këtë kohë të vështira të përballjes me tërmetin dhe për të mbështetur vendimmarrësit dhe ekipet që punojnë në zonën kritike ku ka qenë goditja kryesore e tërmetit.

Ndihma profesionale e misionit izraelit, aktiviteti i tij ishte edhe shprehje e solidaritetit të shtetit të Izraelit, Forcave të Mbrojtjes së Izraelit, Komandës së Frontit të brendshëm me Shqipërinë, qytetarët dhe drejtuesit e saj.

Angazhimi për bashkëpunim të ndërsjellët është vijimësia në ndërtimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet Shqipërisë dhe Izraelit, të mirëqenies së qytetarëve në kohë rreziku, për shpëtimin e jetëve njerëzore në raste emergjente. Ndër rekomandimet kryesore të këtij punimi janë:

Nxjerrja e mësimeve profesionale për fazën jetike të rehabilitimit të vendit dhe aftësisë rikuperuese pas katastrofave natyrore të tërmetit është rekomandim i rëndësishëm, që ka të bëjë me menaxhimin korrekt të fazës “Përgjigje plotësuese”, që të sigurohet pavarësia në menaxhimin e krizës së fenomeneve ekstreme të natyrës sikurse janë tërmetet.

Rekomandohet nivel i lartë i njohurive dhe gatishmërisë së një vendi për të trajtuar një katastrofë të përhapur të fenomeneve ekstreme të natyrës, aq më shumë do të ketë pavarësinë e menaxhimit profesional dhe efektiv.

Kryerja e artikullimit në mënyrë të studiuar mbi pikat kryesore sipas konceptit izraelit për menaxhimin e fazës plotësuese të katastrofave kombëtare dhe fazës kritike për ruajtjen e vazhdimësisë së funksionalitetit, rezistencën dhe qëndrueshmërinë kombëtare ndaj fenomeneve të natyrës.

Rekomandohet evidentimi i aspekteve të përditshme për sfidat e rrezikut dhe zonave të ndryshme në të cilat kërkohet gatishmëria përpara rreziqeve e katastrofave, angazhimi në përballje me fenomenin e tërmetit në Shqipëri.

2. Përmbytjet në Shqipëri, faktor ekstrem kërcënues i sigurisë. Thelbi i përfundimeve dhe rekomandimeve në lidhje me përmbytjet lidhet në radhë të parë me mbrojtjen e jetës së banorëve, pronës, gjësë së gjallë e bizneseve që kryejnë aktivitet në “hartat e rrezikut” të përmbytjeve me qëllim t’i “ndalet dora” natyrës për fenomenin e përmbytjeve, por dhe fenomeneve të tjera ekstreme të natyrës që vendi ynë i ka me shumicë. Nuk ka fenomen ekstrem të natyrës si: përmbytje, tërmete, orteqe, rrëshqitje, dëborëra, ngrica, erëra të forta, bollokime rrugësh, ku nuk kërkohet ndërhyrje të shtetit, mbështetja e policimit, si mjete të efikasitet, shpejtësisë, kulturës institucionale, natyrshmërisë dhe kërkesave të komunitetit. Studimi mbi “përmbytjet” si fenomen ekstrem për t’u kontrolluar, përballuar, disiplinuar e minimizuar humbjet në njerëz është në interes të sigurisë publike. Shmangia e skenarëve të kërcënimeve natyrore duhet të tejkalojë fuqinë matyrore me angazhime që rrjedhin nga Marrëveshja e Klimës e Parisit.

Përvoja botërore shërben për të paraprirë rreziqet e kërcënimit e përmbytjeve duke punuar për të parashikuar të ardhmen. Përvoja jonë rezulton me shumë humbje e dëmtime për mungesë planesh, politikash, strategjish koordinimi e bashkëpunimi institucionale. Të disiplinosh të sotmen do të thotë të minimizosh kërcënimet e përmbytjeve në të ardhmen.

E ardhmja lidhet me kooperimin ndërinstitutional për të njohur fenomenet ekstreme

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

të natyrës të përmbytjeve, duke shfrytëzuar dhe të dhënat që vijnë nga fqinjët, europianët, partnerët strategjikë dhe institucionet prestigjioze të botës në lidhje me përmbytjet, ndryshimet klimaterike, erozionet, etj.

Nxjerrja e mësimave mbi fenomenet ekstreme të natyrës përmes statistikave mund të shfrytëzohen nga organet kompetente shtetërore, duke përfshirë edhe Policinë e Shtetit, strukturat e mbrojtjes dhe strukturat e tjera.

Politikat dhe strategjitë e deritanishme në lidhje me fenomenin ekstrem të natyrës “përmbytje” kanë provuar paefekshmërinë e sistemit standart të deritanishëm si dhe mosfunksionim të sistemit bashkëpunues e koordinues nga nivelet qendrore e lokale, që kanë çuar deri në humbje katastrofale.

Politikat dhe strategjitë për minimizimin e dëmëve nga fenomeni përmbytje nuk janë një “ishull” i shkëputur, dhe që as mund të zbatohen nga një institucion i vetëm, por kërkon bashkëpunimin ndër-institucional të gjerë. Në kushtet e shfrytëzimit barbar të natyrës, nga njerëzit për prishjen e ekosistemeve, si dhe në kushtet e ngrohjes e ndotjes së mëtejshme globale, kërkohet rritja e rolit të shtetit si përgjegjësi i parë i sigurisë publike duke ngritur e menaxhuar veprim efektiv energjik në shërbim të komuniteteve.

Njerëzimi ka qenë përballur gjithmonë me fenomenet ekstreme të të gjithë natyrave, por përmbytjet nuk e mëshirojnë njerëzimin, prandaj skenarët e zgjidhjes ngelen detyrim për strukturat shtetërore, edhe pse sfida përballë fenomeneve kërcënuese do vijojë. Fenomenet e natyrës ekstreme të përmbytjeve të vendosen përballë forcës njerëzore dhe mençurisë së tij duke ecur në korsi dhe duhur europiane. Progresi legjislativ, përafrimi me ligje të BE-së duhet i dukshëm, praktik, i menaxhueshëm, institucional, bashkëpunues, i udhëhequr nga përvojat europiane.

Përballë faktorëve ekstremë natyrorë “të verbër” të pamëshirshëm, të mundësohet kundërpërgjigje institucionale me strategji, plane, programe, buxhet financiar, tej pamësi për të sfiduar të ardhmen e mundshme të ripërsëritshme të përmbytjeve, ku rreziku më i madh për Shqipërinë vjen nga tërmetet, por fakt është se 72% e humbjeve janë nga përmbytjet prandaj buxhetet e llogaritura mirë mund të ndalojnë përmbytjet.

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me partnerë të BE-së, NATO-s, SHBA-së, OKB-së, do të lehtësojë menaxhimin e përbashkët të katastrofave të përmbytjeve me kosto të përbalueshme, ku shtetet ndërkufitare të administrojnë përgjegjësitë me prezencë në fatkeqësitë e njeri-tjetrit, me impenjim, bashkëpunim dhe partneritet.

Buletinet paralajmëruese të përmbytjeve duhet të dalin nga anonimiteti, të jenë më pranë komuniteteve veçanërisht ato me rrisht të lartë.

Disa nga rekomandimet e mundshme në lidhje me këtë punim:

Ngritjen e strukturave të posaçme ligjzbatuese të fokusohen tek planet speciëke për ndalimin e fenomeneve ekstreme; mbajtjen e kapaciteteve për kundërpërgjigje; studime të mirëfillta mbi shkaqet dhe faktorët;

Rishikim themelor i “Planit kombëtar për emergjencat civile”; ndërgjegjësim publik; edukim, arsimim dhe trajnim për mbrojtje efektive. Plani *kombëtar për emergjencat civile* si dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar rekomandohet të mundësojë riformatimin teorik të mbështetur në mundësi praktike të funksionimit të strukturave që nxisin bashkëpunimin dhe qasjet bazuar në Direktivën e BE 2007/60/ datë 23.10.2007, e standardizuar.

Risaktësim detyrash e përgjegjësisë në ministritë e linjës dhe institucionet shtetërore, ristrukturim, organizim dhe menaxhim për minimizim rreziqesh duke përdorur me efikasitet edhe strukturat e sigurisë shtetërore si dhe duke konsoliduar bashkëpunimin

me aktorë e faktorë ndërkombëtarë.

Shfrytëzimin e përvojave botërore për institutet shkencore, krijimi i “të urtëve ekologjikë”, forcim të kujtesës institucionale, ndërgjegjësim, kundërpërgjigje praktike, garantim i sigurisë publike.

Rishikim e ashpërsim legjislativ e penal, disiplinimin e lumenjve “luftarakë”, që faktori “njeri” të dominojë fenomenet; përmirësim i sistemit juridik, politikave, strategjive, projekteve, buxheteve, kodifikimeve etj.

Sigurimet si kulturë dhe si zgjidhje për fenomenet ekstreme të natyrës dhe natyrën e tyre shkatërruese, si zgjidhje ligjore e institucionale mbi bazën e eksperiencave të sigurimeve si praktikë e përparuar botërore ose sikurse quhet si “Blerja e rrezikut”, përmes sigurimesh si një ndër zgjidhjet efikase për përmbytjet, tërmetet, zjarret, ortejë, rrëshqitjet, pandemitë etj.

3. Arkitektura në përballje me katastrofat natyrore.

Arkitektura ka funksion të sigurojë një mjedis të banueshëm dhe të përmirësojë cilësinë e peizazhit fizik për t'i shërbyer njerëzimit. Arkitektura është një profesion, një art, që i përgjigjet problemeve të shfaqura në kontekst duke ofruar zgjidhje, projekte, ndërtime, teknologji dhe risi.

Arkitektura u nënshtrohet teorive të ligjeve natyrore, merr informacion dhe të dhëna nga gjetjet e kërkimit shkencor. Dizajni arkitektonik paraqitet një detyrë themelore për të rregulluar artikulluar dhe paraqitur në mënyrë racionale atë që është midis objektit dhe ta harmonizojë atë me mjedisin për të krijuar rregull në rrjedhën e hapësirës dhe për të përbushur kërkesat estetike, dhe jetësore. Presionet e jashtme si standardet e sigurisë, trendet, financat, teknologjia, materialet duhet të shoqërohen me sigurinë e mjedisit.

Arkitektët duhet të kuptojnë mirë kushtet e vendit, për të ofruar zgjidhje të përshtatshme për sfidat e veçanta. Përfitimi i zgjidhjeve arkitektonike të dizajnit nuk mund të jetë kontradiktore me natyrën dhe se zgjidhja duhet të inkurajojë praninë e natyrës krah për krah me zgjidhjen përfundimtare. Edhe pse siguria njerëzore është primare ajo asnjëherë nuk mund të shkëputet nga mjedisi dhe mënyra se si i afrohem asaj, arkitektura. Nga ky punim dalim në këto rekomandime:

Largimi i përkohshëm i njeriut nga natyra nuk ka qenë periudha më e lavdërueshme e tij, përkundrazi qëndrimi larg saj do të bëjë më të vështirë bashkekzistencën e tyre në kushtet e ndodhjes së fenomeneve të natyrës.

Funksionimi efikas i ekosistemit, cilësia e mjedisit, krijimet e ambienteve natyrore apoharmonizimi i ndërtimit me mjedisin fizik, ndërgjegjësimi, zvogëlimi i ndotjeve mjedisore në projektin arkitektonik janë mjetet kryesore për të arritur një ekuilibër midis njeriut dhe natyrës dhe sigurisë përreth tij.

Dizajni arkitektonik është një problem i zgjidhur dhe një disiplinë e orientuar drejt shërbimit social e cila lëviz me kohën dhe kështu i nënshtrohet ndryshimeve. Këto ndryshime nuk duhet të rrisin në asnjë mënyrë hendekun midis njeriut dhe natyrës; në vend të kësaj ndryshimet duhet të ngushtojnë hendekun, që të dy të bashkëjetojnë në harmoni. Përpjekjet e përbashkëta të të gjithë aktorëve të përfshirë duhet të jenë bashkëpunimi, konsultimi dhe jo konfrontimi dhe konkurrenca.

4. Preventivat për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore.

Në fatkeqësitë natyrore përparësi merr fjala e ekspertit, veprimtaritë menaxhuese

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

të emergjencave, që në fakt kur tëballafaqohemi me situata të jashtëzakonshme, të gjithë pjesëmarrësit në emergjencë të veprojnë në kushte të rënduara psikologjike dhe të parapërgatitura për këtë gjë.

Ekipet emergjente përveç që janë të ngarkuar me stres, punën ua vështirësojnë edhe viktimat nga popullata, të cilët i kaplon frikë, panikë, shpeshherë në mungesë të informacioneve të mjaftueshme përhapen edhe dezinformata të ndryshme. Në shumë vendbanime sidomos në vendet rurale ekipet e shpëtimit munden të vonohen në ofrimin e ndihmave, kuptohet për shkaqe objektive prandaj është e domosdoshme dhe shumë e preferuar që secili qytetar të ketë njohuri elementare për fatkeqësitë e ndryshme që munden ta godasin, që të jetë në gjendje t'i ndihmojnë vetes dhe të tjerëve. Qytetarët individualisht dhe kolektivisht duhet të jenë të përgatitur si në familje, rrugë apo institucione do kontribuojnë që pasojat të minimizohen.

Duke synuar vlefshmërinë e këtij punimi dhe ofrimin e zgjidhjeve për fatkeqësitë mund të ofrohen këshilla mbi reagimin në shtëpi, familje, shoqëri me qëllim të vetëndihmës, por edhe të ofrimit të ndihmës; rekomandojmë:

Krijimin e grupeve shumë profesionale në nivel lokal, duke i pajisur me instruksione dhe udhëzime me shkrim për preventivat mbrojtëse nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera natyrore.

Në gjithë nivelet e pushtetit vendor e qendror mundësimi i ekipeve që merren me trajtimin e emergjencave të kenë aftësi psikologjike dhe sociale.

Rekomandohet që informacionet për situatën aktuale të fenomeneve ekstreme kërcënuese të natyrës të jepen vetëm përmes burimeve zyrtare të informacionit, për të eliminuar konfuzionin në fillim të fatkeqësisë.

5. Emergjencat civile në nivel vendor dhe përballimi i tyre nëpërmjet rregullave, procedurave dhe koordinimit.

Mundësimi i gjetjeve dhe aplikimit të praktikave më të mira në lidhje me miratimin e testimit e planeve të emergjencave që është hapi i parë për t'u kryer sa më shpejt të funksionimin normal të jetesës së komunitetit. Fatkeqësitë natyrore ekstreme, kërkojnë në plan paraprak mbi fatkeqësitë.

Planifikimi paraprak siguron ndërmarrjen e gjithë hapave të nevojshme për t'u përgatitur për një emergjencë dhe zvogëlon dëmet në njerëz apo në infrastrukturë. Element kyç i gatishmërisë për emergjencë është zhvillimi i një programi të menaxhimit të emergjencave. Në rastin e Shqipërisë, arsyet e përgatitjes së këtij udhëzuesi është që t'ju shërbejnë bashkive të reja post reformë, të marrin përgjegjësi për emergjenca civile në çdo kohë, t'i orientojë drejt pritshmërive qytetare për rol parësor e vendimtar në çështje të emergjencave civile, ngritjes së strukturave të qëndrueshme, qendra të shpëtimit dhe evakuimit si dhe tërë mekanizmit zinxhir për një sistem eficient në raste të emergjencave civile vendore.

Njësitë e pushtetit vendor të kenë struktura të ngritura të gatshme operacionale, për gjithë rastet e emergjencave që vijnë si pasojë e fenomeneve ekstreme të natyrës. Rregullat dhe procedurat të shoqërohen me trajnim, njohuri dhe kulturë në menaxhimin e rreziqeve e kërcënimeve të strukturave të njëjësive vendore. Nga ky punim rekomandojmë që:

Bashkitë në zbatim të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, nr. 139/2015 si dhe ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, duhet të kenë planin për menaxhimin e emergjencave civile të bashkisë, të miratuar në këshillin bashkiak.

Bashkitë duhet të mbajnë aktive këtë plan të emergjencave civile, të organizojnë, strukturojnë me teknologji, burime njerëzore dhe trajnime periodike.

Çdo bashki të planifikojë, menaxhojë dhe monitorojë mirë mjetet financiare dedikuar emergjencave civile, me vizionin se është më mirë të investojmë në parandalim sesa në përballim të fenomeneve ekstreme të natyrës.

6. Roli i Policisë së Shtetit në menaxhimin e krizës së Covid-19.

Përgjigjet ndaj pandemisë duhet të sigurohemi se janë proporcionale, të domosdoshme dhe jodiskriminuese, duke mbajtur parasysh masat paraprake të rekomanduara nga OBSH-ja, duke pasur parasysh që policia dhe struktura e ligjzbatuese duhet të vazhdojnë të trajtohen jo vetëm çështjet e sigurisë publike, por dhe ato të shëndetit para, gjatë dhe pas pandemieve.

Policia dhe entet ligjzbatuese ministritë e tyre përkatëse dhe autoritetet gjyqësore të vlerësojnë drejtë situatën pandemike dhe të veprojnë mbi ato vepra që paraqesin një kërcënim të menjëhershëm për komunitetin për zvogëlimin e presionit mbi vendet e paraburgimit e burgjet.

Të zhvillohet paraprakisht një strategji të komunikimit publik, me zyrtarë të shëndetit publik për të zhvilluar mesazhe e strategji për komunikimin e rrezeve në komunitet. Komunikimet duhet të përfshijnë informacion të saktë dhe në kohë dhe duhet të ndiqen udhëzimet e përgjegjshme duke përsosur mënyrat e komunikimit për të zvogëluar frikën dhe panikun e panevojshëm, pajustificueshmërinë, ngritjen e etikës së sjelljes etj.

Mesazhet dhe bashkëpunimi me publikun duhet të jetë i gjerë me udhëzime mbi atë që duhet të bëjë publiku në rast emergjence, duke theksuar rëndësinë dhe përfitimin e drejtpërdrejtë për komunitetin dhe sistemin e tij të shëndetshëm të zbatimit vullnetar të urdhrave të shëndetit publik si masat e karantinës dhe distancimit shoqëror për të eliminuar infektimet.

Në rastin e pandemieve strukturat e policimit përballen me barrën shtesë të operimit me një fuqi punëtore të reduktuar, pasi strukturat nuk janë të imunizuara nga infektimet dhe që mund të kërkojnë izolim pasi të ekspozohen ndaj personave të infektuar. Nga kjo temë rekomandojmë:

Përvojat nënvizojnë nevojën, për t'iu qasur procesit të planifikimit sistematik e logjik, duke filluar me një kuptim të plotë të çështjes.

Zyrtarët e Policisë Shtetit duhet të përqendrohen në zhvillimin e një plani fleksibël që bazohet në rekomandimet e shëndetit publik për një pandemi.

Angazhimi dhe edukimi i punonjësit të policisë, si dhe përfshirja në planifikimin ekzistues i përpjekjeve të reagimit ndaj emergjencave në planifikim, do të ndihmojnë në procesin e përsosjes si punës së strukturave të policisë. Siç vendos në dukje një zyrtar amerikan, "Procesi i planifikimit është po aq i rëndësishëm sa rezultati - ju duhet të kaloni nëpër procesin logjik të të kuptuarit të rrezikut", me qëllim që të merrni masa ndaj tij.

Duhet të marrin vëmendjen e duhur kërcënimet e mundshme penale, parandalimi i ekspozimit, procedurat operacionale që duhen ndjekur kur lejoni vizitorët në ambientet e policisë, të drejtat e njeriut dhe policimi gjatë një pandemie, policimi i përgjegjshëm gjinor gjatë një pandemie.

7. Planifikimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore në Republikën e Kosovës.

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i strategjisë dhe politikave në planifikimin dhe

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

menaxhimin e fatkeqësive edhe në shtetin e ri të Kosovës kërkon veprime të matura e të përgatitura për të ndërvepruar dhe për të krijuar mundësitë e përballjes në të ardhmen me situata të tilla fatkeqësish të natyrës, duke mësuar nga eksperiencia e shteteve në përballjen me natyrën kërcënuese.

Planifikimi i zhvillimit të strategjive dhe politikave të vihen në funksion me një infrastrukturë të përshtatshme që të frenojë kërcënimet e natyrës.

Në gjithë këtë kuadër përveç afirmimit të politikave duhet ta zhvillojmë një plan shumë të detajuar të shfrytëzimit të resurseve ekzistuese si nga ato të sektorit publik me gjitha ato specifika dhe specialitete të cilat i posedon, domosdoshmërisht duhet të kemi një plan konkret që krahas resurseve të sektorit publik t'i shfrytëzojmë edhe resurset nga sektori privat, sepse në një shoqëri moderne ky sektor është mjaft i pajisur dhe ka kapacitete të cilat mund të na hyjnë në punë në situata të caktuara fatkeqësish.

Analiza e kapaciteteve të cilat vetëm i posedon sektori publik me gjithë gamën e institucioneve dhe agjencive të cilat për mision kanë menaxhimin dhe ballafaqimin me fatkeqësitë natyrore, si dhe identifikim i resurseve dhe kapaciteteve të cilat sektori privat i ka në dispozicion dhe krijimi i një plani të detajuar për shfrytëzimin e kapaciteteve falë edhe mekanizmave bashkëpunues me institucionet publike dhe aktorëve relevantë privat.

Identifikimi i zonave të rrezikuara nga fatkeqësi të mundshme natyrore, të vendosen stacione mobile në ato zona të cilat do të mundësonin reagimin me të shpejt dhe në kohë ndaj këtyre dukurive dhe kjo pastaj do ta bënte më të lehtë menaxhimin e situatave sepse një ndërhyrje e shpejtë dhe efikas mund të mënjanojë shumë dëme materiale, dhe sidomos evitim të rrezikuar të humbjes së jetëve njerëzore. Nga ky punim mund të rekomandojmë:

Rishikimi i politikave e strategjive të mirëfillta në mënyrë mos të arrihet në një kolaps ekologjik, social dhe ekonomik. Politikat dhe strategjitë në Kosovë në përgjigje ndaj kërcënimeve, duhen forcuar juridikisht e praktikisht.

Rekomandojmë gjithashtu që në këtë kontekst duhet të hartohen plane konkrete për shfrytëzimin e resurseve ekzistuese të sektorit publik dhe burimeve të sektorit privat, për minimizimin e fenomeneve të natyrës.

Duhet të behet një analizë e gjerë dhe e thellë si dhe të hartohet raport i detajuar ku janë të identifikuar zonat më shumë të kërcënuara nga fatkeqësitë, t'u jepet prioritet zonave problematike unike me synim kundërpërgjigje dhe bashkëpunimin me faktorë mbështetës ndërkombëtarë.

8. Sistemi i zvogëlimit dhe menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri: nevojat dhe mangësi strukturore.

Risku i lartë nga fatkeqësitë është tregues i zhvillimit të dobët, ndaj zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kërkon integrimin e politikës të reduktimit dhe menaxhimit të riskut, për zhvillim të qëndrueshëm.

Procesi i përballimit të fenomeneve ekstreme kërkohej të jetë gjithëpërfshirës duke bërë identifikimin e mësimave të nxjerra për të menaxhuar e përballuar riskun në nivele të ndryshme të ekzekutivit dhe të pushtetit vendor. Është nevojë emergjente forcimi i marrëveshjeve ekzistuese institucionale, legjislative dhe financiare për menaxhimin gjithëpërfshirës të riskut nga fatkeqësitë.

Në planin legjislativ aktet dytësore të Ligjit për Mbrojtjen Civile duhet të zbatohen si dhe të mundësohet shpërndarja e parimeve udhëzuese për përdorimin e buxheteve

specifike të miratuara për DRR-në në Ligjin 45/2019 dhe të zhvillohet një sistem për të monitoruar shpenzimet dhe rezultatet, për të mbikëqyrur rikualifikimin, përpjekjet e rindërtimit duke gjetur mekanizmat e duhur duke forcuar sistemin ekzistues të qeverisjes.

Përmirësim thelbësor të aktiviteteve ekzistuese të ndërgjegjësimit publik dhe fushatave edukative për konceptin RRF (DRR) të integruar në kurrikulat shkollore për të siguruar arsimimin e “aftësive jetësore”.

Krijimi i një programi gjithëpërfshirës trajnimi për menaxhimin e fatkeqësive dhe se ekipet ekzistuese ushtarake USAR dhe MZSH kërkojnë një program kombëtar të standardizuar të trajnimit si dhe të mirëpajisjes për dimër dhe verë për t’iu përgjigjur emergjencave në shkallë më të madhe.

Depot e rezervave shtetërore janë të vendosura në ndërtesa të vjetra dhe të dobëta, të cilat kanë nevojë për rinovim dhe nivelet e rezervave të kërkuara duhet të rishikohen dhe monitorohen në përputhje me praktikat moderne.

Planet e emergjencës civile në nivel kombëtar, qarku dhe bashkie duhet të zhvillohen ose përmirësohen duke integruar identifikimin/vlerësimin gjithëpërfshirës të riskut dhe duke përfshirë procedurat standarde operacionale me shumë aktorë. Nisur nga përfundimet rekomandojmë që:

Të mundësohet rivitalizimi i masave për gatishmëri dhe reagim me masa strukturore e jostrukturore, ku ndër masat strukturore, është instalim serioz për AKMC-në, të njëjstej operacionale emergjente për të plotësuar ato që menaxhohen nga FA, Policia e Shtetit dhe shërbimet mjekësore.

Rekomandojmë që prefekturat dhe bashkitë të pajisen me salla operacionale emergjence të pajisura për të funksionuar me sallën kombëtare operacionale, si dhe të një qendre kombëtare trajnimi për të gjithë aktorët DRR nga reaguesit e vijës së parë deri te menaxhimi i emergjencave është një hendek i qartë. Sigurimi i një qendre trajnimi mund të përmirësojë shumë gatishmërinë dhe përgjigjen në të gjitha nivelet.

Rekomandojmë hartimin e një doktrine gjithëpërfshirëse që të përfshijë gjithë fenomenet e rrezikshme dhe kërcënuese si dhe operacionet për të lehtësuar politika të ndërlidhura dhe procedurave standarde të funksionimit. DRR duhet të jetë i integruar në të gjitha politikat duke i kushtuar vëmendje çështjeve mjedisore, përdorimit të tokës dhe çështjeve që lidhen me ndryshimin e klimës. Ekziston nevoja për të vazhduar përparimin në aplikimin për anëtarësim në Mekanizmin e Mbrotjtjes Civile të Unionit.

9. Planifikimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore në qarkun e Shkodrës.

Planifikimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore, veçanërisht për qarkun e Shkodrës për vetë eksperiencat e përmbytjeve të vazhdueshme mund e duhet marrë në konsideratë kompensimi i dëmeve, por edhe problemet në marrjen, dorëzimin dhe shpërndarjen e ndihmave ushqimore për komunitetin dhe gjënë e gjallë. Planifikimi kërkon funksionim të drejtorive të emergjencave në pushtetin vendor për shkëmbim informacioni, për zbatimin e skemave të vërtetimit, lajmërimit, dhe të ndërhyrjes në njësitë administrative, fshatrat e zonave që rrezikohen nga përmbytja etj.

Këshillat bashkiake të bashkive që janë nën rrezikun e përmbytjeve, të rishikohen taksat dhe tarifat vendore për banorët e zonave të përmbytura, korrigjimin e detyrimit për taksën mbi ndërtesat, familjet e përmbytura.

Mbështetja në nivel qarku e bashkie për lehtësimin e sigurimit ndaj rreziqeve katastrofike në territoret e rrezikut, zgjerimi i mbulesës së sigurimit për pronarët e shtëpive ndërmarrjet e vogla e të mesme si dhe fermerët për të përfshirë mbulimin nga

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

përmbytjet, tërmetet dhe fenomenet e tjera.

Fushata ndërgjegjëse për reduktimin e rrezikut, programet mësimore, informimi i publikut ndërmjet rrjetit elektronik, emisioneve TV, në kuadrin e ditës ndërkombëtare të zvogëlimit të rrezikut. Nga ky punim rekomandojmë:

Hartimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe rajonale në nivelin e qarqeve në Shkodër, për reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe mbrojtjes civile, si dhe përgatitja e miratimi i një akteve juridike të posaçëm për gjithë nivelet e pushteteve, që kontribuojnë në zgjidhjen e problematikës.

Përgatitja dhe miratimi i disa akteve nënligjore të veçanta për kompensimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore; për mënyrën e zbatimit të kompetencave dhe informimit të ndërsjellët detyrues midis bashkisë dhe prefekturës për menaxhimin e emergjencave civile; për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara tek fermerët apo tek të mbjellat në tokat bujqësore; për rolin e këshillit të qarkut në kuadrin e koordinatorit e nënkryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut bashkëpunimin me administratat e bashkive, institucioneve anëtare të Komisionit të Mbrojtjes Civile; për përpilimin e hartave të rrezikut për specifikën e territorit dhe llojit të fatkeqësisë; për përcaktimin e rezervës shtetërore nëpërmjet parakontraktimit nga strukturat private në situatë emergjente për t'i ardhur në ndihmë fermerëve dhe mbështetjen e tyre gjatë përmbytjeve, etj.

Rishikimi dhe rihartimi i *Planit kombëtar të emergjencave civile* si një vendim i vjetruar dhe konceptimi në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen civile" ku të përfshihen elementet kyç të hartimit të planit të rrezikut dhe të emergjencave në lidhje me menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend.

Fuqizimi i shërbimeve të strukturave reaguese të mbrojtjes civile në të gjitha nivelet, rritja e profesionalizmit të kapaciteteve ekzistuese, organizimi dhe funksionimi i komisioneve të mbrojtjes civile të qarkut.

Zbatimi i projekteve për zbutjen dhe kontrollin e territorit nga përmbytjet në komunitetet që kanë rrezikun tradicional ndër vite që preken prej tyre.

10. Pasoja e lumit Shkumbin në territorin e Bashkisë së Rrogozhinës.

Lumi Shkumbin është ndër lumenjtë më të rrëmbyeshëm të vendit dhe në vijimësi për dekada ka sjellë vështirësi dhe probleme të shumta për gjithë komunitetin e njerëzve. Ndër pasojat më të prekshme, dhe më të përmendura janë erozioni, përmbytjet, prani e madhe e mbeturinave, etj. Nga ana tjetër një nga shkaqet më përcaktuese të këtyre pasojave mund të përshkruhet si gjurmime pa kriter e agregateve ku shpesh janë shkelur dhe aktet juridike.

Kundërveprimi si dhe masat e reja ligjore e kanë bërë të vështirë por nuk kanë eliminuar pasojat e shumta që rrjedhin nga përmbytjet, ku sipas të dhënave nga kërkimet në terren, ai vazhdon të mbetet fatale për komunitetet dhe pasuritë e tyre, prandaj nevojiten strategji efektive në parandalimin e katastrofave të shkaktuara nga Shkumbini. Zgjidhja do të ishte me interes bashkëpunimi institucional për minimizimin e pasojave. Rekomandojmë:

rishikim të legjislacionit për individët dhe subjektet që ndotin lumin, por dhe politika ndërgjegjëse në komunitet;

u rekomandojmë strukturave kompetente ndërtimin e tre impianteve në bashkitë Elbasan, Peqin, Rrogozhinë për mbledhjen e mbetjeve;

ngritjen e pikave të emergjencave si dhe sistemimi i ujërave duke përfshirë gjithë

grupet e interesit;

vlerësimin e monitorimit të subjekteve që operojnë në nxjerrjen dhe përpunimit të inerteve të lumit.

vijimin e mbjelljes së pemëve, pastrimit të gjithë luginës dhe deltës së lumit, për ta kthyer destinacionin e tij në funksion të popullatës.

■Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI
Drejtues i sesionit të katërt

■Dr. Dorian KOÇI
Drejtues i sesionit të katërt

Përfundime dhe rekomandime nga sesioni i katërt: “Kuptimi, veçoritë, specifikat dhe metodat e hetimit të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile”

Në botën bashkëkohore përkundër arritjeve të jashtëzakonshme të shkencës, shumë probleme të vjetra të shkatërtimeve të vazhdueshme të shoqëruara me të ashtuquajturat “fenomenet ekstreme të natyrës” mbeten të rrezikshme si më parë. Dukuritë e natyrës, siç janë: tërmetet, erërat e forta, që përfshijnë ciklonet (uraganet, tajfunet) ose tornadot, erupsionet vullkanike, cunamet, zjarret, rrëshqitjet e dheut, thatësira e të tjera, ende vazhdojnë. Njerëzit tani janë në rrezik jo vetëm nga ngjarjet ekstreme gjeofizike, siç janë tërmetet dhe vërshimet, por edhe nga shpërthimet fizike, nga lirimimi i materieve toksike dhe nga aksidentet e mëdha në trafik. Prandaj, në mënyrë permanente dhe sistemore duhet të punohet në vetëdijesimin lidhur me fatkeqësitë, sepse fatkeqësi të reja ndodhin vazhdimisht. Historikisht, fatkeqësitë janë pjesë e zhvillimit njerëzor. Breza të tërë të njerëzimit është dashur t’u bënin ballë katastrofave. Ata vuanin nga pasojat, por edhe shëroheshin nga to dhe e vazhdonin jetën. Njerëzimi është kalitur t’u bëjë ballë këtyre problemeve deri në një shkallë, edhe pse ato as nuk u zhdukën, e as nuk u kufizuan. Kështu që, derisa ne mund t’i modifikojmë pasojat e tyre në mënyra të ndryshme, ato vazhdojnë të shkaktojnë presion të padurueshëm në popullsi, që në çështje të ekzistencës totale, pothuajse është e pamundshme t’u dilet në fund.

Kërkimet mbi fatkeqësitë natyrore përfshijnë studime ndërdisiplinore, me fokus në aspektet e ndikimit të tyre në shoqëri, e në veçanti në çështjet e sigurisë. Mbështetur në studimet e kësaj fushe, shumica e studiuesve e përkufizojnë termin katastrofë si ngjarje që krijon pasoja të konsiderueshme të dëmshme për sigurinë, përkatësisht, ndikimi negativ në shumicën e funksioneve themelore të sistemit të sigurisë. Rreziku nga fenomenet ekstreme natyrore, është i përcaktuar për shumicën e fushave të sistemit të

menaxhimit, siç janë pasojat e mundshme ekonomike, sociale dhe mjedisore të ngjarjeve të rrezikshme që mund të ndodhin në një periudhë të caktuar kohore. Në këtë proces të paracaktimit, ndikim të madh ka zhvillimi i teknologjisë informative dhe lëshimi i satelitëve të vëzhgimit të tokës, të cilët japin të dhëna me rezolucion të ndryshëm hapësinor, spektral dhe kohor, mbi hapësira të gjera gjeografike. Ky zhvillim e ka bërë menaxhimin e rrezikut të katastrofave të paimagjinueshëm pa integrimin e imazheve satelitore dhe përfaqësimit të teknologjisë GIS në ditët e sotme. Sepse, në situata fatkeqësie, vendimet joefektive mund të çojnë në humbje të mëdha, përkatësisht, në shkatërrim infrastrukturë, humbje në njerëz, etj. Menaxhimi i riskut nga katastrofa është proces i përbërë nga shumë faza, të cilat përshkruajnë domosdoshmërinë e vendimmarrjes së informuar. Thelbësore për të arritur këtë është vlerësimi i dëmit të mundshëm të shkaktuar nga fenomenet ekstreme të natyrës. Ndërsa gjatë dekadave të kaluara, janë zhvilluar një larmi metodash të ndryshme, në vende të ndryshme, për vlerësimin *ex-ante* (strategji aktive që vlerëson dhe administron riskun përpara se të ndodhë një fatkeqësi) të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, të cilat e kanë bërë të vështirë krahasimin e metodave të vlerësimit me njëra-tjetrën.

Fatkeqësitë natyrore (dhe ato të shkaktuara nga njeriu), si përmbytjet, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, stuhitë, breshëri, thatësira, zjarret në pyje dhe ndërtesa, janë në rritje në dekadat e fundit, ndërsa katastrofat e ardhshme do të jenë më ekstreme dhe më komplekse, me pasojat të gjera dhe afatgjata, si rezultat, në veçanti, i ndryshimit të klimës dhe ndërveprimit të mundshëm që sjellin disa rreziqe natyrore dhe teknologjike. Viktimat njerëzore, dëmtimet e mëdha në zonat urbane, ndikimi negativ në mjedis dhe dobësimi i mëtejshëm i ekonomisë rajonale, janë ndër treguesit e rritjes së cenueshmërisë. Andaj, parandalimi është i një rëndësie thelbësore për mbrojtjen nga katastrofat dhe kërkon veprim të mëtejshëm siç përcaktohet në rezolutën e Parlamentit Evropian, me titull “Një qasje e komunitetit për parandalimin e katastrofave natyrore dhe të krijuara nga njeriu”.

1. Reshjet e janarit 2021 dhe përmbytjet në Shqipëri. Reshjet e janarit 2021 u karakterizuan me një kohëzgjatje të lartë, me një numër ditësh me reshje rekord me vlera 250% kundrejt normës, ndërsa si sasi rreth 262% kundrejt vlerës mesatare shumëvjeçare. Bazuar në përdorimin e informacioneve nga Sistemi Kombëtar i Monitorimit Meteorologjik, burimeve satelitore dhe të platformave profesionale evropiane me të cilat bashkëpunon IGJEUM, i cili ka ekskluzivitetin për përdorimin e produkteve të tyre është vlerësuar se në Shqipëri situata e reshjeve të muajit janar 2021, u shoqërua me përmbytje në zona të ndryshme të vendit.

Përmbytjet nuk ishin të lokalizuara vetëm në një zonë të vendit, siç kishte ndodhë shumë raste më parë, por ato prekën të gjithë vendin, duke vështirësuar ndërhyrjen me mjete për minimizimin e humbjeve nga kjo dukuri. Njoftimi me kohë nga IGJEUM ishte ndihmës për institucionin e emergjencave civile, për të informuar me kohë pushtetin lokal dhe ndërhyrë me kohë me mjete të disponueshme. Në përputhje me standardet e OBM-së, janë analizuar tregues të ndryshëm të reshjeve, intensitetet e tyre dhe shpërndarja në hapësirë dhe kohë për muajin janar 2021 për territorin e Shqipërisë.

Përdorimi i SIG-së dhe softuerëve të tjerë profesionale, mundësoi një thellim të mëtejshëm në studim jo vetëm mbi karakterin e reshjeve të vrojtuar, raportin e reshjeve të shiut me reshjet e dëborës, por dhe të ndikimeve të përcjella nga ndryshimet klimatike dhe veprimtaria njerëzore në vitet e fundit. Në këtë kumtesë bëhet dhe një analizë e

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

veçorive të përbashkëta dhe të veçanta të përmbytyjeve në vitet e fundit për faktorët e shkaktimit të tyre. Përgatitja dhe shpërndarja në kohë e vlerësimeve parashikuese meteorologjike dhe hidrologjike nga IGJEUM-i, përbën një ndihmesë në punën e infrastrukturës së emergjencave civile, pushtetit lokal e qendror në menaxhimin e situatës, duke ndikuar në minimizimin e pasojave negative.

2. Covid-19 dhe menaxhimi i tij në rastin e Republikës së Kosovës. Pandemia Covid-19 është një nga krizat më të mëdha globale që nga Lufta e Dytë Botërore, e cila në fakt ka përfshirë me këtë virus 193 vende të botës, ndërsa agresori (virusi) u shfaq aq papritur sa pothuaj të gjithë vendet u gjenden të papërgatitura dhe pa strategji të reagimit dhe vetëm po përpiqen të gjejnë mënyra për t'u mbrojtur. Në këto kushte sfiduese, të gjitha shtetet janë në luftë. Qeveritë në mbarë botën kanë ndërmarrë masa të paprecedentë për t'u përballur me sfidat e pandemisë si dhe për të kufizuar rreziqet e saj mbi jetën dhe shëndetin. Këtu nuk bëhet dallim midis fuqive të mëdha apo vendeve të vogla, sepse edhe strukturat e krijuara, organizatat ndërkombëtare apo edhe aleancat e mëdha u kapën në befasi e pa agjendë. Shpejtësia, hapësira globale dhe ndikimi i përhapur i pandemisë së fundit të korona virusit (COVID-19), e kanë bërë menaxhimin e krizave një përparësi kryesore të të gjitha shteteve, sepse ajo vendosi në udhëkryq kritik institucionet dhe shoqëritë.

Shtetet, organizatat dhe aleancat, u gjenden pa strategji dhe kapacitete të përballimit për një sfidë të tillë. Aktualisht shtetet u përballën me një bllokim apo edhe lëndim të një mori procesesh, sepse janë shkaktuar dëme të mëdha ekonomike, sociale e politike.

Kufijtë shtetërorë janë të mbyllur, ekonomitë janë të bllokuara, gjendjet e jashtëzakonshme janë futur në të gjitha vendet, qytetarët ende janë në izolim dhe pandemia ende paraqet kërcënim vdekjeprurës për njerëzit. Shumëçka është e paqartë sepse kostot njerëzore, politike, sociale dhe ekonomike të pandemisë mbeten të paqarta, kurse një gjë është e qartë se nuk ka gjasa për kthim të shpejtë në gjendje para pandemisë.

Në Republikën e Kosovës, kjo nuk ishte kriza e vetme që po zhvillohej. Njëkohësisht, Kosova po merrej me një situatë tejet të paqëndrueshme politike dhe institucionale, të shkaktuar nga pandemia, rrëzimi i qeverisë, e cila çoi në shpërndarjen e Kuvendit dhe formimin e Qeverisë. Qasja e Kosovës në përballje me COVID-19, u sfidua nga mungesa e qasjes parandaluese dhe përgatitore ndaj situatave emergjente, mungesa e bazës së qartë ligjore për vendimet e Qeverisë, kufizimet në resurse dhe kapacitetet e stafit, si dhe mungesa e një sistemi të qartë, transparent dhe konsistent për komunikim me publikun.

COVID-19 ishte tregues se Republika e Kosovës ka mungesë të kapaciteteve për t'u përballur me kërcënimet dhe rreziqet që shkatojnë nga katastrofat natyrore, epidemitë apo kërcënimet tjera që cenojnë sigurinë e përgjithshme. Sfidat e shfaqura në menaxhimin e pandemisë faktuan se Kosovës i mungon një sistem kualitativ i sistemit shëndetësor e shtetëror dhe koordinim institucional, për t'u përballur me kriza shëndetësore të kësaj përmasë.

5. Hydrological and meteorological conditions and the issuance of flood alarm by the National Center for Forecasting and Monitoring of Natural Hazards in Albania. Flooding by rivers is one of the most frequent natural hazards in Albania. Floods are not generated by intense rainfall, but by the hydrological processes of the land surface on which the rainfall occurs. They are the result of the interaction between the hydrology and meteorology of a given area.

With the establishment of the National Center for Forecasting and Monitoring of Natural Hazards, at the Institute of Geosciences, Energy, Water and Environment, the Contemporary Early Forecasting and Warning System was established for the first time in 2010 in Albania.

The flood forecast bulletin is a product of the National Center for Forecasting and Monitoring of Natural Hazards, which is forwarded by e-mail to the Directorate of Civil Emergencies in the Ministry of Defense and all interested ministries. A detailed analysis of hydrological and meteorological conditions that characterize a river basin in a given period, which are crucial in the development of the flood phenomenon. Their analysis as well as the follow-up of standard working procedures by the forecaster of the National Center for Forecasting and Monitoring of Natural Hazards, is very important before the flood alarm is given. Knowledge of the hydrology of the river basin, as

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

well as the history of floods together with physical characteristics such as the shape of the basin, altitude, topography, etc., affect the quality of the alarm.

The main meteorological parameters in the development of the flood phenomenon are precipitation and temperature. Also, other factors such as relative humidity, wind, etc., affect the development of floods. The combination of these parameters are the basis of the European Flood Forecasting Model, which informs a few days in advance about the amount of rainfall that is expected to fall in a given territory, as well as the trend and probability in % for river floods, floods or landslides. On this basis is supported the work of the forecaster to give the alarm through the Bulletin of Natural Hazards.

Urbanization of cities has a great impact on the development of the phenomenon of floods from rivers and frequent floods. Also, in addition to uncontrolled urban development, the non-maintenance of drainage canals, as well as the non-maintenance of damaged embankments on river banks plays a major impact.

6. NATO and disaster relief operations. *Natural disasters are happening more often and are becoming more and more devastating.* Following this trend, the North Atlantic Treaty Organization (NATO) has increased the importance of engaging its forces in international assistance in cases of natural disasters. As a result of this engagement, there have been reactions from critics, who have expressed doubts whether the disaster relief operations are an appropriate area of activity for the Alliance.

For fifty years, NATO's interest and capabilities in protecting populations have served to protect the civilian population. The Partnership for Peace has allowed NATO to work with its partners on disaster preparedness in partner countries and NATO countries. The NATO Rapid Reaction Force was created to meet the Alliance's requirements in the new scenario, building high capacity of its operational and logistical capabilities, such as readiness and autonomy.

The involvement of NATO forces in disaster relief operations is in line with the basic principles of the Alliance. A review of the literature, based on a case study, shows that NATO's involvement in non-military military operations (MOOTW-Military Operations Except War) in humanitarian aid in the event of a disaster it is acceptable, although there are still areas for use, it is an added value but above all it is effective.

There are special agreements between NATO member countries that facilitate disaster support operations. The cooperation is organized in advance with the drafting of NATO standardization agreements (STANAGs). Many countries that need disaster assistance but do not have pre-arranged bilateral agreements, based on the situation they are in, may seek to establish such agreements. This is due to the fact that the logistical structures of the Alliance Rapid Reaction Forces offer a great potential for dual use. This means that logistics forces in addition to the primary mission for genuine combat operations, can also be used in non-combat military operations (MOOTW) such as civil defense or humanitarian aid in case of natural disasters. Example: "NATO engagement in 2005, following a major earthquake in Pakistan. Following a request for assistance from the Pakistani Government (through the United Nations), the Alliance immediately dispatched the NATO Reaction Force (NRF), which successfully engaged all logistical and human resources in a large-scale humanitarian operation.

7. Sustainable management of the Alps, and extreme phenomena of alpine nature.

The Albanian Alps meet in the northern part of Albania, representing the region with the highest altitude and one of the most beautiful in the country. The basins and valleys of the alpine rivers of the “Bjeshkët e Namuna” Mountains are characterized by a high ecological diversity, expressed by a variety of landscapes, habitats (Geographical position and variety of geographical factors, such as: extension from low altitudes, about 600 m to altitudes of high, over 2500 m, quite rugged relief, different direction of mountain slopes, etc., have created diverse habitats for the growth of a developed vegetation and a very rich flora.), forests, shrubs and pastures, as well as from a high biological diversity, with a rich flora and fauna and with many endemisms.

In the Albanian Alps, in general, the current state of habitats are somewhat better preserved, mainly due to geographical and climatic aspects, small number of inhabitants and poor livelihoods, low level of agricultural products, livestock, forestry, handicrafts, etc., as well as the lack of investments in the park infrastructure.

Activities such as landscape degradation, exploitation of natural resources, dumping of aggregates, disorganized tourism, etc., can threaten biodiversity and the landscape, and can lead to a future catastrophe.

8. Towards membership in the European Civil Protection Mechanism (UCPM).

Albania is a step away from becoming a member of the EU. After the entry into force of law no. 45/2019 and the establishment of the structure of the National Civil Protection Agency, there are some other tasks to be accomplished and, referring to the study above, it is recommended as follows:

- harmonization of the Albanian civil protection legislation in accordance with the directives of the European Union and other regulations;
- recognition of the responsible institutions and the highest governmental bodies in the country; with the functioning of the Mechanism (activation of the Mechanism, composition, logistics, trainings, missions, etc.);
- strengthening national capacities for prevention, preparedness, response and co-ordination of civil emergencies caused by various disasters;
- consolidation and training of human and logistical capacities, with the aim of their immediate mobilization according to the relevant procedures of the Mechanization, when international assistance is required and provided;
- early and continuous communication with the ERCC at all times;
- exchange of information with the objective of promoting and encouraging cooperation between Albania and the European Civil Protection System;
- the commitment of Albania and AKMC to benefit as much as possible from IPA programs and projects as well as other international initiatives in the field of civil protection, where they are directly and indirectly involved.

During the fourth session of the VI International Scientific Conference “Extreme Natural Phenomena and Security Issues”, a number of important recommendations were brought, which are presented below:

- implement new policies to minimize flooding in the future, in relation to all space and vulnerable individuals, by relocating them from vulnerable areas, as established in all developed countries;
- to design security policies, creating pockets with spaces intended for floods as a reserve microbase to collect excess water at critical moments of time;
- to apply technical-scientific standards by scientific institutions;

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

- to draft a new policy in the protection of forests, as they not only protect the soil from erosion, but they give their products to the local population while preserving certain flora and fauna;

- the necessity of thinking and preparing the society for scenarios based on assumptions, which in the world of planners is known as "Preparing for the worst case scenario with more serious consequences", in order to increase local capacity to cope effectively with various disasters;

- improve the coordination and management system, promoting a culture of preparedness, and improve crisis response planning, as the COVID-19 pandemic highlighted the challenges of inter-institutional communication and a comprehensive crisis-based approach to central and local must;

- the government should prepare, and the Parliament should approve the National Security Strategy, as well as the Action Plan for Disaster Risk Reduction, as important documents for the construction and coordination of work programs and activities of all entities at the local level, central, as well as foreign and domestic donors, for the prevention and reduction of risks from natural and other disasters;

- permanent and reliable interaction with local and international mechanisms from specific areas, through channels well known by all relevant local, local and central actors;

- it is necessary to establish a strict protocol to deal with extreme natural phenomena, which requires the cooperation of several local actors such as meteorologists, national security experts, seismologists and legal experts, in close cooperation with central actors;

- to draft a clear framework for the dissemination of early warnings, especially at the local level, as well as the integration of traditional EWS in the formal system;

- reviewing development plans and providing guidance on integrating disaster risk reduction measures into these plans;

- continuous monitoring of risks and poor conditions within the municipality;

- preparation of guidelines and standards for local stakeholders in reducing disaster risk;

- implementation of education, training and public awareness programs for local officials, stakeholders and communities;

- development of measures to prevent, minimize and mitigate adverse effects on human life, economy and environment through flood forecasting and early warning;

- addition of surveillance stations, maintenance of the monitoring network, increase and strengthening of the human capacities of the National Center for Forecasting and Monitoring of Natural Hazards;

- It is necessary the program of cooperation of the NATO Alliance with partner countries and countries outside its region, in the field of civil emergency planning, because this cooperation improves civil preparedness, creating policies and structures for this purpose, with the main objective safety in general;

- Improving the system of capacity management of mountain areas, through capacity building and conservation of habitat types, biodiversity and landscape;

- To ensure the management system of the Albanian Alps within the international management standards regarding this field.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**



Punime të pabotuara të vëllimit II, të konferencës
VI ndërkombëtare “Fenomenet ekstreme të natyrës
dhe çështjet e sigurisë”

(~ *Sesioni II* ~)

Policia dhe rëndësia e kurrikulave për menaxhimin e emergjencave civile



■ **Dr. Bilbil MEMAJ**

Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë
bilbil.memaj@asp.gov.al

Abstrakt

Në çdo rast emergjence policia është e para që gjendet në terren dhe për këtë arsye edhe përgjegjësia që ka është jo e vogël. Por edhe rreziku me të cilin mund të përballët, nuk është më i vogël. Nisur nga këto nevoja dhe duke u mbështetur edhe në zhvillimet e viteve të fundit në vendin tonë, jam i mendimit se përdorimi dhe futja e kurrikulave të cilat do të jenë pjesë e programeve të Akademisë së Sigurisë për nivelin menaxherial të oficerëve, është një domosdoshmëri. Tashmë puna për këto kurrikula është në proces, dhe një pjesë e përfundimeve të nxjerra në këtë konferencë, mbështet pikërisht këtë gërshetim njohurish që duhet të kenë institucione, përfshirë këtu edhe Policinë e Shtetit, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të situatave të emergjencave civile. Në këtë punim prezantohet një strukturë konceptore lidhur me këto kurrikula, e cila është duke u plotësuar dita-ditës për finalizimin e kurrikulave për menaxhimin e emergjencave civile dhe rolin e Policisë së Shtetit në to. Kjo punë po vijon nën ndihmesën dhe bashkëpunimin e ndërkombëtarëve dhe stafit të akademisë. Ky material, i bashkëlidhur edhe me përfundimet e tjera të konferencës VI ndërkombëtare të AS-së, do të shpërndahet në institucionet kryesore që kanë të bëjnë me menaxhimin e këtyre emergjencave, duke shpresuar që konkluzionet dhe rekomandimet të ndihmojnë politikatat dhe strategjitë që kanë të bëjnë me to.

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

emergjenca civile, Policia e Shtetit, kurrikula, menaxhim.

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1. Hyrje

Nuk ka aksident, përmytje, tërmet, pandemi, ortek, ngricë, erë të fortë, bllokim rrugësh, zjarr, dëmtim nga breshëri, etj. ku nuk ndihet gjithëpërfshirja e strukturave ligjzbatuese shtetërore, e sidomos e Policisë së Shtetit. Situata të tilla kërkojnë veprime të menjëhershme ndaj kërkohej organizim trajnim dhe gatishmëri e vazhdueshme. Njohja e përgjegjësive që duhet të kenë strukturat shtetërore e civile nga situatat e thjeshta deri tek ato më të komplikuarat të emergjencave civile, është një domosdoshmëri edhe për strukturat e Policisë së Shtetit. Pavarësisht ndihmës që mund të japë Bashkimi Evropian, shtete fqinjë, apo miq të vendit tonë, është një fakt se planëzimin dhe përgjegjësinë për menaxhimin e emergjencave civile e secili shtet e ka më vete. Nëse marrim aspektin praktik, të lidhur me emergjencat civile, trajnimi që ka të bëjë me to mund të shtrihet dhe të prekë disa nivele të shoqërisë e të futet herë-herë edhe në programe mësimore.

Shtete të cilat preken në mënyrë të vazhdueshme nga një natyrë e caktuar katastrofe natyrore, si p.sh. tërmetet në Japoni, trajnojnë çdo grupmoshë që të dijë se si të sillet në një rast emergjence. Fëmijët marrin trajnim qysh herët për këtë gjë. Shembuj të kësaj natyre ka shumë. Ndërkohë, më të trajnuarit natyrisht që janë punonjësit e institucioneve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me emergjencat civile. Policia e Shtetit është një prej këtyre institucioneve. Meqenëse Shqipëria është një vend i cili preket vazhdimisht nga katastrofa të ndryshme natyrore, është një nevojë e rëndësishme, që efektivat e policisë të kenë trajnimin dhe njohuritë e duhura lidhur me menaxhimin e situatave të tilla.

Në çdo rast emergjence policia është e para që gjendet në terren dhe për këtë arsye edhe përgjegjësia që ka është jo e vogël. Por edhe rreziku me të cilin mund të përballet,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

nuk është më i vogël. Nisur nga këto nevoja dhe duke u mbështetur edhe në zhvillimet e viteve të fundit në vendin tonë, jam i mendimit se përdorimi dhe futja e kurrikulave të cilat do të jenë pjesë e programeve të Akademisë së Sigurisë për nivelin menaxherial të oficerëve, është një domosdoshmëri. Tashmë puna për këto kurrikula është në proces, dhe një pjesë e përfundimeve të nxjerra në këtë konferencë, mbështet pikërisht këtë gërshetim njohurish që duhet të kenë institucione, përfshirë këtu edhe Policinë e Shtetit, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të situatave të emergjencave civile. Në vijim do të prezantohet një strukturë konceptore lidhur me këto kurrikula, e cila është duke u plotësuar dita-ditës për finalizimin e kurrikulave për menaxhimin e emergjencave civile dhe rolin e Policisë së Shtetit në to; kjo punë po vijon nën ndihmesën dhe bashkëpunimin e ndërkombëtarëve dhe stafit të akademisë. Ky material, i bashkëlidhur edhe me përfundimet e tjera të konferencës VI ndërkombëtare të AS-së, do të shpërndalet në institucionet kryesore që kanë të bëjnë me menaxhimin e këtyre emergjencave, duke shpresuar që konkluzionet dhe rekomandimet të ndihmojnë politikën dhe strategjitë që kanë të bëjnë me to.

2. Kurrikulat, si nevojë për ndërtimin e koncepteve bazë për policinë, në menaxhimin e emergjencave civile

Sipas vlerësimit të përgjithshëm institucional, tashmë konsiderohet si një qasje “e artë” dizajnimi i trajtimeve, në shumë agjenci bashkë, i zhvillimit strategjik dhe trajnimit menaxhues të personave të cilët do të merren me menaxhimin e situatave të emergjencave civile kombëtare. Në këtë kontekst edhe trajnimi e arsimimi policor duhet ta gjejë veten të përfshirë në zgjerimin e këtyre njohurive menaxheriale për oficerët e policisë. Kurrikulat për menaxhimin e emergjencave dhe mësimet e saj paraqesin konceptet kryesore dhe dimensionet e menaxhimit të emergjencave, të fatkeqësive dhe rreziqeve natyrore apo edhe të atyre të krijuara nga njeriu, që lidhen me punën dhe funksionet e Policisë së Shtetit. Emergjencia dhe fatkeqësi ndodhin në të gjithë botën çdo ditë dhe marrin formë të ndryshme. Shpeshherë ato ndërlikohen duke shkuar edhe përtej vendeve në të cilat ndodhin, madje edhe përtej kombit të tyre.

Trajnimi në këtë drejtim paraqet sfida edhe për vende të zhvilluara. Një ekspert i Universitetit të Oksfordit (*University of Oxford, UK*) dhe një eksperte e Ish-Agjencisë Kombëtare të Përmirësimit të Policimit (*Formerly National Policing Improvement Agency, Bramshill, UK*), në një studim të tyre për trajnimin të vitit 2014 mbi emergjencat civile në Britani, nënvizojnë se ky është i pari studim që bën një përmbledhje historike të trajnimeve në këtë drejtim. Madje, ata shprehen se ka një literaturë të kufizuar edhe për trajnimin në këtë fushë: “Trajnimi për emergjencat civile është një kërkesë ligjore dhe për këtë arsye duhet të organizohet në mënyrë sistematike. Lloje të ndryshme trajnimi përshtaten me fazat e ndryshme të një katastrofe apo incidenti më të madh. Ky është studimi i parë që paraqet zhvillimin historik të trajnimit për emergjencat civile. Ekziston një numër i kufizuar literature bazë për trajnimin mbi emergjencat civile”¹.

Duke pasur parasysh misionin e përgjithshëm të *mbrojtjes civile*, – i cili ka të bëjë me krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të mbrojtur popullsinë dhe burimet e saj

¹ John P. Wilson, Sarah Gosiewska, “Multi-agency gold incident command training for civil emergencies”, *Disaster Prevention and Management*, Vol. 23 No. 5, (2014): 632-648.
<https://doi.org/10.1108/DPM-11-2013-0212>

jetësore, zvogëlimin e rrezikut në rast fatkeqësie dhe emergjence, zhvillimin e një mekanizmi të fortë gatishmërie dhe përgjigjeje, shpëtimin dhe lehtësimin falë një sistemi me shumë nivele dhe të integruar, – trajnimi paraqet konceptin e menaxhimit të krizave, dhe shtrun për diskutim disa aspekte të kësaj teme, veçanërisht për oficerë të nivelit të mesëm e të atij strategjik, duke ofruar një kuptim më të gjerë të këtij sistemi të qeverisjes, në shumë nivele.

Zgjerimi i nivelit të dijes dhe kuptimi i nivelit të qeverisjes në raste emergjencash është jetik për efektivitetin e policisë. Po i referohem një tjetër shembulli nga Britania, një studimi i cili ka të bëjë me një rast shumë specifik emergjence civile. Ndër emergjencat civile, përfshihen edhe ato nukleare. Nuk ka pasur asnjë emergjencë nukleare në Mbretërinë e Bashkuar (MB), e cila të prekë në mënyrë masive shoqërinë. Por, meqenëse MB është një vend nuklear, ajo ka pasur incidente të ndryshme, që lidhen me sektorin ushtarak: transport armësh nukleare, anije, nëndetëse etj². Megjithatë, policia britanike ka trajnime dhe procedura të përcaktuara qartë në lidhje me rastet kur mund të ndodhë një emergjencë civile nukleare. I tillë është studimi që përmend. Ai sqaron përgjegjësitë e policisë në rast të një emergjence bërthamore dhe diskuton mbi përgatitjen dhe planifikimin e nevojshëm me operatorët e organizatave të tjera të cilat do të përfshiheshin gjithashtu në raste aksidentesh. Studimi diskuton pika të veçanta si: strehimin dhe evakuimin, çështjen e tabletave të jodatit të kaliumit, mbrojtjen e oficerëve të policisë, përfshirjen e policisë në qendrat mbështetëse të operacioneve, edukimin publik dhe diskutimin e mëtejshëm mbi integrimin dhe zhvillimin e organizimit të procedurave të emergjencës³.

Po e përmend këtë rast, jo sepse neve si vend na nevojitet që ta trajnojmë policinë shqiptare lidhur me emergjencat civile nukleare, por sepse na duhet që të krijojmë procedura e trajnime lidhur me nevojat që kemi, lidhur me natyrën e emergjencave civile të cilat mund të prekin vendin tonë. Për këtë arsye kanë rëndësi kurrikulat e përmendura; nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse dhe një përmirësim i rolit menaxherial të policisë. Por ç'ndodh nëse ky rol nuk është i koordinuar dhe nuk ka një plan të mirëfilltë emergjence?

Në vitin 2005 në veriperëndim të Anglisë, në qytetin Carlisle, për shkak të reshjeve të jashtëzakonshme ndodhi një përmytje e madhe. Situata u bë edhe më e keqe për shkak të daljes së lumit lokal nga shtrati. Përmytjen zyrtar qendrore të policisë, ato të shërbimit zjarrfikës dhe qendra që priste të personat e evakuuar. Me përmytjen e zyrave të policisë, e cila kishte rolin e komandës strategjike, ra edhe shërbimi IT i cili siguronte mbështetje me informacion, si harta në kohë reale, lëvizje, pamje, ndërlidhje etj. U dëmtua edhe rrjeti elektrik dhe telefonja celulare nuk funksiononte. U kërkua aktivizimi i *Planit të emergjencave (Cumbria General Emergency Plan)* i cili nuk ekzistonte dhe situata u bë më e rëndë. Komanda strategjike dhe ajo taktike u detyruan të vendoseshin në pozicione të reja rreth 30 km larg njëra-tjetrës⁴.

Situata të cilën solla si shembull goditi një vend që ka procedura e trajnim edhe për emergjencat nukleare dhe e kapi të papërgatitur. Mund të merret lehtësisht me mend se sa është fuqia jonë kombëtare për reagimin ndaj situatave të tilla. Për këtë arsye

² Peter Burt, *Playing with Fire: Nuclear Weapons Accidents and Incidents in the United Kingdom* (UK: Nuclear Information Service, 2017).

³ Smith, F. H., *Police procedures in civil nuclear emergencies* (United Kingdom: IBC Technical Services Ltd., 1989).

⁴ Ian Sommerville, Tim Storer, Russell Lock, "Responsibility modelling for civil emergency planning", *Risk Manag* 11, (2009): 179–207.

<https://doi.org/10.1057/rm.2009.11>

nevojitet që të përlogarisim në detajet më të imta mënyrën e reagimit dhe të planëzojmë një ndërveprim institucional shumë efektiv.

Për kurrikulat që po diskutojmë, është me rëndësi njohja me kuadrin ligjor të menaxhimit të emergjencave në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, me zbatimet më të fundit ligjore dhe kuptimi i rolit dhe funksioneve të aktorëve të ndryshëm të përfshirë. Për më tepër, roli i integritetit dhe bashkëpunimit do të trajtohet duke kuptuar funksionet e ndryshme të enteve dhe procedurat që lidhen me të. Për sa i përket aspekteve praktike, mësimet do të paraqesin një përmbledhje të tipologjisë kryesore emergjencë-fatkeqësi duke theksuar të dhëna dhe statistika, ndikimin në territoret shqiptare, shënimin në hartë të zonave të ndryshme me rrezikshmëri dhe si të parashikohet ndikimi fizik dhe shoqëror i këtyre ngjarjeve.

Aspektet e gatishmërisë dhe përgjigjes do të trajtohen me vëmendje aktive e të veçantë duke integruar PSO-të ekzistuese, por gjithashtu duke zgjeruar aftësitë se si të përgatiten planet e menaxhimit të emergjencave dhe si të jemi më të gatshëm në rast përgjigjeje. Për më tepër, komunikimi luan një rol të madh pasi përmes tij, do të integrohen aspektet praktike të mësipërme për të përforcuar njohuritë e pjesëmarrësve mbi komunikimin strategjik dhe mënyrën e të kuptuarit të sjelljeve njerëzore gjatë emergjencave dhe krizave.

Duke marrë parasysh nivelin menaxherial/strategjik të pjesëmarrësve, në segmente të veçanta mësimore do të trajtohet të menduarit strategjik dhe faktet që dëmtojnë procesin e marrjes së suksesshme të vendimeve. Duke qenë se skenari global është duke u zgjeruar, ekziston nevoja për individë shumë të aftë, gjithashtu ekziston nevoja për udhëheqës të rinj që kuptojnë strategjikisht se si të trajtojnë emergjencat dhe fatkeqësitë brenda territorit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përballja me raste emergjencash civile ka ngjashmëri botërore. Në rastin e pandemisë së koronavirusit, disa ndikime që janë të prekshme për efektivat e policisë si në vendin tonë si jashtë tij, mund të ishin këto: “Emergjencat civile dhe katastrofat e lidhura me shëndetin publik ndikojnë negativisht në marrëdhëniet polici-komunitet; duke qenë se janë të parët që përgjigjen, oficerët janë të rrezikuar nga stresi akut dhe lipset mbështetje sociale për ta; planifikimi i pamjaftueshëm para katastrofës vë në rrezik funksionimin dhe reagimin e komisariateve të policisë; janë të nevojshme ndërtimet e mjedisve bashkëpunuese për reagimin efektive ndërmjet agjencive”⁵.

3. Metodologjia e trajnimit për emergjencat civile dhe detyrat e policisë

Metodologjia e zbatuar në kurrikulat e synuara, karakterizohet nga një kombinim i teorisë dhe praktikës që angazhon pjesëmarrësit për të ndërvepruar me personin që zhvillon trajnimin dhe me pjesëmarrësit e tjerë. Pas një sërë prezantimesh dhe mësimesh, pjesëmarrësit do të kuptojnë me sukses çështjen shumëplanëshe dhe me shumë nivele të menaxhimit të emergjencave. Zhvillimi i aftësive praktike për të kryer detyrat e policisë do të inkurajohet përmes ushtrimeve praktike me skenarë e situata nga jeta reale, në mënyrë që pjesëmarrësit të formojnë aftësitë e tyre dhe të përgatiten për punën në

⁵ Julian Laufs, Zoha Waseem, “Policing in pandemics: A systematic review and best practices for police response to COVID-19”, *International Journal of Disaster Risk Reduction* (Volume 51, 2020).
<https://doi.org/10.1016/j.ijdrr.2020.101812>.

teren. Secili trajnues dhe secili folës mund të shërbejë si lektor për një ose më shumë nëntema. Gjatë trajnimit, do të merret parasysh gjithashtu diskutimi i drejtuar, diskutimi mes pjesëmarrësve dhe diskutimi pas aktivitetit. Gjatë trajnimit, do të merret parasysh gjithashtu diskutimi i drejtuar, diskutimi mes pjesëmarrësve dhe fokus grupi për të nxitur aftësitë e buta të së menduarit dhe ato strategjike.

3.1 Metodatat e zhvillimit të mësimit dhe shtrirja kohore

Seanca e trajnimit është strukturuar me mësim ndëreveprues ballë për ballë/në klasë (mësimi do të zhvillohet në internet në rast të forcave madhore). Seanca e trajnimit bazohet në 31 orë mësimore të planifikuara në katër ditë (ose më shumë nëse është e nevojshme). Orët e mësimdhënies do të zhvillohen ballë për ballë nga lektori dhe do të përfshijnë ushtrime praktike të bazuara në skenarë. Mësimet do të zhvillohen në gjuhën shqipe dhe pak segmente do të zhvillohen edhe në gjuhën angleze. Ato do të prezantohen nga oficerë/trajnues të policisë me profesorë të ftuar/ndërrhyrje të folësve nga institucione të tjera për të nxitur një mjedis bashkëpunimi dhe mësimi në shumë nivele. Për më tepër, në leksione do të jenë të pranishëm folës të ftuar nga ente të huaja, në mënyrë që të kuptohen modelet dhe qasjet e huaja dhe që të merret diçka nga përvoja e tyre.

3.2 Vlerësimi i të nxënësve

Do të bëhet një provim përfundimtar. Detyra përfundimtare do të kryhet në përputhje me metodologjinë e përgjithshme të akademisë dhe afateve të rregullta. Në dhënien e notave përfundimtare të semestrit, lektorët mund të marrin parasysh pjesëmarrjen në klasë, përveç detyrave kryesore me shkrim. Duke pasur parasysh faktin që pjesëmarrësit e pranishëm janë të rritur, pjesëmarrja aktive në seancat mësimore sjell përfitime arsimore për të gjithë. Së pari, pjesëmarrja aktive përmirëson aftësinë për të formuluar mendimet në mënyrë të mençur dhe nën presion, që është një lloj ndjenje “normale” gjatë menaxhimit të emergjencave. Së dyti, kontribuon në forcimin e bashkëpunimit duke marrë parasysh përvojën dhe kontributin e secilit pjesëmarrës.

3.3 Rezultatet synuara të së nxënësve

Në fund të trajnimit, synohet që pjesëmarrësit të jenë në gjendje:

- të kuptojnë çështjet e menaxhimit të emergjencave në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe rolin e bashkëpunimit midis palëve të ndryshme të interesuara;
- të parashikojnë nevojat dhe zbatime të së ardhmes dhe të ndërmarrin veprime paraprake;
- duke qenë profesionistë të rangut të lartë, do të jenë të aftë për të hartuar, menaxhuar dhe monitoruar pozicione dhe veprime brenda programeve, të promovuar nga organizata kombëtare, rajonale, ndërkombëtare ose joqeveritare, me qëllim mbrojtjen e dyfishtë të të drejtave të njeriut dhe parandalimin, zbutjen ose zgjidhjen e emergjencave;
- të komunikojnë në mënyrë efektive përmes mjeteve të komunikimit strategjik;
- të zbutin ndikimin e paragjykimeve në procesin e të menduarit strategjik dhe zhvillojnë aftësitë e vendimmarrjes duke punuar nën presion.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

4. Policia dhe menaxhimi i emergjencave civile, si qasje e domosdoshme ndaj sigurisë publike

Nuk është risi që puna e policisë të orientohet drejt atyre kërcënimeve kryesore që cenojnë sigurinë publike. Meqenëse siguria njerëzore vihet në rrezik të lartë gjatë emergjencave civile, Policia e Shtetit, si një prej institucioneve që përfshihet në këto situata duhet të rrisë cilësinë dhe sasinë e arsimimit e të trajnimeve, lidhur me menaxhimin e emergjencave civile, për oficerët e policisë. Do të doja të sillja një tjetër shembull nga kolegët tanë ndërkombëtarë, për të treguar se si zhvillohet raporti ndërmjet arsimimit e trajnimit dhe menaxhimit të emergjencave të ndryshme me të cilat merret policia.

Sipas një studimi norvegjez, drejtuesit kanë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e emergjencave, pasi përgjegjësia e tyre është që të drejtojnë dhe të koordinojnë reagimin. Studimi në fjalë, shqyrtonte se si oficerët e policisë me përgjegjësi drejtuese mësojnë kryerjen e detyrës së reagimit emergjent dhe se si menaxhojnë emergjencat. Të dhënat u mbledhën përmes vëzhgimit të pjesëmarrësve në shërbimin policor para sulmeve terroriste në Kompleksin Qeveritar dhe në kampin rinor të Partisë së Laburiste në ishullin Itëja në Norvegji, më 22 korrik 2011, duke pasur kështu së pari mundësinë e marrjes së një përvoje të drejtpërdrejtë nga oficerët e policisë dhe aktivitetet e punës e të së mësuarit. Dhe pastaj, u analizua se sa të përshtatshme dhe të mjaftueshme janë këto aktivitete për përgatitjen e personelit për të menaxhuar një emergjencë të madhe. Reagimi dhe menaxhimi i situatës së sulmeve terroriste ishte, në tërësi, jo edhe aq i mirë sa duhej të ishte: kryesisht për shkak të ushtrimit jo të përshtatshëm të drejtimit nga ana e policisë. Nga pikëpamja e të mësuarit, këto dobësi nuk duhet të ngjallin habi. Studimi tregonte se aktivitetet mësimore në shërbimin policor drejtoheshin kryesisht drejt punës së përditshme policore dhe emergjencave normale dhe nuk përgatisnin mjaftueshëm oficerë apo drejtues policie për të menaxhuar kriza të reja, ashtu siç ishin sulmet terroriste më 22 korrik⁶.

Nëse shohim situatën më të fundit të një emergjence civile në Shqipëri, atë të COVID-19, vëmë re se pas institucionit të Shëndetësisë, Policia e Shtetit ka pasur efektivat me numrin më të lartë të prekjës e të fatalitetit. Kjo duhet të na bëjë që të reflektojmë për dy gjëra: e para, policia është gjithmonë në linjën fillestare të reagimit në emergjencë civile; e dyta, policia ka nevojë që të trajnohet e arsimohet pikërisht për ato emergjencë me të cilat duhet të përballet, – dhe Shqipëria, sipas raporteve të UNDP-së⁷ e të tjera, është një vend që preket në mënyrë të konsiderueshme nga katastrofat natyrore. Për këto dhe të tjera arsye, zhvillimi i kurrikulave që lidhen me menaxhimin e emergjencave civile dhe detyrat e misionin e policisë në to, nevojitet që të zgjerohet e përmirësohet. Një qasje e re ndaj koncepteve të sigurisë e plotëson vizionin e Policisë së Shtetit dhe fuqizon cilësinë e arsimimit e të trajnimit që ofron Akademia e Sigurisë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁶ Morten Sommer, Ove Njå, Kjetil Lussand, "Police officers' learning in relation to emergency management: A case study", *International Journal of Disaster Risk Reduction* (Volume 21, 2017): 70-84.
<https://doi.org/10.1016/j.ijdr.2016.11.003>.

⁷ Geraldine Becchi, Vanda Dias Dos Santos, Hachim Badji, *Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report For Albania* (United Nations Development Programme, 2011).

Bibliografi

1. Wilson, John P., dhe Sarah Gosiewska. "Multi-agency gold incident command training for civil emergencies". *Disaster Prevention and Management*, Vol. 23 No. 5, (2014): 632-648. <https://doi.org/10.1108/DPM-11-2013-0212>
2. Burt, Peter. *Playing with Fire: Nuclear Weapons Accidents and Incidents in the United Kingdom*. UK: Nuclear Information Service, 2017.
3. Smith, F. H. *Police procedures in civil nuclear emergencies*. United Kingdom: IBC Technical Services Ltd., 1989.
4. Sommerville, Ian, Tim Storer dhe Russell Lock. "Responsibility modelling for civil emergency planning". *Risk Manag* 11, (2009): 179–207. <https://doi.org/10.1057/rm.2009.11>
5. Laufs, Julian, Zoha Waseem. "Policing in pandemics: A systematic review and best practices for police response to COVID-19". *International Journal of Disaster Risk Reduction* (Volume 51, 2020). <https://doi.org/10.1016/j.ijdr.2020.101812>.
6. Sommer, Morten, Ove Njå dhe Kjetil Lussand. "Police officers' learning in relation to emergency management: A case study". *International Journal of Disaster Risk Reduction* (Volume 21, 2017): 70-84. <https://doi.org/10.1016/j.ijdr.2016.11.003>.
7. Becchi, Geraldine, Vanda Dias Dos Santos dhe Hachim Badji. *Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report For Albania*. United Nations Development Programme, 2011.

Parandalimi dhe menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri, si qasje ndaj sigurisë kombëtare



■ **Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN**
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit,
Akademia e Sigurisë
qetsor.orhan@asp.gov.al



■ **MSc. Qetësor GURRA**
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit,
Akademia e Sigurisë
qetësor.gurra@asp.gov.al

Abstrakt

Shqipëria është një nga vendet që ka vuajtur vazhdimisht pasoja të rënda të cilat vijnë si pasojë e fatkeqësive të ndryshme natyrore. Këto pasoja janë kryesisht të karakterit ekonomik, por jo vetëm të tij. Ka një humbje të konsiderueshme vjetore që vjen nga këto fatkeqësi dhe përlogaritja e kësaj humbje, që luhet nga 2 në 2.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), është vërtet një shifër shqetësuese. Degradimi i mjedisit, vakuumet ligjore, urbanizimi shpërthyes, moskontrollimi i lëvizjes apo investimeve njerëzore etj., e kanë ekspozuar vendin tonë ndaj një sërë rreziqesh që deri dje ishin të vegjël apo të një shkalle që nuk krahasohet me shkallën e rreziqeve të sotme. Këto rreziqe që kanë për bazë katastrofat natyrore fuqizohen edhe më shumë nga faktorë të ndryshëm njerëzorë. Shqipëria ka tentuar në dekadat e fundit që të përmirësojë qasjen ndaj zgjidhjes dhe vlerësimit të kësaj problematike. Në ndihmë të zgjidhjes së kësaj problematike, Shqipëria është përpjekur që të ndërtojë një kuadër ligjor sa më të mirë dhe të ketë një qasje e cila të nënvizojë rëndësinë e menaxhimit të emergjencave civile, si të një rëndësie të veçantë. Orientimi ka qenë i dyfishtë: orientim drejt përbaljes së fatkeqësive natyrore sipas kuadrit ligjor Perëndimor dhe përpjekje për përmirësimin apo ngritjen e infrastrukturave institucionale që merren më këtë natyrë kërcënimi. Përmirësimi i kuadrit ligjor e tregon më së miri këtë gjë, dhe shtimi i rëndësisë së një mendësie institucionale, që e shikon trajtimin e emergjencave civile dhe mbrojtjen civile, si kontribuuese për reduktimin e nivelit të cenimit nga këto rreziqe, rrit mundësinë e reduktimit të dëmeve në tërësi. Por, duhet nxjerrë në pah fakti se, në Shqipëri, vënja në praktikë e mendësisë planëzuese e strategjike, që ka lidhje me emergjencat civile, vuan, për shkak të një sërë faktorësh. Kjo gjë duhet analizuar në mënyrë të gjerë dhe të detajuar. Njërin prej aspekteve më kryesore, i cili ka lidhje me faktorët që e vështirësojnë zbatimin e strategjive të menaxhimit të emergjencave natyrore, e trajton edhe ky shkrim. Ky aspekt është ai që i lidh emergjencat natyrore me sigurinë kombëtare. Në këtë aspekt, trajtimi i fatkeqësive natyrore si një kërcënim i shkallës më të lartë, dhe analizimi i tyre nën këtë prizëm, do të sillte trajtim më të fuqishëm të këtij kërcënimi.

Fjalëkyçe:

siguri kombëtare, emergjenca civile, rreziqe dhe kërcënime, strategji e sigurisë kombëtare, kuadri ligjor.

1. Hyrje

Nga eksperiencia e regjistruar historike, Shqipëria është një prej vendeve që ka një nivel të lartë të mundësisë së prekjës prej fatkeqësive natyrore. Në mesjetë “Përpos luftërave, dukuri të tjera të zakonshme për kohën, si zia e bukës, epidemitë dhe fatkeqësitë natyrore, ndikonin në uljen e numrit të banorëve të qyteteve. Epidemitë, si ajo e murtajes, bënëin kërدينë posaçërisht në qytete..”¹. Dhe këto ndikime vijuan deri ditët e sotme, ku natyrisht epidemitë u kufizuan, por katastrofat natyrore vazhduan të jenë kërcënim.

Janë të shumtë faktorët se përse sot kërcënimet nga fatkeqësitë natyrore vijnë të jenë aktive, por mjafton të përmendim se pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare, që përbën rreth tre të katërtat e popullsisë së përgjithshme, është e vendosur në zona gjeografike të cilat kanë shkallë të lartë rrezikshmërie apo mundësi cenimi nga fenomenet ekstreme të natyrës. Kjo gjë, lidhet me gjeografinë e gërshetuar të terrenit shqiptar: malësore dhe fushore e bregdetare, si dhe me kapacitetet dhe metodologjinë e përdorur për përballjen me katastrofat natyrore. Edhe orientimi e ndërgjegjësimi i vendosjes popullore në territor, në raport me kërcënimet që vijnë nga katastrofat natyrore, përbën një çështje sigurie e metodologjie.

Natyra e fatkeqësive natyrore ndaj të cilave ekspozohet Shqipëria është e larmishme; dhe kjo nuk na favorizon në trajtimin e tyre. Natyra e rreziqeve të katastrofave natyrore, siç e përmendëm, është e gjerë. Në mënyrë të përmbledhur mund të përmendim elementët përbërës të saj. Rreziqet kryesore me të cilat përballlet Shqipëria janë: tërmetet,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

¹ Skënder Anamali et al., (2002), *Historia e popullit shqiptar, Volumi 1*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH & Botimet Toena, f. 261.

zjarret, përmbytjet, thatësira, reshjet shumë të dendura të borës, epidemitë, erozioni, ndotjet gjera të mjedisit (efektet e reagimeve natyrore) etj.

Kjo natyrë e shumëllojshme rreziku, e shton mundësinë e prekjes dhe e vështirëson strategjinë e trajtimit të tij. Faktori njerëzor, kultura, trashëgimia, natyra e institucioneve, tradita shtetërore në këtë drejtim etj., janë vetëm disa prej faktorëve të tjerë që e mbështesin përkeqësimin e situatës dhe shtimin e peshës së rrezikut që vjen prej fatkeqësive natyrore. Trajtimi i katastrofave natyrore dhe i rreziqeve që vijnë prej fatkeqësive natyrore, është i pasqyruar edhe në dokumentet strategjike shtetërore. Dokumenti më i rëndësishëm strategjik i Republikës së Shqipërisë, “Strategjia e sigurisë kombëtare” (2014)², e trajton me seriozitet këtë natyrë kërcënimi. Duke parë këtë rëndësi të madhe, duhet që edhe menaxhimi emergjencave kombëtare që burojnë nga këto kërcënime të jetë i një rëndësie të veçantë. Një vlerë të shtuar marrin masat parandaluese për shmangien e dëmeve që vijnë nga faktorët natyrorë, dhe ato njerëzorë, të cilët i shtojnë efektet e të parëve në raste fatkeqësive natyrore. Këto masa, kur trajtohet faktori njerëzor, duhet të jenë të së njëjtit nivel rëndësie, si në rastet kur menaxhohen katastrofat.

2. Profili i rreziqeve natyrore në Shqipëri

Në një mënyrë të qartë e të përmbledhur për natyrën e kërcënimeve natyrore në Shqipëri, flet raporti i UNDP-së (*United Nations Development Programme*), i cili vlerëson rreziqet e kësaj kategorie. Sipas këtij raporti që vlerëson kapacitetet dhe rreziqet nga katastrofat natyrore në Shqipëri, natyra e këtyre rreziqeve është si në vijim. Profili i rrezikut natyror në Shqipëri:

- rreziku sizmik,
- rreziku nga përmbytjet,
- rreziku nga rrëshqitja e dherave,
- rreziqet nga shpërthimet e digave,
- rreziku nga reshjet e borës,
- rreziku epidemik,
- rreziku nga përhapja e zjarreve në pyje,
- rreziku teknologjik³.

Shqipëria është prekur vazhdimisht nga një shkallë e konsiderueshme, - e madje mund të thuhet edhe e lartë, - e goditjes nga tërmetet. Kërcënimi sizmik nuk është i vetmi. Një tjetër rrezik i konsiderueshëm vjen nga rrëshqitjet e dherave dhe nga përmbytjet. Dëmi ekonomik nga këto të fundit është i ndjeshëm dhe i shumanshëm. Hektarë të tërë dëmtohen nga ujërat e lumenjve të cilët bëhen të pakontrollueshëm nga reshjet. Por, faktori përkeqësues, dekadat e fundit, është ai njerëzor. Menaxhimi i këtyre përmbytjeve do të bëhej shumë herë më i lehtë nëse do të kishim zbatuar një sërë masash parandaluese.

Shqipëria është një vend i prirë për katastrofa dhe i ekspozohet herë pas here

² Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2014), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, viti 2014, nr 137, Ligj nr. 103/2014, “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”. Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare.

³ Geraldine Becchi, Vanda Dias Dos Santos, Hachim Badji (2011), *Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report For Albania*, United Nations Development Programme, f. 2.

rreziqeve që mund të ndahen sipas origjinës në dy kategori:

a) me origjinë natyrore: gjeologjike (tërmete, rënie shkëmbinjsh dhe rrëshqitje dheu); hidrometeorologjike (përmytje dhe shira të rrëmbyeshëm, thatësira, stuhi dëbore, reshje të mëdha dëbore dhe stuhi ere); biofizike (zjarre në pyje dhe epidemi); dhe ortekë⁴;

b) me origjinë njerëzore: shpërthimet e digave, përmytjet dhe rreziqet teknologjike⁵.

3. Qasja ndaj fenomenit përmes faktorit njerëzor

Ajo që vlen të theksohet është se faktori njerëzor hyn te ata faktorë të cilët mund të shmangen, përmirësohen e frenohen, kur ndikojnë në përkeqësime të situatave të ndryshme. Komuniteti në zona të ndryshme të Shqipërisë ka ndikuar në shtimin e përmasave të katastrofave natyrore, përmes ndikimit të tij te natyra etj. Emigrimi masiv i brendshëm e i jashtëm ka ushtruar presion në zona të ndryshme shqiptare ose ka krijuar vakuume në të tjera. Zbrazja e zonave rurale dhe mbipopullimi i disa qyteteve, apo urbanizimi i skajshëm e i pakontrolluar i zmadhon përmasat katastrofave.

Ultësira Perëndimore, strehon pjesën më të madhe të popullsisë. Kjo mund të vihet re sipas të dhënave të INSTAT të cilat pasqyrojnë qartë edhe qarqet me popullsinë më të madhe. Kjo dyndje drejt qendrave urbane ka ardhur për shumë faktorë socialë, por ka prodhuar edhe rritjen e ndikimit të faktorit njerëzor që lidhet me fatkeqësitë natyrore. Mund të merret urbanizimi i Durrësit si shembull. Popullsia që migroi së brendshmi në Shqipëri e që u vendos në Durrës, u ekspozua ndaj rrezikut sizmik; por, nga ana tjetër edhe cilësia e ndërtimeve të tyre, dendësia e lartë e popullsisë, terrenet e pasigurta për ndërtim etj., kontribuoi te shtimi i valencës së dëmeve nga katastrofa të mundshme natyrore.

Qarku/Prefectures	2016	2020
	Gjithsej/Total	Gjithsej/Total
Berat	135,441	122,003
Dibër	129,056	115,857
Durrës	280,205	290,697
Elbasan	287,606	270,074
Fier	305,108	289,889
Gjirokastrë	68,020	59,381
Korçë	217,422	204,831
Kukës	81,294	75,428
Lezhë	130,258	122,700
Shkodër	210,168	200,007
Tiranë	842,981	906,166
Vlorë	188,033	188,922
Gjithsej/Total	2,875,592	2,845,955

Fig 1. Popullsia shqiptare e 4-5 viteve të fundit sipas qarqeve, (viti 2016 dhe viti 2020)⁶

⁴ Po aty, f. 5.

⁵ Po aty, f. 6.

Nëse do t'i referoheshim studimit të cituar më sipër të UNDP-së, për Shqipërinë dhe rrezikun nga katastrofat natyrore (*Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report For Albania*) do të vinim re se ai vë në dukje se rritja e investimeve private në toka marginale, përfshirë këtu edhe tokat në rrjedhat e poshtme pranë digave, shndërrohet në subjekt rreziku relativisht më të larta humbjeje⁷. Diskutimi i digave është një tjetër element që i kryqëzuar me faktorin njerëzor shton kërcënimin në raste katastrofash natyrore. Shqipëria, jo vetëm që ka një numër të madh digash, por është e përballur edhe me rrezikun e mirëmbajtjes së tyre, krahas rrezikut që këto diga mund të goditen nga tërmete, rreziqe teknologjike, njerëzore etj.

“Shqipëria ka mbi 300 diga të larta të regjistruara në regjistrin botëror të digave të larta. Jemi vendi i parë në botë për numrin e digave të larta për banor. Një rekord botëror është edhe diga e Bovillës, e cila është ende diga më e lartë në botë me gjeomembranë. Për shkak të qasjes së ekonomisë së centralizuar, rezervuarët shqiptarë shërbejnë kryesisht për prodhim energjie dhe për ujitje. Për qëllimet e bujqësisë, gjatë periudhës së komunizmit u ndërtuan mbi 630 rezervuarë, me një kapacitet prej 5.6 miliardë metra kub ujë. Duke përjashtuar digat mbi lumin Mat, të gjitha të tjerat në Shqipëri janë diga me materiale vendi (dhé, gurë, argjilë). Këto diga janë shumë të qëndrueshme dhe më ekonomike në ndërtim. Sidoqoftë, digat kërkojnë inspektime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme”⁸.

Shqipëria renditet ndër vendet e para në botë për numër të digave të mëdha për 1000 km² si dhe për numër të digave të mëdha për 1 milion banorë, të ndara në dy grupe, diga të cilat përdoren për prodhim hidroenergjie dhe ato për bujqësi. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka në dhe varësinë e saj Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM). Në një takim të bërë së fundi, ministrja Balluku theksoi se fokusi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë do të ishte tek ky komitet duke e ngritur atë në nivelin më të lartë profesional. Detyrat parësore që dalin përpara KKDM-së janë që nga skanimit i situatës së digave, i cili është një proces shumë i rëndësishëm që duhet ndjekur, e deri tek zhvillimi i të gjithë dokumentacioneve që duhet të ketë dosja e çdo dige.

“Në Republikën e Shqipërisë kemi diga të volumeve shumë të mëdha, siç janë digat e kaskadës së Drinit, apo kemi diga, të cilat ndodhen me shumicë në zona të banuara, siç është qyteti i Tiranës, i cili është një nga qytetet me numrin më të madh të digave, mbi 40 diga. Siguria e digave për ne është prioritet dhe misioni i komitetit tuaj është që kjo siguri të garantohet në çdo hap të administratës”, - nënvizoi ministrja Balluku⁹.

Kryetari i KKDM-së, në një pasqyrim të situatës së digave në Shqipëri, ndër të tjera do të theksonte se: “Në vendin tonë janë 650 diga në total, nga të cilat 362 janë diga të mëdha me lartësi mbi 15 metra. Diga e parë është ndërtuar në Shqipëri në vitin 1957. Sot jemi në këtë situatë: kemi shumë pak diga të reja, 5 apo 6 të tilla dhe shumica e

⁶ Instituti i Statistikave, *Treguesit Demografikë dhe Socialë*, “Popullsia sipas qarqeve”, (Tiranë: INSTAT, 2021).

Burimi elektronik:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>

⁷ Geraldine Becchi, *Disaster Risk Reduction Capacity*, f. 6.

⁸ Erjon Kalaja, *Tërmetet duhet të na bëjnë të shikojmë menjëherë sigurinë e digave*, (Tiranë: Exit.al, 26.9.2019).

Burimi elektronik:

<https://exit.al/termetet-duhet-te-na-bejne-te-shikojme-menjehere-sigurine-e-digave/>

⁹ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e RSH, *Prezantohet Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Këshilli Teknik*, (Tiranë: 22.9.2020).

Burimi elektronik:

<https://www.infrastruktura.gov.al/prezantohet-komiteti-kombetar-i-digave-te-medha-dhe-keshilli-teknik>

digave janë mbi 30-40-vjeçare, të cilat kërkojnë patjetër mirëmbajtje, monitorim dhe një shfrytëzim me kujdes”¹⁰.

E sollëm këtë informacion për ta parë nën këndvështrimin e kryqëzimit të rrezikut nga tërmetet, rrezikut nga amortizimi i digave dhe rrezikut nga faktori njerëzor. Rreziku nga tërmeti është një kërcënim natyror i pashmangshëm. Vendi ynë ndodhet në një zonë gjeografike të kërcënuar nga tërmetet. Në rast tërmetesh, digat rrezikojnë të kenë dëmtime. Këto dëmtime mund të jenë më të rënda për shkak të amortizimit të digave. Të dy këto rreziqe, janë ekzistues. Vetëm faktori njerëzor mund të korrigjojë rrezikun a amortizimit, pasi rreziku sizmik nuk shmanget dot. Faktori njerëzor mund të ndahet në dy nënkategorit:

a) faktori njerëzor *institucional* që orienton politikat dhe masat e parandalimit dhe shmangies së emergjencave, dhe,

b) faktori *shoqëror*.

Ky i fundit, faktori njerëzor shoqëror, mund të përkeqësojë situatën përmes veprimeve që ndërmer, si p.sh.: ndërtime në zona të rrezikuara, ndërhyrje në infrastrukturën e digave, ndërtime të pasigurta, shpyllëzime në breza mbrojtës, shfrytëzimi pa kriter i tokave pranë digave për qëllime përfitimi etj.

3.1 Faktori njerëzor shoqëror dhe ndikimi te rreziqet nga katastrofat natyrore

Efekti i fatkeqësive natyrore në Shqipëri amplifikohet, ose zgjerohet në maksimum, edhe nga faktori njerëzor. Kjo gjë tashmë është vënë re dhe pranohet në një mënyrë a në një tjetër. E përmendin shumë dokumente strategjike e vlerësuese të situatës së emergjencave civile, qofshin analiza të huaja, qofshin shqiptare. Ndër shtysat kryesore njerëzore, të cilat tregojnë ndikimin e faktorit njerëzor në shtimin e rrezikshmërisë nga katastrofat natyrore, mund të përmenden këto:

- shkalla relativisht e lartë e varfërisë,
- mungesa e mirëmbajtjes së infrastrukturës,
- ndërtimet e pasigurta,
- praktikat e shfrytëzimit të tokës,
- urbanizimi i shpejtë,
- shfrytëzimi i keq i burimeve natyrore (kullotave, pyjeve, shtretërve të lumenjve, etj.),
- gjatë kalimit nga një ekonomi e kontrolluar nga shteti në një ekonomi të tregut të lirë.

- mungesa e burimeve materiale dhe niveli i ulët i koordinimit midis agjencive që kanë përgjegjësi ligjore në emergjencat civile,

- ndërsa sistemit të edukimit dhe informimit i mungon përfshirja e nevojshme dhe ndikimi në institucionet shtetërore dhe në popullsinë shqiptare në tërësi¹¹.

Duke mbetur vetën te këta elementë njerëzorë që zgjerojnë shkallën e dëmtimit në katastrofa të mundshme natyrore, mund të themi se ata mbartin një problematikë të fjetur dhe një aktive. Problematika e fjetur është ajo problematikë e cila mund të vihet re vetëm në rastet e goditjes nga katastrofat natyrore. Urbanizimi i shpejtë e pa kriterë,

¹⁰ Ibid.

¹¹ Foto Duro, “Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri”, në: Konferenca kombëtare, Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri (Tiranë: IDM, 2015) 2.

Burimi elektronik:

<https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>

është vetëm një prej këtyre shembujve. Cilësia e ndërtimeve të ndërtuara në zona të rrezikshme ose jo të tilla, është shqetësuese. Tërmeti i vitit 2019 e shfaqti më së miri këtë kërcënim. Cilësia e ndërtimeve ka qenë shqetësuese në dekadat e fundit dhe u bë e prekshme vetëm në çastin e rënies së tërmetit. Në këtë kontekst, merr formë edhe ai kërcënim apo problematikë që e quajmë “të fjetur”.

3.2 Faktori njerëzor institucional dhe ndikimi te rreziqet nga katastrofat natyrore

Më shumë se dhjetë vite më parë se të ndodhte ky tërmet, në një intervistë drejtori i Institutit të Gjeoshkencave, prof. dr. Ismail Hoxha,

“Rreziku sizmik për qytetin e Tiranës është përcaktuar në studimin “Mikrozonimi sizmik i qytetit të Tiranës, në shkallë 1:10000”, kryer në vitin 1988 nga Instituti Sizmologjik. A është më i vlefshëm ai... në këtë xhungël ndërtimesh [pyetje]? - Aspektet sizmologjike të mikrozonimit sizmik të qytetit të Tiranës janë të vlefshme për sa kohë është në fuqi kushti aktual i projektimit KTP-N.2-89. Ky kusht kërkon vlerësimin e intensitetit sizmik të sheshit të ndërtimit dhe ky intensitet merret nga hartat e mikrozonimit sizmik. Sigurisht, aspektet e rrezikut sizmik të mikrozonimit të Tiranës dhe të qyteteve të tjera duhet të rivlerësohen në përputhje me metodologjitë e reja të vlerësimit të rrezikut sizmik që konsistojnë në përqasjen probabilitare të tij. Është urgjente që të hartohet kushti i ri teknik dhe harta e re e rrezikut sizmik të vendit duke u mbështetur në metodologjinë probabilitare, në përputhje me standardin e Eurokodit 8. Gjithashtu është e nevojshme që të bëhet edhe rivlerësimi i mikrozonimit të qytetit të Tiranës dhe Durrësit, bazuar në arritjet më të fundit të gjeologjisë dhe sizmologjisë inxhinierike¹²”.

Shqetësimi i shprehur për Tiranën dhe Durrësin rezultoi i saktë, pasi dhjetë vite pas kësaj interviste Shqipëria kaloi një moment të rëndë nga përballimi i një tërmeti të fuqishëm me epiqendër në Durrës. Në tërësinë e vlerësimit të tij, drejtori i Institutit të Gjeoshkencave, ishte përmbledhës i argumenteve që qëndrojnë edhe sot. Realizimi i këtyre mbetet prioritet për çdo kohë e për çdo brez që do të jetojë e ndërtojë në këto zona:

“Çfarë mund të ndodhi me Tiranën në rast të ndonjë tërmeti të magnitudës së lartë. E keni ngritur këtë si shqetësim [pyetje]? - Kjo do të varet nga cilësia e projekteve dhe sidomos nga rigoroziteti i zbatimit të punimeve të ndërtimit. Dëshiroj të theksoj se studimi i detajuar i gjeologjisë në zonat urbane sot është një problem aktual edhe për vendet e zhvilluara, të cilat po tregohen gjithmonë dhe më të vëmendshme për këto studime. Mendoj se duhet të ndërmerren nisma konkrete, edhe në aspektin e saktësisimit në ligjin e urbanistikës, për domosdoshmërinë e kryerjes se studimeve të detajuara gjeo-inxhinierike, ku të përfshihen studimi gjeologo-inxhinierik, hidrogeologjik dhe sizmologo-inxhinierik i territoreve urbane dhe industriale. Njohja e modelit gjeologjik të detajuar të truallit përbën gurin themelor për të gjitha projektimet dhe realizimet e mëtejshme infrastrukturore që do të realizohen në stadtet e mëvonshme në kuadrin e planifikimit dhe zhvillimit urban.¹³”

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹² Ismail Hoxha, intervistoi: Ben Andoni, *Studimet nuk zbatohen në shumë ndërtime* (Tiranë: Revista Mapo, 22 nëntor 2008).

Burimi elektronik: <https://www.geo.edu.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&aid=28>

¹³ Ibid.

3.3 Faktori njerëzor institucional, moszbatimi i një strategjie të shfrytëzimit të burimeve dhe rreziqet nga katastrofat natyrore

Emergjencat civile janë të lidhura ngushtë me faktorët natyrorë. Nxitja e një strategjie dhe e politikave që të kenë mjedisin dhe sigurinë mjedisore në fokus, do të shërbente për të ulur shkallën e dëmeve, dhe për të mënjeluar rreziqe të ndryshme që shkaktohen prej katastrofave natyrore. Në dekadat e fundit në Shqipëri ka pasur një shpërthim ndërtimesh të hidrocentraleve. Në një intervistë të dhënë për revistën “Iliria” aty nga viti 2010, ish-kryeministri Berisha u bënte thirrje investitorëve kroatë e më gjerë, për investim në këtë fushë, në Shqipëri: “Energetika është po ashtu një fushë e interesimit për firmat kroate – në këtë sektor planifikojmë të ndërtojmë 400 hidrocentrale të madhësive të ndryshme përmes projekteve të kapitalit privat. Janë nënshkruar më shumë se 50 marrëveshje në mesin e të cilave edhe njëra e vlefshme një miliardë euro. Ky është rast edhe për ndërtuesit e firmave kroate sepse shumë firma botërore marrin pjesë në ndërtimin e hidrocentraleve”¹⁴.

Këto vendime vazhduan deri në ditën e fundit nga qeveria e kohës. Numri i hidrocentraleve të programuar ishte me qindra, ose deri në mijëra po që se llogariteshin edhe ndërtimet e vogla (mikro): “Dua të sqaroj qytetarët se procedura e koncesionit është një proces shumë i gjatë, i cili fillon me studimin fillestar të burimit, ndonjëherë edhe me vëzhgimin e tij më shumë se një vit, me studimin e gjeologjisë, pronës e shumë aspekteve të tjera. Kjo procedurë ka qenë e mbetet historia më e madhe e suksesit të këtij vendi. E nisur në vitin 2007 e deri më sot, me këto dhjetë hidrocentrale shkon në 370 numri i hidrocentraleve të dhëna për t’u ndërtuar me koncesion në të katër anët e vendit, nga 444 hidrocentrale të vogla, të mesme e të mëdha, që janë përlllogaritur për t’u ndërtuar, pa llogaritur ato mikro që janë me mijëra, për të cilat kërkohet një kuadër më nxitës. . . . Pra, kemi të bëjmë me një proces të një rëndësie jetike për sa i përket punësimit. Këto vepra punësojnë në mënyrë të shpërndarë në të katër anët e vendit deri në zonat më të thella dhe ndryshojnë jetën e atyre komuniteteve, ndërtojnë infrastrukturë lokale dhe me këtë ndryshojnë jetën e atyre komuniteteve”¹⁵.

Nuk është aspak qëllim i këtij punim që të peshojë nga ana politike vendime të caktuara. Vetë ish-kryeministri shprehej asokohe: *Kjo procedurë ka qenë e mbetet historia më e madhe e suksesit të këtij vendi*¹⁶, dhe kjo gjë të shtyn të mendosh se edhe argumentimi shkencor lidhur me të duhet të ishte i madh (?). Duke e marrë të mirëqenë qëllimin e mirë dhe për zhvillim kombëtar, të Këshillit të Ministrave të asaj kohe që flasim, natyrshëm lindin pyetje për këdo: Cili studim vendosi se sa hidrocentrale duhet të ndërtoheshin në Shqipëri? A pati ndonjë studim nga Akademia e Shkencave apo ndonjë institucion tjetër shkencor kombëtar i rëndësishëm? A pati një diskutim publik lidhur me dëmet e mundshme? A pati një qasje gjithëpërfshirëse të politikës shqiptare (pasi ky ishte një investim me rëndësi strategjike kombëtare)? A u mor si rast krahasues një strategji e ngjashme e ndonjë shteti tjetër? A mund të dëmtohej rrjeti hidrik, mjedisi dhe ekosistemi nga këto ndërhyrje? Këto ishin vetëm disa nga pikëpyetjet që mund t’i

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹⁴ Kujtim Morina, Shenide Bilalli, *Bisedë me kryeministrin e Shqipërisë Sali Berishën* (Zagreb: Revista Iliria). <https://www.iliria.com.hr/sq/interviste/interviste-sali-berishen/>

¹⁵ Sali Berisha, *Fjala e Kryeministrit Berisha në mbledhjen e qeverisë* (Arkivi i Këshillit të Ministrave: 16.8.2013). <http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=18411>

¹⁶ Ibid.

lindin kujtdo. Por, edhe pse këto qasje e studime kombëtare mungonin, vijoi procedura. Edhe sot hidrocentralet e shumta të ndërtuara në territorin tonë vijnë të jenë objekt diskutimi.

Ajo që po përpiqemi të themi është se lidhja e faktorit njerëzor me mjedisin dhe katastrofat natyrore mund të shtojë ose të pakësojë rreziqet me të cilat do të duhet të përballemi në të ardhmen. Pyetjet e mësipërme dalin deri në diku të prekur në një studim nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC, 2015) e cila ka në fokus çështjet mjedisore. Në gjykimin tonë, nevojiten studime të gërshetuara që të kenë për themel fushën e sigurisë. Këto studime detyrimisht duhen realizuar nga institucionet shtetërore, të cilët kanë mundësi të gërshetojnë disiplinat dhe të dhënat e gjera. Në përfundimet e studimit të lartpërmendur thuhet:

“1. Zhvillim i sektorit të HEC-ve të vegjël nuk bazohet në dokumente analize të kapaciteteve dhe potencialit të mundshëm. Nuk ekziston asnjë dokument zyrtar publik i cili të dëshmojë dobishmërinë dhe kufizimet e këtij zhvillimi. Për rrjedhojë ka një mungesë vizioni, politike dhe strategjie të qartë kombëtare për sektorin e zhvillimit të HEC-ve të vegjël në vend.

2. Ndërkohë që vendi është në proces zhvillimi të dokumenteve kryesor strategjik, të tilla si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (ku uji është prioriteti i parë i saj); Strategjia për Burimet Ujore dhe Kadastra e Ujit; Strategjia Kombëtare e Planit i Rregullimit të Territorit dhe VSM përkatëse; Strategjia për luftimin e ndryshimeve të klimës dhe përshtatjes; Planet e baseneve të lumenjve Drin dhe Seman, zhvillimi i sektorit të HEC-ve do të kufizojë ose ndikojë përdorimin e burimeve për sektorë të tjerë jetik për vendin, siç është bujqësia apo furnizimi me ujë të pijshëm.

3. Ministria e Energjisë dhe Industrisë përgjegjëse për licencimin e HEC-ve nuk disponon një master-plan zhvillimi kombëtar dhe/ose rajonal për të përcaktuar kapacitetin hidroenergetik të baseneve lumore në vend, vendin ku mund të ndërtohet dhe madhësinë përkatëse.

4. Zhvillim i sektorit të HEC-ve nuk merr parasysh në asnjë rast faktorët kumulativ të investimit (ndërhyrjes në mjedis) dhe të efekteve që ka akumulimi i ujit për përdorim energjie në pjesën e poshtme të lumit deri në derdhjen në det, siç janë ndalimi i aluvioneve dhe gërryerja detare”¹⁷.

4. Strategjia e sigurisë kombëtare (SSK), dhe emergjencat¹⁸

Për të gjithë ata që nuk e kanë shumë të qartë, Strategjia e sigurisë kombëtare (SSK), flet qartë lidhur me rëndësinë që ka trajtimi i emergjencave natyrore. Mjedisi dhe rreziqet e lidhura me të, janë parësore për sa i përket masave që duhen ndërmarrë me qëllim shtimin e sigurisë kombëtare. Po sjellim një përmbledhje të SSK-së, duke vendosur në qendër trajtimin dhe përmendjen që i bëhet emergjencave civile.

Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet e inteligjencës luajnë një rol themelor parashikues, parandalues dhe guditës ndaj rreziqeve për sigurinë kombëtare. Për të

¹⁷ Mihallaq Qirjo et al. Alternativa mjedisore e hec-eve të vegjël, Studim alternativ për ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të HEC-eve të vegjël në rrjedhjet ujore në Shqipëri. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Tiranë, Shtator 2015, 50.

¹⁸ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2014), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, viti 2014, nr 137*, Ligj nr. 103/2014, “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”. Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare, f. 6288.

përmbushur me sukses këtë detyrë profesionalizimi, komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional kanë rëndësi vendimtare. Këto institucione kanë nevojë të modernizohen dhe të konsolidohen për të kontribuar në mënyrë efektive në forcimin e sundimit të ligjit, sigurisë së qytetarëve dhe të RSH-së. Policia e Shtetit ka një rol themelor edhe në kontrollin e territorit, menaxhimin e sigurt të kufijve dhe në *përballimin e emergjencave civile*. Përmbushja me sukses e këtij misioni duhet të realizohet edhe nëpërmjet thellimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit me FA-në.

Fuqizimi i sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes do të arrihet duke zhvilluar këto objektiva mbështetëse:

[...] Zgjerimi i spektrit të angazhimeve të FA-së në kushtet e paqes, në shërbim të qytetarëve dhe në mbështetje të autoriteteve civile, *për përballimin e emergjencave* dhe kontrollin e territorit;

Miratimi i *Strategjisë kombëtare për reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe mbrojtjes civile*;

- Ngritja e “*Qendrës Kombëtare të Emergjencave Civile dhe Krizave*”, e cila do të ofrojë një instrument të centralizuar për drejtimin dhe menaxhimin e emergjencave civile apo krizave ku mund të përfshihet RSH-ja; (SSK, f. 8).

4.1 Analiza e rreziqeve e SSK-së dhe emergjencat civile

Hartimi i SSK-së është bazuar mbi një analizë shtruese të gjitha elementeve përbërëse të sigurisë së RSH-së. Kjo analizë është realizuar nëpërmjet një procesi ndërinstytucional, që ka marrë në shqyrtim tërësinë e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve të vendit, duke i vendosur në një projektion dhjetëvjeçar. SSK pasqyron këndvështrimin rreth faktorëve dhe aktorëve që ndikojnë në sigurinë e Shqipërisë dhe prirjet që kanë gjasë të mbizotërojnë në të ardhmen. Analiza e mjedisit të sigurisë zhvillohet në dy rrafsh kryesore, atë të brendshëm dhe të jashtëm.

- Mjedi i brendshëm

Vendi ynë është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve me origjinë natyrore të karakterit gjeologjik, hidrologjik, atmosferik dhe biofizike, si dhe atyre me origjinë njerëzore, teknologjike dhe industriale. Në rang botëror Shqipëria renditet ndër vendet me pasoja të larta ekonomike nga fatkeqësitë. Rreth 86% e territorit ku gjenerohet afërsisht 88,5% e PBB-së, është e ekspozuar ndaj dy ose më shumë rreziqeve. Sistemi i mbrojtjes civile është i pamjaftueshëm për të menaxhuar numrin në rritje të emergjencave dhe rehabilitimin e shpejtë të gjendjes së shkaktuar prej tyre.

Ndryshimi i klimës është një dukuri globale, që ndikon negativisht në ekuilibrat natyrorë të RSH-së. Për shkak të klimës vendi mund të përballët me fenomene të skajshme më të shpeshta si temperatura të larta, thatësira të zgjatura dhe përmbytje të mëdha. Kjo mund ta ballafaqojë vendin me rrezikun nga fatkeqësitë hidrologjike, gjeologjike dhe biofizike, që prekin zonat e banuara dhe ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në ekonominë kombëtare.

Degradimi i mjedisit në RSH është një dukuri shumë shqetësuese. Ai shfaqet në forma të ndryshme si shtrirja kaotike e qendrave urbane, prerja masive e pyjeve, dëmtimi i tokave bujqësore, ndotja e lartë e baseneve hidrike dhe gërryerja e lumenjve. Këto dukuri kanë prodhuar pasoja të domethënëse në territor, peizazhin urban, në shëndetësi dhe në ekonominë e vendit.

Shqipëria është e prekur dhe rrezikohet edhe në të ardhmen nga erozioni. Zonat më problematike janë ultësira perëndimore, luginat e lumenjve të mëdhenj dhe bregdeti

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

i Adriatikut, ku vija bazë e detit po tërhiqet. Në brendësi të territorit, erozioni parashikohet të shkaktojë reduktim të tokës së punueshme dhe burimeve ujore.

Sëmundjet pandemike përbëjnë rrezik real dhe në rritje për sigurinë kombëtare. Në 20 vitet e fundit RSH-ja është përballur me sëmundje si kolera dhe poliomieliti, me disa lloje virusesh gripale si H5N1 e H7N9, si dhe virusin HIV. Humbjet potenciale në njerëz mund të jenë domethënëse, por ndikimi më i lartë do të shkaktohej nga reagimi i konsumatorëve, mungesat në fuqinë punëtore dhe dëmet kaskadë në sektorin ekonomik. (SSK, f. 13,15)

- Klasifikimi i rreziqeve

Klasifikimi i rreziqeve është bërë duke shqyrtuar dy parametra kryesorë: gjasat e shfaqjes së rrezikut dhe pasojat që mund të shkaktojnë për sigurinë kombëtare. Në bazë të kombinimit të këtyre dy parametrave rreziqet janë klasifikuar në tri nivele. Në nivelin e parë janë grupuar rreziqet që kanë gjasat të larta shfaqjeje dhe pasoja të larta në rast se materializohen. Në nivelin e dytë janë grupuar rreziqet, të cilat ndërthurin gjasat të ulëta dhe pasoja të larta. Në nivelin e tretë janë grupuar rreziqet që kanë gjasat të ulëta shfaqjeje dhe pasoja më të kufizuara. Këto përfundime janë arritur duke analizuar edhe dobësitë strukturore dhe institucionale që ndikojnë më së shumti në aftësinë tonë për t'u përballur me këto rreziqe.

- Rreziqet e nivelit të parë

Kategoritë e mëposhtme të rreziqeve kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e RSH-së. Gjasat e shfaqjes dhe pasojat e tyre për sigurinë kombëtare vlerësohen të larta.

• Korrupsioni dhe krimi i organizuar;

• Kriza energjetike, që kërcënon sigurinë e furnizimit të RSH-së dhe cenon rritjen ekonomike;

• Mangësitë në kontrollin dhe administrimin e territorit, që kërcënojnë sigurinë individuale dhe favorizojnë trafiket e ndryshme;

• Sulmet kibernetike nga aktorë shtetërorë ose joshetërorë;

• *Degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut.* (SSK, f. 17).

6. Përfundime

Nga sa pamë në mënyrë të përmbledhur më sipër, mund të thuhet se nevojitet që SSK të shërbejë si orientim për konsolidimin e një sektorëve të sigurisë që lidhen me emergjencat civile. Domosdoshmëria strategjike lidhet detyrimisht me Kryeministrinë, Qendrën Kombëtare të Emergjencave Civile, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, Ministria e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, të Shëndetësisë etj. Por, nëse strategjia do të mbetet thjesht një parim i pazbatueshëm e i pakonkretizuar në veprime, edhe rreziqet do të jenë të patrajuara sipas rëndësisë së tyre. Dëmi i faktorit njerëzor mbetet shoqërues i shtimit të rrezikshmërisë nga katastrofat natyrore. Sullëm vetëm dy shembuj se si rrjeti lumor dhe digat përbejnë një imperativ të trajtimit strategjik, por që në fakt janë trajtuar thjesht në nivel qeveritar dhe me plane afatshkurtrat. Mungesa i institucioneve që të kryejnë studime të thelluara dhe analiza të gërshetuara me qëllim që të masin shkallën e rrezikut ë vjen nga pasojat e katastrofave natyrore, shkatërrimit të mjedisit, degradimit të kontrollit mbi territor etj., shton akoma më shumë dëmin që shkakton natyra kur shfrenohet me forcat e saj.

Për t'i bërë ballë natyrës dhe katastrofave natyrore, duhet investuar te infrastruktura fizike, materiale, teknologjia, mjetet etj., dhe, te elementi njerëzor. Ky i fundit është “truri” që do përballojë rreziqet e natyrës. Nëse nuk arrijmë që të ngremë kapacitete njerëzore, institucionale, shoqërore, të cilat të jenë të afta dhe të denja shkencërisht për analizimin e gërshtuar të çështjeve të sigurisë, në fokusin e katastrofave natyrore, atëherë katastrofat natyrore do të dëmtojnë dyfish. Kjo masë e dyfishtë, do të shtohet për arsye se në vend që të parandalojmë do të përkeqësojmë me paaftësinë tonë shoqërore e institucionale. Shkatërrimi i instituteve shkencore në këtë dekada është një shembull; shkatërrimi i territorit, është një tjetër shembull, mungesa e trajtimit të çështjeve sizmologjike, hidroenergetike, të digave, të pyjeve, etj., si çështje të rëndësishme së parë, të sigurisë kombëtare, është një shembull tjetër. Në tërësinë e diskutimit, që sollëm, ajo që synonim ishte që të vendosnim nën prizmin e sigurisë kombëtare çdo gjë që lidhet me degradimin mjedisor dhe me katastrofat natyrore; emergjencat civile kanë një rrezikshmëri të tillë, që duhen parë si një luftë e vazhdueshme në të cilën kombi është i përfshirë. Në luftë nuk ka vetëm dëmtime fizike, por ka edhe dëme materiale e financiare. Për këto të fundit, vit pas viti jemi dëshmitarë që ato janë të pranishme. Për t'i parandaluar nuk mjafton vetëm kodi penal, por duhet organizuar mendimi sipas një rrjeti ndërinstitucional i cili të ofrojë ekspertizë të sigurisë. Emergjencat civile, kanë qenë janë dhe do të mbeten çështje të sigurisë kombëtare. Dhe si të tilla duhen trajtuar.

Bibliografia

1. Skënder Anamali et al., (2002), Historia e popullit shqiptar, Volumi 1, Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH & Botimet Toena.
2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2014), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, viti 2014, nr 137, Ligj nr. 103/2014, "Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë"*. Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare.
3. Geraldine Becchi, Vanda Dias Dos Santos, Hachim Badji (2011), *Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report For Albania*, United Nations Development Programme.
4. Instituti i Statistikave, *Treguesit Demografikë dhe Socialë*, "Popullsia sipas qarqeve", (Tiranë: INSTAT, 2021). Burimi elektronik: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>
5. Geraldine Becchi, *Disaster Risk Reduction Capacity*.
6. Erjon Kalaja, *Tërmetet duhet të na bëjnë të shikojmë menjëherë sigurinë e digave*, (Tiranë: Exit.al, 26.9.2019). Burimi elektronik: <https://exit.al/termetet-duhet-te-na-bejne-te-shikojme-menjehere-sigurine-e-digave/>
7. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e RSH, *Prezantohet Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Këshilli Teknik*, (Tiranë: 22.9.2020). Burimi elektronik: <https://www.infrastruktura.gov.al/prezantohet-komiteti-kombetar-i-digave-te-medha-dhe-keshilli-teknik>
8. Foto Duro, "Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri", në: Konferenca kombëtare, Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri (Tiranë: IDM, 2015). Burimi elektronik: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>
9. Ismail Hoxha, intervistoi: Ben Andoni, *Studimet nuk zbatohen në shumë ndërtime* (Tiranë: Revista Mapo, 22 nëntor 2008). Burimi elektronik: <https://www.geo.edu.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&aid=28>
10. Kujtim Morina, Shenide Bilalli, *Bisedë me kryeministrin e Shqipërisë Sali Berishën* (Zagreb: Revista Iliria). <https://www.iliria.com.hr/sq/interviste/interviste-sali-berishen/>
11. Sali Berisha, *Fjala e Kryeministrit Berisha në mbledhjen e qeverisë* (Arkivi i Këshillit të Ministrave: 16.8.2013). <http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=18411>
12. Mihallaq Qirjo et al. Alternativa mjedisore e hec-eve të vegjël, Studim alternativ për ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të HEC-eve të vegjël në rrjedhjet ujore në Shqipëri. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Tiranë, Shtator 2015.
13. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2014), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, viti 2014, nr 137, Ligj nr. 103/2014, "Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë"*. Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Gjeopolitika e pandemive, bioarmët dhe biosiguria



■ **Dr. Albert Hitoaliaj**
Qendra e Kërkimit Shkencor,
Akademia e Sigurisë
albert.hitoaliaj@asp.gov.al

Abstrakt

Që kur koronavirusi u përhap nëpër botë, shpërthyen një sërë analizash të shumëllojshme. Një pjesë e tyre ishin analiza që trajtonin aspektin gjeopolitik të botës, nën ndikimin e koronavirusit. Dy prirje kryesore mund të vihen re në linjën logjike të këtyre analizave. Prirja e parë, e konsideron KOVID-19 thjesht si një element të shtuar në lojën e madhe gjeopolitike, e cila vijon të njëjtin proces dhe raport mes fuqive, por me instrumente të reja dhe në rrethana të reja: mjedisit strategjik i shtohet koronavirusi. Ndërkaq, prirja e dytë e konsideron shfaqjen e koronavirusit në mjedisin strategjik si një element i cili do të ndryshojë përgjithmonë raportet politike e gjeopolitike të botës; disa thonë që tashmë e ka ndryshuar edhe realitetin shoqëror në mënyrë të pakthyeshme. Ky punim synon që të verë në dukje shndërrimin e natyrës së gjeopolitikës si pasojë e shpërndarjes së virusit KOVID-19. Dy qëndrimet e analizave të përmendura vijnë të argumentuara duke u mbështetur në një kornizë më të gjerë të trajtimit të çështjes. Përt'iu përgjigjur pyetjes: "A e ndryshoi koronavirusi gjeopolitikën?", ndërtohet një panoramë e cila jep informacion mbi prirjen e përdorimit të armëve biologjike qysh nga lashtësia e deri sot; sqarohet koncepti i biosigurisë, i mundësisë së përdorimit të të dhënave individuale gjenetike për interesa që lidhen me luftën biologjike, armët biologjike apo edhe bioarmët etnike (armë të cilat bazohen te diferencat gjenetike etnike, sipas shkencës) etj. Analiza përpiket që të hedhë dritë mbi këtë transformim të tashëm të gjeopolitikës, i cili është ndikuar nga koronavirusi. Punimi mbron idenë se koronavirusi ka ndryshuar gjeopolitikën pasi i ka dhënë rëndësi teknologjisë kompjuterike dhe biologjisë, si mjete të cilët ndikojnë sistemin ndërkombëtar botëror. Duke sjellë një këndvështrim të tillë, punimi synon që të ofrojë një pikëpamje të re që ka lidhje me gjeopolitikën, pandemitë dhe biosigurinë kombëtare, duke nxjerrë në pah edhe interesin shqiptar për trajtimin e kësaj çështje.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

gjeopolitikë, biosiguri, koronavirus, luftë biologjike, pandemi, armë biologjike.

1. Hyrje

“Mes gjithë formave të luftës, asnjëra nuk ka qenë më e dën timer në sytë e njerëzimit se sa përdorimi i lëndëve kimike dhe i agentëve biologjikë. Që nga kohërat e lashta, përdorimi i helmeve është konsideruar shkelje e rregullave të luftës. Sot, armët kimiko-biologjike shikohen nga publiku me një tmerr dhe neveri, që nuk ndihet të jetë i tillë, për lloje të tjera armësh, shumë më shkatërruese. Këtij reagimi i gjendet filli te përvoja historike, e tillë si sulmet me gaz të Luftës së Parë Botërore, dhe madje edhe te frikët psikologjike të rrënjësura thellë. Cilado qoftë origjina e saj, kjo neveri është shprehur në përpjekjet e vazhdueshme ndërkombëtare për ta bërë të jashtëligjshme luftën kimiko-biologjike”¹.

Pavarësisht se që në kohët e lashta ka ekzistuar dën timer i armëve biologjike, shembuj të përdorimit të tyre kanë ekzistuar që nga lashtësia. Arsyeja e përdorimit të tyre, mbase qëndron te fakti se mbijetesa në një luftë është më e rëndësishme se morali. Mes përpjekjeve më të shquara që janë bërë për shmangien e përdorimit të këtyre armëve, ka qenë Protokoll i Gjenevës, i vitit 1925. Këtë protokoll e firmosën 84 vende të cilat u betuan se nuk do të përdornin kundër palëve të tjera të nënshkruese, “gazra asfiksues, helmues ose të llojeve të tjera”, “çdo lëng, material apo pajisje të ngjashme”, ose “metoda të luftimit bakteriologjik”².

Gjithsesi, ky protokoll do të ndalonte vetëm përdorimin e këtyre armëve, si shtet i parë, në një konflikt. Një shtet i sulmuar me armë kimiko-biologjike mund të përgjigjej në të njëjtën mënyrë. Për më tepër, protokoll i nuk i ndalon palëve të drejtën

¹ United States Congress, House Committee on Foreign Affairs, *Chemical-biological Warfare: U.S. Policies and International Effects: Report ...* (U.S. Government Printing Office, 1970), 1.

² United States Congress, 1.

e prodhimit të armëve kimike apo biologjike. SHBA, edhe pse me një rol të rëndësishëm për krijimin e këtij protokolli, e firmosi në atë kohë, por nuk e ratifikoi atë³. *Protokolli i Gjenevës*, u nënshkrua në Gjenevë më 17 qershor 1925, hyri në fuqi më 8 shkurt 1928; ratifikimi i tij, u këshillua nga Senati i SHBA-së më 16 dhjetor 1974, u ratifikua nga Presidenti i SHBA-së më 22 janar 1975⁴. Duke iu referuar si burim, Departamentit të Shtetit të SHBA-së, më datën 20 dhjetor të vitit 1989 Shqipëria është bërë pjesë e këtij protokolli, ka aderuar, por nuk e ka ratifikuar atë⁵. Sipas burimeve të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, kjo datë, është po ashtu edhe data e ratifikimit të marrëveshjes⁶.

Megjithëkëtë, luftës biologjike i gjenden rrënjët shumë kohë më parë, në lashtësi. Njeriu është përpjekur gjithmonë që të përdorë bakteret, viruset, sëmundjet, helmet, bimët etj., për të arritur fitoren e tij mbi një kundërshtar. Krijimet e programeve të armëve biologjike në vitet 1920-1944, duket se e ngritën luftën biologjike një herë e mirë në nivelin e programeve shtetërore. Kjo prirje antike dhe këto programe të sofistikuar, janë arsye e fortë se përse koronavirusi nuk përfaqëson thjesht një pandemi globale. Ai është një shembull, një model dhe një tregues se si mund të jetë një realitet i ri me rreziqe biologjike. Faktori biologjik është përdorur gjithmonë si armë në histori dhe nuk ka arsye të mendohet se në të ardhmen nuk do të ndodh më kjo gjë. Koronavirusi dhe teknologjia i kanë dhënë një pamje tjetër përfytyrimit gjeopolitik të së ardhmes. Tashmë biosiguria dhe siguria kibernetike po shfaqen më qartë, jo vetëm si domosdoshmëri, por edhe si tregues të transformimeve që po ndodhin në sistemin ndërkombëtar.

2. Termat bazë të luftës biologjike

Përpara se të zgjerohemi në një analizë mbi gjeopolitikën dhe armët biologjike, vlen të shohim disa shpjegime lidhur me termat themelore që kanë lidhje me luftën biologjike.

Agjentët biologjikë. Studimi i 1969-s i Kombeve të Bashkuara, për sekretarin e përgjithshëm, deklaroi se: “Agjentët bakteriologjikë (biologjikë) të luftës janë organizma të gjallë, cilado qoftë natyra e tyre, apo materiali infektiv që rrjedh prej tyre, të cilat synojnë të shkaktojnë sëmundje ose vdekje te njeriu, kafshët ose bimët, efektet e të cilëve [agjentëve] varen nga aftësia e tyre për t’u shumëzuar brenda personit, kafshës ose bimës së sulmuar”. Ky përkufizim, nuk i përfshin toksinat brenda termit

³ United States Congress, 1.

⁴ Under Secretary for Arms Control and International Security, *Protocol for the Prohibition of the Use in War of Asphyxiating, Poisonous or Other Gases, and of Bacteriological Methods of Warfare* (Geneva Protocol) (Washington: Bureau of International Security and Nonproliferation, 2002).

Burimi elektronik: <https://2009-2017.state.gov/t/isn/4784.htm>

State Parties. Done at Geneva, June 17, 1925, Entered Into Force February 8, 1928

1. States Parties: (A = Accession, R = Ratification, D = Declaration of Succession) :

Albania December 20, 1989, A [A = Accession].

Pra, Shqipëria vetëm sa ka aderuar në Protokollin e Gjenevës së 1925, sipas burimit të Departamentit të Shtetit të SHBA-së.

⁵ Under Secretary for Arms Control and International Security.

⁶ Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, *Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve: Raporti vjetor mbi kontrollin e eksporteve, 2013* (Tiranë: UNDP/SEESAC, 2013), 23.

“Protokolli i Gjenevës (Protocol for the Prohibition of the Use in War of Asphyxiating, Poisonous or other Gases, and of Bacteriological Methods of Warfare), nënshkruar në Gjenevë, më 17 korrik 1925.

Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 8 korrik 1928.

Data e nënshkrimit nga Shqipëria:

Data e ratifikimit/aderimit/hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 20 dhjetor 1989”

agjentë biologjikë⁷.

Agjentët e armëve biologjike, janë ata agjentë mikrobe, agjentë të tjerë biologjikë dhe toksina, të cilët synohet që të përdoren si armë biologjike. Këta përmenden gjithashtu si agjentë të zgjedhur, me një referencë të sëmundjes që shkaktojnë; p.sh. “*Bacillus anthracis*” është bakteri që shkakton antraksin⁸.

Armët biologjike [të përmendura shpesh edhe si *bioarmë*] u referohen municioneve, pajisjeve ose mjeteve të tjera të shpërndarjes, përfshirë edhe bombat, avionët cisternë spërkatës dhe pajisje të tjera, të planifikuara për përdorim në shpërndarjen e agjentëve biologjikë dhe të toksinave, për qëllime armiqësore. Mjetet kryesore të përhapjes janë ato spërkatëset, që hidhen për t’u thithur nga një popullsi që është objektiv, ose spërkatës që hidhen mbi kultura bimore. Spërkatje të tilla, janë grimca shumë të vogla të cilat pluskojnë në ajër duke udhëtuar në të përmes rrymave ajrore, në vend që të precipitojnë në tokë⁹.

Lufta biologjike, i referohet përdorimit ushtarak të mikrobeve, agjentëve të tjerë biologjikë (përfshirë këtu: baktere, viruse dhe kërpudha) ose toksinave, me qëllim shkaktimin e vdekjes, paaftësimin e përkohshëm, dëmtimin e përhershëm të njerëzit, ose datimin e kafshëve apo bimëve për qëllime ushtarake¹⁰.

Bioterrorizëm. Qendra e Shteteve të Bashkuara për Kontrollin e Sëmundjeve, e ka përcaktuar bioterrorizmin, si: hedhje e qëllimshme nga aktorë joshitetërorë, e viruseve, e baktereve ose e agjentëve të tjerë, të përdorur për të shkaktuar sëmundje ose vdekje të njerëzit, e gjithashtu edhe të kafshët ose bimët. Bioterrorizmi synon të krijojë viktimë, terror, përçarje të shoqërisë ose humbje ekonomike, duke u frymëzuar nga besimet ideologjike, fetare ose politike. Sidoqoftë, bioterrorizmi mund të përdoret gjithashtu edhe për të shkaktuar humbje të konsiderueshme ekonomike, duke infektuar bagëtinë ose të korrat, ose duke molepsur ndërtesa¹¹.

Bioterrorist. Një bioterrorist mund të jetë çdo aktor joshitetëror që përdor ose kërcënon se do të përdorë agjentë¹² biologjikë në emër të një kauze politike, fetare, ekologjike ose një të njëjtë kauze ideologjike, pa pasur referenca për këtë drejtësi të tijen morale ose politike. Ky akt përfshin aktorë joshitetërorë, të cilët veprojnë me mbështetjen e organizatave ushtarake të një shteti mashtrues, dhe agjentët biologjikë sigurohen e shpërndahen me mjete të maskuara e të improvizuara dorëzimi¹³.

Biokrimi. Biokrimi nënkupton përdorimin e një agjenti biologjik për të vrarë ose për të sëmurur individë të vetëm, ose një grup të vogël individësh, motivuar nga hakmarrja apo fitimi monetar përmes zhvatjes/kërcënimit, në vend të besimeve politike, ideologjike, fetare ose të tjera. Për shembull, dr. Taranath Bhattacharyna ishte një fizikan

⁷ UN Department of Political and Security Council Affairs, *Chemical and bacteriological (biological) weapons and the effects of their use, Report of the Secretary-General* (UN Document A/7575/Rev1, No. E.69 I. 24, New York, 1969). Cituar në: U. C. Jha dhe K. Ratnabali, *Biological weapons. Coronavirus: Weapon of Mass Destruction?* (New Delhi: Vij Books India Pvt Ltd., 2020), 10.

⁸ Jeanne Guillemin, *Biological weapons: from the invention of state-sponsored programs to contemporary bioterrorism* (New York: Columbia University Press, 2005), 3.

⁹ Guillemin, 2.

¹⁰ Guillemin, 2.

¹¹ U. C. Jha dhe K. Ratnabali, *Biological weapons. Coronavirus: Weapon of Mass Destruction?* (New Delhi: Vij Books India Pvt Ltd., 2020), 11.

¹² AGJENT m. spec. Shkaku i një dukurie a i një ndryshimi në natyrë ose në organizmat e gjalla, elementi a faktori veprues; shkaktori i një sëmundjeje. Agjent fizik (kimik, atmosferik). Agjent i jashtëm (i brendshëm). Referuar: Akademia e Shkencave e RPSSH, *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1980).

¹³ U. C. Jha dhe K. Ratnabali, *Biological weapons. Coronavirus: Weapon of Mass Destruction?* (New Delhi: Vij Books India Pvt Ltd., 2020), 11.

me eksperiencë në bakteriologji. Ai dhe Benoyendra Chandra Pandey (thjeshtri i Benoyendra-s) vranë 20-vjeçaren Amarendra Pandey me një dozë vdekjeprurëse të “Y. Pestis”, pas një grindjeje që patën për ndarjen e pasurisë së babait të tyre. Shembuj të tjerë janë përdorimi i ricinit për të hequr qafe një partner, ose vrasja e disidentit hungarez Georgi Markov në Londër, më 1978, me një toptë që përmbante ricin, i injektuar te viktima me një çadër¹⁴ [operacion nga ish-KGB].

Biorreziku. Biorreziku përcaktohet si çdo mikroorganizëm (përfshirë, por jo i kufizuar veç në to): baktere, viruse, kërpudha, baktere të pafiltrueshme, ose protozoarë, parazitë, agjentë transmetues, toksina biologjike, substanca infektive ose ndonjë përbërës natyror, i bioinxhinierisë ose i sintetizuar, i cili do mikroorganizëm apo substance infektive, që është i aftë të shkaktojë, sa vijon: (i) vdekje, sëmundje ose ndonjë mosfunksionim tjetër biologjik te njerëzit, kafshët, bimët ose te organizma të tjera të gjalla; (ii) ndryshim të dëmshëm të mjedisit; ose (iii) një ndikim të pafavorshëm te tregtia ose marrëveshjet tregtare¹⁵.

Biosiguria. Biosiguria synon pakësimin e rrezikut të vjedhjes, të humbjes, të cenueshmërisë së qëllimshme dhe të hedhjes, së patogjenëve ose së toksinave. Ajo përfshin një spektër të gjerë rreziqesh e kërcënimesh të mundshme, duke filluar nga aktivitete kriminale, të tilla si sabotimi, akte të izoluara agresioni, e deri te bioterrorizmi dhe spiunazhi. Ruajtja e agjentëve infektivë është gjithashtu një detyrim ligjor kombëtar, sipas *Konventës së armëve biologjike dhe toksinave* të vitit 1972 (BTWC) dhe *Rezolutës 1540* të Këshillit të Sigurimit të KB. Biosiguria e zbatuar ka një numër të rëndësishëm përbërësish si, përgjegjësia e punonjësve, kontrolli i materialeve, zhvillimi i procedurave standarde të funksionimit, pajtueshmëria me procedurat e biosigurisë, siguria fizike, kontrolli i hyrjes, siguria e informacionit, siguria e transportit, regjimet e duhura për raportimin dhe reagimin e incidenteve të sigurisë, mbajtja e vlerësimit dhe e rishikimit të vazhdueshëm, dhe pajisja me trajnim dhe edukim¹⁶. Para se të shohim përcaktimin e termit “biosigurim” duhet të vëmë në dukje se “biosiguria” dhe “biosigurimi”, paçka se janë të ngjashëm si terma, ata kanë dallime mes tyre. Këto terma, ashtu si dhe “biorreziku” shpjegohen në mënyrë të detajuar nga *Libri i mjekësisë ushtarake*, i ushtresë së SHBA-së¹⁷.

Biosigurimi. “Biosigurimi” ose “sigurimi biologjik” është zbatim i kombinimeve të procedurave dhe të praktikave laboratorike, për pajisjet laboratorike dhe për pajisjet e sigurisë kur punohet me agjentë që të mundshëm biorreziku. Objektivi themelor i çdo programi të biosigurimit është frenimi i agjentëve biologjikë shumë të rrezikshëm. Qëllimi i frenimit është zvogëlimi ose eliminimi i përballjes së punëtorëve të laboratorit, së personave të tjerë dhe së ambientit të jashtëm me këta agjentë të rrezikshëm. Biosigurimi varet nga tre elementë: nga teknikat e praktikave standarde laboratorike mikrobiologjike, nga pajisjet e sigurisë dhe nga lloji i instrumenteve. Sigurimi biologjik, ose “biosigurimi” është zbatim i koncepteve që kanë të bëjnë me: vlerësimin e rrezikut, teknologjinë inxhinierike, mbrojtjen e personalit dhe të pajisjeve, politikat, trajnimet dhe ilaçet parandaluese për të promovuar praktikatat e sigurta laboratorike, procedurat dhe përdorimin e duhur të pajisjeve frenuese¹⁸.

¹⁴ Jha dhe Ratnabali, 11.

¹⁵ Jha dhe Ratnabali, 11.

¹⁶ Jha dhe Ratnabali, 12.

¹⁷ David E. Harbourt, et. al., “Biosafety,” në *Medical Aspects of Biological Warfare: Text Book of Military Medicine*, red. Bozue Joel, Christopher K. Cote and Pamela J. Glass (Office of the Surgeon General: US Army Medical Department Centre and School, 2018), 869-894.

¹⁸ Jha dhe Ratnabali, *Biological weapons*, 12.

3. Bioarmët dhe lufta biologjike, në një retrospektivë historike

Më 1770 p.e.s. pllakat shumere në qytetin Mari, tregojnë se ata i kuptonin se si ndodhnin sëmundjet ngjitëse. Më 1500-1200 p.e.s. hititë të infektuar me murtajë, dërgoheshin në tokat e armikut. 1300 p.e.s. ndodh rënia e murtajës në Egjipt, e kërkuar nga Moisiu dhe shkatërrimi i Xherikos nga izraelitët, po në 1350 p.e.s. Më 1200 p.e.s. në Luftën e Trojës përdorëshin shigjeta të helmuara; filistinët infektohen me murtajë pasi kishin vjedhur Arkën e Besëlidhjes nga izraelitët. Më 100 p.e.s. Solomoni ndërtoi tempullin e tij në Jerusalem dhe mbylli në qypa shpirtrat e murtajës. Më 900 p.e.s. Elijah krijon marifetet e zjarra me naftë. Homeri, në 750 p.e.s. përshkruan Odisenë duke helmuar shigjetat. Më 600 p.e.s. në Kirra të Greqisë, arrihet një fitore që mundësohet nga helmimi i ujit. Sun Zu, në librin *Arti i luftës*, përshkruan armët me zjarr në vitin 500 p.e.s. Më 500 p.e.s. në betejën e Spartës kundër Plateias përdoren zjarre me squfur; Ctesias përmend në këtë kohë edhe armët me vaj të Indisë. Në 409-396 p.e.s. Kartagjena pushton Sicilinë; gjejmë helmimin e verës së armikut me bimë madërgone. Në Indi më 326 p.e.s. *Ligjet Manusë* dënonin përdorimin e shigjetave me helm e me zjarr; kurse po në Indi në atë kohë Arthashastra këshillonte përdorimin e strategjive me helm e zjarr. Të asaj periudhe janë recetat kineze për shigjeta me gaze të helmëta e toksike. Në 200 p.e.s. Hanibali përdorte hedhjen e nepërkave me katapulta, kurse Aquillus, më 131 p.e.s. helmonte pushtet në Azi. Në Romën e vitit 189 të e.s. kemi dëshminë e një epidemie murtaje të shpërndarë nga njeriu¹⁹.

Edhe paraardhësit e shqiptarëve, ilirët, nuk bëjnë përjashtim nga përdorimi i armëve biologjike antike. “M. Shuflaj ve në dukje se, ndërsa qytetet me popullsi të përzier lulëzonin, viset malore ilire vazhdonin me luftue me shigjetat e tyre të lyera me helm gjarpri”²⁰.

Në Kinë, për armët biologjike më të hershme (shigjeta me helm etj.) që i përkasin vitit 2735 p.e.s., merita i njihet babait të mjekësisë kineze, Shen Nungut. Për armët me helm të Kinës flet gjerësisht Ralph Sawyer në veprën e tij, *The Tao of Deception: Unorthodox Warfare in Historic and Modern China* (2007)²¹.

Në vitin 2007 shkencëtarët deklaruan se në një vilë romake pranë Pompeit zbuluan një substancë në një enë mbajtëse, një tinar, që ishte i mbushur me një përzierje bimësh që nga vitit 79 p.e.s. Ishte një përzierje e një recete të fortë, bimësh mjekësore me kocka e mish reptilësh. Por nuk ishte një helm. Sipas arkeologëve bëhej fjalë për një kundërhelm universal që besohej se mund të përdorej kundër çdo helmi. Rreth 100 vjet më parë se Pompei, një kombinim i dozave të vogla të helmeve dhe kundërhelmet e tyre, amalgamë e quajtur *Mithridatium*, ishte shpikur nga mbreti Mithridates VI i Pontusit, një strateg dhe mjeshtrë i toksikologjisë. Kjo recetë u mor nga mjeku i perandorit Nero dhe funksionoi për shumë kohë e qarkulloi mes familjeve mbretërore. Formula tashmë ka humbur. Por ka dëshmi së përmbante në vetvete edhe opium dhe copa nepërke të shtypur. Pra, kemi që në antikitet përpjekjen e fitimit të imunitetit ndaj armëve biologjike të armikut²².

¹⁹ Adrienne Mayor, *Greek Fire, Poison Arrows Scorpion Bombs – Biological and Chemical Warfare in the Ancient World* (New York: Overlook Duckworth, 2009), 18-20.

²⁰ Mehmet Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe* (Tiranë: Gjergj Fishta, 2006), 77.

²¹ Adrienne Mayor, *Biological Warfare*, 11.

²² Mayor, *Greek Fire*, 8.

Adrienne Mayor, një historiane e specializuar për luftën biologjike dhe bioarmët në lashtësi, e ftuar në samitin ndërkombëtar të biosigurisë në Washington DC, u intervistua nga *History Channel* së bashku me Serguei Popov. Ky i fundit, ka qenë një ish-kërkues shkencor nga më të mirët e ish-Bashkimit Sovjetik, pjesë e programit *Biopreparat*, dezertoi dhe erdhi në SHBA më 1992. Pas një pune prej dekadash në Rusi për krijimin e superviruseve të ndërtuara përmes inxhinierisë gjenetike, ai punoi në Amerikë për *National Center for Biodefense* (Qendra Kombëtare e Mbrojtjes Biologjike), duke i kushtuar jetën kërkimeve për gjetjen e një kundërhelmi universal të ditëve tona, njëlloj si *Mithridatium* antik. Së bashku me kolegët punojnë për një vaksinë universale kundër çdo arme patogjene²³.

Helmimi i ujit dhe ushqimeve. Një nga teknikat më të vjetra të luftës biologjike në histori, është helmimi i ujit dhe ushqimeve të një kundërshtari. Shkatërrimi i të korrave dhe helmimi i puseve haset shpesh në histori. Këtu kemi përmendur edhe shembullin e njohur të betejës së Sfetigradit dhe helmimin e pusit nga osmanët. Strategjia e shtrëngimit të të rrethuarve duke u hequr çdo burim uji e ushqimi është e njohur. Prandaj helmimet e tyre hasen shpesh në histori. Në Luftërat Gotike të 535-555 të e.s., romakët e rrethuar u detyruan të hanë fekale njerëzore, hithra të helmëta dhe miell acid lendesh lisi, – me pasoja fatale²⁴.

Helmimi i ujërave dhe shpërndarja e sëmundjeve ka qenë një praktikë e njohur edhe në luftërat që kanë bërë shqiptarët në mbrojtje në trojeve. Më 1448, në rrethimin e Sfetigradit (pranë Dibrës) kemi një shembull të përdorimit të një arme biologjike kundër një ushtrie. Sipas Barletit është hedhur një qen i ngordhur në burimin e ujit me të cilin furnizohej kështjella e rrethuar. “Qeni në pust ka rënë! Dibranët nuk’ e pinin ujët’ e kërmës’ së shkretë, tjetër pus s’kish, qysh të rrinin? pa ujë s’rrohet në jetë”²⁵. Pusi sekret ishte i vetmi burim që ushqente kështjellën. “Në te vëtemin pus te Sfetigradit, nga i cili pinin uje ndënjesit dhe garnizoni, tradhetori, i paguar prej Turqve, hodhi naten një qen te ngordhur”²⁶. Si strategji, helmimi i ujit doli më efikas se sa sulmet me armë. “Murati II kërkoi të dorëzohej kështjella, e bombardoi, u përpoq ta marrë me tradhti Stellushin, sulmoi disa herë Sfetigradin, por dështoi. [...] kur osmanët gjetën ujësjellësin e kështjellës dhe i prenë asaj ujin, mbrojtësit u detyruan të dorëzoheshin me kusht që të dilnin të lirë e të largoheshin të armatosur prej saj”²⁷.

Për arsye se “garnizoni i Sfetigradit, i përbërë nga forca shqiptare dhe reparte bullgare, nën komandën e Pjetër Perlatit, u qëndroi heroikisht sulmeve turke dhe [...] sulltani u përpoq t’i tërhiqte forcat e Skënderbeut në një betejë vendimtare jashtë kalasë, por nuk ia arriti dot qëllimit.”²⁸, Noli nuk e beson këtë mënyrë dorëzimi. Noli analizon situatën duke thënë se: “Legjenda e Barletit, sipas së cilës një qen i ngordhur paskish qenë hedhur prej një tradhëtari në të vetmin pus të kështjellës, dhe garnizoni paskish refuzuar të pinte nga ata ujë, është tepër naive dhe nuk mund të pranohet si arsye dorëzimit të kalasë te turqit”²⁹. Por, kjo humbje mbeti e kujtuar edhe në traditën popullore si fryt i

²³ Mayor, 9.

²⁴ Mayor, 12.

²⁵ Naim Frashëri, *Histori e Skënderbeut, Vepra 3* (Prishtinë: Rilindja, 1978), 155.

²⁶ Fan Stylian Noli, *Historia e Skënderbeut: Gjergj Kastriotit, Mbretit të Shqipërisë, 1412-1468* (Shtypeshkronja e “Diellit”, 1921), 161.

²⁷ Aleks Buda, Xhevat Lloshi red., *Fjalor enciklopedik shqiptar* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1985), 90.

²⁸ Selim Islami, Kristo Frashëri, Aleks Buda, red., *Historia e popullit shqiptar, v. 1* (Tiranë: USHT, Instituti i Historisë e Gjuhësisë, 1968), 261.

²⁹ Fan Stylian Noli, *Gjergj Kastrioti Skenderbeu: 1468-1968* (Tiranë: Shtëpia botonjese “Naim Frashëri”, 1967), 97.

tradhtisë: “Në kangën që e pason këtë pjesë thuhet për’ të [ai që tradhtoi për një grusht paresh]: *E vraftë Zoti, ai helmatisi ujin e kështjellës; shpirti i tij mos e paftë kurrë Parajsën*”³⁰.

Armët patogjene. Në vitin 2007 u zbuluan disa prova që tregonin se hititët, në luftëra e tyre me arzuat, më 1320-1318 p.e.s., edhe pse më të dobët se kundërshtarët, arritën të fitojnë luftën falë një arme sekrete biologjike. Hodhën desh dhe gomarë të infektuar me taluremi, në territorin e armikut dhe sëmundja prej kafshëve kaloi te njerëzit. Më pas kjo mori emrin “murtaja hitite”. Lufta antike me armë biologjike njihej edhe nga romakët, të cilët, përdorimin e armëve të tilla e quanin *pestilentia manufacto* d.m.th. murtajë nga dora e njeriut³¹.

Pijet dehëse dhe gjumëndjellëse. Komandanti më i hershëm i një ushtrie, i cili ishte njëkohësisht edhe me njohur farmakologjike, ishte gjenerali Chrysame. Historia i përket vitit 1000 p.e.s. kur grekët kolonizonin Joninë. Përdori drogat bimore kundër armikut duke shkaktuar çmendje të përkohshme të trupave. Edhe gjenerali Mithridates, ishte një mjeshtër i toksikologjisë. Kautilya ishte një strateg ushtarak e shkencëtar njëkohësisht, i cili jetoi në Indinë e kohës së Aleksandërit të Madh. Ishte një toksikolog i njohur.

Ditët e sotme kërkohet po ashtu një gërshetim i aftësive ushtarake me ato të shkencës, për krijimin e armëve biologjike. E gjej interesante përmendjen e faktit se, gjenerali ish-sovjetik në krye të programit të bioarmëve me ADN hibride, ishte një specialist i biologjisë molekulare³².

Insekte dhe kafshë, si armë. Insektet helmuese mund të kenë qenë nga armët më të hershme zoologjike në histori. Shembujt janë të shumtë dhe një prej botimeve që e trajton gjerësisht këtë përdorim, është libri *Six-Legged Soldiers: Using Insects as Weapons of War* (2008).

Njësia e kërkimit shkencor të Pentagonit, DARPA ka deklaruar arritje në programin e saj, *Vivisystems*: minj të robotizuar, kontroll kafshësh në distancë, insekte sajborg, për t’i përdorur në luftë. Krahës tyre, duhet përmendur se Marina e SHBA-së (*US Navy*) ka kohë që trajnon delfinët dhe luanët e detit për operacione ushtarake kundër armikut. Armët të tilla me bazë biologjike, por jo virusale apo bakteriologjike janë përdorur që në lashtësi³³.

Të përpiqesh për të kontrolluar armët biologjike, me helme, tymra, gazra, insekte e kafshë të infektuara apo helmuese, etj., ka qenë shumë e vështirë që në lashtësi. Këto armë mund të dëmtojnë edhe ata që i hedhin. “Në pothuajse të gjitha kulturat, si antike ashtu edhe moderne, armët biologjike dhe kimike janë parë si më të neveritshme se sa armët konvencionale,” – vëren eksperti i armëve biokimike dr. Leonard Cole³⁴.

4. Gjeopolitika dhe projektet shtetërore për bioarmë

Përdorimi i armëve biologjike ka një zanafillë shumë të hershme. Megjithatë, me kalimin e shekujve edhe pse nuk ka pasur përdorime botërore të armëve të tilla, përsëri kërkimet në këtë fushë kanë ardhur duke u përsosur. Programet e shteteve të ndryshme përfshijnë kërkime të avancuara në këtë fushë. Veçmas frikës së përdorimit të armëve biologjike nga shtete të caktuara në një luftë, ekziston edhe frika e përdorimit të viruseve

³⁰ Edward A. Licho, red., *Gjergj Kastrioti Skenderbeu: 1468-1968*, (New York: Pan-Albanian Federation of America Vatra, 1968), 103.

³¹ Mayor, *Greek Fire*, 12.

³² Mayor, 12.

³³ Mayor, 13.

³⁴ Mayor, 14.

apo baktereve për qëllime terrorizmi. “Bioterrorizmi” dhe “biosiguria” kanë filluar të jenë përherë e më shumë në vëmendjen e strukturave të sigurisë në botë. Në tetor të 2003, në Washington DC, organizohej një konferencë botërore për biosigurinë. Ishte e organizuar nga *Harvard Medical School*, *Harvard School of Public Health*, *Harvard Medical International*, në bashkëpunim me *RAND Center for Domestic and International Health Security* dhe *Jane’s Information Group*. Ekspertët ndërkombëtarë të biosigurisë paraqitën shembuj të ndryshëm se si mund t’i përgjigjej bota një sulmi biologjik me antraks, li, sars etj.³⁵ Emrat e organizuesve, siç shihet, ndahen në dy kategori: shkencëtarë nga fusha e mjekësisë dhe ekspertë të sigurisë e inteligjencës. Aktivitete të tilla nuk janë të rralla, pasi interesi për mbrojtjen biologjike sa vjen e shtohet.

Por, studimi i armëve biologjike has vështirësi të mëdha. Për pjesën më të madhe të programeve shtetërore që merren me kërkime për bioarmët, nuk gjendet informacion. Shtetet zbatojnë norma të forta sigurie lidhur me to. Nga ana tjetër studimi i armëve biologjike kërkon një gërshetim njohurish në fusha të tillë si: biologjia, politika, historia, të drejtat e njeriut, etika, jurisprudenca, gjeopolitika etj. Pra, në njërën anë duhen analistë shumë të përgatitur, dhe në anën tjetër, është problemi i gjetjes së informacionit. “E tërë tema e diskutimit mbi armët biologjike karakterizohet nga një shkallë e pazakontë keqinformimi e madje edhe dezinformimi”³⁶.

Në gjeopolitikën klasike shteti si aktori kryesor, përdor çdo instrument për mbrojtjen e interesave të tija jetike. Pikëpamjet realiste të politikës shpeshherë janë kundërshtuar, por në luftë dhe në kushte mbijetese, makiavelizmi ka treguar gjithmonë se nuk i ikën koha. Lufta biologjike mund të jetë edhe më “e pisët” se sa luftërat e tjera, me armë konvencionale. Kërcënimi prej viruseve është më i tmerrshëm dhe më i pamoralshëm se sa çdo lloj arme tjetër. Kemi të bëjmë me një armik të padukshëm që nuk mund të luftohet me armët e njohura. Shkenca është e vetmja përgjigje ndaj këtyre armëve biologjike. Por jo çdo shtet mund të kundërpërgjigjet në mënyrë shkencore, pasi nivelet e njohurive në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve kundër armëve biologjike, janë shumë të ndryshme në shkallë botërore.

Siç pamë më lart, përpjekja e njeriut për përdorimin e sëmundjeve e viruseve si armë është shumë e lashtë. Lidhur me programet shtetërore që bëjnë kërkime të tilla, pjesa dërrmuese e njerëzimit nuk është në dijeni. Kërkimet në këtë drejtim janë shumë më të gjera nga sa mund të mendohet. Në shekullin e 20-të fuqi të mëdha si SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Japonia etj., kanë zhvilluar programe të luftës biologjike në sekret të plotë.

Që pas 1972, me nënshkrimin e *Konventës për armët biologjike*, programet shtetërore, në pamje të parë, u duk sikur u mbyllën. Por thjesht sa u bënë edhe më sekrete. Biologu molekular, gjenerali sovjetik Igor Ashmarin, urdhëronte në fillim të 1979-s, shkencëtarët e programit *Biopreparat*, që të bashkonin neurotransmetuesit njerëzorë me hormonin “opioid betaendorfin” si përgjigje ndaj dhimbjes ose ndaj stresuesve të ndryshëm, në viruse të ndryshëm. Bioarmët që kishin në shënjestër personalitetin dhe sjelljen e armikut nuk ishin fantazi tashmë, ashtu siç nuk ishte as shpërndarja e helmit të kobrës përmes virusit³⁷.

“Pas vitit 1945, armët nukleare e lanë në hije kërcënimin e armëve biologjike, derisa mbaroi Lufta e Ftohtë. Atëherë potenciali i paprovuar i armëve biologjike doli në skenë

³⁵ Mayor, 15.

³⁶ Guillemin, *Biological weapons*, vii.

³⁷ Mayor, *Biological Warfare*, 16.

si një rend i ri kërcënimi, duke u dukur teknikisht më i arritshëm se sa armët bërthamore ose kimike”³⁸.

Rrethanat e kohës kushtëzonin udhëheqësit botërorë të lëviznin në mënyra të ndryshme për krijimin e armëve biologjike që pas Protokollit të Gjenevës, të vitit 1925. Franca dhe Japonia, në vitet e LIB ishin në pozicione të ndryshme; në LIIB shkencëtarët amerikanë e ata britanikë u rekrutuan për të fituar një luftë të rëndësishme; Lufta e Ftohtë solli programet e avancuara shkencore biologjike të integruara në projekte ushtarake amerikane, sovjetike etj., dhe lufta biologjike u bë një realitet sekret i frikshëm. Armët nukleare e tmerronin botën me atë që dihej, ndërsa ato biologjike i tmerronin shkencëtarët me pasoja të cilat ishin të pamendueshme, në një rast konflikti botëror.

Po përse nuk u arrit që armët biologjike të fitonin pozicionin e armëve moderne? Patogjenet ishin prodhuar, municionet ishin të ngarkuara në raketa etj., testimet ishin bërë, planet e sulmit ekzistonin. Por ushtarakët dhe politikanët kurrë nuk e shkelën vijën për të kryer sulme strategjike me armë të tilla, edhe kur ata mund ta kishin bërë. Pyetjes se “përse nuk u përdorën asnjëherë armët biologjike” në periudhën e Luftës së Ftohtë, mund t’i gjeshe disa arsye. Dështimi dhe tmerri i parë nga përdorimi i armëve kimike është përgjigja. Së pari, përdorimi i armëve biologjike kundërshtohet me forcë nga i gjithë opinioni publik; së dyti, kufizimet ligjore ndërkombëtare; së treti, problemet teknike: mbrojtja e armikut, përdorimi i maskave, etj.³⁹

Pas 11 shtatorit, dhe pas përdorimit të antraksit përmes letrave, SHBA-ja riorganizoi mbrojtjen civile dhe zgjeroi mbështetjen për mbrojtjen e atdheut (“homelande security”). “Një nga direktivat më të rëndësishme për sigurinë e atdheut, ishte përdorimi i teknologjisë që vinte nga kërkimet shkencore mjekësore, për të mbrojtur civilët kundër bioterrorizmit”⁴⁰. Në të njëjtën kohë që u ndërmorën nismat për biombrojtjen, u kuptua se biologjinë moderne nuk mund ta kontrollonte asnjë shtet vetëm për vete. Transferimi botëror i bioteknologjisë është i pashmangshëm. Në vitin 1991 diskutimet e zhvilluara nga Nënkomiteti i Teknologjisë (*Subcommittee on Technology and Competitiveness of the Committee on Science, Space, and Technology*) në Kongresin e SHBA-së, theksohej pikërisht transferimi, shpërthimi në rritje dhe ndikimi i jashtëzakonshëm që do të kishte në të ardhmen e afërt bioteknologjia. Mijëra patenta po regjistroheshin; një lum fondesh dhe një interes gjithnjë e në rritje si për përfitime e përdorimin e saj në tregti të ndryshme, edhe për botën akademike e të kërkimeve laboratorike⁴¹.

4.1 Armët biologjike dhe lufta biologjike

Armët biologjike mbetën të papërdorura në kohët moderne, me përjashtim të dy rasteve. Japonia, edhe pse e kishte firmosur Protokollin e Gjenevës, zhvilloi një program armësh biologjike në Mançuri, nga viti 1934 në vitin 1945. Ushtria e saj ishte unike për sa i përket shpërndarjes së epidemive. Ushtria Imperiale e Japonisë, u shkaktoi mjaft vuajtje kinezëve dhe sovjetikëve: sëmundje epidemike të shpërndara, sabotime me armë biologjike, infektive uji e ushqimesh etj. Ky ishte përjashtimi i parë. Rasti i

³⁸ Guillemin, *Biological weapons*, vii.

³⁹ Guillemin, ix.

⁴⁰ Guillemin, x.

⁴¹ United States Congress House, *Biotechnology and Technology Transfer: Hearing Before the Subcommittee on Technology and Competitiveness of the Committee on Science, Space, and Technology*, U.S. House of Representatives, One Hundred Second Congress, First Session, May 6, 1991, Volume 4 (Washington: U.S. Government Printing Office, 1991), 32

dytë, i cili është dhe më i vështirë që të dokumentohet, ishte përdorimi i agjentëve biologjikë operacione të fshehta speciale. Përpyekja e gjermanëve në LIB për të infektuar tufa kafshësh me antraks dhe sëmundjen e kërrnjotës, e cila është një lëngatë e kafshëve shtëpiake, sidomos e kuajve dhe qenve; atyre u qelbëzohen grykët, u rrjedhin e u zihen hundët. Ndoshta ky është shembulli më i saktë i regjistruar i këtij lloji sabotimi⁴².

Përdorimi i armëve biologjike ka pasur joshje. Ai është luhatur, mes përparësive dhe mangësive, që ofronte për përdoruesit. Programet e përparuara shtetërore të armëve biologjike nuk e kanë ulur asnjëherë ritmin e kërkimeve. Krahas armëve që mund të shpërndanin epidemi, të cilat do zhbënin faktorin njerëzor në mënyrë masive të armiku, kishte edhe nga ata agjentë biologjikë që nuk ishin vdekjeprurës. Ishin “të mirë” dhe të frytshëm.

Gjatë viteve 1950, Shtetet e Bashkuara, përveç punës për armë biologjike shumë vdekjeprurëse, krijuan edhe një rezervë të madhe bombash që përmbanin patogjenin e sëmundjes së brucelozës, një agjent biologjik që tash ishte eksploruar mirë. Bruceloza shkakton ethe, djersitje të mëdha, shumë dhimbje koke e paaftësi, si dhe dhimbje shpine; zakonisht zgjat me javë ose më gjatë, dhe ka një normë fataliteti të vlerësuar në shpërthime natyrore prej rreth dy për qind. Ky vlerësim do të thoshte, se në një qytet të madh do të vdisnin dhjetëra mijëra, në mënyrë që arma të ishte vërtet vdekjeprurëse me efektin e saj⁴³.

Kohët e fundit, përdorimi i njohur, i mundshëm, i “Brucella”-s si një bioarmë së bashku me shqetësimin në rritje mbi bioterrorizmin, ka çuar në klasifikimin e saj [brucelozës] nga Qendrat e Shteteve të Bashkuara për Kontrollin e Sëmundjeve (*United States Centers for Disease Control*) si një agjent i kërcënimit biologjik i “Kategorisë B”⁴⁴.

Qëllimi i mbrojtjes së një kombi të tërë kundër luftës së mundshme të mikrobeve u shfaq më fuqimisht në vitet 1990, kur Shtetet e Bashkuara, Izraeli, Japonia dhe shtete të tjera filluan të reagojnë ndaj kërcënimit të perceptuar të bioterrorizmit. Në këtë pikë, si pasojë e programeve kryesore shtetërore, sistemi për sulmet e parashikuara ndaj civilëve, ndryshoi rrënjësisht. Ai që qëndroi pa ndryshuar, ishte ndikimi, relativisht i ngadaltë, i sëmundjeve infektive, gjë që lejon planifikimin dhe reagimin e shëndetit publik⁴⁵.

Franklin Roosevelt, ishte i mendimit se si armët kimike ashtu dhe ato biologjike ishin barbare dhe nuk duheshin përdorur kurrë. Akoma më i çuditshëm fakti se edhe Hitleri ishte kundër përdorimit të armëve biologjike e kimike. Më 1969, presidenti Nixon hoqi dorë nga armët biologjike duke këputur lidhjen ndërmjet ushtrisë dhe përparimit amerikan e Perëndimor drejt bioteknologjisë. Por, pas viteve 1990 presidenti Clinton pati një tjetër vizion për bioterrorizmin. Ai drejtoi iniciativën për të rritur gatishmërinë e brendshme dhe për të shtuar aktivitetin e inteligjencës me qëllim që të dekurajoheshin sulme të tilla⁴⁶.

4.2 Programi francez i armëve biologjike

Rivaliteti franko-gjerman i viteve 1900, duket se nuk mbeti pa prekur edhe pjesën e armëve biologjike. Frika e dyanshme nga një luftë e mundshme, zgjerohej edhe te

⁴² Guillemin, *Biological weapons*, 5.

⁴³ Guillemin, 7.

⁴⁴ David L. Hoover et al. “Development of New Brucella Vaccines by Molecular Methods”, në *Brucella: Molecular & Cell Biol.*, red. Ignacio Lopez-Goni, Ignacio Moriyon (Taylor & Francis, 2005), 369.

⁴⁵ Guillemin, *Biological weapons*, 8.

⁴⁶ Guillemin, 9.

frika e përdorimit të armëve biologjike, të cilat ishin në fillimet e tyre. Më 1919, pas një kërkesë të qeverisë franceze, Auguste Trillat, drejtori i Laboratorit të Kërkimit Kimik të Forcave Detare, kreu kontrollin e një fabrike farmaceutike gjermane, si pjesë e mbikëqyrjes së vendosur nga kushtet e *Traktatit të Versajës* dhe Komisioni i Kontrollit i Aleatëve. Nga këqyrja e fabrikës, drejtori francez i laboratorëve bakteriologjikë me sa duket krijoi besimin se kërkimi gjerman për armët biologjike, vazhdonte. Francezët ishin të vetëdijshëm se gjermanët kishin përdorur në fushata të luftës, antraks kundër bagëtive; madje edhe vetë francezët kishin kryer sabotime të tilla me agjentë të fshehtë.

Raporti i Trillat për qeverinë franceze ndezi alarmin. Nga ana tjetër, edhe gjermanët kishin frikën e tyre, që ushqejej nga zërat e përhapur për bombat bakteriologjike sovjetike. Megjithatë ekspertët e tyre ushtarakë ishin skeptikë në lidhje me luftën biologjike, duke këshilluar se ajo mund të kthehej në të kundërt, duke dëmtuar atë që sulmonte. Në vend të armëve biologjike, ata u përqendruan më tepër te kimike. Mirëpo e kundërta ndodhi me francezët. Ata nuk e nënvlerësuan luftën biologjike dhe përdorimin e armëve të tilla. Në vitin 1921 Ministria Franceze e Luftës arriti në përfundimin se Franca duhet të fillonte një program të armëve biologjike. Për të udhëhequr programin, ushtria iu drejtua Trillat-it. Ai tashmë kishte kryer disa eksperimente që kishin të bënin me transmetimin e baktereve në ajër. Me shumë gjasa, Trillat ishte shkencëtari i parë qeveritar që llogariti vlerën e mundshme ushtarake të armëve biologjike dhe që luajti një rol në vënien në zbatim të tyre⁴⁷.

Ai mbrojti idenë për kërkime mbi antraksin, brucelozën, kolerën, dizenterinë, murtajën dhe tifon si armë të mundshme. I shihte armët biologjike si të vlefshme për të goditur prapavijën e armikut. Studio edhe mënyrat e shpërhapjes së tyre nga ajri dhe dëmet që mund të shkaktonin mbi popullsi, kafshë e të mbjella. Trashëgimia e Pasterit i dha Francës një shtysë të fortë lidhur me institutet e kërkimeve biologjike. Këta të fundit së bashku me universitetet dhe shkollat mjekësore, kontribuan te kërkimet për armët biologjike. Askush nuk e di se sa larg shkuan këto kërkime në Francë. Në vitet 1927-1934, përpjekjet për armë biologjike duket se shuhen, por kjo periudhë përkon më *Protokollin e Gjenevës*. Shkencëtarët francezë e ndiqnin me ankth zhvillimin kërkimor në Gjermani. Ata informoheshin mbi literaturën e shkencëtarëve gjermanë. Një burim gjerman, që ata citonin, thoshte, se “fitimtar do të jetë ai komb që do të dijë se si të gjejë bakterin/*bacillus* më të helmët dhe vaksinën më efikase për të mbrojtur veten kundrejt tij”⁴⁸.

Kërkimi francez për armë biologjike, në vitet 1935-1940 ishte shumë më aktiv se sa në Mbretërinë e Bashkuar, në SHBA, në Gjermani apo në ndonjë fuqi tjetër Perëndimore. Kur trupat gjermane përparuan në 1940, i gjithë dokumentacioni francez për armët biologjike avulloi dhe nuk u gjet asnjë provë. Në dekadat më pas këto programe do të vijonin ekzistencën e tyre sekrete. Idetë dhe mënyrat e zbatimit të Trillat, për shpërndarje virusesh e bakteresh nga ajri, retë “e infektuara”, përdorimi aviacionit, sulmet në prapavijë, mbrojtja me maska, përdorim kundërmasash, vaksinim etj., me kalimin e kohës u bënë realitet shkencor.

4.3 Programi britanik i armëve biologjike

Pavarësisht se nga britanikët, gjermanët dhe amerikanët, fillimisht kishte skepticizëm

⁴⁷ Guillemin, 25.

⁴⁸ Dupérieré, “La guerre bactérienne,” Rochemaix, “Epidémies provoquées,” në Guillemin, *Biological weapons*, 26.

lidhur me armët biologjike, me kalimin e kohës ky skepticizëm u zëvendësua me programe kërkimi. Frika se gjermanët mund të përdornin për sabotime me agjentë armë biologjike siç kishin bërë në LIB me infektimin e kafshëve u rikthye më e fortë, në vitin 1940. Programi britanik pati një përshkallëzim rritës për shkak të tmerrit që kishin ata ndaj një sulmi të mundshëm gjerman. Këto kërcënime biologjike u dhanë udhë programeve për armë biologjike britanike. Sipas disa dokumenteve sekrete, te të cilat mbështetej gazetari britanik, Henry Wickham Steed⁴⁹, Gjermania kishte kryer hetime lidhur me ndikimin që do të kishte një sulm ajror me armë kimike dhe biologjike në Londër e Paris. Sipas këtyre dokumenteve ishin kryer vëzhgime edhe për shpërndarjen e baktereve dhe patogjeneve përmes metrove e ajrit. Kërcënimi gjerman shërbeu si një justifikim i mirë për zhvillimin e kapaciteteve të armëve biologjike në Britani.

Këto programe zhvilloheshin në sekret të thellë pas 1944-s. Maurice Hankey, një sekretar i Kabinetit britanik, i 1939-s, për vite të tëra u cilësua nga media si armik i programeve të armëve biologjike. Por e vërteta ishte ndryshe. "Sikur të mos kishte qenë për Hankey-n, britanikët nuk do të kishin ndërmarrë masat e duhura kundër luftës biologjikë (fuqizimi i shëndetit publik ndërsa për ushtarakët: vaksina, maska fytyre, ilaçe)⁵⁰.

Hankey njihet si babai themelues, i programit të shkencëtarëve të armëve biologjike. Ai kishte rol qendror dhe të fshehtë në këtë drejtim. Kjo gjë dëshmohej nga dokumentacioni i deklasifikuar kohët e fundit. Ai bashkëpunoi ngushtë me Ministrinë e Luftës Ekonomike e cila kishte krijuar një agjenci klandestine (*Special Operations Executive*) që kryente sabotime; kjo e fundit, më vonë u bë myshteri te programi i armëve biologjike⁵¹.

Hankey u bë më 1936 kreu i Nënkomitetit për Luftën Bakteriologjike (*Subcommittee on Bacteriological Warfare*). Ndërkohë ai kishte rekrutuar shkencëtarët më të mirë të Britanisë, si Mellanby, Ledingham, Topley e të tjerë me nam. Detyra e tyre ishte përgatitja e mbrojtjes së vendit nga sulmet biologjike dhe rritja e kapaciteteve me armë biologjike për kundërpërgjigje⁵². Institute shkencore, laboratorë mjekësorë, të shëndetit publik, qendra emergjencash etj., ishin vendosur në rrjet për të qenë të gatshëm ndaj një lufte të tillë. Raporte, studime e diskutime të ndryshme, trajtonin që nga shpërndarja prej avionëve e agjentëve infektues e deri të kundërmasat në raste sulmesh. Në fund, aty nga viti 1939, Sër Edward Mellanby, pjesë e këtyre programeve dhe sekretar i Këshillit të Studimeve Mjekësore (*Medical Research Council*), i kërkoi Hankey-t që të merrte leje nga kryeministri Chamberlain që të fillonin një varg eksperimentesh me spërkatje nga avionët (*aerosol*), në Institutin Kombëtar të Studimeve Mjekësore (*National Institute for Medical Research*). Kryeministri pranoi, meqenëse Hankey deklaroi se këto eksperimente do të ishin për mbrojtje dhe jo për sulm. Por, nuk u raportua kurrë në mënyrë të plotë e të qartë se ç'karakter kishin ato. Kërkesa që bëri Mellanby shënon një hap fillestar drejt eksplorimit tërësor të fuqisë së antraksit dhe agjentëve të armëve të tjera biologjike⁵³.

Me kalimin e kohës pati një zhvillim të shkencës ushtarake britanike që lidhej me kërkimin e armëve biologjike. Kjo u bë në heshtje dhe pa zhurmë.

⁴⁹ Brian Balmer, *Britain and Biological Warfare: Expert Advice and Science Policy, 1930-65* (Palgrave, 2001), 15.

⁵⁰ Guillemin, *Biological weapons*, 43.

⁵¹ Guillemin, 44.

⁵² Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 29-53.

⁵³ Guillemin, *Biological weapons*, 46.

4.3.1 Kanadaja dhe bashkëpunimi me Britaninë për programin e armëve biologjike

Një nga emrat më të njohur të fillimeve të programeve të armëve biologjike, është kanadezi Frederick Banting, asokohe, kreu i qendrës shkencore së Universitetit të Torontos. Së bashku me John James Macleod, më 1932 ai fitoi Çmimin Nobel për zbulimin e insulinës. Ishte një pionier dhe vizionar i kërkimeve mbi armët biologjike. Në LIB kishte parë tmerrin e përdorimit të armëve kimike nga gjermanët dhe se sa të papërgatitur ishin aleatët. Besonte se në të ardhmen lufta biologjike do të fitonte përparësi. Ai përfytyronte një të ardhme ku avionët shpërndanin nga lartësi të mëdha baktere të ndryshme si pjesë e luftës bakteriologjike. Ai mbështeste pa rezerva dhe në mënyrë entuziaste programin britanik të viteve '30-40 të armëve biologjike; mendonte se duhet të kishin epërsi ndaj gjermanëve⁵⁴.

Në vitin 1939, Banting ishte futur në ushtri duke u mobilizuar për luftën kundër Gjermanisë dhe mbante gradën major. Në këtë kohë, bashkë me kolegun e tij, toksikologun Israel Rabinowitch, ai vizitoi në Britani bazën e Porton Down, në Wiltshire, aty ku zhvilloheshin programet për luftën kimike e biologjike⁵⁵. U sugjerua që fushat e Suffield-it të Albertas, në Kanada, me sipërfaqe rreth 1000 milje katrore të përdoreshin për testet me armë kimike e biologjike. Kjo, u bë më pas, një qendër e këtyre testeve.

Banting besonte se lufta mes kombeve do të ndryshonte në të ardhmen, dhe për këtë arsye, lufta biologjike do të vlerësohej më shumë. Përgatiti një memorandum mbi mënyrën e organizimit dhe një strukturim të mundshëm të luftës biologjike të cilin e paraqiti te britanikët. Ky organizim do të kishte tre funksione: *së pari*, ishte mbledhja dhe njohja e gjithë patogjenëve që mund të përdoreshin si agjentë armësh biologjike; *së dyti*, ishte kërkimi dhe krijimi i armëve (plumba e bomba të infektuara, krijim "pluhuri bakteriologjik" që do të shpërndahej nga avionët; madje Banting parashikoi edhe krijimin e prodhimit të baktereve në fabrika); *së treti*, programi propozonte ndërtimin e një "Komiteti vigjilence", i cili do të ishte një lloj dege e inteligjencës, dhe do të gjurmonte çdo aktivitet të dyshimtë dhe spiunazhi, të tilla, si shitblerjet e pajisjeve të makinerive laboratorike për prodhim patogjenesh (ky komitet do të shërbente edhe për të paralajmëruar edhe publikun me mënyra të ndryshme për rreziqet, duke siguruar maska hunde etj., në raste shpërndarjeje sëmundjesh). Banting që në atë kohë paralajmëronte për shpërndarjen e baktereve me anë të zarfeve, gjë që u bë realitet më 2001 në SHBA⁵⁶.

Ai e përfundonte memorandum⁵⁷ e tij drejtuar britanikëve, duke ofruar hapësirat e gjera kanadeze për testime dhe bakteriologët ekspertë kanadezë, përmes Departamentit të Mbrojtjes Kombëtare të Kanadasë (*Department of National Defence*). Banting pësoi zhgënjim nga qasja britanike (sidomos e Hankey-t) për bashkëpunim dhe më 1940 ai u largua drejt Kanadasë i bindur se memorandum i tij ishte refuzuar. Por, Hankey menjëherë pas largimit të tij, dha udhëzime që të ndiqeshin këshillat e shkencëtarit kanadez. Pas diskutimesh të ndryshme mbi rëndësinë e armëve biologjike (pas ardhjes së Churchill-it në fuqi, i cili kishte disa mosmarrëveshje me Hankey-n), më

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁵⁴ Guillemin, 45-46.

⁵⁵ Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 36

⁵⁶ Guillemin, *Biological weapons*, 48-49.

⁵⁷ Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 32.

18 gusht 1940, ministri i Rezervave, Herbert Morrisoni, urdhëroi krijimin e Departamentit të Biologjisë në bazën Porton. Synimi ishte kërkimi shkencor dhe krijimi i armëve biologjike. U rekrutua edhe bakteriologu Paul Fildes, një shkencëtar i njohur britanik, me qëllim rritjen e kapaciteteve të armëve mësymëse biologjike. Programi i kërkimit për këto armë, më 1942 ishte i sekretit më të lartë. Nën udhëheqjen e Fildes-it u testuan dhe u hulumtuan përdorime të ndryshme të antraksit nga avionët: spërkatje apo bomba⁵⁸.

Këto zhvillime Churchill i mbështeste. Për më tepër, ai kishte shkruar për to qysh kohë më parë nga LIIB:

“Kisha shkruar qysh më herët, në vitin 1925, disa mendime dhe pyetje të një karakteri teknik, të cilat do të ishte gabim po të shmangeshin ditët e sotme: A nuk mund të ketë metoda të përdorimit të energjisë shpërthyes në mënyrë të tillë intensive, të pakrahasueshme me çdo gjë të zbuluar deri më tani? A nuk mund të gjendet që një bombë, jo më e madhe se sa një portokall, që të zotërojë një fuqi të fshehtë për shkatërrimin e një blloku të tërë ndërtesash - madje, të përqendrohet forca e një mijë tonëve eksploziv dhe të hidhet në erë një qytezë me një goditje? A nuk mundet që eksplozivët, madje edhe të llojit ekzistues, të drejtohen automatikisht me makineri fluturuese, përmes valëve apo rrezeve të tjera, pa njeri pilot, në një vargan të pandërprerë, mbi një qytet, arsenal, fushime ose kantiere të armikut? . . . Studimi i sëmundjeve, i murtajës së përgatitur në mënyrë metodike dhe të hedhur qëllimisht mbi njerëz e kafshë, sigurisht që po studiohet në laboratorët e më shumë se sa një vendi të vetëm, të madh. Vrugë për të shkatërruar të korrat, antraksi për të vrarë kuajt dhe bagëtitë, murtaja për të helmuar jo vetëm ushtritë, por rajone e tëra: të tilla janë linjat përgjatë së cilave shkenca ushtarake po përparon, pa pendim”⁵⁹.

Banting, pas kthimit në Kanada, përparoi me programin e tij për armët biologjike. Ai u bë krijuesi i programit kanadez dhe ndikuesi i tërthortë i programeve britanike dhe amerikane për armët biologjike. Ishin vitet 1940 dhe kërcënimi gjerman kishte bërë të mundur që të çliroheshin të gjitha programet e mundshme që kishin të bënin me sigurinë dhe me armët. Programet e armëve biologjike ishin në ngritje. Interesi lidhur me to ishte në rritje. Zyrtarët e lartë britanikë i mbështetën këto kërkime. Sekret i lidhur me këto kërkime ishte shumë i lartë. Në këtë drejtim po punonin shkencëtarët më në zë të vendit, të cilët u futën në shërbim të këtyre programeve shtetërore të luftës biologjike. Kanadaja, nga ana tjetër, ishte një aleat i cili po ashtu po ndërtonte programe të kërkimit mbi armët biologjike.

4.3.2 Armët biologjike dhe fillimi i financimeve të mëdha për to

Me rënien e Francës, tre industrialistë të mëdhenj të Kanadasë hodhën miliona dollarë për hulumtime që kishin të bënin me luftën. Ata ishin: John David Eaton, themeluesi i *T. Eaton Company Limited*; sër Edward Beatty, presidenti i *Canadian Pacific Railway*; dhe Samuel Bronfman, kreu i *Seagrams*. Ata kontaktuan me tre shkencëtarë të njohur kanadezë për të zhvilluar programe lidhur me luftën dhe armët. Banting ishte njëri prej tyre. Dy të tjerët ishin, inxhinieri C. J. MacKenzie dhe kimisti i njohur Otto Maass, i përkushtuar ndaj prodhimit të armëve kimike. Këta ta gjashtë do

⁵⁸ Guillemin, *Biological weapons*, 52.

⁵⁹ Winston Churchill, *The Second World War: The gathering storm, Volume 1* (Michigan: Houghton Mifflin, 1948), 41.

të formonin një komitet shumë sekret me ekspertë të shkencës e të ushtrisë (*War Technical and Scientific Development Committee*). Banting, me laboratorin e tij dhe në bashkëpunim me laboratorin prestigjioz *Connaught Laboratory* filloi prodhimin e bioarmëve. I bindur për rëndësinë e tyre, ai mblodhi rreth vetes biologë e shkencëtarë të njohur për të punuar më një numër të madh patogjenesh. Në veri të Torontos ai kishte ndërtuar një vend të gjerë testimesh e eksperimentesh, të quajtur “Ferma” (*The Farm*). Shumë shpejt arritën sukses në eksperimentet e shpërndarjes së bakterit të tifos me hedhje nga avionët. Programi i armëve biologjike që drejtonte Banting pati mbështetjen e kryeministrit kanadez, MacKenzie King; atij iu lejua nga Ministria e Mbrojtjes (*Department of National Defence*) prodhimi në masë i baktereve. Plani i tij ishte që të prodhonte qindra tonelata me organizma virusal që do përdorehin si armë biologjike. Ky prodhim fabrike nuk u krye në Kanadanë e luftës, por vizioni i tij për prodhimin industrial ushqe programin amerikan e të tjerë, të luftës biologjike⁶⁰.

“Kryeministri MacKenzie King e shihte Banting si një tjetër Marconi, – e për më tepër, si një kanadez që kishte dhënë kontributin e tij për të mirën e njerëzimit. Sigurisht që Kanadaja duhet ta nderonte atë”⁶¹. Reputacioni i lartë që kishte Banting u shpreh me mbështetje dhe besim.

Kryeministri kanadez e prezantoi punën sekrete të Banting-ut te Vannevar Bush, presidenti *Carnegie Institute* dhe themeluesi i Komitetit Kërkimor të Mbrojtjes Kombëtare (*National Defense Research Committee*), i cili ishte edhe këshilltar i presidentit amerikan, Franklin Roosevelt. Në dallim nga britanikët, shkencëtarët amerikanë dhe ata kanadezë patën që në fillim një bashkëpunim të gjerë në fushën e armëve biologjike. Në 21 shkurt të vitit 1941, Banting vdes në një aksident ajror; ishte drejtuar për në bazën britanike Porton Down, ku hulumtoheshin bioarmët. Vetëm pak ditë më pas, Paul Fildes, arriti sukses në eksperimentet e shpërndarjes së antraksit me spërkatje (*aerosol*) nga avioni duke e përdorur si armë biologjike⁶².

Në fund të luftës, drejtuesi i projektit të Departamentit të Biologjisë, në Britani, Paul Fields, si dhe disa shkencëtarë të tjera do t’u ktheheshin kërkimeve shkencore civile⁶³. Por ata u bënë përsëri, shpejt, pjesë e kërkimeve që kishin të bënin me luftën biologjike. Operacionet “Harness”, “Cauldron”, “Hesperus”, ishin tregues i qartë i kësaj⁶⁴.

4.4 Programi amerikan i armëve biologjike

Programi i armëve biologjike në SHBA filloi kryesisht pas LIIB edhe pse ata i hapën dyert për vizionin e Frederick Banting mbi armët biologjike dhe prodhimin masiv në fabrika, qysh para Luftës. Në verën e vitit 1942 Shërbimi i Armëve Kimike i SHBA-së (*US Chemical Warfare Service/CWS*) kishte kontakte me Paul Fildes dhe me ekspertët kanadezë, për të ndërtuar programin amerikan të luftës biologjike. Por, pavarësisht CWS-së, qeveria amerikane nuk tregoi interes për këtë program⁶⁵. Ky interes do të ndryshonte me kalimin e kohës dhe Fields do të bashkëpunonte me virusologë amerikanë në periudhën e operacioneve të pasluftës⁶⁶ (të cilët i përmendëm më sipër).

⁶⁰ Guillemin, *Biological weapons*, 52.

⁶¹ Michael Bliss, *Banting: A Biography* (University of Toronto Press, 1992), 121.

⁶² Guillemin, *Biological weapons*, 53.

⁶³ Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 74.

⁶⁴ Balmer, 104-116.

⁶⁵ Guillemin, *Biological weapons*, 58.

⁶⁶ Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 115-116.

Shkencëtarët civilë ishin kryesorët në planëzimin dhe diskutimet sekrete të programit amerikan të luftës biologjike. Rolin e tyre në kërkimet shkencore ushtarake e përcaktonte Komiteti Shkencor i Mbrojtjes Kombëtare (*National Defense Research Committee*).

Më 1941, Departamenti i Luftës organizoi një takim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit (*Office of Scientific Research and Development*), the zyrën e Gjeneralit Surgeon, CWS-në dhe Inteligjencën e Ushtrisë (*Army intelligence/G-2*). Ky grup rekomandoi kërkime të mëtejshme për programin e luftës biologjike. Sekretari i Luftës, Henry Stimson, i kërkon sakaq një raport, Frank Jewett, presidentit të Akademisë Kombëtare të Shkencave (*National Academy of Sciences*). Jewett pas këtyre zhvillimeve lidhet me biologun e Universitetit të Wisconsin-it, Edëin Fred, i cili ngriti Byronë e Këshilltarëve të Luftës (*War Bureau of Consultants*), e cila përbëhej nga dymbëdhjetë shkencëtarë. Një javë më pas Roosevelt-i pranoi gojarisht rekomandimet e këtij komiteti për të hulumtuar armët biologjike⁶⁷.

Në këtë mënyrë, kishte filluar programi amerikan i kërkimeve shkencore për armët dhe luftën biologjike. Më 1942 SHBA-ja hapi bazën Dugway Proving Ground, Utah, e cila kishte territore prej më shumë se një çerek milionë hektarësh; më vonë do të përdorej për testimet biologjike. Pavarësisht mbështetjes për këto armë, Roosevelt-i ishte parimisht kundër. Një tjetër njësi kërkimore shkencore ishte themeluar në Camp Detrick, Maryland kurse kërkimet në terren zhvilloheshin në Horn Island, Pascagoula, Mississippi dhe Dugway në Utah⁶⁸.

Bashkëpunimi i agjencive dhe programeve të luftës biologjike kanadeze, britanike dhe amerikane vijoi. Deri nga viti 1944 bazat sekrete kanadeze prodhonin e testonin më shumë armë biologjike se amerikanët. Në gusht të vitit 1944, programi amerikan ishte shumë më përpara për prodhim antraksi etj., përmes programit të luftës biologjike që tani drejtohej nga Ira Baldwin, një eksperte nga Universiteti i Wisconsin-it. Nga viti 1943 e më pas amerikanët patën një zgjerim të programit të armëve biologjike. Që nga fillimi i këtyre programeve, Kanadaja, SHBA-ja dhe Britania ruajtën sekret të thellë. Ata morën masa sigurie jo vetëm që të ruanin informacionin nga armiku, por edhe nga publiku i tyre dhe nga pjesa tjetër e forcave të armatosura⁶⁹. Dr Edwin B. Fred, po i Universitetit të Wisconsin-it, kishte organizuar një mbledhje me shkencëtarë biologë të cilët e kishin pranuar kërcënimin e lartë që vinte nga lufta biologjike dhe kishin formuluar edhe rekomandimet përkatëse. Përfundimet e tyre ishin marrë parasysh nga zyrtarët e lartë.⁷⁰

U bënë eksperimente me kafshë, bimë etj., për të parë efektet e armëve biologjike të ndryshme. U prodhuan bombat e *Tipit F*, të cilat mund të agjentë të lëngshëm biologjikë, d.m.th. një armë biologjike. Pas testimit të këtij tipi në *Camp Detrick*, u përpoqën që të krijonin një bombë tjetër biologjike që të kishte prodhim më të lehtë e më masiv. E quajtën bombë të tipit *SPD Mark I* dhe në maj 1944 u prodhuan pesëmijë të tilla. Por fabrika dhe baza më e madhe e prodhimit të armëve biologjike të kohës, ishte në Vigo County, Indiana, e themeluar më 1942⁷¹.

Bashkëpunimi me britanikët arriti majën kur Fields, projektoi se kjo fabrikë mund të prodhonte deri 500 000 bomba me armë biologjike në muaj. Për tetë muaj do

⁶⁷ Guillemin, *Biological weapons*, 59.

⁶⁸ Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 46.

⁶⁹ Guillemin, *Biological weapons*, 63.

⁷⁰ Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 46.

⁷¹ Guillemin, *Biological weapons*, 66.

prodhoheshin mbi katër milionë bomba të cilat do të hidheshin mbi Gjermani sipas një plani të detajuar, që prekte zonat urbane; Berlini ishte shënjestra më e madhe. “Operacioni Vegjetarian” i cili ishte planifikuar që të hidhte këto bomba me antraks përmes Forcave Ajrore Britanike, me qëllim që të shfaroste tërë bagëtitë e gjedhët në Gjermani, duke eliminuar furnizimin me mish e me qumësht të saj, nuk u realizua kurrë, sepse Gjermania u mund me armë konvencionale⁷².

Divizioni i Projekteve Speciale (*The Special Projects Division/SPD*) i vendosur në Camp Detrick, një bazë ajrore e papërdorur, ishte qendra e programit të kërkimit të armëve biologjike. SPD-ja vepronte në shkallën më të lartë të sekretit. Eprorët dhe oficerët e saj i përgjigjeshin drejtpërdrejt Washington-it. Në vitet ‘50, baza *Camp Detrick* në Maryland, mbetej akoma njësia më e madhe kërkimore dhe eksperimentuese në SHBA⁷³.

Projektet e SPD-së u shpërndanë nëpër universitete e qendra të kërkimit shkencor në SHBA; në dallim nga britanikët, amerikanët patën një program të madh me shkencëtarë të shumtë dhe personel të trajnuar gjerësisht, p.sh.: shkencëtarët e Harvardit, zhvilluan vaksinën kundër sëmundjeve të shpendëve dhe kundër toksinës *botulinum*; Instituti i Toksikologjisë i Universitetit të Çikagos punoi mbi spërkatjet (*aerosol*); Universiteti i Northwestern-it dhe ai i Kalifornisë në San Francisko, punuan mbi toksina e butakëve; Universiteti i Cincinnati-t dhe Universiteti i Kansasit, mbi tulareminë; Universiteti i Notre Dame mbi grupe bakteresh e virusesh si tifoja, sëmundje të etheve të njerëzit etj.; Shkolla e Mjekësisë e Universitetit të Stanfordit mbi patogenin *fungus Coccidioides*; Universiteti Shtetëror i Ohaios dhe Universiteti i Wisconsin-it, mbi kulturat masive të sporeve; Universiteti i Cornell-it zhvillonte një projekt mbi antraksin; Universiteti Shtetëror i Miçiganit, një projekt mbi brucelozën; Marina (The Navy), Departamenti i Agrikulturës, Instituti Kombëtar i Shëndetit dhe departamente të ndryshme të shëndetit publik, zhvillonin që të gjithë projekte laboratorike të lidhura me armët biologjike⁷⁴.

Të gjitha këto projekte dhe kërkime shkencore, që ishin pjesë e programit amerikan të luftës biologjike, zhvilloheshin në sekret të plotë dhe me organizim të detajuar shtetëror. Produktet dhe njohuritë e tyre shoqëroheshin më pas me strategjitë e luftës, të prodhimit të armatimit, bashkëpunimet me aleatët etj.

Pavarësisht se kishte informacion nga shkencëtari gjerman i arratisur, Helmuth Simons [Simons, i njohur edhe si Lehmann, ishte pjesë e një grupi gjermanësh që emigruan në Britani pas viteve 1932-1933; ishin të gjithë të skeduar nga MI5 dhe dosja e tij PF 42816, bashkë me ato të së tjerëve, akoma nuk është deklasifikuar⁷⁵], se Gjermania kishte zhvilluar armë biologjike me toksinën *botulinum*, sipas agjencive të inteligjencës ishte konsideruar si informacion i pabesueshëm. Amerikanët kishin informacion të vërtetuar nga *Ultra*, programi i përgjimeve të bisedave gjermane, se nazistët jo vetëm që nuk kishin armë biologjike por trembeshin se mos provokonin padashur përdorimin e këtyre armëve kundër tyre⁷⁶.

Ishin përgatitur edhe vaksinat për trupat që do të luftonin; Kanadaja prodhoi 25 000 vaksina kundër toksinës botilinium, ndërsa SHBA prodhoi mbi një milionë dosa,

⁷² Guillemin, 69-70.

⁷³ Balmer, *Britain and Biological Warfare*, 106.

⁷⁴ Guillemin, *Biological weapons*, 70.

⁷⁵ Anthony Grenville, Andrea Reiter, *Political Exile and Exile Politics in Britain after 1933* (BRILL, 2011), 190, 203.

⁷⁶ Guillemin, *Biological weapons*, 71.

për t'i përdorur për 300 000 trupa nëse do të ishte e nevojshme⁷⁷. Por, kur u zhvillua *D-Day*, as armët biologjike të planifikuara nga programet e Aleatëve, nuk u përdorën e as vaksinat nuk hynë në punë. Ndërkohë kishin marrë jetë ngado programet shumë sekrete të armëve dhe luftës biologjike, të cilat janë aktive edhe ditët e sotme.

4.5 Programi japonez i armëve biologjike

Në vitin 1942 Kina deklaronte për Aleatët se Japonia e kishte sulmuar duke përdorur pleshta të infektuar me murtajë, të cilët i shkaktuan vdekje të konsiderueshme. Pas LIIB, amerikanët dërguan shkencëtarë të tyre që të hulumtonin kapacitetet e teknologjisë së armëve që kishte Japonia. As armët kimike e as ato atomike nuk paraqitën interes për raportin e hetuesve drejtuar presidentit Harry Truman; për armët biologjike, shkruhej se njohuritë mbi to u duheshin shtuar atyre të programit ushtarak amerikan. Programi japonez i luftës biologjike kishte zhvilluar vakcina apo kura për murtajën, tifon, dizenterinë dhe shumë sëmundje të tjera si dhe serume diagnostifikues, antigjene dhe ilaçe, përfshirë këtu edhe penicilinën. Pas LIIB amerikanët bënë një ujdë me shkencëtarët japonezë, gjë që i ripozicionoi amerikanët në programin shumë sekret të armëve biologjike gjatë Luftës së Ftohtë, bazuar edhe në doktrinën e luftës totale të epokës bërthamore⁷⁸.

Në vitin 1947 G-2 (Inteligjenca Ushtarake e SHBA-së) ftoi dr. Norbert Fell, të bazës Camp Detrick (aty ku zhvilloheshin testime të armëve biologjike) që të vlerësonte, jo nëse ishin kryer krime lufte me armë biologjike, por nëse shkencëtarët japonezë zotëronin informacione që mund t'u vlenin interesave kombëtare amerikane. Gjenerali japonez, Ishii Shiro (1892–1959), krijuesi i programit japonez të luftës biologjike ishte pikasur në Tokio. Mendohej se kishte me vete dokumentacion të fshehur. Që në vitin 1945, Zyra e Shërbimeve Strategjike (*Office of Strategic Services/OSS*), pararendësja e CIA-s, kishte arritur në përfundimin se Japonia “kishte ndoshta, shkencëtarët më të informuar, mes vendeve të gjithë botës, për armët biologjike”. Në vitin 1937 Shefat e Shtabit të Bashkuar të ushtrisë së SHBA-së rekomandonin sekretin më të thellë për këto operacione inteligjence. Kishte zëra që programi sekret japonez për armët biologjike të kishte kryer eksperimente me njerëz. Por, programi i Ishii-t ishte zhvilluar nën mbështetjen e perandorit. Po të gjykohej ky program për krime lufte, si puna e kampeve naziste, figura hyjnore e perandorit japonez do të rrënohej e bashkë me të do të zhytej në kaos e tërë shoqëria. Gjenerali amerikan Douglas MacArthur dhe qeveria e SHBA-së e ruajtën atë nga kjo gjë. Duhej ruajtur sekreti mbi programin japonez të luftës biologjike si për perandorin edhe për interesat kombëtare amerikane; nëse bëheshin të ditura eksperimentet etj., njohuritë e arritura nga Ishii dhe shkencëtarët japonezë do të digjeshin⁷⁹.

Norbert Fell dhe kolegët e tjerë që iu bashkuan atij në Japoni, kryen hetime mbi programin japonez. Fell-i intervistoi gjeneralin Ishii lidhur me programin e armëve biologjike dhe vizionin e tij. Mbi 600 faqe të printuara shpjegojnë teknikat e sabotimit, spiunimit dhe përdorimit të armëve biologjike si dhe 100 faqe me arritje që shpjegojnë fazat e luftës biologjike dhe të luftës kimike; informacioni ishte i një rëndësie të madhe për interesat amerikane⁸⁰. Arritjet e japonezëve ishin të avancuara. Të dhënat e

⁷⁷ Eric Croddy, C. Perez-Armendariz, J. Hart, *Chemical and Biological Warfare: A Comprehensive Survey for the Concerned Citizen* (Springer Science & Business Media, 2002), 259.

⁷⁸ Guillemin, 76.

⁷⁹ Guillemin, 78.

eksperimenteve japoneze me njerëzit për efektet mbi antraksin u ofruan amerikanëve informacione që nuk do i kishin pasur ndonjëherë në laboratorët e tyre. G-2 dhe personeli i shkencëtarëve ushtarakë amerikanë, vendosën që çdo informacion mbi programin japonez të armëve biologjike të ruhej në sekret dhe të mos dilte në publik; kjo u konsiderua një çështje me rëndësi kritike për sigurinë kombëtare amerikane. U bë një marrëveshje mes shkencëtarëve japonezë dhe amerikanëve. I gjithë informacioni i mbledhur nga amerikanët do të qëndronte në kanalet e inteligjencës dhe nuk do të kishte gjykim për krime lufte. Si rrjedhim nuk u bë publik asnjë krim lufte i kryer nga shkencëtarët japonezë të programit të armëve biologjike e asnjë gjyq lidhur me to. Mirëpo një duzinë shkencëtarësh ushtarakë japonezë që ishin marrë me këtë program ranë në duart e sovjetëve. Në gjyqin e zhvilluar ndaj tyre në Kharbarovsk, ata dëshmuan për eksperimentet ndaj njerëzve, të cilat britanikët dhe amerikanët i njihnin. Këta të fundit i konsideruan dëshmitë e tyre propagandë sovjetike. Nisur nga dënimet e lehta që morën këta shkencëtarë, u kuptua se ata kishin bërë marrëveshje me sovjetët. Sipas informacioneve BRSS-ja kishte një program të zhvilluar për armët biologjike, që nga viti 1930⁸¹.

Japonia ishte vendi me programin më të përparuar të armëve biologjike, në botë, për kohën. Kjo u arrit përmes përpjekjeve dhe vizionit të gjeneralit Ishii. Ai udhëtoi nëpër botë me vite, që pas Protokollit të Gjenevës (1925), duke vizituar laboratorët shkencorë në Gjermani, Francë, Britani, Bashkimin Sovjetik e SHBA. Qëllimi i tij ishte që të fitonte sa më shumë njohuri mbi të rejat e fundit në biologji, në Perëndim. Ai iu bashkua ushtrisë dhe kur shpалosi idenë e tij lidhur me programin e armëve biologjike, në vitet '30, u mbështet nga nivelet më të larta ushtarake. Programin e ndau në dy kategori të sekretit më të lartë: kategoria "A", që ishin armët e sulmit, dhe kategoria "B" që ishin armët mbrojtëse. Njësitë kryesore të programit japonez të luftës biologjike ishin *Reparti 731* dhe *Reparti 100*. Repartet dhe njësitë e tjera akademike ishin satelitë të tyre. Programi u shtri duke përfshirë edhe institucionet akademike japoneze, mjekë e shkencëtarë të rinj që kishin ide.

Por, ka shumë faqe të errëta pas këtyre arritjeve. Kërkimet japoneze mbi armët biologjike janë bërë duke eksperimentuar edhe mbi qenie njerëzore: "Është e qartë se eksperimentimi mbi njerëzit ishte i lig. Sidoqoftë, është e qartë gjithashtu, se shumë mjekë të ndërgjegjshëm dhe mendimtarë ishin gjithashtu ishin pjesë e "Repartit 731" dhe e aktiviteteve të ngjashme. Këta janë njerëz që nuk do të vrisnin kurrë një qenie tjetër njerëzore në kontekstin normal shoqëror. Ata janë lloji i njerëzve që do të shqetësoheshin shumë nëse thjesht sa do të plagosnin një tjetër person gjatë një aksidenti automobilistik (Tsuneishi dhe Asano, *Bacterial Warfare Unit and Suicide of two Physicians*, f. 4)"⁸².

4.6 Programi rus i armëve biologjike

Bashkimi Sovjetik ka pasur programin më të sofistikuar e më të gjerë të armëve biologjike në botë. Historia e tij është shumë e panjohur, por ka edhe shumë informacione që kanë qarkulluar, falë edhe personave të rëndësishëm që kanë dezertuar vazhdimisht e që kanë dhënë informacione të bollshme rreth këtij programi. Ai e ka zanafillën aty

⁸⁰ Sheldon H. Harris, *Factories of Death: Japanese Biological Warfare, 1932-45, and the American Cover-up* (Routledge, 2002), 202.

⁸¹ Guillemin, 80.

⁸² Harris, *Factories of Death*, 31.

nga viti 1920.

Origjina e programit sovjetik ushtarak për armët biologjike lidhet ngushtë me Yakov Moiseevich Fishman. Në gusht të vitit 1925, kur ishte 35 vjeç, ai u bë kreu i Drejtorisë Kimiko-Ushtarake (*Voенно-химическое управление*, shkurt e njohur si *VOKhIMU*). Filloi kështu organizimi dhe puna për krijimin e armëve biologjike për BRSS. Fishman ishte arkitekti i programit të mbrojtjes së luftës biologjike⁸³.

Organizimi i mikrobiologjisë bakteriologjike sovjetike filloi të bëhej duke mbledhur njerëzit më të talentuar. Ishte kjo koha kur u angazhua edhe Ivan Mikhailovich Velikanov, një ekspert i toksinës *butilinum*, i cili u ngrit si një shkencëtar i shquar në karrierë, në programin e hershëm sovjetik të armëve biologjike.

Fishman ishte drejtori i parë i IKhO-së, Instituti i Mbrojtjes Kimike i Ushtrisë së Kuqe (*Institut khimicheskoi oborony imeni Osoaviakhima RKKA ose IKhO*), i krijuar në 7 prill 1928, në varësi të VOKhIMU-t. Laboratori bakteriologjik pësoi disa ndryshime, që nga *Seksioni V* (biokimia) në *Seksionin N*, më 1929, dhe më pas u njoh si Departamenti i Nëntë. Ivan Mikhailovich Velikanov, një mikrobiolog brilant, u vendos fillimisht në IKhO. Me krijimin e Departamentit të Nëntë, lidhet ngushtë edhe emri i Efim Il'ich Demikhovskii, i cili u diplomua shkëlqyer në *Ekaterinoslav Medical Institute* (Dnepropetrovsk, Ukrainë), më 1925; drejtori i the *Institutit Krimeas Pasteur*. Një grup bakteriologësh nga ky institut u bënë më pas pjesë e programit ushtarak⁸⁴.

Faza tjetër e zgjerimit të programit sovjetik u zhvillua në kohën e dyshimeve të ndërsjellëta midis BRSS dhe Gjermanisë. Një ngjarje kryesore që mund të ketë qenë thelbësore në vendimmarrjen sovjetike, ishte marrja në vitin 1930, nga Voroshilov, komisar i popullit për çështjet ushtarake dhe detare dhe kryetari i Këshillit Ushtarak Revolucionar të BRSS-së, e një raporti të inteligjencës, i cili pretendonte se Gjermania po kryente zhvillimin e armëve bakteriale, të cilat ishin në fazën e testeve në terren⁸⁵.

Gjatë LIIB Stalini u detyrua që t'i zhvendoste bazat e laboratorët sekret të luftës biologjike për shkak të avancimeve gjermane. Gjithsesi, ata përdorën kundër trupave naziste bioarmë me tulareminë, më 1942, pranë Stalingradit. Pas LIIB programi pati vetëm rritje, derisa më 1973, u krijua *Biopreparat* ("Përgatitja e substancave biologjike"). Ky ishte një rrjet i gjerë laboratorësh sekretë, ushtarakësh, civilësh e shkencëtarësh me fokus kërkimi të bioagjentët. Personeli i tij shkonte deri në 30 mijë vetë. Ishte i lidhur me ministrinë kryesore, Akademinë e Shkencave etj. Ka qenë mohuar ekzistenca e tij me dekada, por një prej informuesve më të mëdhenj është koloneli Kanatzhan "Kanat" Alibekov ose Ken Abilek. Ai dezertoi dhe sot është në SHBA. Ka bërë edhe libra lidhur me historikun e zhvillimit të programeve sekrete të bioarmëve të ish-BRSS-së⁸⁶.

Kapacitetet ruse në këtë drejtim vazhdojnë të jenë ende të panjohura. Nuk është krejt rastësi krijimi i shpejtë dhe efikas i vaksinës ruse kundër COVID-19. Kjo gjë tregon aftësi në drejtim të përgjigjes ndaj një biokërcënimi.

5. KOVID-19, biosiguria dhe gjeopolitika

Më datë 31 dhjetor 2019, Kina do të informonte Organizatën Botërore të

⁸³ Anthony Rimmington, *Stalin's Secret Weapon, The Origins of Soviet Biological Warfare* (Oxford: Oxford University Press, 2018), 20.

⁸⁴ Rimmington, *Stalin's Secret Weapon*, 28.

⁸⁵ Rimmington, 39.

⁸⁶ Alibek, Ken dhe Stephen Handelman, *Biohazard: The Chilling True Story of the Largest Covert Biological Weapons Program in the World – Told from Inside by the Man Who Ran It* (Delta, 2000).

Shëndetësisë (OBSH) për disa raste pneumonie me origjinë të panjohur. E gjitha po ndodhte në provincën Hubei, në kryeqytetin e saj, Wuhan. Provat e mbledhura fillimisht, sugjeruan se shpërthimi i këtij infektimi vinte nga një treg prodhimesh deti në Wuhan, i cili u mbyll me 1 janar 2020. Agjenti shkaktar u deklarua të ishte një virus, që më pas u quajt *SARS-CoV-2.1*. Transmetimi i tij nga njeriu në njeri u konfirmua më 14 janar 2020, kohë në të cilën *SARSCoV-2* ishte përhapur tashmë në shumë vende në të gjithë botën. Më 11 mars 2020, iu transmetua gjithë botës e OBSH-së deklarata se COVID-19 ishte një pandemi dhe na përballte të gjithëve me një emergjencë të shëndetit publik që duhej përballuar në mënyrë ndërkombëtare. Më pas do të vijonte lufta e njerëzimit kundër këtij virusi. Dëmet ishin të mëdha: njerëzore, ekonomike, sociale, politike etj. Dhe vazhdojnë akoma të jenë.

Sipas OBSH-së (Organizata Botërore e Shëndetësisë), të dhënat e fundit në nivel botëror, deri në muajin qershor 2021, që lidhen me raportimet për koronavirusin janë si më poshtë⁸⁷:

- *rastet me KOVID-19, gjithsej:* 180 654 652;
- *rastet e raportuara rishtas, në 24 orët e fundit:* 360 668;
- *vdekjet, gjithsej:* 3 920 463;
- *vdekjet, raportuar rishtas në 24 orët e fundit:* 7 367.

Filloi ndërkohë edhe një luftë e pashembullt psikologjike, me tipare të operacioneve të informacionit, dezinformimit dhe operacioneve psikologjike (PSYOPS). Thelbi i kësaj luftë ishte gjetja e përgjigjeve mbi origjinën e virusit, mbi përfituesit, mbi manipuluesit botërorë, mbi zbardhjen e informacioneve shtetërore sekrete etj. Lajme të rreme, gjysmë të rreme dhe të vërteta të pabesueshme mbushën anekënd internetin dhe shoqëritë anembanë botës; dhe vijnë të gëlojnë ende. Disa prej atyre “zërave” që mund të përmendim në mënyrë të përmblodhur, janë: koronavirusin e kanë shpërndarë përmes pickimit të mushkonjave; koronavirusin e ka ndërtuar njeriu; ky virus u krijua në laboratorët e Kinës e SHBA-së që të përdorej si armë biologjike; mund të shpërndahet me postë, ose me paketat e blerjeve *online*; nuk mund të shpërhapet në zona me lagështi, me borë dhe në të ftohtë; edhe pse fataliteti i atyre që u infektuan ishte 2%, u fol gjerësisht se kush infektohet me këtë virus do të vdesë; të haje hudhra, të pije ujë çdo 15 minuta dhe të merrje vitaminë C, nuk infektoheshe me këtë virus; madje, qarkulluan edhe çmenduri që pohonin se urina e lopës ose e gamileve, përzier me limona, parandalonte infektimin nga virusi; teknologjia 5G ishte përgjegjëse për shpërhapjen e virusit, etj.

Por, anash këtyre lajmeve të rreme (*feik njuz*), a mund të jetë KOVID-19 një armë biologjike? A ka zëra ekspertësh që e pohojnë këtë gjë, apo është thjesht një fantazi qesharake? Ekzistojnë deklarata politikanësh nga shtete të zhvilluara që kanë akuzuar Kinën dhe anasjelltas për shpërndarje të qëllimshme të virusit (politikani kinez Zhao Lijian, nëndrejtori i Departamentit të Informacionit të Ministrisë kineze të Punëve të Jashtme, akuzoi me një deklaratë zyrtare SHBA-në se marinsat amerikanë kishin sjellë virusin në Kinë), fsheheje të së vërtetës, krijim arme biologjike, etj. Këtyre u shtohen edhe artikuj e deklarata ish-ushtarakësh apo ish-pjesëtarësh të shërbimeve inteligjente, ose edhe individësh aktivë në sektorët e sigurisë, që pohonin ekzistencën e një mundësie të fortë, se ky virus ishte krijuar në laborator.

Duke lënë mënjane zërat e politikanëve, duhet sjellë në vëmendje një deklaratë e

⁸⁷ WHO Coronavirus (COVID-19) Dashboard. Sipas të dhënave të rifreskuara në qershor 2021.
Burimi elektronik: <https://covid19.who.int/table>

fuqishme nga një emër shumë i njohur i shkencës. Profesori francez Luc Montagnier, fituesi i Çmimit Nobel të vitit 2008 për punën e tij mbi zbërthimin e kodeve të virusit HIV (AIDS-i), deklaroi në një intervistë të gjatë televizive në Francë, në vitin 2020 se koronavirusi ishte produkt i një pune njerëzore. Kjo deklaratë shkaktoi shumë zhurmë e madje u kërkua llogari për të edhe në seancat e Komisionit Evropian nga eurodeputetë:

“Profesori francez Luc Montagnier, fituesi i Çmimit Nobel të vitit 2008 për punën e tij mbi HIV-in si shkak i epidemisë së AIDS-it, argumenton se koronavirusi është një virus i manipuluar. Ai [Luc Montagnier] ka deklaruar se: *Ky virus është prodhuar nga një laborator. Ai është ajo që quhet një rikombinim; ndoshta, i prodhuar në ndonjë laborator kinez. Është një punë profesionistësh, biologësh molekularë; është puna sahatçinjsh. Ekziston një presion i pamasë që gjithçka e cila ka lidhje me origjinën e virusit të fshihet. I kërkohet Komisionit që t’u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme.*

1. A jeni në gjendje të sqaroni nëse koronavirusi është një virus natyror, rezultat i një gabimi në një laborator apo është një virus i krijuar nga njeriu?

2. A ka prova shkencore që konfirmojnë deklaratat e Montagnier-it?

3. A e ka nxitur [Komisioni] Kinën që të qartësojë në mënyrë të padyshimtë shkaqet e përhapjes së virusit?

Përgjigja e dhënë nga znj. Kyriakides, në emër të Komisionit Evropian, ishte se: *Nuk ka asnjë provë për të mbështetur pretendimin se virusi SARS-CoV-2 është rezultat i një manipulimi.*⁸⁸

Por teza e Montagnier ishte e qartë dhe e thjeshtë: SARS-CoV-2 ose i quajtur ndryshe KOVID-19, ishte bërë duke modifikuar kodet e virusit të SIDA-s⁸⁹. Dy elementë e bënë atë të besueshëm: e njëjti shumë mirë virusin e AIDS-it dhe ishte një virusolog i famshëm. Programet shtetërore të luftës biologjike, tashmë janë një realitet botëror prej një shekulli. Kështu që nuk ka asnjë habi po qe se kemi të bëjmë me një virus të krijuar. Niveli i sekretit që zbatojnë këto programe është ai më i larti; strategjitë e përdorura sot mund të jenë të ndryshme nga ato të menduarat për një përdorim masiv në luftë. Mjafton të shohësh dëmet dhe e kupton se nuk mungojnë interesat shtetërore pas një sulmi të supozuar nga një shtet i caktuar. Me gjithë dyshimet ekzistuese, ka ndodhur një shndërrim i madh: sapo është dhënë shembulli botëror me një provë të vërtetë, se si mund të jetë efekti i një pandemie globale. U tregua faqe gjithë njerëzimit se cilat janë pasojat. Edhe në mos qoftë e vërtetë se ky virus u ndërtua nga dora e njeriut, është e vërtetë ana tjetër: u dha një leksion përdorimi i një arme të tillë. Grupe të caktuara me interesa terroriste apo shtete të ndryshme, tashmë e kanë të qartë se ç’do të thotë ndikim i një arme biologjike me rrezikshmëri botërore.

Dhe, terrorizmi është tashmë një fenomen ekzistues. Me daljen e KOVID-19 në skenë u bëme botërisht të vetëdijshëm për fuqinë që kanë viruset nëse përdoren nga grupe të caktuara si armë biologjike; tashmë ndikimi i tyre mund të përlloratet më lehtësisht sepse koronavirusi na e dha këtë fushëpamje. Rreziku i dukshëm që paraqet terrorizmi ka gjasa që të bëhet edhe më i madh në të ardhmen e afërt, për shkak të qasjes së terrorizmit te një gamë e re e luftës: bioterrorizmi. Krahas bioterrorizmit, edhe

⁸⁸ Silvia Sardone, “Oggetto: Dichiarazioni del premio Nobel Montagnier sulle origini del coronavirus”, *Interrogazioni parlamentari*, 22 aprile 2020, *Interrogazione con richiesta di risposta scritta E-002429/2020 alla Commissione, Articolo 138 del regolamento*, (European Parliament, 2020).

Burimi elektronik: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-9-2020-002429_IT.html

⁸⁹ William Audureau, *Le coronavirus, fabriqué à partir du virus du sida ? La thèse très contestée du professeur Montagnier. Le Prix Nobel de médecine 2008 a repris à son compte une étude indienne déjugée, qui affirme que le SARS-CoV-2 a été manipulé en laboratoire*, (Le Monde, 17 avril 2020).

shtete e ndryshme ka të ngjarë që të zhvillojnë armë biologjike dhe të përparojnë në një drejtim të ri të konflikteve në arenën botërore Shtetet mund të operojnë përmes armëve të sofistikuara biologjike. Agjentët viralë janë të prirë ndaj ndryshimeve gjenetike dhe mutacionit, prandaj mund edhe të manipulohen ose krijohen në laborator për të marrë karakteristikat e dëshiruara. Ndryshimet e mëdha që solli COVID-19 treguan se një luftë e tillë, me armë biologjike mund të sjellë dëme të mëdha ekonomike, botërore edhe me pak investim. Nevojitet kështu një qasje e përgjithshme ndaj këtyre kërcënimeve të mundshme biologjike, që mund të prekin të gjithë kombet.

Në vitin 2020, Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikonte se gjatë dy viteve të ardhshme, rezultatet rritëse shkallë-shkallë të pandemisë mund të arrijnë në 9 trilionë dollarë. Organizata Ndërkombëtare e Punës vlerësoi se pandemia do të zhdukte 6.7 për qind të orëve të punës në të gjithë botën në tremujorin e dytë të vitit 2020 (ekuivalente kjo, me 195 milion punëtorë me orar të plotë pune). Sipas Programit Botëror të Ushqimit, ndikimi i mundshëm i virusit COVID-19 në sistemet ushqimore mund të bënte që më shumë se një e katërta e një miliardë njerëzve të vuanin nga uria akute, deri në fund të vitit 2020. Sipas UNESCO-s, më shumë se një miliard studentë në të gjithë botën kanë humbur pjesëmarrjen në universitete apo shkolla, në rreth 160 vende⁹⁰.

Nevojitet që të përmirësojmë mënyrën se si u jemi përgjigjur agjentëve të luftës biologjike dhe të mos qëndrojmë te qasjet e shkuara. Tashmë kjo luftë është një realitet. Pak rëndësi ka nëse është realitet i qëllimshëm, apo e gjitha ndodhi në mënyrë aksidentale: modeli i kësaj lufte u prezantua në terren. Për këtë arsye duhen ndërtuar strategji më të vlefshme parandalimi për të ardhmen.

6. Përfundime

Si përfundim duhet të kemi të qartë se biosiguria është një koncept që po merr përparësi ditët e sotme. Biosiguria lidhet me nivelin e sigurisë në të gjitha aspektet e jetës: nga bimët te njeriu. Rreziqet që kanë lidhje me biosigurinë do të bëhen më të mprehtë për shkak se teknologjia e sotme mundëson akoma më shumë modifikimet me bazë gjenetike, mbledhjen e të dhënave gjenetike, modifikimin e viruseve etj.

Krahas bioteknologjisë kemi nga ana tjetër edhe lëvizjen e lirë dhe zhdukjen e kufijve. Kjo gjë mundëson transmetimin e kollajshëm të viruseve nga një shtet në tjetrin, nga një rajon i botës në një tjetër. Prej dekadash është vënë alarmi nga studiues të virologjisë se bota është e kërcënuar nga shpërthimet e epidemive. Edhe megaurbanizimi është një faktor që i ndihmon këto shpërthime. Por mbi të gjitha ne nuk jemi të përgatitur që të trajtojmë këtë natyrë kërcënimi pasi e kemi lënë pas dore. Investimet e shteteve vazhdojnë të jenë peng i sigurisë kombëtare konvencionale dhe sektorët e sigurisë thithin më shumë investime se sa shkenca e mjekësisë, apo masat parandaluese për pandemitë. Nga ana tjetër këto bëjnë pjesë të kërcënimit botëror, ku edhe siguria kombëtare përfshihet në të. Kjo u vu re qartë gjatë pandemisë së COVID-19. Në periudhën e valës së parë tensionet mes shteteve Perëndimore u rritën, edhe pse kishim të bënim me shtete që ishin pjesë e BE-së apo e NATO-s. Mund të themi se biosiguria ishte ajo që po çalonte gjatë goditjes nga kjo pandemi.

Siguria biologjike, ose biosiguria nuk është e lehtë të përcaktohet dhe shkakton një larmi interpretimesh. Është e rëndësishme që të përcaktohet qartë kuptimi në të cilin

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹⁹⁰ Jha dhe Ratnabali, *Biological weapons*, 179.

përdoret termi. Në një kuptim të gjerë, ajo është një “qasje strategjike dhe e integruar, e cila përfshin politikën dhe kornizat rregulluese që analizojnë dhe menaxhojnë rreziqet në sektorët e sigurisë ushqimore, jetës dhe shëndetit të kafshëve, dhe jetës e shëndetit të bimëve, duke përfshirë edhe rrezikun mjedisor”⁹¹.

Gjithsesi, shëndeti dhe jeta e njerëzve, ose e shoqërisë, mbeten në majë të ruajtjes nga kërcënimet e mundshme të kësaj natyre. Po Shqipëria dhe shqiptarët a mund të preken nga kërcënime të tilla?

Biosiguria si koncept, dhe si një sërë praktikash e parimesh, përbëhet nga një tërësi e ndërlikuar elementesh. Nevojitet që ne si Shqipëri, të kemi një qartësi mbi aspektet e biosigurisë, mbi zbatimin e saj në shoqërinë shqiptare të ditëve moderne, e cila është pjesë e një rrjeti botëror tashmë; nevojitet që ne të dimë implikimet globale të biosigurisë, pasi ato do të ndikojnë patjetër në vendin tonë. Ajo që është më e rëndësishmja, nevojitet që të ndërtohen korniza mbi konceptet që lidhin e biosigurinë me shëndetin kombëtar, me mbrojtjen, me kërkimin shkencor dhe me bujqësinë e mjekësinë. Këto korniza duhen parë si hallka të së njëjtave korniza rajonale e botërore. Tërësia e këtyre elementëve duhet të realizohet nga agjenci të specializuara për sigurinë. Vetëm ato mund të bëjnë interpretimin e të dhënave. Pra nevojitet ndërtimi i institucioneve, strategjive e i një baze ligjore mbështetëse që të ndërtohet ky dimension i ri i sigurisë. Krahas këtyre, nevojitet edhe shpërndarja e informacionit publik dhe edukimi shoqëror lidhur me këto rreziqe.

Biosiguria, e ka rrënjën e fjalës *siguri* dhe në fjalorin e përditshëm gjeti përdorim më të gjerë pas sulmeve të 11 shtatori [shënim: letrat me antraks]⁹². Zhvillimi i politikave të biosigurisë lidhet me qasjen ndaje patogjeneve, menaxhimin e kërkimit me përdorim të dyfishtë dhe mbikëqyrjen e fushave në lindje e sipër, të tilla si gjenomika sintetike, e cila është ende në progres dhe ka të ngjarë të evoluojë në vitet e ardhshme. Ndryshimet në politikat e biosigurisë kanë mundësinë që të ndikojnë në vrullshëm mënyrën e kryerjes së kërkimit shkencor dhe ndarjen e fondeve. Është e domosdoshme që shkencëtarët të qëndrojnë të azhurnuar me legjislacionin aktual të sigurisë⁹³. Ky është një tregues i fortë se qasja kombëtare që duhet të ketë Shqipëria ndaj biosigurisë ka të bëjë me dy lëvizje. Së pari, duhet konsideruar shkenca si një kolonë mbështetëse e sigurisë kombëtare, pjesë e së cilës është edhe biosiguria. Për këtë arsye duhet investuar te shkenca si një investim që ka lidhje me çështjet e mbijetesës kombëtare. Së dyti, duhet që sektorë të ndryshëm të kërkimit shkencor shqiptar, të kenë aktivitete dhe koncepte që lidhen fushën e sigurisë. Në këtë mënyrë ata do të krijojnë një komunikim dhe një ndërveprim më të qartë me kolegët e tyre të fushës së sigurisë.

Ka edhe një shkallë tjetër të biosigurisë. Ajo lidhet me të ashtuquajturat “armë etnike”, “bioarmë etnike” ose “armë biogjenetike”. Ka një lloj biokërcënimi i cili lidhet me gjenetikën e një grupi të caktuar, të një popullsie ose kombi. Studiohet ADN-ja e një popullsie të caktuar dhe përpunohen viruse të cilët mund të godasin atë popullsi për shkak të gjeneve që ka. Kjo gjë është konsideruar thjesht teorike nga shumë analistë apo studiues. Por ekzistojnë mendimet e kundërta që mbështeten në argumente të bazuara mbi fakte.

⁹¹ Ryan N. Burnette, Jenna E. Hess, Joseph P. Kozlovac, and Jonathan Y. Richmond, “Defining Biosecurity and Related Concepts”, në: *Biosecurity: understanding, assessing, and preventing the threat*, red. Ryan Burdette (New Jersey: John Wiley&Sons, Inc., Hoboken, 2013), 3.

⁹² Ryan N. Burnette, “Defining Biosecurity”, 4.

⁹³ Gigi Kwik Gronvall, “Current Efforts to Fortify Biosecurity Policy in the U.S.”, në: *Biosecurity: understanding, assessing, and preventing the threat*, red. Ryan Burdette (New Jersey: John Wiley&Sons, Inc., Hoboken, 2013), 194.

“Bioteknologët mund të dizajnojnë dhe të ndërtojnë viruse nëpërmjet pjesëve të viruseve ekzistues dhe përmes tyre të bëjnë armë vdekjeprurëse. Ndoshta më shqetësueset janë ato që krijohen për të goditur një individ ose një grup të caktuar – të ashtuquajturat *sëmundje të dizajnuara*. Tucker-it, i kishte deklaruar Hazem Aliu, një virusolog me eksperiencë shumëvjeçare, që ishte i përfshirë në programin e armëve biologjike të Irakut, se kishin studiuar virusin *camel pox* si një *armë etnike* për shkak se arabët janë shumë të imunizuar ndaj këtij virusi që prek gamilet, meqenëse kanë jetuar gjatë me to; ndërsa Perëndimorët nuk kanë imunitet dhe preken lehtë nga kjo sëmundje”⁹⁴.

Kemi të bëjmë vetëm me një shembull se si gjenetika mund të ushqejë programet e luftës biologjike. Duhet të risjellim edhe një herë në kujtesë se këto programe janë programet më sekrete në botë dhe zhvillohen nga shtete të cilët kanë nivelin shkencor më të avancuar në botë. Kur i ka pasur Iraku si programe, merret me mend se ku mund të kenë arritur vendet e fuqishme.

Qeveria kineze po ndërton aktualisht bazën më të madhe në botë, të të dhënave të ADN-së; kjo është duke u drejtuar nga policia, në bashkëpunim të ngushtë me partnerë kryesorë të industrisë në të gjithë globin. Megjithatë, ndryshe nga menaxherët e bazave të të dhënave të tjera mjekoligjore, autoritetet kineze janë duke regjistruar qëllimisht dhjetëra milionë njerëz që nuk kanë ndonjë historik serioz veprimtarie kriminale. Këta individë (përfshirë edhe fëmijë të moshës parashkollore) nuk kanë asnjë kontroll mbi mënyrën se si mbliidhen, ruhen dhe përdoren mostrat e tyre. Ata nuk e kanë asnjë ide të qartë lidhur me ndonjë ngatërresë të mundshme të mbledhjes së ADN-së së tyre dhe të fiseve të tyre.

Fushatat e mëparshme të mbledhjes së ADN-së të qeverisë kineze kanë qenë të përqendruara në Tibet dhe Xinjiang, por, duke filluar nga fundi i vitit 2017, Ministria e Sigurisë Publike e zgjeroi fushatën në gjithë Kinën, duke synuar miliona burra e djem me qëllim të “përmirësimit të gjithanshëm të aftësisë së organeve të sigurisë publike për të zgjidhur çështjet, dhe për të menaxhuar e kontrolluar shoqërinë”⁹⁵.

Megjithatë, duhet përmendur se analizat e ADN-së për kriminalistikën, janë pjesë e metodave të hetimeve penale për më shumë se tre dekada në botë. Ka dhjetëra vende që zotërojnë baza të dhënash të ADN-së, të kërkueshme në mënyrë elektronike, që lejojnë policinë të krahasojë mostrat biologjike të gjetura gjatë hetimeve mjekoligjore, me profilet e ruajtura në ato baza të dhënash. As Kina nuk bën përjashtim nga këto metoda. Por, në vitin 2003, Ministria e Sigurisë Publike të Kinës filloi ndërtimin e bazës së të dhënave të veta ligjore të ADN-së. Ashtu si bazat e të dhënave të tjera, ajo përmblote mostra të marra nga autorë krimesh dhe nga të dyshuar. Sidoqoftë, që nga viti 2013, autoritetet kineze mbledhin mostra të ADN-së nga të gjitha bashkësitë e pakicave etnike dhe nga qytetarët e zakonshëm, të cilët nuk janë pjesë e ndonjë hetimi penal dhe mbi të gjitha, pa miratimin apo informimin e duhur. Baza e të dhënave gjenetike e qeverisë kineze ka të ngjarë të përmbajë më shumë se 100 milion profile, e ndoshta 140 milion, duke e bërë atë bazën më të madhe të të dhënave të ADN-së në botë; madje ajo vazhdon të rritet ende⁹⁶.

Ky është një program i madh i qeverisë kineze që ka lidhje me sigurinë dhe me

¹⁹⁴ Bradley A. Thayer, *Darwin and International Relations: On the Evolutionary Origins of War and Ethnic Conflict* (University Press of Kentucky, 2009), 198.

⁹⁵ Emile Dirks, James Leibold, “Genomic surveillance: Inside China’s DNA dragnet”, *Policy Brief Report No. 34/2020* (Australian Strategic Policy Institute, Jun. 1, 2020), 3.

⁹⁶ Dirks dhe Leibold, “Genomic surveillance”, 4

biovëzhgimin e popullsisë. Jo më kot janë mbledhur profilet e ADN-së së pothuajse gjithë popullsisë së Krahinës Autonome të Tibetit (rreth 3 milionë profile)⁹⁷. Studimi i cituar këtu (*Australian Strategic Policy Institute*, 2020) është studimi i vetëm i kësaj shkalle mbi këtë praktikë kineze. Burimet e përdorura janë burime të hapura. Por, sa profile ADN-je mund të mblidhen në mënyrë klandestine përditë në botë? Askush nuk mund të thotë me siguri së shtetet nuk i mbledhin të dhënat gjenetike të shtetasve të tyre apo të popullsisë mbi të cilat kanë interes. Natyrisht, kjo gjë përbën shkelje të së drejtave të njeriut, konventave ndërkombëtare etj. Të gjithë janë të vetëdijshëm se në çështjet e mbijetesës e të sigurisë, të drejtat janë shkelur përgjatë gjithë historisë. Teknologjia dhe natyra e re e kërcënimeve duhet të na alarmojë edhe neve si shtet, që të kthejmë sytë në këtë drejtim. Të dhënat biometrike mund të gërshetohen me elementë të biokërcënimeve. Mjafton të sjellim disa autorë dhe studime të ndryshme për të kuptuar se profilet gjenetike të kombeve janë të ndryshme nga njëri-tjetri. Vetvetiu, studimi i këtyre bazave gjenetike çon drejt njohurisë dhe përdorimit të saj për mbrojtje, duke zgjeruar kështu biosigurinë. Në vitin 1975 mikrobiologu shqiptar Luigi Benusi, arriti në përfundimin shkencor se populli shqiptar kishte një profil shpërndarjeje të llojeve të grupeve të gjakut të ndryshëm nga ai i popujve të tjerë të botës. Ky raport i ABO është tregues etnik. Ai përdori metodat shkencore statistikore e matematike të Brenstajnit, Konorskyt, Strengut, Mulekut, Ottenbergut. Benusi përdori një bazë të dhënash relativisht të madhe për nxjerrjen e përfundimeve. Popullsia arbëreshe e Italisë, po ashtu, tregon se e ka ruajtur tiparin gjenetik kombëtar; dallojnë nga italianët, kur përdoret metoda e krahasimit të grupeve të gjakut. Benusi këshillon në fund të kërkimit të tij, që këto hulumtime të zhvillohen më tej duke zgjeruar bazën e të dhënave. Kjo do të ndihmonte që të kuptoheshin më mirë edhe natyra e sëmundjeve të ndryshme që mund të prekin popullsinë shqiptare etj.⁹⁸




Figura 1: Grafiku Streng i bazuar në klasifikimin e propozuar nga Ottenberg. (Luigi Benusi, 1975). Sipas statistikave dhe llogaritjeve të grupeve të gjakut ABO jepet pozicionimi i etnive botërore. Shqiptarët gjenden pranë qendrës.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »

⁹⁷ Dirks dhe Leibold, 4.

⁹⁸ Luigi Benusi, *Grupet e gjakut: aspekte imunologjike, klinike, mjekoligjore dhe etnologjike në lidhje sidomos me popullin shqiptar* (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, 1975).

⁹⁹ American Society of Hematology. "Studies Offer New Evidence for Possible Link Between Blood Type and COVID-19 Susceptibility and Severity." *Hematology.org*. <https://www.hematology.org/newsroom/press-releases/2020/possible-link-between-blood-type-and-covid-19> (label-accessed June, 2021).

Vlen të përmendet këtu, se më 2020, Shoqata Amerikane e Hematologjisë, bëri një deklaratë bazuar në një studim të saj, se rrezikshmëria e infektimit nga KOVID-19 kishte gjasë që të ndikohej nga grupet e gjakut; sipas tyre, grupi i gjakut O ishte më pak i rrezikuar.⁹⁹ Por ruajtja e këtyre strukturave gjenetike te kombet është edhe më e vjetër se sa mund të mendohet. Një botim i cili synonte që të gjente rrënjët e popullsisë së lashtë indoevropiane, gërshetoi kërkimet gjenetike, arkeologjike, historike, arkeologjike etj. “Bashkëevolucioni i geneve dhe gjuhëve: origjina e indoevropianëve”¹⁰⁰ është një nga pjesët e këtij libri të një grupi shkencëtarësh seriozë¹⁰¹. Do i referohemi kësaj pjese për të parë vjetërsinë dhe veçantinë shqiptare. Autori, Alberto Piazza, është një profesor i gjenetikës njerëzore në Universitetin e Torinos. Sipas teorisë së Colin Renfrew, dëshmitë e gjuhës indoevropiane janë deri 9000 vjeçare.

“Problemi i origjinës së familjes gjuhësore indoevropiane dhe i popullsisë gjuhësisht indoevropiane, vitet e fundit, ka zgjuar interes shumë më të madh se sa në kohët e mëparshme, në njëfarë mase edhe falë librit të Colin Renfrew (1987), i cili sugjeroi se bujqit që filluan të përhapen 9000 vite më parë nga Anadoli, flisnin gjuhë indoevropiane. Në thelb, hipoteza e tij bazohej te treguesi, i paraqitur fillimisht nga Ammerman dhe Cavalli-Sforza (1984), sipas të cilit, përhapja e sistemeve neolitike të kultivimit nga *Gjysmëhëna Pjellore* i duhej atribuuar përhapjes së vetë fermerëve, e jo vetëm asaj të teknologjisë bujqësore; dhe, te konsiderata që popullatat që emigrojnë e ruajnë gjuhën e tyre sa më shumë të jetë e mundur”¹⁰².

Sipas analizave të kryqëzuara gjenetike, gjuhësore e historike, popullsia shqiptare rezulton të jetë përfaqësuesja më e vjetër e popullsisë që populluan Evropën në agimin e saj.

“Një analizë e re e çështjes paraqitet në një studim ende të pabotuar (Piazza et al., në shtyp) të një serie të dhënash leksikore (dyqind fjalë) të marra nga gjashtëdhjetë e tre gjuhë indoevropiane, botuar nga Dyen, Kraskal dhe Blek (Dajën, Kraskal, Black 1992). Duke filluar nga një matricë e largësisë gjuhësore, elementet e së cilës janë fraksioni i fjalëve me të njëjtën rrënjë leksikore për çdo çift gjuhësh, dhe nga transformimi i saj (i aftë për t'i bërë elementet e matricës proporcionale me kohën e diferencimit), kemi rindërtuar pemën gjuhësore, të treguar skematikisht në figurën 2. *Rrënja e pemës i ndan shqiptarët prej të tjerëve*, me një përqindje riprodhimi (besueshmëria për rindërtimin e pemës) prej 71 për qind. Dega e dytë më e vjetër është armenishtja. Interpretimi më i thjeshtë është se, *gjuha e fermerëve të hershëm emigrantë anadollas, mbijeton sot te dy pasardhëse të drejtpërdrejta: shqipja dhe armenishtja*. . .

. . . ekziston një korrelacion midis variabëlve gjenetikë dhe gjuhësorë, prej 69 për qind, i cili është statistikisht i rëndësishëm.”¹⁰³

⁹⁹ American Society of Hematology. “Studies Offer New Evidence for Possible Link Between Blood Type and COVID-19 Susceptibility and Severity.” *Hematology.org*.
<https://www.hematology.org/newsroom/press-releases/2020/possible-link-between-blood-type-and-covid-19>

¹⁰⁰ Alberto Piazza, “I geni e le lingue umane. Due alberi genealogici a confronto”, *Le radici prime dell'Europa; Gli intrecci genetici, linguistici, storici*, red. Gianluca Bocchi, Mauro Ceruti (Milano: Bruno Mondadori, 2001), 78-80.

¹⁰¹ Luigi Luca Cavalli-Sforza, Anthony Edwards, Albert J. Ammerman, Paolo Menozzi, A. Silvana Santachiara-Benerecetti, Alberto Piazza, Joan Marler, Colin Renfrew, James P. Mallory, Tamaz V. Gamkrelidze, Mario Alinei, Francisco Villar, Winfred P. Lehmann, Bernard Sergent, Merritt Ruhlen, Sergej Starostin, Giovanni Semerano, Martin Bernal, Walter Burkert, Emanuele Banfi, Antonio Pilati. Këta janë bashkëautorët e librit.

¹⁰² Alberto Piazza, “I geni e le lingue umane”, 79.

¹⁰³ Alberto Piazza, 79.

¹⁰⁴ Alberto Piazza, 80.


¹⁰⁵ Morral, N., Bertranpetit, J., Estivill, X. et al. “The origin of the major cystic fibrosis mutation (ΔF508) in European populations”. *Nature Genetics* 7, 169–175 (1994), 169.

¹⁰⁶ Morral, et al. “The origin of the major cystic fibrosis mutation”, 174.

¹⁰⁷ Aleksandër Dhima, *Antropologjia etnike e shqiptarëve* (Tiranë: UET Press, 2017).

¹⁰⁸ Morral, et al. “The origin of the major cystic fibrosis mutation”, 173.

Në figurën 2: Do të vihet re se disa gjuhë shfaqen dy ose tre herë, sepse u referohen varianteve dialektore ose sociogjuhësore të ndryshme. Për shembull, në rastin shqipe "I" ("Albanese I"), është gegërishtja (bashkësia e dialekteve veriore); shqipe "II" ("Albanese II"), është toskërishtja (bashkësia e dialekteve të jugut); shqipe "III" ("Albanese III"), është gjuha letrare kombëtare. Për detaje shih Dyen, Kruskal and Black (1992), Piazza et al.



Një kërkim tjetër shkencor që ka lidhje me veçantinë gjenetike të shqiptarëve, është ai që trajton alelin FC508 (aleli difektoz i Fibrozës Cistike/FC). Të dhëna mbi këtë alel që gjendet te më shumë se 60% e popullsisë shqiptare janë dhënë në studime të bëra nga Universiteti i Tiranës, Universiteti i Torinos etj. Me pak fjalë ky tipar gjenetik tregon se shqiptarët janë gjenetikiisht të ndryshëm nga pjesa tjetër e Evropës. Vetëm Shqiptarët dhe baskët e kanë alelin FC508 me shumicë. Kjo mund të shpjegohet me izolimin e këtyre dy popujve dhe ruajtjen e papërzierë që nga lashtësia.

FC508 është mutacioni më i shpeshtë i fibrozës cistike (FC) dhe llogaritet për afërsisht 70% të kromozomeve FC botës. Tri shënjes mikrosatelitë polimorfikë shumë të lartë janë përdorur për të studiuar origjinën dhe evolucionin e kromozomeve FC508 nëpër Evropë. Të dhënat e haplotipeve tregojnë se FC508 është zhvilluar më shumë se 52 000 vjet më parë, te një popullsi gjenetikiisht e ndryshme nga çdo grupim i veçantë evropian i sotëm dhe u shpërnda nëpër Evropë përmes ekspansioneve kronologjikiisht të ndara, të cilët janë përgjegjësit e frekuencave të ndryshme të FC508 në Evropë¹⁰⁵.

Figura 3. Prezantim UPGMA (metodë me kuptim matematikor) i nxjerrë nga frekuencat mikrosatelit të haplotipit të kromosomeve ΔF508 nga popullsitë evropiane. Shqipëria ka një nivel shumë të lartë të këtij aleli; kjo tregon veçantinë gjenetike të shqiptarëve: gjenetiksht të ndryshëm nga popujt e tjerë evropianë.¹⁰⁸

Ancestral population for ΔF508. Comparison of microsatellite haplotypes for ΔF508 and normal chromosomes has indicated that these two chromosome groups are genetically distant and therefore, that ΔF508 arose in a population with a different genetic background to that of the present European population. The high frequency of alleles 23 and 17 of IVS8CA, 31 and 32 of IVS17BTA, and 13 of IVS17BCA on ΔF508 chromosomes,




Fig. 3 UPGMA (unweighted pair group method with arithmetic mean) representation obtained from microsatellite haplotype frequencies of ΔF508 chromosomes from European populations.

Studimi i këtij grupi autorësh, vërteton se mutacioni FC508 ka një originë të vetme. Të dhënat e vlerësuar tregojnë se mutacioni FC508 ka ndodhur së paku 52 000 vjet më parë. Të dhënat mbi linjat qelizore limfoblastoide e kanë llogaritur shkallën e mutacionit të linjave terminale (mutacionet somatike të papërfshira) të jetë rreth 1.0×10^4 / locus / gamete. Duke marrë në konsideratë këtë shkallë, mosha e FC508 do të ishte rreth 173 000 vjet. Gjithsesi, ngjan se ky është një mbivlerësim, përderisa ky do e paraprinte/tejkalonte ekspansionin e njeriut modern, dhe nëse do të ishte kështu, mutacioni do të gjendej te i gjithë njerëzimi, pa kufizime racore e gjeografike. Skica e vërtetë për moshën e FC508 gjendet, me gjasë, ndërmjet këtyre dy vlerësimeve. Meqenëse ky mutacion llogaritet në 52 000 vjet, mund të ketë hyrë në Evropë me popullsitë e Paleolitit të lartë, para 40 000 vjetësh. Frekuenca relative e haplotipit 23-31-13 është e njëtrajtshme nëpër Evropë, me përjashtim të Shqipërisë dhe të Vendit Bask, me gjasë për shkak të kampioneve të pakta të ekzaminuara, ose, për shkak të efektit themelues [shënim A.H.: d.m.th. këta janë themeli i këtij haplotipi].¹⁰⁶

Ka edhe burime të tjera që flasin mbi veçoritë gjenetike e antropologjike të shqiptarëve. Një prej tyre është botimi i prof. dr. Aleksandër Dhima, i cili trajton me burime të bollshme edhe prekjen e viseve shqiptare nga epidemi të ndryshme, duke bërë një qasje te faktori etnik gjenetik. Edhe nga ana e antropologjisë fizike, shqiptarët reflektojnë veçantinë e tyre krahasuar me popujt e tjerë.¹⁰⁷

Për t'u rikthyer edhe një herë te lidhja që ekziston me biosigurinë, duhet theksuar fakti se veçoritë etnike nuk u sollën si studim mbi identitetin, por si elementë biologjikë të cilët mund të shfrytëzohen në raste të caktuara. Për këtë arsye, nisur nga situata botërore në zhvillim dhe nga treguesit që shfaqin fuqizimin e biokërcënimeve në të ardhmen, lind si nevojë emergjente që për këto kërkime të jepen fonde të veçanta, pasi janë të lidhur ngushtësisht me sigurinë kombëtare. Në epokën që sapo kemi hyrë bioteknologjia do të gërshtohet gjithnjë e më shumë me sektorin e sigurisë, deri sa ta mbizotërojë tërësisht këtë të fundit.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Bibliografi

1. United States Congress, House Committee on Foreign Affairs. *Chemical-biological Warfare: U.S. Policies and International Effects: Report ...*. Washington: U.S. Government Printing Office, 1970.
2. Under Secretary for Arms Control and International Security. *Protocol for the Prohibition of the Use in War of Asphyxiating, Poisonous or Other Gases, and of Bacteriological Methods of Warfare* (Geneva Protocol). Washington: Bureau of International Security and Nonproliferation, 2002.
Burimi elektronik: <https://2009-2017.state.gov/t/isn/4784.htm>
3. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë. *Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve: Raporti vjetor mbi kontrollin e eksporteve, 2013*. Tiranë: UNDP/SEESAC, 2013.
4. "Protokolli i Gjenevës (Protocol for the Prohibition of the Use in War of Asphyxiating, Poisonous or other Gases, and of Bacteriological Methods of Warfare), nënshkruar në Gjenevë, më 17 korrik 1925.
5. UN Department of Political and Security Council Affairs. *Chemical and bacteriological (biological) weapons and the effects of their use, Report of the Secretary-General* (UN Document A/7575/Rev1, No. E.69 I. 24, New York, 1969). Cituar në: U. C. Jha dhe K. Ratnabali. *Biological weapons. Coronavirus: Weapon of Mass Destruction?*. New Delhi: Vij Books India Pvt Ltd., 2020.
6. Guillemin, Jeanne. *Biological weapons: from the invention of state-sponsored programs to contemporary bioterrorism*. New York: Columbia University Press, 2005.
7. Jha, U. C. dhe K. Ratnabali. *Biological weapons. Coronavirus: Weapon of Mass Destruction?*. New Delhi: Vij Books India Pvt Ltd., 2020.
8. Akademia e Shkencave e RPSSH. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë : Akademia e Shkencave e RPSSH, 1980.
9. Harbourt, David E. et. al. "Biosafety". *Medical Aspects of Biological Warfare: Text Book of Military Medicine*, redaktuar nga Bozue Joel, Christopher K. Cote dhe Pamela J. Glass. Texas: Office of the Surgeon General: US Army Medical Department Centre and School, 2018.
10. Mayor, Adrienne. *Greek Fire, Poison Arrows Scorpion Bombs – Biological and Chemical Warfare in the Ancient World*. New York: Overlook Duckworth, 2009.
11. Elezi, Mehmet. *Fjalori i gjuhës shqipe*. Tiranë: Gjergj Fishta, 2006.
12. Frashëri, Naim. *Histori e Skënderbeut*, Veptra 3. Prishtinë: Rilindja, 1978.
13. Noli, Fan Stylian. *Historia e Skënderbeut: Gjergj Kastriotit, Mbretit të Shqipërisë, 1412-1468*. Boston: Shtypeshkronja e "Diellit", 1921.
14. Buda, Aleks, dhe Xhevat Lloshi, red. *Fjalor enciklopedik shqiptar*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1985.
15. Islami, Selim, dhe Kristo Frashëri, Aleks Buda, red., *Historia e popullit shqiptar, v. 1* (Tiranë: USHT, Instituti i Historisë e Gjuhësive, 1968).
16. Noli, Fan Stylian. *Gjergj Kastrioti Skenderbeu: 1468-1968*. Tiranë: Shtëpia botonjese "Naim Frashëri", 1967.
17. Licho, Edward A., red. *Gjergj Kastrioti Skenderbeu: 1468-1968*. New York: Pan-Albanian Federation of America Vatra, 1968.
18. United States Congress House. *Biotechnology and Technology Transfer: Hearing Before the Subcommittee on Technology and Competitiveness of the Committee on Science, Space, and Technology, U.S. House of Representatives, One Hundred Second Congress, First Session, May 6, 1991, Volume 4*. Washington: U.S. Government Printing Office, 1991.
19. L. Hoover, David, et. al. "Development of New Brucella Vaccines by Molecular Methods". *Brucella: Molecular & Cell Biol*, redaktuar nga Ignacio Lopez-Goni, Ignacio Moriyon. Oxfordshire: Taylor & Francis, 2005.
20. Balmer, Brian. *Britain and Biological Warfare: Expert Advice and Science Policy, 1930-65*. London: Palgrave, 2001.
21. Churchill, Winston. *The Second World War: The gathering storm, Volume 1*. Michigan: Houghton Mifflin, 1948.
22. Bliss, Michael. *Banting: A Biography*. Toront: University of Toronto Press, 1992.
23. Grenville, Anthony, dhe Andrea Reiter. *Political Exile and Exile Politics in Britain after 1933*. Leiden: BRILL, 2011.
24. Croddy, Eric, dhe Clarisa Perez-Armendariz, John Hart. *Chemical and Biological Warfare: A Comprehensive Survey for the Concerned Citizen*. Berlin: Springer Science & Business Media, 2002.
25. Sheldon H. Harris. *Factories of Death: Japanese Biological Warfare, 1932-45, and the American Cover-up* (Routledge, 2002).
26. Rimmington, Anthony. *Stalin's Secret Weapon, The Origins of Soviet Biological Warfare*. Oxford: Oxford University Press, 2018.
27. Alibek, Ken dhe Stephen Handelman. *Biohazard: The Chilling True Story of the Largest Covert Biological Weapons Program in the World – Told from Inside by the Man Who Ran It*. Delta, 2000.
28. WHO Coronavirus (COVID-19) Dashboard. Sipas të dhënave të rifreskuara në qershor 2021.
Burimi elektronik: <https://covid19.who.int/table>
29. Sardone, Silvia. "Oggetto: Dichiarazioni del premio Nobel Montagnier sulle origini del coronavirus", *Interrogazioni parlamentari, 22 aprile 2020, Interrogazione con richiesta di risposta scritta E-002429/2020 alla Commissione, Articolo 138 del regolamento*. European Parliament, 2020.
Burimi elektronik: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-9-2020-002429_IT.html

30. Audureau, William. *Le coronavirus, fabriqué à partir du virus du sida ? La thèse très contestée du professeur Montagnier. Le Prix Nobel de médecine 2008 a repris à son compte une étude indienne déjugée, qui affirme que le SARS-CoV-2 a été manipulé en laboratoire.* Paris: Le Monde, 17 avril 2020.
31. Burnette, Ryan N., et. Al. "Defining Biosecurity and Related Concepts". *Biosecurity: understanding, assessing, and preventing the threat*, red. Ryan Burdette. New Jersey: John Wiley&Sons, Inc., Hoboken, 2013.
32. Gronvall, Gigi Kwik. "Current Efforts to Fortify Biosecurity Policy in the U.S.". *Biosecurity: understanding, assessing, and preventing the threat*, red. Ryan Burdette. New Jersey: John Wiley&Sons, Inc., Hoboken, 2013.
33. Thayer, Bradley A. *Darwin and International Relations: On the Evolutionary Origins of War and Ethnic Conflict.* University Press of Kentucky, 2009.
34. Dirks, Emile, James Leibold. "Genomic surveillance: Inside China's DNA dragnet". *Policy Brief Report No. 34/2020.* Australian Strategic Policy Institute, Jun. 1, 2020.
35. Benusi, Luigi. *Grupet e gjakut: aspekte imunologjike, klinike, mjekoligjore dhe etnologjike në lidhje sidomos me popullin shqiptar.* Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, 1975.
36. American Society of Hematology. "Studies Offer New Evidence for Possible Link Between Blood Type and COVID-19 Susceptibility and Severity." *Hematology.org*.
<https://www.hematology.org/newsroom/press-releases/2020/possible-link-between-blood-type-and-covid-19>.
37. Piazza, Alberto. "I geni e le lingue umane. Due alberi genealogici a confronto". *Le radici prime dell'Europa; Gli intrecci genetici, linguistici, storici*, redaktuar nga Gianluca Bocchi, Mauro Ceruti. Milano: Bruno Mondadori, 2001.
38. Morral, N., Bertranpetit, J., Estivill, X. et al. "The origin of the major cystic fibrosis mutation (ΔF508) in European populations". *Nature Genetics* 7, 169–175 (1994).
39. Dhima, Aleksandër. *Antropologjia etnike e shqiptarëve.* Tiranë: UET Press, 2017.